

Thesari i lutjeve

Hafiz M. A.



Thesari i lutjeve

Lutjet e Kuranit

Lutjet e Profetit Muhammed^{sas}

Lutjet e Mesihut të Premtuar^{as}

Hafiz M. A.

Tiranë, 2016

Thesari i lutjeve

Autor: *Hafiz M. A.*

(Albanian translation of “*Khazeenatud-Duaa*”, “*Treasure of Prayers*”)

Botimi i fundit (i pestë) në gjuhën urdu: “*Khazeenatud-Duaa*”, 2014

Botimi i parë në shqip: 2016

© Islam International Publications Limited

E përktheu nga origjinali: Samad Ghori

Redaktore gjuhësore: Sevi Agolli

Redaktor shkencor: Bekim Bici

Botues:

Islam International Publications Ltd.

Islamabad, Sheephatch Lane,

Tilford, Surrey GU10 2AQ, UK

Faqosja: Kudsia Ghori

Dizajni: Petani Design, Tiranë

U shtyp në shtypshkronjën: *Gent.grafik, Tiranë*

ISBN: 978-1-84880-258-2

Pëmbajtja

| | |
|-----------------|----|
| Parathënie..... | 15 |
|-----------------|----|

PJESA I - Lutjet e Kuranit Famëlartë.....17

| | |
|---|----|
| Parathënie..... | 19 |
| 1. Lutja e përsosur..... | 21 |
| 2. Lutje për të dëshmuar besimin dhe për të kërkuar dëlirësinë..... | 22 |
| 3. Dëshmia e besimit dhe e veprimit dhe lutja që ata të pranohen..... | 22 |
| 4. Lutje e Ibrahimit ^{as} për të gjetur mbështetje te Zoti..... | 23 |
| 5. Lutje për të kërkuar të mirat e botës dhe të ahiretit..... | 23 |
| 6. Lutje për të kërkuar mirësitë e botës dhe të ahiretit..... | 24 |
| 7. Lutje për të kërkuar mbrojtje nga nxitjet e shejtanit..... | 24 |
| 8. Lutje për të qëndruar gjithmonë në udhë të drejtë..... | 24 |
| 9. Lutje për të pasur qëndrueshmërinë dhe ndihmën kundër mohuesve..... | 25 |
| 10. Lutje për të shpëtuar nga ndëshkimi i Zotit dhe nga poshtërimi në ditën e kiametit dhe për të pasur faljen, fundin e mirë dhe përmbushjen e premtimit të Zotit..... | 25 |
| 11. | 26 |
| 12..... | 27 |
| 13. Lutje e përsosur për të kërkuar falje, mëshirë dhe ndihmën kundër armiqve..... | 27 |
| 14. | 28 |
| 15. Lutje për të kërkuar qëndrueshmërinë dhe fundin e mbarë..... | 28 |
| 16. Lutje për të kërkuar faljen e mëkateve dhe për të shpëtuar nga ndëshkimi i Zotit..... | 29 |
| 17. Lutje për të kërkuar falje për grynahet, teprimin dhe për të kërkuar qëndrueshmërinë..... | 29 |
| 18. Lutje për të kërkuar mëshirë dhe falje..... | 30 |
| 19. Lutje për të kërkuar falje e mëshirë kur nuk je i vetëdijshëm..... | 30 |
| 20. Lutje për të shpëtuar nga vështirësitë..... | 30 |

| | |
|--|----|
| 21. Lutje për të pasur forcë që të luftosh me të keqen..... | 31 |
| 22. Lutje për të gjetur shërim nga sëmundja..... | 31 |
| 23. Lutje për të kërkuar falje e mëshirë duke e pranuar Zotin si mbrojtës..... | 32 |
| 24. Lutje për të kërkuar falje, duke pranuar fajin..... | 32 |
| Lutje të ndryshme për të kërkuar falje dhe mëshirë..... | 33 |
| 25. | 33 |
| 26. | 33 |
| 27. Lutje për të kërkuar falje për popullin e humbur..... | 33 |
| 28. Lutje për të shpëtuar nga ndëshkimi i xhehenemit..... | 34 |
| 29. Lutje për të kërkuar falje dhe për t'u mbrojtur nga zilia..... | 34 |
| 30. Lutje për të kërkuar mëshirë dhe falje..... | 35 |
| 31. Lutje e përvulur e engjëjve <i>arsh</i> -mbartës për besimtarët e sinqertë..... | 36 |
| 32. Lutje e bashkëshortes së shtypur në rrugën e Allahut për të shpëtuar nga bashkëshorti mizor..... | 37 |
| 33. Lutje për të mos u përfshirë në mizori..... | 38 |
| 34. Lutje për të shpëtuar nga trazirat e popullit mizor..... | 38 |
| 35. Lutje për të shpëtuar nga banorët mizorë të një qyteti dhe për të gjetur mundësinë e mërgimit..... | 39 |
| 36. Lutje për të mos qenë mizor pas marrjes së pushtetit..... | 39 |
| 37. Lutje për të përparuar në dije..... | 40 |
| 38. Lutje për të kërkuar kthjelltësinë në shpirt, lehtësinë në punë dhe ndikimin në gjuhë..... | 40 |
| 39. Lutje për të kërkuar përparime shpirtërore dhe faljen e Zotit..... | 40 |
| 40. Lutje për të kërkuar vdekje gjatë besimit dhe për të pasur fund të mbarë..... | 41 |
| 41. Lutje e përvulur për të kërkuar mirësi..... | 41 |
| 42. Lutje për të kërkuar riskun dhe paqen..... | 42 |
| 43. Lutje për kërkuar të mira materiale dhe shpirtërore për fëmijët..... | 42 |
| 44. | 43 |
| 45. Një lutje e dishepujve të Hazret Isait ^{as} | 43 |
| 46. Lutje për të gjetur fuqinë, riskun dhe për të shlyer borxhet..... | 44 |
| 47. Lutje për të kërkuar vendimin dhe fitoren prej Zotit..... | 45 |
| 48. Lutje për të kërkuar ndihmë kur pushtoheni nga të tjerët..... | 45 |

| | |
|---|----|
| 49. Lutje për të kërkuar shenjë vendimtare..... | 46 |
| 50. Lutje për mohuesit dhe përgënjeshtuesit..... | 46 |
| 51. Lutje për të kërkuar falje për veten, për prindërit dhe për besimtarët..... | 47 |
| 52. Lutje për udhëzimin e njerëzve..... | 47 |
| 53. Lutje për të ndëshkuar armiqtë..... | 48 |
| 54. Lutje për të kërkuar ndihmë kundër popullit keqbërës..... | 48 |
| 55. Lutje për të shpëtuar nga ndikimet e popullit keqbërës..... | 49 |
| 56. Lutje për të kërkuar shenjë kundër popullit mohues..... | 49 |
| 57. Lutja e Hazret Musait për t'u treguar mirënjohës ndaj Zotit dhe për t'u distancuar nga të padrejtët..... | 50 |
| 58. Lutje për të kërkuar gjykim..... | 50 |
| 59. Lutje për të kërkuar mëshirë dhe lehtësim në punë..... | 50 |
| 60. Lutje për të kërkuar pasardhës të dëlirë..... | 51 |
| 61. Lutje për të kërkuar fëmijë të nënshtruar dhe adhurues të Zotit..... | 51 |
| 62. Lutje për veten e për fëmijët, që të bëhen adhurues të Zotit dhe për të kërkuar falje për veten, për prindërit dhe për të gjithë besimtarët..... | 52 |
| 63. Lutje për të kërkuar aftësinë e vendimmarrjes, sinqeritetin, emër të mirë dhe xhenetin..... | 52 |
| 64. Lutje për të pasur pushtet dhe forcë të jashtëzakonshme..... | 53 |
| 65. Lutje për të falënderuar Zotin, për të kërkuar mundësinë e veprave të mira dhe pasardhës të dëlirë..... | 54 |
| 66. Edhe një lutje tjetër për të falënderuar Zotin dhe për të kërkuar sinqeritet..... | 54 |
| 67. Lutje për të kërkuar fëmijë të dëlirë..... | 55 |
| 68. Lutje për të kërkuar fëmijë në moshë të thyer..... | 55 |
| 69. Lutje për të shpëtuar nga vetmia dhe për të pasur trashëgimtarë të denjë..... | 56 |
| 70. Lutje për të kërkuar bashkëshorte e fëmijë të dëlirë dhe për t'u bërë model i mirë për ta..... | 56 |
| 71. Lutje për të kërkuar mëshirë për prindërit, për shkak të mirësive të tyre..... | 57 |
| 72. Lutje për të hipur në anije..... | 57 |
| 73. Lutje tjetër për të hipur në anije..... | 57 |
| 74. Lutje për të hipur në një mjet udhëtimi..... | 58 |
| 75. Besimi në madhësitinë absolute të Zotit dhe në premtimet e Tij..... | 58 |

| | |
|---|----|
| 76. Lutje për të pasur fillim dhe fund të mbarë dhe ndihmë të veçantë nga Zoti..... | 59 |
| 77. Lutje që veprat të kenë vlerë..... | 59 |
| 78. Lutje për t'u dërguar paqe njerëzve të zgjedhur të Zotit..... | 60 |
| 79. Lutje për t'u kthyer tek Allahu dhe për të treguar besim të përsosur..... | 60 |
| 80. Lutje për ta pasur Zotin të mjaftueshëm..... | 61 |
| 81. Lutje për të kërkuar vendim hyjnor..... | 61 |
| 82. Lutje për të pasur ndihmën hyjnore gjatë kundërshtimit nga populli..... | 62 |
| 83. Shfaqja e besimit kur i dëgjon premtimet hyjnore..... | 62 |
| 84. Lutje që duhet bërë në mëngjes e në mbrëmje për të shlyer gabimet..... | 62 |
| 85. Lutje e besimtarëve kur janë në vështirësi..... | 63 |
| 86. Lutje për t'ia dedikuar fëmijën Zotit..... | 64 |
| 87. Lutje e robërve të Zotit përballë përbuzjes së përgënjeshtresve..... | 64 |
| 88. Lutje që duhet bërë në mëngjes e në mbrëmje për të larguar brengat..... | 65 |
| 89. Lutje për të pasur mbrojtjen e Zotit nga çdo e keqe..... | 65 |
| 89. Surja <i>El-IKHLAS</i> | 66 |
| 90. Surja <i>El-Felek</i> | 66 |
| 91. Surja <i>En-Nas</i> | 67 |
| 92. Një lutje e bukur për pranimin e adhurimeve dhe lutjeve..... | 67 |

PJESA II - Lutjet dhe përgjërimet e Profetit Muhammed^{sas}69

| | |
|--|----|
| Parathënie..... | 71 |
| Lutje për të kërkuar bekimet e Zotit në synime e në vepra..... | 74 |
| Lutje për të gjetur dashurinë e Zotit | 74 |
| Një lutje e Hazret Daudit ^{as} | 74 |
| Lutje për të shkuar në banjë..... | 75 |
| Lutje për të dalë nga banja..... | 75 |
| Lutje për abdes..... | 76 |
| Lutje gjatë azanit..... | 76 |
| Lutje pas azanit..... | 77 |
| Lutje kur del nga shtëpia për namaz..... | 77 |

| | |
|---|-----|
| Lutje për të shkuar në xhami..... | 78 |
| Lutje kur hyn në xhami..... | 79 |
| Lutje kur del nga xhamia..... | 79 |
| Lutje të ndryshme për të filluar namazin..... | 79 |
| Lutje të ndryshme në <i>rûku</i> | 81 |
| Lutje gjatë qëndrimit (<i>kijamit</i>) pas <i>rûkusë</i> | 83 |
| Lutje të ndryshme në sexhde..... | 84 |
| Lutje midis dy sexhdeve..... | 86 |
| Lutje në <i>teshehud</i> | 86 |
| Salavatet | 87 |
| Lutje për të kërkuar të mirat e botës dhe të besimit..... | 88 |
| Lutje për të kërkuar mbrojtje nga ndëshkimi i varrit dhe nga fatkeqësitë e tjera..... | 88 |
| Edhe një lutje tjetër e përsosur..... | 89 |
| Lutje të ndryshme në namazin e <i>tehexhudit</i> | 90 |
| Lutja e <i>kunutit</i> | 95 |
| Lutje pas dhënies së selamit nga namazi..... | 97 |
| Madhërimi e lavdërimi (<i>tesbihu e tahmidi</i>)..... | 98 |
| Lutje për të pasur emocione në lutje..... | 100 |
| Lutje të ndryshme pas namazit..... | 101 |
| Namazi dhe lutja kur je në nevojë..... | 104 |
| <i>Istihara</i> - namazi dhe lutje për të kërkuar mirësi në çështje të caktuara..... | 105 |
| Namazi i <i>tesbihut</i> | 106 |
| Lutje të ndryshme të përditshmërisë..... | 107 |
| Lutje gjatë recitimit të Kuranit Famëlartë..... | 109 |
| Lutje gjatë sexhdes së recitimit të Kuranit..... | 114 |
| Lutje për mbarimin e recitimit të Kuranit..... | 115 |
| Lutje kur sheh hënën e re..... | 116 |
| Lutje për të çelur agjërimin..... | 116 |
| Lutje për Natën e Kadrit..... | 117 |
| Lutje telbija gjatë ihramit..... | 117 |
| Lutje kur sheh Qaben, Shtëpinë e Allahut..... | 118 |
| Lutje për të bërë tevfat rreth Qabes..... | 118 |

| | |
|--|-----|
| Lutje gjatë ecjes midis kodrave Safa dhe Marva..... | 119 |
| Lutje në kodrën Safa..... | 119 |
| Një lutje shumë e përlurur dhe përgjëruese në fushën e Arafatit..... | 120 |
| Lutje e ditës së kurbanit..... | 121 |
| Lutje gjatë hedhjes së gurëve, gjatë haxhit..... | 121 |
| <i>Tekbiret</i> e bajrameve..... | 122 |
| Lutjet e Bajramit..... | 123 |
| Hytbja e së premtes dhe e Bajramit..... | 124 |
| Hytbja e <i>nikahut</i> (martesës)..... | 125 |
| Hytbja e dytë..... | 127 |
| Lutje për haxhinjtë e Shtëpisë së Allahut..... | 128 |
| Lutje gjatë kthimit nga Qabja, Shtëpia e Allahut..... | 128 |
| Lutje të ndryshme për të ngrënë bukë..... | 123 |
| Lutje për të ngrënë bukë kur je i ftuar diku..... | 131 |
| Lutje kur pi qumësht..... | 131 |
| Lutje kur vesh rroba të reja..... | 132 |
| Lutje kur shihesh në pasqyrë..... | 133 |
| Lutje kur del nga shtëpia..... | 133 |
| Lutje për të hyrë në shtëpi..... | 134 |
| Lutje për të dalë në pazar..... | 134 |
| Lutje të ndryshme për udhëtim..... | 135 |
| Lutje për të hipur në mjet transporti..... | 136 |
| Lutje për t'u mbrojtur nga e keqja në udhëtim..... | 136 |
| Lutje gjatë natës së tmerrshme gjatë udhëtimit..... | 136 |
| Lutje gjatë ngjitjes në lartësi..... | 137 |
| Lutje kur shkon në luftë..... | 137 |
| Lutje e lamtumirës..... | 138 |
| Lutje për të hyrë në fshat a qytet të ri..... | 138 |
| Lutje të ndryshme të mëngjesit e të mbrëmjes..... | 139 |
| Kryelutje për të kërkuar falje..... | 146 |
| Lutje për t'u mbrojtur nga e keqja e kohës dhe e fqinjit..... | 146 |
| Lutje për të kërkuar shi..... | 147 |
| Namazi për të kërkuar shi..... | 147 |

Përmbajtja

| | |
|--|------------|
| Lutje për të shpëtuar nga zemërimi i Zotit gjatë vetëtimës..... | 148 |
| Lutje për t'u mbrojtur nga shtrëngata..... | 148 |
| Lutje për t'u mbrojtur nga përmytjet..... | 149 |
| Lutje të ndryshme para gjumit..... | 149 |
| Lutje të ndryshme kur zgjohesh nga gjumi..... | 153 |
| Lutje për të larguar pagjumësinë..... | 154 |
| Lutje kur trembesh në ëndërr..... | 154 |
| Lutje për çiftin e sapomartuar..... | 155 |
| Lutje para se të kryhen marrëdhëniet bashkëshortore..... | 156 |
| Lutje për të kërkuar ndihmë gjatë agonisë së vdekjes..... | 156 |
| Lutje në momentin e vdekjes..... | 156 |
| Lutje për të pasur shpërblim të mirë gjatë vështirësisë..... | 157 |
| Lutja e namazit të xhenazes..... | 157 |
| Lutje e xhenazes së të miturit..... | 158 |
| Lutje kur varros të vdekurin..... | 159 |
| Lutje kur viziton varrezën..... | 159 |
| Lutje të ndryshme të përsosura të Profetit Muhammed^{sas} | 161 |
| Lutje për të kërkuar rrugën e drejtë..... | 162 |
| Lutje për qëndrueshmërinë në zemër..... | 162 |
| Lutje për t'iu mbështetur tërësisht Zotit të Madhërishëm..... | 162 |
| Lutje për t'u përmirësuar shpirtërisht dhe materialisht..... | 163 |
| Lutje për të pasur mirësi në botë dhe në ahiret..... | 164 |
| Lutje për të pasur mbrojtjen e Allahut..... | 164 |
| Lutje për të pasur <i>takvanë</i> dhe dëlirësinë..... | 166 |
| Lutje për të pasur druajtjen dhe vetëmjaftueshmërinë..... | 166 |
| Lutje për t'u bërë njeri i përshpirtshëm..... | 166 |
| Lutje për të pasur dëlirësinë..... | 167 |
| Lutje për të pasur shëndet dhe siguri..... | 167 |
| Lutje për të shpëtuar nga ndikimi i ogurit të keq..... | 168 |
| Lutje kur hasni diçka të pakëndshme..... | 168 |
| Lutje për të kërkuar bekime..... | 169 |

| | |
|--|-----|
| Lutje për të gjetur frikën dhe besimin e përsosur ndaj Zotit..... | 169 |
| Lutje për të pasur bereqet në risk..... | 170 |
| Lutje për të pasur bereqet në risk gjatë pleqërisë..... | 170 |
| Lutje për të pasur bereqet në të vjela e të lashta..... | 171 |
| Lutje për të kërkuar mundësinë e të vepruarit dhe të të falënderuarit..... | 171 |
| Një lutje e përsosur..... | 171 |
| Lutje për të kërkuar dije të dobishme..... | 172 |
| Mënyra dhe lutja për të mësuar Kuranin përmendsh..... | 173 |
| Një lutje e përsosur për të kërkuar çdo të mirë dhe për t'u mbrojtur nga çdo e keqe..... | 175 |
| Lutje për të kërkuar nivele të larta shpirtërore..... | 176 |
| Lutje për të kërkuar dëlirësinë së jashtmi dhe së brendshmi..... | 177 |
| Lutje të ndryshme për të larë borxhet dhe për t'u larguar nga veset..... | 178 |
| Lutje për t'u çliruar nga borxhet..... | 179 |
| Lutje për t'u larguar nga borxhet dhe për të pasur vetëmjaftueshmëri..... | 179 |
| Lutje për të sëmurin..... | 180 |
| Të fryrët gjatë sëmundjes..... | 181 |
| Lutje për t'u shëruar nga temperatura..... | 181 |
| Lutje gjatë dhimbjes..... | 181 |
| Lutje për t'u shëruar nga bllokimi i urinës..... | 182 |
| Lutje për të rifituar shikimin..... | 182 |
| Lutje për të shpëtuar nga sëmundjet e jashtme e të brendshme..... | 183 |
| Lutje për t'u mbrojtur nga syri i keq..... | 184 |
| Lutja e hallexhiut..... | 184 |
| Lutja e atij që shikon një hallexhi..... | 185 |
| Lutje gjatë sprovës..... | 185 |
| Lutje të ndryshme gjatë shqetësimeve e vështirësive..... | 185 |
| Lutje për t'u liruar nga brengat dhe për të pasur dashurinë ndaj Kuranit..... | 186 |
| Lutje në kohë të vështirë..... | 187 |
| Lutje për mbrojtjen e Islamit dhe për të kërkuar mirësi..... | 189 |
| Lutje për besim, shëndet dhe virtyte të larta..... | 190 |
| Lutje për të kërkuar falje dhe mëshirë..... | 190 |
| Një lutje me shumë ndikim për të kërkuar falje..... | 191 |

| | |
|---|-----|
| Një lutje shumë e bukur për të kërkuar falje për mëkatet..... | 191 |
| Lutje për mëshirë dhe falje..... | 192 |
| Lutje për të kërkuar falje..... | 192 |
| Lutje për të shpëtuar nga e keqja..... | 193 |
| Lutje për të shpëtuar nga ndikimet e shejtanit..... | 194 |
| Lutje për të shpëtuar nga e keqja e armikut..... | 195 |
| Lutje për të shpëtuar nga veset..... | 195 |
| Një lutje e veçantë..... | 196 |
| Lutje për të kërkuar mirësi dhe për t'u mbrojtur nga të këqijat..... | 197 |
| Lutje për t'u ruajtur nga <i>shirku</i> | 198 |
| Lutje për të shpëtuar nga zemërimi i Zotit..... | 198 |
| Një lutje e përsosur për të hyrë në mbrojtjen e Zotit..... | 199 |
| Lutje për t'u mbrojtur nga veset..... | 199 |
| Lutje për t'u mbrojtur nga veset..... | 200 |
| Lutje për të shpëtuar nga aksidentet..... | 200 |
| Lutje për t'u mbrojtur nga uria dhe mashtrimi..... | 200 |
| Lutje për umetin për udhëtimet në mëngjes..... | 201 |
| Lutje për të kërkuar falje për muhaxhirët (mekasit) dhe për ensarët (medinasit)..... | 201 |
| Lutje për mposhtjen e armikut në betejën e Hendekut..... | 201 |
| Lutje për ushqimin e familjes së Profetit dhe të umetit..... | 202 |
| Lutje në mbështetje të kalifëve dhe udhëheqësve të umetit..... | 202 |
| Lutje përgjëruese e Profetit Muhammed ^{sas} gjatë udhëtimit për në Taif..... | 203 |
| Një lutje e çuditshme për të qenë i varfër..... | 204 |
| Lutje për t'u bërë rob i veçantë i Zotit të Madhërishtëm..... | 204 |
| Lutje duke përmendur emrin më të bekuar të Zotit të Madhërishtëm..... | 205 |
| Një lutje e përsosur..... | 205 |
| Lutje që bëhet në momentin kur pranohet lutja..... | 206 |
| Lutje për të pasur përfundim të mirë..... | 206 |
| Emrat e bukur të Allahut dhe pranimi i lutjes..... | 207 |
| Lutje për mbarimin e recitimit të Kuranit Famëlartë..... | 210 |

| | |
|---|------------|
| PJESA III - Lutjet e Imam Mehdiut, Mesihut të Premtuar^{as} | 211 |
| Parathënie..... | 214 |
| Realiteti i lutjes, rëndësia dhe bekimet e saj..... | 218 |
| Parimet e lutjes..... | 224 |
| Shembulli i Hazret Mesihut të Premtuar ^{as} në lutje..... | 230 |
| Lutje me pasion | 230 |
| El-Fatiha në fillim të lutjes..... | 230 |
| Lutje për udhëzimin e botës..... | 231 |
| Lutje për t'u pastruar nga mëkatet..... | 231 |
| Lutje për miqtë..... | 231 |
| Lutje për armikun..... | 233 |
| Lutje për besimin..... | 233 |
| Lutje për fëmijët dhe bashkëshorten..... | 233 |
| Lutja më e dobishme..... | 234 |
| Lutje për të kërkuar pëlqimin e Zotit..... | 234 |
| Lutja e përditshme e Hazret Mesihut të Premtuar ^{as} | 235 |
| Shpalljet e Hazret Mesihut të Premtuar ^{as} rreth pranimit të lutjes..... | 235 |
| Ngjarje besimshtytëse të Mesihut të Premtuar ^{as} rreth pranimit të lutjeve..... | 237 |
| Lutjet e Imam Mehdiut, Mesihut të Premtuar ^{as} | 246 |
| Një lutje e përrulur për të kërkuar faljen e mëkateve..... | 246 |
| Disa lutje të tjera për shpëtimin nga mëkatet..... | 247 |
| Lutja e pendesës gjatë <i>bejt</i> it (besëlidhjes)..... | 247 |
| Lutje për të kërkuar pëlqimin e Zotit..... | 249 |
| Lutja e vetmisë për të pasur shoqërinë e Zotit..... | 250 |
| Lutje për të pasur përqendrim në namaz..... | 250 |
| Lutje për të shpëtuar nga mosagjërimi në muajin e Ramazanit..... | 251 |
| Lutje për të bërë në Qabe..... | 251 |
| Lutje për të varrosurit në <i>Bahishti Makberah</i> | 253 |
| Lutje për xhematin e tij..... | 254 |
| Lutje për përparimin e xhematit Ahmedia..... | 254 |
| Lutje për kundërshtarët..... | 255 |
| Lutje për vendosjen e njëshmërisë së Zotit në të gjithë botën..... | 257 |

| | |
|--|-----|
| Lutje për udhëzimin e njerëzimit..... | 257 |
| Lutje për pjesëmarrësit në <i>Xhelsa Salana</i> | 258 |
| Udhëzime të Hazret Mesihut të Premtuar ^{as} rreth disa lutjeve të Kuranit..... | 260 |
| Lutjet e Kuranit që iu shpallën Hazret Mesihut të Premtuar ^{as} | 262 |
| Lutje të shpallura..... | 263 |
| Lutje për të kërkuar falje dhe për t'u bërë rob i veçantë i Zotit..... | 266 |
| Lutje për të kërkuar falje dhe përfundim të mirë..... | 266 |
| Lutje për të pasur pastërti dhe dëlirësi..... | 267 |
| Këshilla për të dërguar <i>salavatet</i> dhe për të kërkuar falje..... | 268 |
| <i>Salavatet</i> që buruan nga thellësia e shpirtit..... | 269 |
| Disa lutje të veçanta..... | 269 |
| Lutje e shpallur për të shpëtuar nga gjëma dhe sëmundja..... | 270 |
| “Emri madhor” (Ismi Azem)..... | 271 |
| Lutje për të gjetur shërim..... | 272 |
| Lutje për të gjetur shërim nga dhimbja e sëmundjes..... | 272 |
| Edhe një lutje tjetër për të gjetur shërim..... | 273 |
| Lutje për të dalë nga vështirësia..... | 273 |
| Lutje për të pasur dashurinë dhe faljen e Zotit..... | 274 |
| Një lutje me plot dashuri ndaj Zotit..... | 274 |
| Lutje për të pasur ndihmës të fesë..... | 274 |
| Lutje për të pasur bekim të përjetshëm..... | 275 |
| Lutje për të pasur bereqet në pasuri..... | 275 |
| Lutje të ndryshme për të shtuar dijen (<i>ilmin</i>) dhe njohjen (<i>irfanin</i>)..... | 276 |
| Lutje për të pasur mendësinë dhe dijen e duhur..... | 276 |
| Lutje për të pasur të vërtetën dhe udhëzimin..... | 277 |
| Lutje për mëshirë dhe ndihmë..... | 277 |
| Lutje për të kërkuar mëshirë..... | 278 |
| Lutje për ndihmë pas përballjes me përgënjeshttrimin..... | 278 |
| Lutje për kundërshtarët më mizorë dhe armiqtë e fesë | 279 |
| Lutje për të pasur ndihmës të fesë..... | 279 |
| Lutje për përmirësimin e umetit të Muhamedit ^{sas} | 279 |
| Një lutje përgjëruese pas lëndimeve nga një kundërshtar..... | 280 |
| Një lutje e përsosur me plot dashuri ndaj Zotit..... | 281 |

| | |
|--|------------|
| Një lutje tejet emocionuese për dashurinë e Zotit..... | 285 |
| Lutje për një sahab të tij të sinqertë, që ai të bëhej me djalë..... | 287 |
| Disa lutje të veçanta të shpallura mbi Hazret Mesihun e Premtuar ^{as} | 289 |
| Disa nga lutjet e Hazret Mesihut të Premtuar^{as} në vargje..... | 296 |
| Lutje për ata që e quajnë Mesihun e Premtuar mohues (<i>qafir</i>)..... | 297 |
| Motivim për lutje dhe për mbështetje te Zoti i Vetëm..... | 299 |
| Përshkrimi i gjendjes së mjerueshme të muslimanëve dhe lutje plot dhimbje për triumfin e Islamit..... | 301 |
| Lutje për të ardhmen e fëmijëve..... | 306 |
| Një lutje e hershme në gjuhën perse..... | 311 |
| Lutje për të kërkuar falje dhe dashurinë e Zotit..... | 314 |
| Lutje për të kërkuar gjykimin midis së vërtetës dhe gënjeshtërs..... | 315 |
| Disa strofa përgjëruese në gjuhën arabe..... | 319 |
| Shpjegim i termave..... | 320 |
| Shkurtesat..... | 321 |
| Adresat..... | 322 |

Fjala e botuesit

Elhamdulillah-lah që lexuesit shqiptarë tashmë kanë në dorë një thesar lutjesh. “Lutja është thelbi i adhurimit”, - thotë i Dërguari i Allahut^{s.a.s}. Le t’i zbukurojmë adhurimet tona me lutje, ashtu siç na kanë mësuar Zoti i Madhërishëm, i Dërguari i Tij^{s.a.s} dhe Mesihu i Premtuar^{a.s}.

Ky thesar lutjesh përfshin thuajse të gjitha lutjet e Kuranit Famëlartë, mbi 250 lutje të Profetit Muhammed^{s.a.s}, udhëzime të çmueshme nga Mesihu i Premtuar^{a.s} rreth lutjes dhe, gjithashtu, disa nga lutjet e tij në prozë e në poezi. Zoti e bëftë këtë libër për të gjithë shqiptarët, një mundësi për ta njohur Atë edhe më shumë dhe një mjet për t’iu afruar Atij!

Kjo përmbledhje e vyer u përpilua në gjuhën urdu nga dietari, z. *Hafiz M* . Ajo u soll në gjuhën shqipe nga Samad Ghori, nën kujdesin e redaktorëve, znj. Sevi Agolli dhe z. Bekim Bici. Për faqosjen e tij punoi studioja grafike “petanidesign”, si dhe znj. Kudsia Ghori. Zoti i Madhërishëm ua shpërbleftë të gjithëve me të mira!

Ues-selam

Munir-ud-Din Shams

Add. Vakilot-Tasnif

(Drejtore i botimeve të Xhematit Musliman Ahmedia)

27 maj, 2016

Botuesi

PJESA I

Lutjet e Kuranit Famëlartë

Parathënie

Me sa shumë ëndrra e dashuri i rritin dhe i edukojnë prindërit fëmijët e tyre. Që në vegjëli u mësojnë gjuhën. I mësojnë të thonë: nënë e babë. I mësojnë të kërkojnë ujë, qumësht, bukë. E kur fëmija mëson të shprehet dhe fillon t'u kërkojë prindërve duke belbëzuar, sa shumë gëzohen ata dhe me çfarë kënaqësie ia plotësojnë dëshirën! Me reflekset e tyre, fëmijët e vegjël e të pafajshëm të bëjnë për vete aq fort, saqë tregohesh i gatshëm t'u japësh gjithçka që të kërkojnë. Por edhe kërkesat e fëmijëve zakonisht nuk kanë ndonjë peshë për sa i përket vlerës materiale, ashtu siç as prindërit ose kushdo qoftë dhënësi, nuk kanë mundësinë që t'ua përmbushin çdo dëshirë.

Edhe Zoti ynë Bujar që na do shumë, më shumë sesa prindërit tanë, Vetë na ka mësuar metodat e të kërkuarit duke thënë: **“Lypni prej Meje, Unë do t'ju jap”**. Ai na ka mësuar edhe fjalët përgjëruese, që na tregojnë se me çfarë dashurie e përvulësie duhet të shtrijmë duart para Tij. E gjithë kjo a nuk është vallë, sepse Ai dëshiron të na bekojë e begatojë?! Pa dyshim, këto janë pretekstet e Tij vetëm për të na plotësuar kërkesat.

رحمت پر ہی بہانہ ہی جو ہے

“Mëshira e Zotit kërkon pretekste!”

Në Kuranin Famëlartë, Zoti ynë Bujar na ka mësuar edhe lutjet, edhe metodat e saj dhe për sa i përket fuqisë së Tij dhuruese, ajo është e pakufishme. Prandaj, këto lutje kuranore kanë një ndikim të fuqishëm dhe ai që ka përfituar më shumë nga ky ndikim sekret, pa dyshim, ka qenë udhëheqësi dhe lideri ynë, Hazret Muhammed Mustafai^{sas}. Po, pikërisht ai, i dashuri i Zotit, në gjuhën e të cilit kanë

rrjedhur për herë të parë këto lutje të shpallura dhe që gëzoi edhe përmbushjen e tyre. Nëse Hazret Ademi^{as} dhe Hazret Junusi^{as} gjetën shpëtim me anë të lutjeve të mësuara prej Zotit, si është e mundur vallë, që lutjet që iu diktuan kryeprofetit e të dashurit të Zotit të mos kenë ndikim madhështor?! E vërteta është që, ashtu siç e ka shpalosur Kurani Famëlartë kapitullin e lutjes dhe siç i ka mbledhur lutjet e profetëve të ndryshëm, këtë nuk e ka bërë asnjë libër tjetër në botë. Përveç kësaj, Kurani na ka ofruar edhe modelet më të bukura të lutjeve në raste nevojash të ndryshme. Në librin që keni në dorë janë mbledhur thujt të gjitha lutjet me gjithë kontekstin e tyre, në mënyrë që lexuesit ta kuptojnë brendësinë e secilës lutje dhe kur ta thonë, të qëllojnë në shenjë. Ashtu e bëftë Allahu!

Në këtë libër është bërë përpjekje që të sjellim edhe ato lutje që nuk ishin të shënuara në libra të tjerë lutjesh. Lutjet janë radhitur me një renditje të natyrshme me titujt të përshtatshëm.

Numrat e ajeteve janë dhënë duke numëruar *bismil-lahun* si ajet të parë të çdo sureje.

I lutemi Allahut të Madhërishëm të na e pranojë këtë përpjekje modeste dhe të na pranojë edhe lutjet që na i ka mësuar Vetë për këtë qëllim. Ashtu e bëftë Zoti!

این دعا از من و از جملہ جہاں آئین ہا

“U pranofte kjo lutje e imja dhe e të gjithë botës!”

Paqja qoftë mbi ju!

Hafiz M. A.

14 korrik 2005

1. Lutja e përsosur

Suren *El-Fatiha*, i Dërguari i Allahut^{sas} e ka quajtur *më e mira e Kuranit* (Efdelul Kur'an)¹

I Dërguari i Allahut^{sas} përmes një shpalljeje u njoftua që ka një lutje, e cila nuk i është dhënë asnjë profeti të mëparshëm dhe ajo është *El-Fatiha*. Po ashtu, një lutje e përsosur është edhe ajo që gjendet në ajetet e fundit të sures *El-Bekare*. Çdokush që i kërkon Zotit me anë të këtyre lutjeve, kërkesa e tij nuk refuzohet.²

Në një *hadhith kudsî*, Zoti i Lartësuar thotë: “Unë e kam ndarë namazin midis Meje e robit Tim dhe ai patjetër do të gjejë gjithçka që është kërkuar në këtë lutje”.³

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ ۝ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ۝
مَلِكِ يَوْمِ الدِّينِ ۝ إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ ۝
إِهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ ۝ صِرَاطَ الَّذِينَ
أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ ۝ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ ۝

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit. Lavdia është e Allahut, Zotit të botëve; të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit; Sunduesit të ditës së gjykimit. Vetëm Ty të

1. Mustadrak Hakim, vëll. 1, f. 747.

2. Muslimi, Kitabus-salatul-musafirin, bab fadlil-Fatiha.

3. Muslimi, Kitabus-salat, bab vuxhub kir'atil-Fatiha.

adhurojmë dhe vetëm Ty të kërkojmë ndihmë. Na udhëzo në rrugën e drejtë. Në rrugën e atyre që i bekojnë, që nuk tërhoqën zemërim dhe që nuk devijuan.⁴ (Amin!)

2. Lutje për të dëshmuar besimin dhe për të kërkuar dëlirësinë

Kjo lutje në Kuranin Famëlartë i referohet grupit të të mirëve që vijnë nga fetë e tjera, sidomos nga feja e krishterë, të cilët e pranojnë të vërtetën dhe lutën:

رَبَّنَا آمَنَّا فَاكْتُبْنَا مَعَ الشَّاهِدِينَ ۝ وَمَا لَنَا لَا نُؤْمِنُ
بِاللَّهِ وَمَا جَاءَنَا مِنَ الْحَقِّ وَلَا وَنَطْمَعُ أَنْ يُدْخِلَنَا رَبُّنَا
مَعَ الْقَوْمِ الصَّالِحِينَ ۝

O Zoti ynë! Ne besuam, prandaj na shëno si dëshmitarë. E përse të mos e besojmë Allahun dhe të vërtetën që na ka ardhur, përderisa dëshirojmë që Zoti ynë të na pranojë në grupin e njerëzve të sinqertë?!⁵

3. Dëshmia e besimit, e veprimit dhe lutja që ato të pranohen

Dishepujt kur panë kundërshtimin ndaj Isait^{as} nga të katërta anët, i kërkuan ndihmë Zotit me këtë lutje:

رَبَّنَا آمَنَّا بِمَا أَنْزَلْتَ وَاتَّبَعْنَا الرَّسُولَ فَاكْتُبْنَا مَعَ الشَّاهِدِينَ ۝

O Zoti ynë! Besuam atë që na ke zbritur dhe e ndoqëm të Dërguarin. Prandaj, na shëno si dëshmitarë!⁶

4. Kurani Famëlartë 1:1-7.

5. Kurani Famëlartë 5:84-85.

6. Kurani Famëlartë 3:54.

4. Lutje e Ibrahimit^{as} për të gjetur mbështetje te Zoti

Në një ajet të tij, Kurani Famëlartë porositi besimtarët të përvetësojnë modelin e Ibrahimit^{as}, dhe në të njëjtin ajet, përmend këtë lutje të tij:

رَبَّنَا عَلَيْكَ تَوَكَّلْنَا وَإِلَيْكَ أَنبَأْنَا وَإِلَيْكَ الْمَصِيرُ ۝

O Zoti ynë! Te Ti mbështetemi, Te Ti vijmë të penduar dhe te Ti do të kthehem.⁷

5. Lutje për të kërkuar të mirat e botës dhe të ahiretit

Një njeri i kërkoi Hazret Enes ibni Malikut^{ra} që ai të lutej për të. Hazret Enesi bëri lutjen që është shënuar më poshtë. Pyetësi i kërkoi për më shumë lutje. Hazret Enesi^{ra} iu përgjigj: “Çfarë dëshiron më shumë?! I kam lypur Zotit të mirat e kësaj bote dhe të ahiretit për ty”.⁸

Po Hazret Enesi^{ra} rrëfen, që i Dërguari i Allahut^{sas} shpesh e bënte këtë lutje:⁹

رَبَّنَا آتِنَا فِي الدُّنْيَا حَسَنَةً وَفِي الْآخِرَةِ
حَسَنَةً وَفِي مَا عَذَابِ النَّارِ ۝

O Zoti ynë! Na jep të mirën në këtë botë, të mirën në ahiret dhe na shpëto nga ndëshkimi i zjarrit!¹⁰

7. Kurani Famëlartë 60:5.

8. Tefsir Ibni Kethir, pj. 1, f. 558.

9. Buhariu, Kitabut-tefsir.

10. Kurani Famëlartë 2:202.

6. Lutje për të kërkuar mirësitë e botës dhe të ahiretit

Hazret Musai^{as} për popullin e tij kishte bërë këtë lutje:

وَاصْبِرْ لَكَ فِي هَذِهِ الدُّنْيَا حَسَنَةً وَفِي الْآخِرَةِ إِنَّا هُنَا لِإِلَيْكَ

Na cakto të mira edhe në këtë botë, edhe në ahiret. Ne udhëzohemi nga Ti.¹¹

7. Lutje për të kërkuar mbrojtje nga nxitjet e shejtanit

Amr bin Seidi^{ra} rrëfen: “I Dërguari i Allahut^{sas} na kishte mësuar disa lutje, që t’i bënim para se të flinim, ndër të cilat ishte edhe lutja që është në vijim, që e bëjmë për të kërkuar mbrojtje nga nxitjet e shejtanit”.¹²

رَبِّ أَعُوذُ بِكَ مِنْ هَمَزَاتِ الشَّيْطَانِ ﴿١﴾
وَأَعُوذُ بِكَ رَبِّ أَنْ يَحْضُرُونِ ﴿٢﴾

O Zoti im! Më mbro nga nxitjet e djajve. Më mbro, o Zoti im, që ata të mos më afrohen.¹³

8. Lutje për të qëndruar gjithmonë në udhë të drejtë

Hazret Umi Selma^{ra} rrëfen:

“I Dërguari i Allahut^{sas} shpesh lutej: “O Drejtuesi i zemrave! Vendosma zemrën në fenë Tëndel!” E pyeta: O i Dërguari i Allahut! Edhe zemrat ndryshojnë? Ai më lexoi këtë lutje të Kuranit duke thënë: “Për këdo qoftë, ekziston mundësia t’i shtrembërohet zemra.

11. Kurani Famëllartë 7:157.

12. Tirmidhiu, Kitabud-da’vat, bab 94.

13. Kurani Famëllartë 23:98-99.

Prandaj shpesh duhet ta bëjmë këtë lutje¹⁴:

رَبَّنَا لَا تُزِغْ قُلُوبَنَا بَعْدَ إِذْ هَدَيْتَنَا وَهَبْ لَنَا مِنْ لَدُنْكَ رَحْمَةً
إِنَّكَ أَنْتَ الْوَهَّابُ ۝

O Zoti ynë! Mos na shtrembëro zemrat pasi na ke udhëzuar dhe na dhuro mëshirë prej Teje! Me të vërtetë, Ti je Dhuruesi i madh!¹⁵

9. Lutje për të pasur qëndrueshmërinë dhe ndihmën kundër mohuesve

Sipas Kuranit Famëlartë, Hazret Taluti (Xhed'uni) bëri këtë lutje kur doli për t'u ballafaquar me armikun e tij, Xhalutin, dhe, rrjedhimisht, Zoti i Lartësuar atij i dha fitoren, ndërsa armikut humbjen poshtëruese:

رَبَّنَا أَفْرِغْ عَلَيْنَا صَبْرًا وَ ثَبِّتْ أَقْدَامَنَا
وَ انصُرْنَا عَلَى الْقَوْمِ الْكَافِرِينَ ۝

O Zoti ynë! Na dhuro durimin, na forco këmbët dhe na ndihmo kundër popullit mohues.¹⁶

10. Lutje për të shpëtuar nga ndëshkimi i Zotit dhe nga poshtërimi në ditën e kiametit dhe për të pasur faljen, fundin e mirë dhe përmbushjen e premtimit të Zotit

Hazret Ajshja^{ra} rrëfen: “Kur zbritën ajetet e mëposhtme, i Dërguari i Allahut^{sas} filloi namazin me të qarë. Hazret Bilali^{ra} erdhi për ta

14. Ed-Durrul Menthur Lil Sujuti, vëll. 2, f 8.

15. Kurani Famëlartë 3:9.

16. Kurani Famëlartë 2:251.

njoftuar për namazin *fard* dhe e pyeti për shkakun pse qante. Ai iu përgjigj: “Mbrëmë më zbritën këto ajete. ... Është shumë fatkeq ai që i lexon dhe nuk thellohet në to”. Disa rrëfime të tjera tregojnë se i Dërguari i Allahut^{sas} çdo natë i recitonte këto ajete dhe thoshte: “Ai që reciton gjatë natës ajetet e fundit të sures *Ali-Imran*, për të shkruhet sikur të ketë falur namaz gjatë gjithë natës”.¹⁷

رَبَّنَا مَا خَلَقْتَ هَذَا بَاطِلًا ۖ سُبْحَانَكَ قَبْلَنَا عَذَابَ النَّارِ ۝

O Zoti ynë! Këto nuk i ke krijuar kot! Ti je i Shenjtë. Prandaj, na shpëto nga ndëshkimi i zjarrit!¹⁸

11.

رَبَّنَا إِنَّا سَمِعْنَا مُنَادِيًا يُنَادِي لِلْإِيمَانِ أَنْ آمِنُوا بِرَبِّكُمْ فَآمَنَّا ۗ
رَبَّنَا فَاعْفُ عَنَّا ذُنُوبَنَا وَكَفِّرْ عَنَّا سَيِّئَاتِنَا وَتَوَقَّنَا مَعَ الْأَبْرَارِ ۝

O Zoti ynë! Ne sigurisht kemi dëgjuar një lajmëtar, i cili na thërret drejt besimit (duke thënë): Besoni në Zotin tuaj! Dhe ne e besuam. Prandaj, o Zoti ynë, fali gjynahet tona, zhduki ligësitë tona prej nesh dhe na jep vdekje me të mirët.¹⁹

17. Tefsir Kurtubi, vëll. 4, f. 310.

18. Kurani Famëllartë 3:192.

19. Kurani Famëllartë 3:194.

12.

رَبَّنَا وَإِنَّا مَا وَعَدْتَنَا عَلَىٰ رُسُلِكَ وَلَا تُخْزِنَا يَوْمَ الْقِيَامَةِ
إِنَّكَ لَا تُخْلِفُ الْمِيعَادَ ﴿٢٠﴾

O Zoti ynë! Na jep edhe atë që u ke premtuar të dërguarve të Tu dhe mos na poshtëro në ditën e kiametit. Ti pa dyshim që nuk e shkel premtimin.²⁰

13. Lutje e përsosur për të kërkuar falje, mëshirë dhe ndihmën kundër armiqve

Dy ajetet e fundit të sures *El-Bekare* përbëhen nga lutjet e poshtëshënuara. Hazret Ebu Mesudi^{ra} tregon se këto dy ajete janë më se të mjaftueshme për atë që i lexon para se të flejë gjatë natës dhe janë prej atij thesari të *arshit*, që nuk i është dhënë asnjë profeti tjetër para Profetit Muhammed^{sas}.²¹

I Dërguari i Allahut^{sas} ka theksuar se besimtarët duhet t'i mësojnë përmendsh këto dy ajete dhe t'ua mësojnë edhe anëtarëve të familjes së tyre, sepse ato përbëhen nga namazi, Kurani dhe lutja.²²

Më poshtë jepet vetëm pjesa e lutjes së këtyre dy ajeteve:

سَمِعْنَا وَأَطَعْنَا غُفْرَانَكَ رَبَّنَا وَإِلَيْكَ الْمَصِيرُ ﴿٢١﴾

Ne e dëgjuam dhe iu bindëm. Na fal, o Zoti ynë! Te Ti është kthimi!

20. Kurani Famëlartë 3:195.

21. Tefsir Tibri, pj. 3, f. 434.

22. Sunen Ed-Darimi, Kitabul-fadlil-Kuran, suret Fatiha.

14.

رَبَّنَا لَا تُؤَاخِذْنَا إِنْ نَسِينَا أَوْ أَخْطَأْنَا ۗ رَبَّنَا وَلَا تَحْمِلْ عَلَيْنَا
إِصْرًا كَمَا حَمَلْتَهُ عَلَى الَّذِينَ مِن قَبْلِنَا ۗ رَبَّنَا وَلَا تُحَمِّلْنَا
مَا لَا حَاقَةَ لَنَا بِهِ ۗ وَاعْفُ عَنَّا ۗ وَاعْفِرْ لَنَا ۗ وَارْحَمْنَا ۗ
أَنْتَ مَوْلَانَا فَانصُرْنَا عَلَى الْقَوْمِ الْكَافِرِينَ ۝

O Zoti ynë! Mos na ndëshko nëse harrojmë ose gabojmë! O Zoti ynë! Mos na ngarko me barrën, që ua ngarkove atyre që ishin para nesh! O Zoti ynë, mos na ngarko diçka që nuk mund ta mbartim! Na tolero, na fal dhe na mëshiro! Ti je Miku ynë. Prandaj, na ndihmo kundër popullit mohues!

15. Lutje për të kërkuar qëndrueshmëri
dhe fund të mbarë

Magjistarët e Faraonit u mundën përballë Hazret Musait^{as} dhe duke e kuptuar të vërtetën, e besuan Hazret Musain^{as}. Faraoni i kërcënoi me një ndëshkim të dhimbshëm. Duke iu përgjigjur atij, ata treguan forcën e besimit të tyre dhe iu lutën Zotit:

رَبَّنَا أَفْرِغْ عَلَيْنَا صَبْرًا وَتَوَقَّأْنَا مُسْلِمِينَ ۝

O Zoti ynë! Jepna durimin dhe mundësona vdekje kur (Të) jemi nënshtruar.²³

23. Kurani Famëllartë 7:127.

16. Lutje për të kërkuar faljen e mëkateve dhe për të shpëtuar nga ndëshkimi i Zotit

I Dërguari i Allahut^{sas} tha: “Kur Zoti dëshiron të ndëshkojë ndonjë popull, së pari u hedh një sy njerëzve që falin namazin e natës dhe i kërkojnë falje, dhe për shkak të tyre e heq ndëshkimin.²⁴

رَبَّنَا إِنَّا أَمْنَا فَاغْفِرْ لَنَا ذُنُوبَنَا وَقِنَا عَذَابَ النَّارِ ﴿٢٥﴾

O Zoti ynë! Ne padyshim që besuam. Andaj, na fal gjynahet dhe na shpëto prej ndëshkimit të zjarrit.²⁵

17. Lutje për të kërkuar falje për gjynahet, teprimin dhe për të kërkuar qëndrueshmëri

Zoti i Madhërishëm lëvdon njerëzit e sinqertë që besuan profetët dhe nuk u treguan të dobët edhe kur iu desh të luftonin përkrah profetëve kundër armiqve të tyre. Kurani Famëlartë na siguron një lutje të tyre dhe thotë se Zoti i Madhërishëm do t’ua shpërblejë sakrificën në këtë botë dhe në botën tjetër.

رَبَّنَا اغْفِرْ لَنَا ذُنُوبَنَا وَإِسْرَاقَنَا فِي أَمْرِنَا وَتَبِّثْ أَقْدَامَنَا
وَانصُرْنَا عَلَى الْقَوْمِ الْكَافِرِينَ ﴿٢٦﴾

O Zoti ynë! Na fal mëkatet tona dhe teprimin në çështjet tona, na forco këmbët dhe na ndihmo kundër popullit mohues!²⁶

24. Shuabul-Iman, pj. 3, f. 83.

25. Kurani Famëlartë 3:17.

26. Kurani Famëlartë 3:148.

18. Lutje për të kërkuar mëshirë dhe falje

Duke harruar porosinë e Zotit, Hazret Ademi^{as} shijoi pemën e ndaluar. Atëherë Zoti i Madhërishëm i mësoi një lutje dhe kur Hazret Ademi e tha atë, Zoti iu kthye dhe tregoi mëshirë ndaj tij.²⁷ Ajo lutje është:

رَبَّنَا ظَلَمْنَا أَنفُسَنَا وَإِن لَّمْ تَغْفِرْ لَنَا وَتَرْحَمْنَا
لَنَكُونَنَّ مِنَ الْخَاسِرِينَ ﴿٢٨﴾

O Zoti ynë! Kemi shkelur veten tonë! Nëse nuk do të na falësh dhe nuk do të na mëshirosh, do të bëhemi të humbur.²⁸

19. Lutje për të kërkuar falje e mëshirë kur nuk je i vetëdijshëm

رَبِّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ أَنْ أَسْأَلَكَ مَا لَيْسَ لِي بِهِ عِلْمٌ
وَإِلَّا تَغْفِرْ لِي وَتَرْحَمْنِي أَكُنَّ مِنَ الْخَاسِرِينَ ﴿٢٩﴾

O Zoti im! Më mbro nga kërkesat e mia për të cilat nuk kam dijeni. Nëse nuk më fal dhe nuk më mëshiron, do të bëhem një prej të humburve.²⁹

20. Lutje për të shpëtuar nga vështirësitë

Hazret Sad Ibni Uekasi^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} tha: “Çdo musliman që bën lutjen që ka bërë Hazret Junusi^{as} kur ishte në barkun e peshkut, do t’i pranohet. Në rrëfim thuhet, gjithashtu,

27. Kurani Famëlartë 2:38; Ed-Durrul-Menthur, vëll. 3, f. 75.

28. Kurani Famëlartë 7:24.

29. Kurani Famëlartë 11:48.

se në Kuranin Famëlartë, pas kësaj lutjeje, ngaqë përmendet edhe premtimi “Në këtë mënyrë Ne i shpëtojmë besimtarët”, cilido besimtar që e bën këtë lutje, pasi pranon fajin e vet, do t’i pranohet.³⁰ Lutja e Hazret Junusit vijon:

لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ سُبْحَانَكَ إِنِّي كُنْتُ مِنَ الظَّالِمِينَ ﴿١٠١﴾

Nuk ka të adhurar tjetër përveç Teje. Ti je i Shenjtë. Unë kam qenë ndër të padrejtët.³¹

21. Lutje për të pasur forcë që të luftosh me të keqen

Kur gruaja e Azizit të Egjiptit dhe disa gra të tjera e provokuan Hazret Jusufin^{as} për të bërë vepra imorale, Hazret Jusufi^{as} bëri këtë lutje përgjëruese, për të cilën Allahu i Madhërishëm në Kuranin Famëlartë thotë se ia pranoi dhe e mbrojti Hazret Jusufin^{as} nga intrigat e grave.

رَبِّ السَّجُنِ أَحَبُّ إِلَيَّ وَمَا يَدْعُونَ نَجِيَّ إِلَيْهِ وَالْأَنْصَرِفَ
عَنِّي كَيْدَهُنَّ أَصْبُ إِلَيْهِنَّ وَأَكُنَّ مِنَ الْجَاهِلِينَ ﴿١٠٢﴾

O Zoti im! Më shumë dua burgun, sesa atë për të cilën ato më ftojnë. Nëse nuk më largon mua nga intriga e tyre, do të anoj nga ato dhe do të bëhem një ndër injorantët.³²

22. Lutje për të gjetur shërim nga sëmundja

Kur Hazret Ejubi^{ra} ishte në gjendje tejet të dhimbshme, i kërkoi

30. Tefsir Kurtubi, pj. 11, f. 334.

31. Kurani Famëlartë 21:88.

32. Kurani Famëlartë 12:34.

mëshirë Zotit të Madhërishëm me lutjen e mëposhtme. Lutja iu pranua dhe ai u shërua mrekullisht.

أَيُّ مَسْنَى الضَّرِّ وَأَنْتَ أَرْحَمُ الرَّحِيمِينَ ﴿٣٣﴾

(O Zoti im!) Mua më ka zënë një dhimbje e madhe, kurse Ti je më i Mëshirshmi nga të gjithë mëshiruesit.³³

23. Lutje për të kërkuar falje e mëshirë, duke pranuar Zotin si mbrojtës

Hazret Musai^{as} së bashku me shtatëdhjetë besimtarë shkuan rrëzë malit Tur, ashtu siç ishin porositur nga Zoti i Madhërishëm. Por, aty ra tërmet. Hazret Musai mendoi se ishte një ndëshkim nga Zoti, për shkak të *shirkut* që kishte bërë populli i tij dhe për këtë iu lut Atij:

أَنْتَ وَلِيُّنَا فَامْغِرْكَ وَأَرْحَمْنَا وَأَنْتَ خَيْرُ الْغَافِرِينَ ﴿٣٤﴾

Ti je Miku ynë! Falna dhe mëshirona, sepse Ti je Mëkatfalësi më i mirë.³⁴

24. Lutje për të kërkuar falje, duke pranuar fajin

Gjatë ndërhyrjes që bëri Hazret Musai^{as} midis dy njerëzve që po grindeshin, njëri u vra nga dora e tij. Atëherë ai bëri këtë lutje, për të cilën Zoti i Madhërishëm thotë se ia pranoi dhe e fali:

رَبِّ إِنِّي ظَلَمْتُ نَفْسِي فَاغْفِرْ لِي

O Zoti im! Kam shkelur mbi veten. Më fal mua!³⁵

33. Kurani Famëlartë 21:84.

34. Kurani Famëlartë 7:156.

35. Kurani Famëlartë 28:17.

Lutje të ndryshme për të kërkuar falje dhe mëshirë

25.

Gjatë mungesës së Hazret Musait^{as}, bijtë e Izraelit e bënë viçin Zot. Kur u kthye, Hazret Musai^{as} qortoi vëllanë e tij, Harunin, si dhe popullin e tij. Populli u pendua dhe bëri një lutje, të cilën mund ta quajmë “Lutja e popullit të Musait^{as} për pendesë”:

لَيْتَ لَمْ يَرْحَمْنَا رَبُّنَا وَيَغْفِرْ لَنَا لَتَكُونُوا مِنَ الْخَيْرِينَ ﴿٣٥﴾

Zoti ynë, nëse nuk na mëshiron e nuk na fal, ne përnjëmend do të jemi të humbur.³⁶

26.

Po në këtë rast, edhe Hazret Musai^{as} iu lut Zotit për të kërkuar falje për veten dhe për vëllanë e tij:

رَبِّ اغْفِرْ لِي وَلِإِخِي وَأَدْخِلْنَا فِي رَحْمَتِكَ وَأَنْتَ أَرْحَمُ الرَّحِيمِينَ ﴿٣٦﴾

O Zoti im! Më fal mua dhe vëllanë tim dhe na prano në mëshirën Tënde! Ti je Mëshiruesi i të gjithë mëshiruesve.³⁷

27. Lutje për të kërkuar falje për popullin e humbur

Hazret Ebu Dheri^{ra} tregon: “Njëherë i Dërguari i Allahut^{sas} fali namazin gjatë gjithë natës dhe bëri vetëm këtë lutje. E pyeta: “O i Dërguari i Allahut! Ju e dini gjithë Kuranin, përse po përsërisni vetëm një ajet?” Ai m’u përgjigj: “Po bëja lutje për *umetin* tim”.

36. Kurani Famëlartë 7:150.

37. Kurani Famëlartë 7:152.

“Çfarë përgjigje more?”, e pyeta. “Po ta tregoj përgjigjen, shumica e njerëzve do të heqin dorë nga namazi”, më tha.³⁸

Kurani Famëllartë na tregon se këtë lutje e kishte bërë Hazret Isai^{as} për popullin e tij:

إِنَّ تَعَذِّبَهُمْ فَإِنَّهُمْ عِبَادُكَ ۗ وَإِنْ تَغْفِرْ لَهُمْ
فَإِنَّكَ أَنْتَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ۝

(O Zot!) Nëse i ndëshkon, janë robërit e Tu dhe nëse i fal, pa dyshim, Ti je i Plotfuqishmi, i Urti.³⁹

28. Lutje për të shpëtuar nga ndëshkimi i xhehenemit

Duke përmendur vetitë e robërve të të Gjithëmëshirshmit, Allahu i Madhërishëm thotë se ata kalojnë netët duke bërë *sexhde*, duke qëndruar para Zotit, duke e adhuruar Atë dhe duke u lutur që Ai t'i shpëtojë nga ndëshkimi i xhehenemit:⁴⁰

رَبَّنَا اصْرِفْ عَنَّا عَذَابَ جَهَنَّمَ ۚ إِنَّ عَذَابَهَا كَانَ غَرَامًا ۝

O Zoti ynë! Largo prej nesh ndëshkimit e xhehenemit. Ndëshkimi i tij përnjëmend është “ngjitës”.⁴¹

29. Lutje për të kërkuar falje dhe për t'u mbrojtur nga zilia

Një sahab fali namazin bashkë me të Dërguarin e Allahut^{sas}. I

38. Ed-Durrul-Menthur, lis-Sujuti, vëll. 3, f. 240.

39. Kurani Famëllartë 5:119.

40. Kurani Famëllartë 25:64-65.

41. Kurani Famëllartë 25:66.

Dërguari i Allahut^{sas} tha: “Ky është xhenetli!” Hazret Abdullah Ibni Omerit^{ra} i lindi kërshtëria për të zbuluar se nga cila vepër e tij Zoti i Madhërishëm ia bëri këtë mirësi. Ai vizitoi shtëpinë e tij dhe bujti tek ai, i cili e mikpritte mjaft ngrohtë. Abdullah Ibni Omerit^{ra} rrëfen: “Natën unë fala namazin e *tehexhudit*, por ai nuk u zgjua. Të nesërmen unë agjërova, kurse ai jo. Atëherë nuk durova dot dhe e pyeta se cila është ajo vepër që të ka bërë xhenetli, sepse i Dërguari i Allahut^{sas} tha se je i tillë. “Më mirë pyete të Dërguarin e Allahut^{sas}, që të njoftoi se jam xhenetli”, m’u përgjigj ai”. Abdullah Ibni Omerit^{ra} shkoi tek i Dërguari i Allahut^{sas} për t’u sqaruar, por ai i tha: “Thuaji që të ta tregojë veprën e tij”. Vetëm atëherë sahabi në fjalë i tregoi duke thënë: “Bota tek unë nuk vlen për asgjë. Nuk merakosem fare se sa e fitoj dhe sa e humb atë. Së dyti, nuk kam zili në zemër ndaj askujt”. Hazret Abdullahu^{ra} u shpreh: “Padyshim që Allahu të dha epërsi mbi ne dhe pikërisht këtë lutje Ai ua ka mësuar besimtarëve”.⁴²

رَبَّنَا اغْفِرْ لَنَا وَلِإِخْوَانِنَا الَّذِينَ سَبَقُونَا بِالْإِيمَانِ وَلَا تَجْعَلْ
فِي قُلُوبِنَا غِلًّا لِلَّذِينَ آمَنُوا رَبَّنَا إِنَّكَ رَءُوفٌ رَحِيمٌ ۝

O Zoti ynë! Na fal ne dhe vëllezërit tanë paraardhës në besim dhe mos lër zili aspak në zemrat tona ndaj atyre që besuan. O Zoti ynë! Pa dyshim, je i Dhembshur, Mëshirëbërës.⁴³

30. Lutje për të kërkuar mëshirë dhe falje

Njëherë Hazret Ebu Bekri i kërkoi të Dërguarit të Allahut^{sas} që t’i mësonte ndonjë lutje për të bërë në namaz. I Dërguari i Allahut^{sas} i mësoi një të tillë, në të cilën në veçanti kërkohet mëshira dhe falja

42. Tefsir Ed-Durrul-Menthur lis-Sujuti, vëll. 5, f. 199.

43. Kurani Famëlartë 59:11.

prej Zotit.⁴⁴ Një lutje të tillë e kemi edhe në Kuran. Hazret Abdullah Ibni Mesudi^{ra} bëri këtë lutje duke lexuar edhe tri ajete të tjera, që i paraprijnë asaj dhe fryu një të sëmure. I sëmuri u shërua. Ai tha: “Pasha Zotin! Një njeri që e ka besimin të palëkundur nëse e lexon këtë ajet në një mal, edhe ai do t’i dorëzohet”.⁴⁵

رَبِّ اغْفِرْ وَارْحَمْ وَأَنْتَ خَيْرُ الرَّحِيمِينَ ﴿٣٥﴾

O Zoti im! Fal dhe mëshiro! Ti je më i miri nga të gjithë mëshiruesit.⁴⁶

31. Lutja e përulur e engjëjve *arsh*-mbartës për besimtarët e sinqertë

Teksa sahabët^{ra} po bisedonin për madhësinë e Zotit, aty erdhi i Dërguari i Allahut^{sas} dhe tha: “Edhe unë do t’ju them diçka rreth madhësisë së Zotit”. Më pas ai u tregoi rreth engjëjve që janë mbartës të *arshit* dhe që janë krijesa madhështore të Zotit të Lartësuar.⁴⁷

Jahja Ibni Muadh Raziu tregon se, edhe sikur qoftë një engjell i *arshit* të kërkojë falje për besimtarët, shpresohet se ata do të falen.

Si do të jetë vallë kur të gjithë engjëjt e *arshit* të kërkojnë falje për besimtarët?!⁴⁸

44. Tefsir Ed-Durrul-Menthur lis-Sujuti, vëll. 5, f. 18.

45. Tefsir Kurtubi, pj. 2, f. 157.

46. Kurani Famëlartë 23:119.

47. Tefsir Ed-Durrul-Menthur lis-Sujuti, vëll. 5, f. 347.

48. Tefsir Kurtubi, pj. 15, f. 295.

رَبَّنَا وَسِعْتَ كُلَّ شَيْءٍ رَّحْمَةً وَعِلْمًا فَاغْفِرْ لِلَّذِينَ تَابُوا وَاتَّبَعُوا
سَبِيلَكَ وَقِهِمْ عَذَابَ الْجَحِيمِ ۝ رَبَّنَا وَأَدْخِلْهُمْ جَنَّاتٍ عَدْنٍ
الَّتِي وَعَدْتَهُمْ وَمَنْ صَلَحَ مِنْ آبَائِهِمْ وَأَزْوَاجِهِمْ وَذُرِّيَّاتِهِمْ
إِنَّكَ أَنْتَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ۝ وَقِهِمُ السَّيِّئَاتِ وَمَنْ تَقِ السَّيِّئَاتِ
يَوْمَئِذٍ فَقَدْ رَحِمْتَهُ ۚ وَذَلِكَ هُوَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ ۝

O Zoti ynë! Ti sundon çdo gjë me mëshirë dhe dije. Andaj, fali ata që u penduan dhe ndoqën rrugën Tënde dhe shpëtoji nga ndëshkimi i xhehenemit. Dhe o Zoti ynë, në kopshtet e përjetshme që ua ke premtuar, pranoji ata dhe këdo që vepron mirë nga etërit, bashkëshortet dhe fëmijët e tyre. Ti me të vërtetë je i Plotfuqishmi, i Urti. Dhe shpëtoji nga ligësitë. Atë ditë, këdo që shpëtove prej (pasojava të) ligësive, e ke mëshiruar. Ky është pikërisht sukseasi madhështor.⁴⁹

32. Lutja e bashkëshortes së shtypur në rrugën e Allahut për të shpëtuar nga bashkëshorti mizor

Faraoni ushtronte dhunë ndaj gruas së vet, për shkak se ajo kishte një fe tjetër. Gruaja e tij bëri këtë lutje për t'i shpëtuar mizorisë së tij. Në rrëfime thuhet se lutja i ishte pranuar dhe Zoti që në këtë botë i kishte treguar asaj shtëpinë e xhenetit.

49. Kurani Famëlartë 40:8-10.

رَبِّ ابْنِ لِي عِنْدَكَ بَيْتًا فِي الْجَنَّةِ وَنَجِّنِي مِنْ
فِرْعَوْنَ وَعَمَلِهِ وَنَجِّنِي مِنَ الْقَوْمِ الظَّالِمِينَ ﴿٥٠﴾

O Zoti im! Ndërto për mua në xhenet një shtëpi pranë Teje, më shpëto nga Faraoni dhe vepra e tij dhe nga populli mizor.⁵⁰

33. Lutje për të mos u përfshirë në mizori

Besimtarët e përsosur kur do të shohin xhehenemin, pasi të kenë hyrë në xhenet, do të luten:

رَبَّنَا لَا تَجْعَلْنَا مَعَ الْقَوْمِ الظَّالِمِينَ ﴿٥١﴾

O Zoti ynë! Mos na bëj popull mizor.⁵¹

34. Lutje për të shpëtuar nga trazirat e popullit mizor

Një pakicë e të rinjve pranoi besimin në dorën e Hazret Musait^{as}. Ai i këshilloi të mbështeteshin te Zoti, kurse të rinjtë iu përgjigjën: “Tek Allahu mbështetemi” dhe iu lutën Zotit:

رَبَّنَا لَا تَجْعَلْنَا فِتْنَةً لِّلْقَوْمِ الظَّالِمِينَ ﴿٥٢﴾
وَنَجِّنَا بِرَحْمَتِكَ مِنَ الْقَوْمِ الْكٰفِرِينَ ﴿٥٢﴾

O Zoti ynë! Mos na bëj sprovë për popullin mizor dhe me mëshirën Tënde na shpëto nga populli mohues.⁵²

50. Kurani Famëlartë 66:12.

51. Kurani Famëlartë 7:48.

52. Kurani Famëlartë 10:86-87.

35. Lutje për të shpëtuar nga banorët mizorë të një qyteti dhe për të gjetur mundësinë e mërgimit

Hazret Abdullah Ibni Abasi^{ra} (e ëma, Umi Fazl, e kishte pranuar besimin në vitet e para të Islamit) tregon: “Pasi i Dërguari i Allahut^{sas} mërgoi nga Meka, unë dhe nëna ime kemi qenë ndër ata fëmijë e gra të dobëta që përmenden në Kuranin Famëlartë, se luten për ndihmën e Allahut që të mërgojnë”.⁵³ Me triumfin mbi Mekën, Zoti i Madhërishëm i ndihmoi dhe i liroi nga mizoritë e banorëve të saj.

رَبَّنَا أَخْرِجْنَا مِنْ هَذِهِ الْقَرْيَةِ الظَّالِمِ أَهْلُهَا ۗ وَاجْعَلْ
لَنَا مِنَ لَدُنْكَ وَلِيًّا ۗ وَاجْعَلْ لَنَا مِنْ لَدُنْكَ نَصِيرًا ۝

O Zoti ynë! Na nxirr nga ky qytet, banorët e të cilit janë bërë mizorë. Na dërgo prej Teje ndonjë mik; na dërgo prej Teje ndonjë ndihmës.⁵⁴

36. Lutje për të mos qenë mizor pas marrjes së pushtetit

Duke i dhënë sihariqin e fitores, me anë të kësaj lutjeje, si duket, Zoti i Madhërishëm i mësoi faljen të Dërguarit të Allahut^{sas}:

رَبِّ إِمَّا تَرَيْتَنِي مَا يُوعَدُونَ ۝
رَبِّ فَلَا تَجْعَلْنِي فِي الْقَوْمِ الظَّالِمِينَ ۝

O Zoti im! Nëse do të më tregosh atë që ua ke premtuar, mos më bëj një ndër mizorët, o Zoti im!⁵⁵

53. Buhariu, Kitabut-tefsir, sure En-Nisa.

54. Kurani Famëlartë 4:76.

55. Kurani Famëlartë 23:94-95.

37. Lutje për të përparuar në dije

Zoti i Madhërishëm të Dërguarit të Allahut^{sas} i mësoi këtë lutje për të pasur dritën hyjnore në vendimmarrjet e tij:

رَبِّ زِدْنِي عِلْمًا ۝

O Zoti im, më shto diturinë!⁵⁶

38. Lutje për të kërkuar kthjelltësinë në shpirt, lehtësinë në punë dhe ndikimin në gjuhë

Kur Hazret Musai^{as} mori urdhrin prej Zotit që të shkonte në oborrin mbretëror të Faraonit e t'i përcillte mesazhin e Tij, ai bëri lutjen e mëposhtme. Hazret Asma Binti Emis^{ra} rrëfen: “Kam parë të Dërguarin e Allahut^{sas} në rrëzë të malit Thebir duke bërë të njëjtën lutje. Ai po i lutej Zotit duke thënë: “O Zot! Të kërkoj të njëjtën gjë që të ka kërkuar vëllai im, Musai”⁵⁷

رَبِّ اشْرَحْ لِي صَدْرِي ۝ وَيَسِّرْ لِي أَمْرِي ۝
وَاحْلُلْ عُقْدَةً مِّنْ لِّسَانِي ۝ لِيَفْقَهُوا قَوْلِي ۝

O Zoti im! Më zgjero kraharorin! Më lehtëso punën dhe më zgjidh njëjën e gjuhës, që ata ta kuptojnë fjalën time!⁵⁸

39. Lutje për të kërkuar përparime shpirtërore dhe faljen e Zotit

Allahu i Madhërishëm udhëzon besimtarët që të bëjnë pendesë të sinqertë, sepse në këmbim të saj, Ai do t'ua largojë mëkatet dhe do

56. Kurani Famëllartë 20:115.

57. Tefsir Ed-Durrul-Menthur lis-Sujuti, vëll. 4, f. 295.

58. Kurani Famëllartë 20:26-29.

t'i pranojë në xhenete me pëlqimin e Tij. Më pas ata do të kenë dritë para dhe pas dhe do të luten:

رَبَّنَا آتِنَا نُورًا وَاجْفِرْنَا إِنَّكَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿٥٩﴾

O Zoti ynë! Plotësona dritën tonë dhe falna! Ti pa dyshim je i Plotfuqishëm mbi çdo gjë.⁵⁹

40. Lutje për të kërkuar vdekje gjatë besimit dhe për të pasur fund të mbarë

Pas provës së burgut, Zoti i Madhërishëm i mundësoi Hazret Jusufit^{as} mbretërinë. Kur erdhën vëllezërit e tij së bashku me prindërit, Hazret Jusufi^{as} bëri këtë lutje për ta falënderuar Zotin:

رَبِّ قَدْ آتَيْتَنِي مِنَ الْمُلْكِ وَعَلَّمْتَنِي مِنْ تَأْوِيلِ الْأَحَادِيثِ ﴿٥٩﴾
فَاطِرَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ۗ أَنْتَ وَلِيَّ فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ ﴿٦٠﴾
تَوَفَّنِي مُسْلِمًا وَأَلْحِقْنِي بِالصَّالِحِينَ ﴿٦٠﴾

O Zoti im! Ti më ke dhënë një pjesë nga pushteti dhe më ke mësuar dije për të interpretuar ëndrrat. O Krijuesi i qiejve dhe i tokës! Ti je Miku im në këtë botë dhe në ahiret. Më jep vdekjen kur jam i nënshtruar dhe më bashko me të sinqertët.⁶⁰

41. Lutje e përulur për të kërkuar mirësi

Hazret Abdullah Ibni Abasi^{ra} tregon se në kohën kur Hazret Musai^{as} bëri lutjen e mëposhtme, gjendja e tij ishte kaq e mjerueshme,

59. Kurani Famëlartë 66:9.

60. Kurani Famëlartë 12:102.

saqë qoftë për një kokërr hurme, ai varej nga të tjerët.⁶¹ Pas kësaj lutjeje, Zoti i Madhërishëm jo vetëm që ia rregulloi qëndrimin dhe ushqimin, por i dha familje dhe shtëpi në mërgim.

رَبِّ اِنِّى لِمَا اَنْزَلْتَ اِىَّ مِنْ خَيْرٍ فَقِيْرٌ ﴿١٠﴾

O Zoti im! Çfarëdo mirësie të më dërgosh, unë me të vërtetë jam lypës për të.⁶²

42. Lutje për të kërkuar riskun dhe paqen

Gjatë ndërtimit të Shtëpisë së Allahut, Hazret Ibrahim^{as} i ishte lutur Zotit që t'i siguronte paqe qytetit të Mekës dhe risk banorëve të tij dhe, gjithashtu, fëmijët e tij t'i mbante larg idhujtarisë. Zoti ia pranoi të gjitha këto lutje.⁶³

رَبِّ اجْعَلْ هٰذَا بَلَدًا اٰمِنًا وَاَرْضًا رٰزِقًا لِّاَهْلِهٖ مِنَ النَّحْمٰتِ
مَنْ اٰمَنَ مِنْهُمْ يٰاَللّٰهُ وَاَلْيَوْمَ الْاٰخِرِ

O Zoti im! Bëje këtë qytet të paqes dhe ushqej banorët e tij, që besojnë në Allah dhe në ditën e fundit, me fruta të çdolloji.⁶⁴

43. Lutje për kërkuar të mira materiale dhe shpirtërore për fëmijët

Për të mira materiale dhe shpirtërore të fëmijëve të tij, Hazret Ibrahim^{as} kishte bërë edhe këtë lutje:

61. Tefsir Ed-Durrul-Menthur lis-Sujuti, vëll. 5, f. 125.

62. Kurani Famëlartë 28:25.

63. Tefsir Ed-Durrul-Menthur lis-Sujuti, vëll. 4, f. 86.

64. Kurani Famëlartë 2:127.

رَبَّنَا إِنِّي أَسْكَنْتُ مِنْ ذُرِّيَّتِي بُوَادِعَ ذِي زَرْعٍ عِنْدَ بَيْتِكَ
الْمُحْرَمِ رَبَّنَا لِيُقِيمُوا الصَّلَاةَ فَاجْعَلْ أَفِيدَةً مِنَ النَّاسِ
تَهْوِي إِلَيْهِمْ وَارزُقْهُمْ مِنَ الثَّمَرَاتِ لَعَلَّهُمْ يَشْكُرُونَ ﴿٥٥﴾

O Zoti im! Kam vendosur disa nga fëmijët e mi në një luginë të pambjellë, pranë Shtëpisë Sate të shenjtë o Zoti im, që ata të kryejnë namazin. Bëj që zemrat e njerëzve të anojnë nga ata dhe jepu ushqim prej të vjelave që ata të të falënderojnë. O Zoti ynë! Ti pa dyshim e di atë që ne fshehim dhe atë që e zbulojmë. Për Allahun asgjë nuk është e fshehtë, as në tokë e as në qiell.⁶⁵

44.

رَبِّ اجْعَلْ هَذَا الْبَلَدَ آمِنًا وَاجْنُبْنِي وَبَنِيَّ أَنْ نَعْبُدَ الْأَصْنَامَ ﴿٥٦﴾

O Zoti im! Bëje këtë qytet të paqes dhe më ruaj mua dhe fëmijët e mi nga adhurimi i idhujve.⁶⁶

45. Një lutje e dishepujve të Hazret Isait^{as}

Dishepujt i kishin kërkuar Hazret Isait^{as} që të lutej, që atyre t'u zbriste një sofër qiellore e të kishin ushqim me bollëk. Atëherë Hazret Isai^{as} kishte bërë këtë lutje, së cilës Allahu i Madhërishëm i qe përgjigjur duke thënë se do t'ia jepte sofrën, por kushdo që do të tregohej mosmirënjohës, do ta ndëshkonte rëndë.

65. Kurani Famëlartë 14:38-39.

66. Kurani Famëlartë 14:36.

اللَّهُمَّ رَبَّنَا أَنْزِلْ عَلَيْنَا مَاءً بَارِدًا مِنَ السَّمَاءِ تَكُونُ لَنَا عَيْدًا لَا أَوْلِيَانَا
وَآخِرِنَا وَآيَةً مِنْكَ ۝ وَأَرْزُقْنَا وَأَنْتَ خَيْرُ الرَّزُقِينَ ۝

O Allah! Zoti ynë! Zbritna një sofër prej qiellit, që të jetë festë për ne, për të parin tonë dhe për të fundmin tonë, që të jetë shenjë prej Teje, dhe na ushqe. Ti je Furnizuesi më i mirë.⁶⁷

46. Lutje për të gjetur fuqinë, riskun dhe për të shlyer borxhet

I Dërguari i Allahut^{sas} këshilloi Hazret Muadhini^{ra} që të lexonte këto dy ajete për të shlyer borxhet dhe i tha: “Çdo musliman hallexhi që do t’i lexojë këto dy ajete, Zoti i Madhërishëm do ta lirojë atë nga borxhi dhe nga halli. Mukatili thotë se të Dërguarit të Allahut^{sas} i është mësuar kjo lutje kur ai deshi të triumfonte mbi Persinë dhe Perandorinë Romake”.⁶⁸

اللَّهُمَّ مَلِكِ الْمُلْكِ تُؤْتِي الْمُلْكَ مَنْ تَشَاءُ وَتَنْزِعُ الْمُلْكَ مِمَّنْ
تَشَاءُ ۝ وَتُعِزُّ مَنْ تَشَاءُ وَتُذِلُّ مَنْ تَشَاءُ ۝ بِيَدِكَ الْخَيْرُ ۝ إِنَّكَ عَلَى
كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ۝ تُؤَلِّجُ اللَّيْلَ فِي النَّهَارِ وَتُؤَلِّجُ النَّهَارَ فِي اللَّيْلِ
وَتُخْرِجُ الْحَيَّ مِنَ الْمَيِّتِ وَتُخْرِجُ الْمَيِّتَ مِنَ الْحَيِّ ۝ وَتَرْزُقُ
مَنْ تَشَاءُ بِغَيْرِ حِسَابٍ ۝

O Allah! Zotëruesi i sundimit! Ti i jep sundimin kujt të duash dhe ia merr sundimin kujt të duash. Ti nderon kë të duash dhe poshtëron kë të duash. Mirësia është në dorën Tënde. Ti

67. Kurani Famëlartë 5:115.

68. Tefsir Kurtubi, pj. 4, f. 54.

pa dyshim je i Plotfuqishëm mbi çdo gjë që dëshiron. Ti fut natën te dita dhe ditën te nata. Ti nxjerr të gjallin nga i vdekuri dhe të vdekurin nga i gjalli. Ti i jep pa masë atij që Ti do!⁶⁹

47. Lutje për të kërkuar vendimin dhe fitoren prej Zotit

Hazret Abdullah Ibni Abasi^{ra} tregon se Hazret Shuejbi^{as} kur u zhgënjye nga populli i tij se pse nuk udhëzohej, me anë të kësaj lutjeje i kërkoi Zotit që të lëshonte vendimin e Tij përfundimtar. Pas kësaj, populli i tij u shkatërrua nga një tërmet i fuqishëm.⁷⁰

وَيْعِ رَبَّنَا كُلُّ شَيْءٍ عَلَّمْنَا عَلَى اللَّهِ تَوَكَّلْنَا رَبَّنَا افْتَحْ
بَيْنَنَا وَبَيْنَ قَوْمِنَا بِالْحَقِّ وَأَنْتَ خَيْرُ الْفَاتِحِينَ ﴿٧٠﴾

O Zoti ynë! Ti sundon çdo gjë me dije. Tek Allahu jemi mbështetur. O Zoti ynë! Vendos me drejtësi midis nesh dhe midis popullit tonë. Ti je më i miri prej të gjithë gjykatësve.⁷¹

48. Lutje për të kërkuar ndihmë kur pushtoheni nga të tjerët

Populli i Hazret Nuhut^{as} kur kaloi çdo kufi në mohimin e tij dhe e quajti gënjeshtar, magjistar dhe të ligë, Hazret Nuhu i dërrmuar i bëri këtë lutje Zotit të Madhërishëm:

أَيُّ مَغْلُوبٍ فَاتِحِرٍ ﴿٧٢﴾

(O Zoti im) Jam i pushtuar, më ndihmo!⁷²

69. Kurani Famëlartë 3:27-28.

70. Tefsir Kurtubi, pj. 7, f. 251.

71. Kurani Famëlartë 7:90.

72. Kurani Famëlartë 54:11.

49. Lutje për të kërkuar shenjë vendimtare

Hazret Nuhu^{as} pasi u zhgënje shumë nga populli i tij, iu lut Zotit të shfaqte ndonjë shenjë vendimtare dhe ta shpëtonte atë dhe xhematin e tij. Allahu i Madhërishëm ia dëgjoji lutjen dhe e fundosi popullin e tij në ujë, kurse Nuhun^{as} dhe besimtarët e tij i shpëtoi nëpërmjet një anijeje, të cilën ata e kishin ndërtuar sipas udhëzimit të Zotit. Lutja e Hazret Nuhut^{as} ishte:

رَبِّ إِنَّا قَوْمِي كَذَّبُونِ ۖ فَافْتَحْ بَيْنِي وَبَيْنَهُمْ فَتْحًا
وَنَجِّنِي وَمَنْ مَعِيَ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ ۝

O Zoti im! Populli im më përgënjeshtroi. Prandaj, bëj gjykim të qartë midis meje dhe atyre dhe më shpëto mua dhe besimtarët që janë me mua.⁷³

50. Lutje për mohuesit dhe përgënjeshtresit

Hazret Katada^{ra} tregon se Hazret Nuhu^{as} e mallkoi popullin e tij atëherë kur ai u lajmërua prej Zotit se asnjë prej tyre nuk do ta besonte atë.

رَبِّ لَا تَذَرْ عَلَيَّ الْأَرْضَ مِنَ الْكٰفِرِينَ دَيًّا ۗ إِنَّكَ إِن تَذَرْنَاهُ
يُضِلُّوا عِبَادَكَ وَلَا يَلِدُوا إِلَّا فَاجِرًا كَفَّارًا ۝

O Zoti im! Mos lër askënd prej mohuesve të banojë në tokë. Po i le ata, patjetër do t'i devijojnë robërit e Tu dhe s'do të lindin (gjë tjetër), veçse të ligë dhe mohues të ashpër.⁷⁴

73. Kurani Famëllartë 26:118-119.

74. Kurani Famëllartë 71:27-28.

51. Lutje për të kërkuar falje për veten, për prindërit dhe për besimtarët

Pasi bëri lutjen kundër mohuesve dhe përgënjeshtresve, Hazret Nuhu^{as} u lut për besimtarët:

رَبِّ اغْفِرْ لِي وَلِوَالِدَيَّ وَلِمَنْ دَخَلَ بَيْتِي مُؤْمِنًا وَارْحَمْ الْمُؤْمِنِينَ
وَالْمُؤْمِنَاتِ وَلَا تَزِدِ الظَّالِمِينَ إِلَّا تَبَارًا ۝

O Zoti im! Më fal mua dhe prindërit e mi dhe këdo që hyri në shtëpinë time si besimtar dhe të gjithë besimtarët e besimtare. Ndërsa mizorëve, shtojua vetëm humbjen.⁷⁵

52. Lutje për udhëzimin e njerëzve

Ndër lutjet madhore që bëri Hazret Ibrahim^{as} gjatë ndërtimit të Shtëpisë së Allahut është edhe ajo, në të cilën ai kërkoi udhëzimin e njerëzve. Për këtë lutje i Dërguari i Allahut^{sas} thoshte: “Jam fryt i lutjeve të babait tim Ibrahim”.⁷⁶

رَبَّنَا وَابْعَثْ فِيهِمْ رَسُولًا مِنْهُمْ يَتْلُو آيَاتِكَ وَيُعَلِّمُهُمُ
الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَيُرْسِلُهُمْ إِلَى الْبُرُوجِ الْحَكِيمِ ۝

O Zoti ynë! Dërgoju atyre një të dërguar (i cili të jetë) nga mesi i tyre, që t’u recitojë ajetet e Tua, t’u mësojë librin, urtësinë dhe t’i pastrojë ata. Me të vërtetë, Ti je i Plotfuqishmi, i Urti!⁷⁷

75. Kurani Famëlartë 71:29.

76. Tefsir Kurtubi, pj. 2, f. 117.

77. Kurani Famëlartë 2:130.

53. Lutje për të ndëshkuar armiqtë

Kur Hazret Musai^{as} bëri lutjen e poshtëshënuar, u njoftua prej Zotit që lutja i ishte pranuar dhe mori edhe porosinë që ai vetë të tregohej i qëndrueshëm e të mos ndiqte rrugën e të paditurve:

رَبَّنَا إِنَّكَ آتَيْتَ فِرْعَوْنَ وَمَلَأَهُ زِينَةً وَأَمْوَالًا فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا
رَبَّنَا يُضَلُّوا عَنْ سَبِيلِكَ رَبَّنَا اطْمِسْ عَلَى أَمْوَالِهِمْ وَاشْدُدْ عَلَى
قُلُوبِهِمْ فَلَا يُؤْمِنُوا حَتَّى يَرَوْا الْعَذَابَ الْأَلِيمَ ۝

O Zoti ynë! Ti pa dyshim i ke dhënë Faraonit dhe parisë së tij luks dhe pasuri të jetës së kësaj bote. O Zoti ynë! Mos vallë me qëllim që ata t'i devijojnë (të tjerët) nga rruga Jote?! O Zoti ynë! Shkatërroji pasuritë e tyre dhe shtrëngoji zemrat e tyre, sepse ata nuk do të besojnë derisa të shohin ndëshkimin e dhimbshëm.⁷⁸

54. Lutje për të kërkuar ndihmë kundër popullit keqbërës

Kur Hazret Luti^{as} i bëri vërejtje popullit të tij për sjelljen e tyre dhe u tha që të hiqnin dorë nga veprimet e pamoralshme, ata iu përgjigjën: “Na sill ndonjë ndëshkim, nëse je i vërtetë!” Për këtë, Hazret Luti^{as} u lut:

رَبِّ انصُرْنِي عَلَى الْقَوْمِ الْمُفْسِدِينَ ۝

O Zoti im! Ndhimomë kundër popullit keqbërës.⁷⁹

78. Kurani Famëllartë 10:89.

79. Kurani Famëllartë 29:31.

55. Lutje për të shpëtuar nga ndikimet e popullit keqbërës

Populli jo vetëm që e refuzoi këshillën e Hazret Lutit^{as}, por e kërcënoi Lutin duke thënë: “Po këmbëngule më, do të të dëbojmë nga vendi”. Atëherë Hazret Luti^{as} bëri lutjen që vijon, për të cilën Allahu i Madhërisëm thotë: “Ne ia pranuan lutjen dhe e shpëtuan Lutin dhe familjen e tij, përveç gruas së tij, kurse popullin e tij e shkatërruam”.

رَبِّ نَجِّنِي وَأَهْلِي مِمَّا يَعْمَلُونَ ﴿٨٠﴾

O Zoti im! Shpëtomë mua dhe familjen time nga ajo që bëjnë ata.⁸⁰

56. Lutje për të kërkuar shenjë kundër popullit mohues

Pasi mori parashikimin që do të fitonin Tokën e Shenjtë, Hazret Musai^{as} i porositi njerëzit e tij të hynin në të. Ata e refuzuan. Atëherë Hazret Musai^{as} bëri lutjen e mëposhtme, për shkak të së cilës Toka e Shenjtë iu bë e ndaluar për dyzet vjet.

رَبِّ إِنِّي لَا أَمْلِكُ إِلَّا نَفْسِي وَأَخِي فَافْرِقْ بَيْنَنَا
وَبَيْنَ الْقَوْمِ الْفَاسِقِينَ ﴿٨١﴾

O Zoti im! Nuk kam fuqi për (të bindur) askënd, përveç vetes dhe vëllait tim. Prandaj, na ndaj ne nga populli i pabindshëm.⁸¹

80. Kurani Famëlartë 26:170

81. Kurani Famëlartë 5:26.

57. Lutja e Hazret Musait për t'u treguar mirënjohës ndaj Zotit dhe për t'u distancuar nga të padrejtët

Hazret Musai^{as} me pavetëdije qëlloi për vdekje një njeri dhe për këtë ai i kërkoi falje Zotit. Zoti e njoftoi për faljen, dhe ai bëri këtë lutje falënderimi:

رَبِّ يَمَّا أَنْعَمْتَ عَلَيَّ فَلَنْ أَكُونَ ظَهِيرًا لِّلْمُجْرِمِينَ ﴿٥٧﴾

O Zoti im! Për shkak se më bëre mirësi, nuk do të ndihmoj më keqbërësit.⁸²

58. Lutje për të kërkuar gjykim

Hazret Katada^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} kur shkonte për luftë, ndër të tjera bënte sidomos këtë lutje⁸³:

رَبِّ اخْكُم بِالْحَقِّ ۗ وَرَبَّنَا الرَّحْمَنُ الْمُسْتَعَانُ
عَلَى مَا تَصِفُونَ ﴿٥٨﴾

O Zoti im! Vendos me drejtësi. (O mohues!) Zoti ynë është i Gjithëmëshirshmi, të cilit i kërkohet ndihmë kundër asaj që trilloni ju.⁸⁴

59. Lutje për të kërkuar mëshirë dhe lehtësim në punë

Për banorët e shpellës, Allahu i Madhërishtëm thotë se ata ishin disa burra që u fshehën nëpër shpella për ta mbrojtur njëshmërinë e Zotit, dhe bënë këtë lutje:

82. Kurani Famëlartë 28:18.

83. Tefsir Ed-Durrul-menthur, lis-Sujuti, vëll. 4, f. 342.

84. Kurani Famëlartë 21:113.

رَبَّنَا آتِنَا مِنْ لَدُنْكَ رَحْمَةً وَهَيِّئْ لَنَا مِنْ أَمْرِنَا رَشَدًا ۝

O Zoti ynë! Na jep mëshirë dhe na udhëzo në çështjen tonë!⁸⁵

60. Lutje për të kërkuar pasardhës të dëlirë

Për ta vijuar misionin e tij, Hazret Ibrahim^{as} me këtë lutje i kërkoi Zotit pasardhës të dëlirë, së cilës Zoti iu përgjigj duke thënë se atij do t'i jepte një fëmijë të dhembshur:

رَبِّ هَبْ لِي مِنَ الصَّالِحِينَ ۝

O Zoti im! Dhuromë (trashëgimtar) prej të sinqertëve.⁸⁶

61. Lutje për të kërkuar fëmijë të nënshtruar dhe adhurues të Zotit

Hazret Ibrahim^{as} bëri edhe këtë lutje kur ai dhe i biri, Hazret Ismail^{as}, po rindërtonin Shtëpinë e Allahut:

رَبَّنَا وَاجْعَلْنَا مُسْلِمَيْنِ لَكَ وَمِنْ ذُرِّيَّتِنَا أُمَّةً مُسْلِمَةً لَكَ
وَأَرْسِلْنَا مَتَابِعَنَا وَتُبَّ عَلَيْنَا إِنْكَ أَنْتَ الثَّوَابُ الرَّجِيمُ ۝

O Zoti ynë! Na bëj të bindurit e Tu dhe, edhe prej pasardhësve tanë, bëj një popull Tëndin të bindur, na trego mënyrat e adhurimeve dhe sakrifikimeve tona dhe na prano pendimin duke na mëshiruar! Me të vërtetë, Ti je Pendimpranuesi, Mëshirëbërësi!⁸⁷

85. Kurani Famëlartë 18:11.

86. Kurani Famëlartë 37:101.

87. Kurani Famëlartë 2:129.

62. Lutje për vete e për fëmijët që të bëhen adhurues të Zotit dhe për të kërkuar falje për vete, për prindërit dhe për të gjithë besimtarët

Hazret Ibni Xherixhi^{ra} thotë: “Umeti i Hazret Ibrahimit^{as} ka mbetur gjithnjë adhurues i Zotit”. Ellama Sha’bi thotë: “Aq shumë më gëzon lutja që kanë bërë Hazret Nuhu^{as} dhe Hazret Ibrahimit^{as} për faljen e krejt besimtarëve, burra e gra, saqë nuk do të gëzohesha kaq shumë edhe sikur të kisha gjithë pasurinë botës”.⁸⁸

رَبِّ اجْعَلْنِي مُقِيمَ الصَّلَاةِ وَمِنْ ذُرِّيَّتِي رَبَّنَا وَتَقَبَّلْ دُعَاءِ ﴿٥٨﴾
رَبَّنَا اغْفِرْ لِي وَلِوَالِدَيَّ وَلِلْمُؤْمِنِينَ يَوْمَ يَقُومُ الْحِسَابُ ﴿٥٩﴾

O Zoti im! Më bëj mua dhe pasardhësit e mi ta ngremë namazin dhe, o Zoti ynë, pranoje lutjen! O Zoti ynë! Më fal mua dhe prindërit e mi dhe të gjithë besimtarët ditën kur të bëhet kontrolli.⁸⁹

63. Lutje për të kërkuar aftësinë e vendimmarrjes, sinqeritetin, emër të mirë dhe xhenetin

I Dërguari i Allahut^{sas} tha: “Njeriu pas abdesit, nëse përmend emrin e Allahut dhe e bën këtë lutje të Hazret Ibrahimit^{as}, Allahu i Madhërishëm i jep ushqimin e xhenetit, sëmundjet ia bën shpagim të mëkateve, i dhuron jetë fatbardhë dhe vdekje dëshmore. Mëkatet e tij edhe sikur të jenë aq shumë sa shkuma e detit, do t’i falen. Atij i jepet aftësia e vendimmarrjes, sinqeritet dhe emër i mirë në këtë botë”.⁹⁰

88. Tefsir Ed-Durrul-Menthur, lis-Sujuti, vëll. 4, f. 46.

89. Kurani Famëllartë 14:41-42.

90. Tefsir Ed-Durrul-Menthur, lis-Sujuti, vëll. 4, f. 89.

رَبِّ هَبْ لِي حُكْمًا وَأَلْحِقْنِي بِالصَّالِحِينَ ﴿٩١﴾ وَاجْعَلْ لِي
إِنْسَانَ صِدْقِي فِي الْآخِرِينَ ﴿٩٢﴾ وَاجْعَلْنِي مِنْ وَرَثَةِ جَنَّةِ النَّعِيمِ ﴿٩٣﴾

O Zoti im! Dhuromë urtësinë dhe më bashko me të sinqertët. Te të mëvonshmit, më bëj gjuhë të së vërtetës. Më bëj një ndër trashëgimtarët e xhenetit bekimplotë.⁹¹

64. Lutje për të pasur pushtet dhe forcë të jashtëzakonshme

Lutja e poshtëshënuar e Hazret Sulejmanit^{as} u pranua dhe, edhe njerëzit më rebelë iu nënshtruan atij.

Hazret Salma Ibni El-Ekua^{ra} thotë se i Dërguari i Allahut^{sas} kur bënte ndonjë lutje, përmendte në veçanti atributin El-Uehab (Dhuruesi) të Zotit të Madhërishëm. Për shembull thoshte: *Subhana rabijel A'la El-Uehab*, domethënë *I Shenjtë është Zoti im, i Lartësuar, Dhuruesi*.⁹² Të njëjtën gjë e shohim edhe në lutjen e mëposhtme të Hazret Sulejmanit^{as}:

رَبِّ اغْفِرْ لِي وَهَبْ لِي مُلْكًا لَا يَنْبَغِي لِأَحَدٍ مِّنْ بَعْدِي ﴿٩٤﴾
إِنَّكَ أَنْتَ الْوَهَّابُ ﴿٩٥﴾

O Zoti im! Më fal dhe më dhuro pushtet (të tillë), që pas meje të mos i përkasë askujt. Ti je Dhuruesi i madh.⁹³

91. Kurani Famëlartë 26:84-86.

92. Musned Ahmed, vëll. 4, f. 57.

93. Kurani Famëlartë 38:36.

65. Lutje për të falënderuar Zotin, për të kërkuar mundësinë e veprave të mira dhe pasardhës të dëlirë

Sipas rrëfimeve, i pari që bëri këtë lutje ishte Hazret Ebu Bekri^{ra} dhe Zoti ia pranoi lutjen në atë mënyrë, që prindërit, vëllezërit dhe të gjithë fëmijët e tij e pranuan Islamin.⁹⁴

رَبِّ أَوْزِعْنِي أَنْ أَشْكُرَ نِعْمَتَكَ الَّتِي أَنْعَمْتَ عَلَيَّ وَعَلَى وَالِدَيَّ
وَأَنْ أَعْمَلَ صَالِحًا تَرْضَاهُ وَأَصْلِحْ لِي فِي دَرْجَتِي ۖ إِنَِّّي نَبْتُ إِلَيْكَ
وَإِلَى مِنَ الْمُسْلِمِينَ ۝

O Zoti im! Më mundëso të të falënderoj për bekimin që më dhe mua dhe prindërve të mi; të bëj vepra të mira që Ti i pëlqen dhe m'i përmirëso fëmijët. Unë, sinqerisht, kthehem i penduar te Ti dhe, pa dyshim, jam ndër të nënshtruarit.⁹⁵

66. Edhe një lutje tjetër për të falënderuar Zotin dhe për të kërkuar sinqeritet

Kur ushtria e Hazret Sulejmanit^{as} kaloi nga lugina Nemla, populli i atjeshëm u fut nëpër shtëpi nga frika e saj. Duke e parë këtë, Hazret Sulejmani^{as} bëri lutjen:

رَبِّ أَوْزِعْنِي أَنْ أَشْكُرَ نِعْمَتَكَ الَّتِي أَنْعَمْتَ عَلَيَّ
وَعَلَى وَالِدَيَّ وَأَنْ أَعْمَلَ صَالِحًا تَرْضَاهُ وَأَدْخِلْنِي بِرَحْمَتِكَ
فِي عِبَادِكَ الصَّالِحِينَ ۝

O Zoti im! Më mundëso të të falënderoj për bekimin që më dhe mua dhe prindërve të mi; të bëj vepra të mira që Ti i pëlqen

94. Tefsir Ed-Durrul-Menthur, lis-Sujuti, vëll. 5, f. 41.

95. Kurani Famëllartë 46:16.

dhe me mëshirën Tënde më prano në grupin e robërve të Tu të sinqertë.⁹⁶

67. Lutje për të kërkuar fëmijë të dëlirë

Hazret Zakaria^{as} duke parë fruta jashtë stine te Hazret Merjemja^{as} (e cila ishte nën kujdesin e tij) e pyeti: “Nga të kanë ardhur këto?” “Nga Allahu”, iu përgjigj ajo. Kjo e tërhoqi fuqishëm Hazret Zakarian^{as}, që të bënte lutjen e mëposhtme. Lajmi i pranimit të kësaj lutjeje i erdhi kur ai ende ishte në *mihrab* duke u falur dhe ai u njoftua se do të kishte një fëmijë me emrin Jahja.⁹⁷

رَبِّ هَبْ لِي مِنْ لَدُنْكَ ذُرِّيَّةً طَيِّبَةً ۗ إِنَّكَ سَمِيعُ الدُّعَاءِ ۝

O Zoti im! Dhuromë prej Vetes pasardhës të dëlirë. Ti pa dyshim e dëgjon shumë lutjen.⁹⁸

68. Lutje për të kërkuar fëmijë në moshën e thyer

Se sa bukur e bëri lutjen Hazret Zakaria^{as} për të kërkuar fëmijë në moshën e thyer, na e tregon vetë lutja e tij:

رَبِّ إِنِّي وَهَنَ الْعَظْمُ مِنِّي وَاشْتَعَلَ الرَّأْسُ شَيْبًا وَلَدَأْكَمِنِّي بَدْعًا يَا
رَبِّ شَقِيًّا ۝ وَإِنِّي خِفْتُ الْمَوَالِيَ مِنْ وَرَائِي وَكَانَتِ امْرَأَتِي
عَاقِرًا فَهَبْ لِي مِنْ لَدُنْكَ وَلِيًّا ۖ فَرَّبْتَنِي وَأَيُّكَ مِنَ الْيَعْقُوبِ
وَاجْعَلْهُ رَبِّ رَضِيًّا ۝

O Zoti im! Eshtrat më janë dobësuar. Koka më është zbardhur nga thinjat, por, o Zoti im, kurrë nuk kam dalë i pafat kur të

96. Kurani Famëlartë 27:20.

97. Kurani Famëlartë 3:30-38.

98. Kurani Famëlartë 3:39.

jam lutur Ty. Unë kam frikë nga ortakët e mi pas meje, ndërsa gruan e kam shterpë. Pra, dhuromë një trashëgimtar, që të më trashëgojë edhe mua dhe të trashëgojë edhe familjen e Jakubit. Dhe, o Zoti im, bëje atë shumë të pëlqyer.⁹⁹

69. Lutje për të shpëtuar nga vetmia dhe për të pasur trashëgimtarë të denjë

Allahu i Madhërishëm thotë se kur Hazret Zakaria^{as} bëri këtë lutje, Ai ia pranoi duke ia përmirësuar shëndetin bashkëshortes së tij dhe duke i dhënë Jahjanë.

رَبِّ لَا تَذُرْنِي قَرْوًا وَأَنْتَ خَيْرُ الْوَارِثِينَ ۝

O Zoti im! Mos më lër vetëm. Ti je më i miri nga të gjithë trashëgimtarët.¹⁰⁰

70. Lutje për të kërkuar bashkëshorte e fëmijë të dëlirë dhe për t'u bërë model i mirë për ta

Duke përmendur cilësitë e robërve të të Gjithëmëshirshmit, Kurani Famëlartë thotë se ata luten kështu:

رَبَّنَا هَبْ لَنَا مِنْ أَزْوَاجِنَا وَذُرِّيَّاتِنَا قُرَّةَ أَعْيُنٍ
وَاجْعَلْنَا لِلْمُتَّقِينَ إِمَامًا ۝

O Zoti ynë! Dhurona prej bashkëshorteve dhe fëmijëve tanë prehjen e syve dhe bëna udhëheqës të të devotshmëve.¹⁰¹

99. Kurani Famëlartë 19:5-7.

100. Kurani Famëlartë 21:90.

101. Kurani Famëlartë 25:75.

71. Lutje për të kërkuar mëshirë për prindërit, për shkak të mirësive të tyre

Zoti i Madhërishëm i mësoi të Dërguarit të Allahut^{sas} dhe *umetit* të tij këtë lutje për prindërit. I Dërguari i Allahut^{sas} thotë: “Fëmija nuk mund t’ua shpërblejë prindërve derisa ta lirojë të atin nga skllavëria”.¹⁰²

رَبِّ اَرْحَمُهُمَا كَمَا رَبَّيْنِي صَغِيرًا

O Zoti im! Mëshiroji të dytë, në atë mënyrë, siç ata më kanë rritur kur unë isha i vogël.¹⁰³

72. Lutje për të hipur në anije

Kur ndodhën përmbytjet, Hazret Nuhu^{as} me udhëzimin hyjnor kishte bërë këtë lutje duke hipur në anije. Anija e tij u ndal në majën e malit Xhudi. I Dërguari i Allahut^{sas} thoshte se kjo lutje për umetin tim është një garanci që ai nuk do të fundoset.¹⁰⁴

بِسْمِ اللّٰهِ مَجْرَبَهَا وَمُرْسَاهَا اِنَّ رَبِّي لَغَفُورٌ رَّحِيْمٌ

Me emrin e Allahut bëhet lundrimi dhe ankorimi i saj. Zoti im pa dyshim është shumë Mëkatfalës, Mëshirëbërës.¹⁰⁵

73. Lutje tjetër për të hipur në anije

Allahu i Madhërishëm e udhëzoi Hazret Nuhun^{as} që, kur të hipte në anije, së pari të thoshte: “Lavdia është e Allahut që na shpëtoi

102. Muslimi, Kitabul-itk, bab fadli itkil-ualid.

103. Kurani Famëlartë 17:25.

104. Tefsir Kurtubi, pj. 9, f. 37.

105. Kurani Famëlartë 11:42.

nga populli mizor”, e më pas të bënte lutjen e mëposhtme. Këtë lutje Hazret Aliu^{ra} e bënte edhe kur hynte në xhami.¹⁰⁶

رَبِّ أَنْزِلْنِي مُنْزَلًا مُّبْرَكًا وَأَنْتَ خَيْرُ الْمُنْزِلِينَ ﴿١٠٧﴾

O Zoti im! Më zbarko në një vend të bekuar dhe Ti je zbarkuesi më i mirë.¹⁰⁷

74. Lutje për të hipur në mjet udhëtimiti

Profeti Muhammed^{sas} kur hipte në mjet udhëtimiti thoshte tri herë: “*Subhanallah, Elhamdulil-lah, Allahu ekber*” (i Shenjtë është Allahu, lavdia është e Allahut, Allahu është më i Madhi), dhe më pas bënte këtë lutje:¹⁰⁸

سُبْحَانَ الَّذِي سَخَّرْنَا هَذَا وَمَا كُنَّا لَهُ مُقْرِنِينَ ﴿١٠٩﴾
وَإِنَّا إِلَىٰ رَبِّنَا لَمُنْقَلِبُونَ ﴿١١٠﴾

I Shenjtë është Ai që na e nënshtroi këtë dhe ne vetë nuk mund ta nënshtonim. Ne pa dyshim te Zoti ynë do të kthehemi.¹⁰⁹

75. Besimi në madhësinë absolute të Zotit dhe në premtimet e Tij

I Dërguari i Allahut^{sas} thotë se lutja e mëposhtme shërben edhe për të gjetur sendet e humbura dhe për të kompensuar sendet e prishura.¹¹⁰

106. Tefsir Kurtubi, pj. 12, f. 120.

107. Kurani Famëlartë 23:30.

108. Muslimi, Kitabul-haxh, bab ma jekulu idha rekiba.

109. Kurani Famëlartë 43:14-15.

110. Ed-Durrul-Menthur, lis-Sujuti, vëll. 2, f. 9.

رَبَّنَا إِنَّكَ جَامِعُ النَّاسِ لِيَوْمٍ أَلَيْسَ فِيهِ
إِنَّ اللَّهَ لَا يُخْلِفُ الْمِيعَادَ ۝

O Zoti ynë! Ti je Mbledhësi i njerëzve për ditën, në të cilën nuk ka dyshim. Me të vërtetë, Allahu nuk e shkel premtimin.¹¹¹

76. Lutje për të pasur fillim dhe fund të mbarë dhe ndihmë të veçantë të Zotit

Hazret Abdullah Ibni Abasi^{ra} rrëfen: “Pak para se të ndodhte mërgimi drejt Medinës, të Dërguarit të Allahut^{sas} iu zbrit ajeti i mëposhtëm, i përbërë nga një lutje.¹¹² Kjo lutje është e provuar për të pasur fillim dhe fund të mbarë në çdo punë të mirë”.

رَبِّ أَدْخِلْنِيْ مُدْخَلَ صِدْقِيْ وَأَخْرِجْنِيْ مُخْرَجَ صِدْقِيْ
وَاجْعَلْ لِّيْ مِنْ لَّدُنْكَ سُلْطٰنًا نَّصِيْرًا ۝

O Zoti im! Më mundëso hyrjen me vërtetësi dhe daljen me vërtetësi dhe më jep prej Vetes Sate ndihmës të fuqishëm.¹¹³

77. Lutje që veprat të kenë peshë

I Dërguari i Allahut^{sas} tha: “Kushdo që lexon këto ajete pas namazit ose pas mbarimit të mbledhjes, Zoti i Madhërishëm do t'i vlerësojë shumë veprat e tij në ditën e gjykimit”.¹¹⁴

111. Kurani Famëlartë 3:10.

112. Buhariu dhe Muslimi.

113. Kurani Famëlartë 17:81.

114. Tefsir Ed-Durrul-Menthur, lis-Sujuti, vëll. 4, f. 295.

سُبْحَانَ رَبِّكَ رَبِّ الْعِزَّةِ عَمَّا يَصِفُونَ ۗ وَسَلَامٌ عَلَى الْمُرْسَلِينَ ۗ
وَالْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ ۗ

I pastër është Zoti yt, Zoti i nderit, nga gjithçka që trillojnë ata. Paqja qoftë mbi të dërguarit dhe lavdia është e Allahut, Zotit të botëve!¹¹⁵

78. Lutje për t'u dërguar paqe njerëzve të zgjedhur të Zotit

Zoti i Madhërishëm i mësoi Profetit Muhammed^{sas} këtë lutje për t'u dërguar paqe njerëzve të zgjedhur të Tij:

الْحَمْدُ لِلَّهِ وَسَلَامٌ عَلَى عِبَادِهِ الَّذِينَ اصْطَفَىٰ
اللَّهُ خَيْرٌ أَمَّا يُشْرِكُونَ ۗ

Lavdia është e Allahut dhe paqja qoftë mbi robërit e Tij, të cilët Ai i ka zgjedhur. A është më i mirë Allahu apo ai që ata ia bëjnë ortak?!¹¹⁶

79. Lutje për t'u kthyer tek Allahu dhe për të treguar besim të përsosur

Hazret Musai^{as} kur nuk përballoi dot një shfaqje të madhësisë së Zotit, i ra të fikët. Pasi e mori veten, ai bëri këtë lutje:

115. Kurani Famëlartë 37:181-183.

116. Kurani Famëlartë 27:60.

سُبْحَانَكَ تَبَّتْ إِلَيْكَ وَ أَنَا أَوَّلَ الْمُؤْمِنِينَ ﴿١١٧﴾

I Shenjtë je Ti. Po kthehem i penduar te Ti dhe unë jam i pari ndër besimtarët.¹¹⁷

80. Lutje për ta pasur Zotin të mjaftueshëm

Hazret Ibrahim^{as} këtë lutje e kishte bërë kur e hodhën në zjarr kundërshtarët e tij.¹¹⁸

حَسْبُنَا اللَّهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ ﴿١١٨﴾

Neve na mjafton Allahu dhe sa Kujdestar i mirë është Ai!¹¹⁹

81. Lutje për të kërkuar vendim hyjnor

Rreth lutjes që vijon, Seid Ibni Hasna thotë: Unë di një ajet me të cilin çfarëdo që t'i kërkojë robi Zotit, Ai ia jep. Me këtë lutje i Dërguari i Allahut^{sas} niste namazin e *tehexhudit* dhe para saj shtonte edhe fjalët: “O Allah! Zoti i Xhibrailit, i Mikailit dhe i Israfilit!”¹²⁰

اللَّهُمَّ فَاطِرَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ عَلِمَ الْغَيْبِ وَالْقَهَادَةِ
أَنْتَ تَحْكُمُ بَيْنَ عِبَادِكَ فِي مَا كَانُوا فِيهِ يَخْتَلِفُونَ ﴿١٢١﴾

O Allah! Krijuesi i qiejve dhe i Tokës! I Dijshmi i së fshehtës dhe i të dukshmes! Ti do të gjykosh robërit e Tu për (çdo) çështje ku ata kundërshtojnë.¹²¹

117. Kurani Famëlartë 7:144.

118. Buhariu, Kitabut-tefsir, sure Ali-Imran.

119. Kurani Famëlartë 3:174.

120. Tefsir Kurtubi, pj. 15, f. 265.

121. Kurani Famëlartë 39:47.

82. Lutje për të pasur ndihmën hyjnore gjatë kundërshtimit nga populli

Për shkak të lutjes së Hazret Nuhut^{as} që vijon, Allahu i Madhërishëm e shpëtoi atë nga furtuna dhe nga populli përmes një anijeje.

رَبِّ انصُرْنِي بِمَا كَذَّبْتَنِي ﴿٧٧﴾

O Zoti im! Ndhimomë, sepse ata më kanë përgënjeshtuar.¹²²

83. Shfaqja e besimit kur i dëgjon premtimet hyjnore

Besimtarët dijeplotë kur dëgjojnë fjalën e Zotit, bien në sexhde te pragu i Tij dhe i luten:

سُبْحَانَ رَبِّنَا إِنْ كَانَ وَعْدُ رَبِّنَا لَمَفْعُولًا ﴿٢٠﴾

I Shenjtë është Zoti ynë. Premtimi i Zotit tonë do të përmbushet pashmangshmërisht.¹²³

84. Lutje që duhet bërë në mëngjes e në mbrëmje për të kompensuar gabimet

Hazret Abdullah Ibni Abasi^{ra} rrëfen se i Dërguari i Allahut^{sas} ka thënë: “Ai që lexon këto ajete në mëngjes, i kompenson paraprakisht gabimet që bën gjatë ditës që vjen dhe ai që i lexon në mbrëmje, i kompenson gabimet që bën gjatë natës që vjen.”¹²⁴

122. Kurani Famëlartë 23:27.

123. Kurani Famëlartë 17:109.

124. Ebu Daudi, Kitabul-adab, bab ma jekulu idha asbaha.

فَسَبِّحْ لِلَّهِ حِينَ تُمْسُونَ وَحِينَ تُصْبِحُونَ ۝ وَلَهُ الْحُكْمُ
فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَعَشِيًّا وَحِينَ تُظْهِرُونَ ۝ يُخْرِجُ الْحَيَّ
مِنَ الْمَيِّتِ وَيُخْرِجُ الْمَيِّتَ مِنَ الْحَيِّ وَيُحْيِي الْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا
وَكَذَلِكَ تُخْرَجُونَ ۝

Pra, Allahu është i Pastër (në çdo rrethanë), edhe atëherë kur ngryseni, edhe atëherë kur gdiheni. E Atij është lavdia në qiej e në Tokë. Edhe kur errësohet, edhe kur hyni në mesditë. Ai nxjerr të gjallin nga i vdekuri dhe nxjerr të vdekurin nga i gjalli. Ai ngjall tokën pas vdekjes së saj. Në këtë mënyrë do të nxirreni edhe ju.¹²⁵

85. Lutja e besimtarëve kur janë në vështirësi

Besimtarët e durueshëm të Zotit, kur i kap ndonjë vështirësi a fatkeqësi, bëjnë lutjen që vijon, për shkak të së cilës ata gëzojnë mëshirën dhe bekimet e Zotit të tyre dhe konsiderohen të udhëzuar.¹²⁶

Hazret Husejn Ibni Aliu^{ra} tregon se besimtari që bën këtë lutje gjatë vështirësisë, Zoti i Madhërishëm në të njëjtën masë ia kompenson me shpërblim.¹²⁷

Kjo është arsyeja që edhe sendet e humbura gjenden me anë të kësaj lutjeje:

إِنَّا لِلَّهِ وَإِنَّا إِلَيْهِ رَاجِعُونَ ۝

Sigurisht, jemi të Allahut dhe tek Ai do të kthehemi.¹²⁸

125. Kurani Famëlartë 30:18-20.

126. Kurani Famëlartë 2:158-156.

127. Ibni Maxha, Kitabul-xhenaiz, bab ma xha'a fis-sabr.

128. Kurani Famëlartë 2:157.

86. Lutje për t'ia dedikuar fëmijën Zotit

Nëna e Hazret Merjemes^{as} këtë lutje e bëri për t'ia dedikuar Zotit të Madhërishëm fëmijën që kishte në bark, lutje të cilën Zoti ia pranoi dhe asaj i dha një vajzë jashtëzakonisht të dëlirë, që ishte pikërisht Hazret Merjemja^{as}.

رَبِّ اِنِّي نَذَرْتُ لَكَ مَا فِي بَطْنِي مُحَرَّرًا فَتَقَبَّلْ مِنِّي
اِنَّكَ اَنْتَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ ﴿١٢٩﴾

O Zoti im! Atë që kam në barkun tim, ta kam dedikuar Ty, duke e liruar (nga çështjet e botës). Pranoje këtë prej meje! Pa dyshim, Ti je Dëgjuesi, i Gjithëdijshmi.¹²⁹

87. Lutja e robërve të Zotit përballë përbuzjes së përgënjeshtresve

Mohuesit dhe përgënjeshtresit e shenjave të Zotit të Madhërishëm kur të pranojnë fajin e tyre në ditën e gjykimit, Zoti i Madhërishëm do t'u thotë: *“Shporruni dhe mos komunikoni me Mua, sepse keni përqeshur robërit e Mi që bënë këtë lutje”*. Gjithashtu, Zoti do t'i njoftojë robërit e tij që, për shkak të durimit të tyre, Ai i ka shpërblyer shumë. Lutja e robërve të Zotit është si vijon:

رَبَّنَا اَمَّا فَاغْفِرْ لَنَا وَاَرْحَمْنَا وَاَنْتَ خَيْرُ الرَّحِيمِينَ ﴿١٣٠﴾

O Zoti ynë! Ne besuam! Prandaj, falna dhe mëshirona! Ti je më i miri prej të gjithë mëshiruesve.¹³⁰

129. Kurani Famëlartë 3:36.

130. Kurani Famëlartë 23:110.

88. Lutje që duhet bërë në mëngjes e në mbrëmje për të larguar brengat

Hazret Ebu Derda^{ra} tregon se ai që bën këtë lutje në mëngjes e në mbrëmje nga shtatë herë, Allahu i Madhërishëm do t'ia largojë brengat që ai ka për botën dhe për përtejbotën.¹³¹

حَسْبِيَ اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ عَلَيْهِ تَوَكَّلْتُ
وَهُوَ رَبُّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ ۝

Më mjafton Allahu. Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Tij. Tek ai u mbështeta. Ai është Zoti i arshit madhështor.¹³²

89. Lutje për të pasur mbrojtjen e Zotit nga çdo e keqe

Hazret Abdullahu^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} ka thënë: “Lexoni tri suret e fundit të Kuranit para se të flini gjatë natës, sepse ato janë të pashoqe për të kërkuar mbrojtje”.¹³³

Hazret Ajshja^{ra} rrëfen: “Sa herë që i Dërguari i Allahut^{sas} sëmurej, lexonte dy suret e fundit të Kuranit dhe frynte në trupin e tij. Në ditët e fundit të jetës së tij, kur gjendja iu përkeqësua, unë i lexoja këto sure, fryja në duart e mia dhe ia fërkoja trupin”.¹³⁴

131. Ebu Daud, Kitabul-adab, bab ma jekulu idha asbaha.

132. Kurani Famëlartë 9:129.

133. Nisai, Kitabul-istiadha, bab 1.

134. Buhariu, Kitab fadailil-Kuran, bab fadili-muavadhat.

89. Surja *El-IKHLAS*

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ ۝ اللَّهُ الصَّمَدُ ۝ لَمْ يَلِدْ ۝ وَلَمْ يُولَدْ ۝
وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ ۝

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.
Thuaj: Ai, Allahu është i Vetëm. Allahu është i Pavaruri. Ai nuk ka lindur (askënd) dhe as nuk është i lindur. Askush nuk ka qenë asnjëherë i barabartë me Të.¹³⁵

90. Surja *El-Felek*

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ ۝ مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ ۝ وَمِنْ شَرِّ
عَاسِقٍ إِذَا وَقَبَ ۝ وَمِنْ شَرِّ النَّفَّاثَاتِ فِي الْعُقَدِ ۝
وَمِنْ شَرِّ حَاسِدٍ إِذَا حَسَدَ ۝

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.
Thuaj: Kërkoj mbrojtjen e Zotit të agimit; nga e keqja e asaj që Ai ka krijuar; nga e keqja e errësuesit kur sjell errësi; nga e keqja e atyre që fryjnë në nyje dhe nga e keqja e ziliqarit kur shpreh zili.¹³⁶

135. Kurani Famëlartë 112:1-5.

136. Kurani Famëlartë 113:1-6.

91. Surja En-Nas

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ
مَلِكِ النَّاسِ إِلَهِ النَّاسِ
مِنْ شَرِّ الْوَسْوَاسِ الْخَنَّاسِ
الَّذِي يُوَسْوِسُ فِي صُدُورِ النَّاسِ
مِنَ الْجِنَّةِ وَالنَّاسِ

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit. Thuaj: Kërkoj mbrojtjen e Zotit të njerëzve; të Sunduesit të njerëzve; të Adhuruarit të njerëzve, nga e keqja e pëshpëritjes së djallit që fshihet pas pëshpëritjes, që pëshpërit në zemrat e njerëzve; qoftë të xhindëve, qoftë të njerëzve.¹³⁷

92. Një lutje e bukur për pranimin e adhurimeve dhe lutjeve

Gjatë rindërtimit të Shtëpisë së Allahut, Hazret Ibrahim^{as} ka bërë disa lutje. Lutja e fundit e tij ishte:

رَبَّنَا تَقَبَّلْ مِنَّا إِنَّكَ أَنْتَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ

O Zoti ynë! Pranoje këtë prej nesh! Me të vërtetë, Ti je Dëgjuesi, i Dijshmi!¹³⁸

137. Kurani Famëlartë 114:1-7.

138. Kurani Famëlartë 2:128.

PJESA II

Lutjet dhe përgjërimet e Profetit Muhammed

paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të

Parathënie

Me rastin historik të njëqindvjetorit të Xhematit, më 1989, i bëra kërkesë Hazret Kalifit të Katërt^{ra} që, duke hyrë në shekullin e dytë, do të ishte mirë t'i bënim dhuratë Xhematit një përmbledhje me të paktën 100 lutje të Profetit Muhammed^{sas}. Kalifi, me shumë mirësi, tha: “Ide shumë e mirë është kjo”, dhe më ngarkoi ta realizoja këtë detyrë. Kështu, gjatë *xhelsa salanës* së Anglisë të vitit 1989, Zoti më mundësoi t’ia paraqisja Kalifit përmbledhjen, të cilën ai ia dërgoi Drejtorit të Botimeve, z. Sejid Abdul Heji, për të marrë këshillë. Ai këshilloi që kjo përmbledhje të mos kufizohet vetëm deri në njëqind lutje, por t’i shtohen edhe disa lutje të tjera të dobishme e të praktikuara nga Profeti Muhammed^{sas}. Pasi iu shtuan edhe ato, Hazret Kalifi i Katërt^{ra} dha miratimin e botimit të kësaj përmbledhjeje, e cila, deri më tani është botuar disa herë këtu në Rabvah, nëpërmjet Shakur Bhait dhe në Kadian, nëpërmjet Drejtorisë së Botimeve.

Ndihej fort nevoja e një përmbledhjeje që sillte lutjet e Profetit Muhammed^{sas}. Inshallah, me anë të këtij libri kjo nevojë do të përmbushet më së miri, në të cilin te çdo lutje është përmendur edhe historiku i saj!

Një aspekt shumë i bukur i udhëheqësit tonë, Hazret Muhammedit^{sas}, është larmishmëria e tij, që rrezatonte jo vetëm në punët e tij të përditshme, por edhe në lutjet e tij. Kjo është arsyeja se për një punë të caktuar shpesh gjejmë disa lutje të tij. Me këtë shumëllojshmëri lutjesh të tij, mbase ai synonte jo vetëm përqendrimin, por edhe

pasqyrimin e realitetit dhe që përsëritja e disa lutjeve të mësuara përmendsh të mos bëhej thjesht një rit.

Në pjesën e parë të kësaj përmbledhjeje, që përbëhet nga më shumë se dyqind lutje, ju sjellim lutjet që Profeti^{sas} bënte në raste të caktuara, kurse në pjesën e dytë të tij do të gjeni lutjet e tij të ndryshme, që ai vazhdimisht i bëri Zotit të Madhërishëm me sinqeritet, përlulesi dhe përgjërime. Përzgjedhja e fjalëve dhe thellësia e kuptimeve të këtyre lutjeve përbëjnë dëshmi të gjallë se ky Profet analfabet ka pasur aftësinë më të lartë shprehëse.

Këto përgjërime, nga njëra anë, hedhin dritë mbi përlulesinë e skajshme dhe besimin e palëkundur të Profetit^{sas} ndaj Zotit të Madhërishëm dhe, nga ana tjetër, rrezatojnë fuqishëm dashurinë ndaj Zotit që dallgëzonte në zemrën e tij të sinqertë.

E vërteta është se Profeti Muhammed^{sas} na bëri mirësi shumë të madhe, duke na lënë një thesar kaq të paçmueshëm lutjesh. Që t'i jemi mirënjohës, nuk kemi ndonjë rrugë tjetër, përveçse të lutemi për të e t'i dërgojmë *salavate* atij.

Zoti bëftë që, përmes këtyre lutjeve, ne të gëzojmë dashurinë ndaj Tij dhe ndaj të dashurit të Tij dhe të gëjmë bekimin e pranimit të lutjes! Amin!

سُبْحَانَ اللَّهِ وَبِحَمْدِهِ سُبْحَانَ اللَّهِ الْعَظِيمِ
اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ وَآلِ مُحَمَّدٍ

I Shenjtë është Allahu, me lavdinë e Tij! I Shenjtë është Allahu, i Madhërishmi! O Allah! Lartësoje Muhammedin dhe popullin e Muhammedit.

Në këmbim të kësaj dhurate të bukur me lutje, do t'u bëja kërkesë modeste vëllezërve dhe motrave për lutje të veçanta edhe për mua. Allahu i Madhërishëm na mundësoftë të bëjmë lutje të pranueshme, sipas praktikës së të Dërguarit të Allahut^{sas}! Amin!

Gjatë botimit të dytë, në vitin 2000, kjo përmbledhje për herë të parë u radhit në kompjuter dhe u botua me disa lutje shtesë. Më pas, në botimin e 2005-ës, iu shtuan edhe lutje të tjera. Në 2014-ën, kjo përmbledhje u botua sërish, pas rishikimit të referencave, punë të cilën e realizoi z. Asif Halil, misionar i Xhematit. Për rishikimin e përkthimit të lutjeve në gjuhën urdu, kanë kontribuar z. Ataun-Nur dhe z. Basil Ahmed Basharat, të dy misionarë të Xhematit. Allahu i shpërbleftë të gjithë!

Allahu i Madhërishëm shpërbleftë edhe Shakur Bhain, i cili vijon ta botojë këtë libër për dobinë e të gjithëve!

Ues-selam

Kërkues i lutjeve

Hafiz Muzaffar Ahmad

Lutje për të kërkuar bekimet e Zotit në synime e në vepra

Hazret Ebu Bekri^{ra} rrëfen se, kurdoherë që i Dërguari i Allahut^{sas} dëshironte të bënte ndonjë punë, lutej:

اللَّهُمَّ خِرْلِيْ وَاخْتَرْلِيْ

O Allah! Më mundëso të mirën dhe më mundëso të bëj zgjedhjen e duhur!¹³⁹

Lutje për të gjetur dashurinë e Zotit

Abdullah ibni Jezid El-Ensari^{ra} thotë se njëra ndër lutjet që bënte i Dërguari i Allahut^{sas} ishte edhe kjo:

اللَّهُمَّ ارْزُقْنِيْ حُبَّكَ وَحُبَّ مَنْ يُّنْفَعُنِيْ حُبُّهُ عِنْدَكَ اللَّهُمَّ مَا رَزَقْتَنِيْ
بِمَا أَحِبُّ فَاجْعَلْهُ قُوَّةً لِّيْ فِيْمَا تُحِبُّ، وَمَا رَزَوَيْتَ عَنِّيْ بِمَا أَحِبُّ
فَاجْعَلْهُ فَرَاغًا لِّيْ فِيْمَا تُحِبُّ-

O Allah! Dhuromë dashurinë Tënde, dashurinë e atij, dashuria e të cilit më bën dobi pranë Teje. O Allah! Atë që më ke dhuruar dhe që e dua, ktheje në forcë për mua për të fituar atë që Ti e do. Atë që Ti ma largon prej meje dhe që e dua, zëvendësoje me atë që Ti e do.¹⁴⁰

Një lutje e Hazret Daudit^{as}

Hazret Ebu Darda^{ra} tregon se Hazret Daudi^{as}, që e adhuronte Zotin më shumë se kushdo tjetër, për të pasur dashurinë e Zotit bënte këtë lutje:

139. Tirmidhiu, Kitabud-da'vat, bab 86.

140. Tirmidhiu, Kitabud-da'vat, bab 74.

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ حُبَّكَ وَحُبَّ مَنْ يُحِبُّكَ وَالْعَمَلَ الَّذِي يُبَلِّغُنِي
حُبَّكَ ، اللَّهُمَّ اجْعَلْ حُبَّكَ أَحَبَّ إِلَيَّ مِنْ نَفْسِي وَمَالِي وَأَهْلِي وَمِنْ
الْمَاءِ الْبَارِدِ-

O Allah! Të kërkoj dashurinë Tënde! Dashurinë e atij që Ti e do; veprën që më sjell te dashuria Jote! O Allah! Dashurinë Tënde bëje për mua më të dashur sesa vetja ime, pasuria ime, familja ime dhe uji i ftohtë!¹⁴¹

Lutje për të shkuar në banjë

Hazret Enesi^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} kur shkonte për të kryer nevojat personale, bënte këtë lutje:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْخُبْثِ وَالْخَبَائِثِ-

O Allah! Më mbro nga e ndyra dhe të ndyrat!¹⁴²

Lutje për të dalë nga banja

Hazret Ajshja^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} kur kthehej nga kryerja e nevojave personale, bënte këtë lutje:

غُفْرَانَكَ

Të kërkoj falje (o Zot)!¹⁴³

141. Tirmidhiu, Kitabud-da'vat, bab 74.

142. Buhariu, Kitabut-da'vat, bab ed-dua endal-khala.

143. Tirmidhiu, Kitabut-tahara, bab ma jekulu idha kheraxha minel khala.

Hazret Ebu Dherr Gefari^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} kur kthehej nga kryerja e nevojave personale, bënte këtë lutje:

الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي أَذْهَبَ عَنِّي الْأَذَى وَعَافَانِي-

Lavdia është e Allahut, që ma largoi shqetësimin dhe më dha shëndet!¹⁴⁴

Lutje për abdes

Hazret Omer Ibnil-Hatabi^{ra} rrëfen se i Dërguari i Allahut^{sas} kur mbaronte abdesin, thoshte këto fjalë:

أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ وَأَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ
وَرَسُولُهُ- أَللَّهُمَّ اجْعَلْنِي مِنَ التَّوَّابِينَ وَاجْعَلْنِي مِنَ الْمُتَطَهِّرِينَ-

Dëshmoj se nuk ka të adhurar tjetër përveç Allahut. Ai është i Vetëm, i Pashoq. Dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i Dërguari i Tij. O Allah! Më bëj ndër të penduarit dhe ndër të pastrit.

I Dërguari i Allahut^{sas} gjithashtu thoshte, se ai që lutet në këtë mënyrë pas abdesit, i hapen dyert e xhenetit.¹⁴⁵

Lutje gjatë ezanit

Hazret Ebu Said Hudriju^{ra} thotë se i Dërguari i Allahut^{sas} ka thënë: “Kur të dëgjoni ezanin, përsëritni fjalët e myezinit”. Gjithashtu thuhet nga Hazret Omeri^{ra}: “Ai që i përsërit me sinqeritetin e zemrës fjalët e ezanit bashkë me myezinin dhe kur thuhet Haj-ja alas-salat dhe Haj-ja alal-falah, thotë:

144. Ibni Maxha, Kitabut-tahara, bab ma jekulu idha kheraxha minel khala.

145. Tirmidhiu, Kitabut-tahara, bab ma jekulu ba'del-uedu.

لَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ

“Sundim dhe fuqi s’ka askush tjetër përveç Allahut”,

do të hyjë në xhenet”.¹⁴⁶

Lutje pas ezanit

Hazret Xhabir Ibni Abdullah^{ra} rrëfen se i Dërguari i Allahut^{sas} ka thënë:

Ai që lutet me këto fjalë pas dëgjimit të ezanit, do të meritojë ndërmjetësimin tim në ditën e gjykimit:

اللَّهُمَّ رَبِّ هَذِهِ الدَّعْوَةُ التَّامَّةُ وَالصَّلَاةُ الْقَائِمَةُ مُحَمَّدٌ الْوَسِيْلَةُ
وَالْفَضِيْلَةُ وَأَبْعَثْ مَقَامًا مَحْمُودًا الَّذِي وَعَدْتَهُ، إِنَّكَ لَا تُخْلِفُ الْمِيْعَادَ -

O Allah! O Zoti i kësaj thirrjeje të përsosur dhe namazit të ngritur! Dhuroji Muhammedit (sa) mundësinë e ndërmjetësimit, epërsinë, nivelin e lartë dhe caktoje atë në gradën e pëlqyer që Ti ia premtove.¹⁴⁷

Lutje kur del nga shtëpia për namaz

Hazret Ebu Seid Hudrij^{ra} thotë: “Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut^{sas} duke thënë se ai që bën këtë lutje gjatë kohës kur del nga shtëpia për namaz, Allahu i Madhërishëm i cakton shtatëdhjetë mijë engjëj, të cilët kërkojnë falje për të dhe Vetë Allahu i Madhërishëm i kushton vëmendje namazit të tij:

146. Muslimi, Kitabus-salat, bab istixhabul-keul mithl ue kulil-muadhin.

147. Buhariu, Kitabul-adhan, bab ed-dua endan-nida; Sunen El-Kubra, vëll. 1, f. 410.

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ بِحَقِّ السَّائِلِينَ عَلَيْكَ وَبِحَقِّ مُمْشَايَ هَذَا فَإِنِّي لَمْ
أَخْرُجْ أَشْرًا وَلَا بَطْرًا وَلَا رِيَاءً وَلَا سُمْعَةً خَرَجْتُ هَرْبًا وَفِرَارًا مِنْ ذُنُوبِي
إِلَيْكَ خَرَجْتُ إِتْقَاءَ سُخْطِكَ، وَابْتِغَاءَ مَرْضَاتِكَ فَاسْأَلُكَ أَنْ تُعِيدَنِي
مِنَ النَّارِ وَأَنْ تُغْفِرَ لِي ذُنُوبِي-

O Allah! Të kërkoj me të drejtën që gëzojnë kërkimtarët pranë Teje dhe me të drejtën e ardhjes sime drejt Teje. Ti e di që mua nuk më ka nxjerrë (nga shtëpia) as krenaria e as mburrja, as reklamimi e as dukja, por kam dalë për t’u larguar e për të ikur nga mëkatet e mia e për të ardhur te Ti. Kam dalë duke shpresuar mëshirën Tënde dhe duke u frikësuar prej ndëshkimit Tënd. Kam dalë duke iu shmangur mospëlqimit Tënd dhe duke dëshiruar pëlqimin Tënd. O Zot! Të kërkoj që me mëshirën Tënde të më shpëtosh prej zjarrit.¹⁴⁸

Lutje për të shkuar në xhami

Hazret Abdullah Ibni Amr Ibnil Asi^{ra} rrëfen se i Dërguari i Allahut^{sas} kur hynte në xhami, bënte lutjen e mëposhtme. Në rrëfimin e tij gjithashtu thuhet se ai që bën këtë lutje, për të shejtani shprehet: “Ky njeri për gjithë ditën e sotme ka marrë mbrojtjen kundër meje”.

أَعُوذُ بِاللَّهِ الْعَظِيمِ وَبِوَجْهِهِ الْكَرِيمِ وَسُلْطَانِهِ الْقَدِيمِ
مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ-

Kërkoj mbrojtjen e Allahut të Madhërishëm, të fytyrës së Tij bujare dhe të sundimit të Tij të përhershëm nga shejtani i mallkuar.¹⁴⁹

148. Ibni Maxha, Kitabul-masaxhid, bab el-meshij iles-salat.

149. Ebu Daud, Kitabus-salat, bab ma jekuluhur-rexhulu enda dukhulil-mesxhid.

Lutje kur hyn në xhami

E bija e të Dërguarit të Allahut^{sas} Hazret Fatima^{ra} rrëfen se i Dërguari i Allahut^{sas} kur hynte në xhami, bënte këtë lutje:

بِسْمِ اللَّهِ وَالصَّلَاةِ وَالسَّلَامِ عَلَى رَسُولِ اللَّهِ أَللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي ذُنُوبِي وَافْتَحْ لِي أَبْوَابَ رَحْمَتِكَ -

Me emrin e Allahut! Bekimi dhe paqja qofshin mbi të Dërguarin e Allahut! O Zoti im! M'i fal gjynahet dhe më hap dyert e mëshirës Sate!¹⁵⁰

Lutje kur del nga xhamia

I Dërguari i Allahut^{sas} kur dilte nga xhamia, bënte këtë lutje:

بِسْمِ اللَّهِ وَالصَّلَاةِ وَالسَّلَامِ عَلَى رَسُولِ اللَّهِ أَللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي ذُنُوبِي وَافْتَحْ لِي أَبْوَابَ فَضْلِكَ -

Me emrin e Allahut! Bekimi dhe paqja qofshin mbi të Dërguarin e Allahut! O Zoti im! M'i fal gjynahet dhe më hap dyert e bekimit Tënd!¹⁵¹

Lutje të ndryshme për të filluar namazin

(1) Hazret Aliu^{ra} rrëfen se i Dërguari i Allahut^{sas} kur thoshte tekbinin (Allahu Ekber) për të nisur namazin, lutej me këto fjalë:

150. Tuhfatudh-dhakirin, lish-Sheukani, vëll. 1, f. 145.

151. Tuhfatudh-dhakirin, lish-Sheukani, vëll. 1, f. 146.

وَجَّهْتُ وَجْهِيَ لِلدِّينِ فَطَرَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ حَنِيفًا وَمَا أَنَا مِنَ
الْمُشْرِكِينَ، إِنَّ صَلَاتِي وَنُسُكِي وَمَحْيَايَ وَمَمَاتِي لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ لَا
شْرِيكَ لَهُ وَبِذَلِكَ أُبْرْتُ وَأَنَا مِنَ الْمُسْلِمِينَ-اللَّهُمَّ أَنْتَ الْمَلِكُ لَا إِلَهَ
إِلَّا أَنْتَ، أَنْتَ رَبِّي وَأَنَا عَبْدُكَ-ظَلَمْتُ نَفْسِي وَاعْتَرَفْتُ بِذُنُوبِي
فَاعْفِرْ لِي ذُنُوبِي جَمِيعًا إِنَّهُ لَا يَغْفِرُ الذُّنُوبَ إِلَّا أَنْتَ وَاهْدِنِي لِأَحْسَنِ
الْأَخْلَاقِ لَا يَهْدِي لِأَحْسَنِهَا إِلَّا أَنْتَ وَأَصْرِفْ عَنِّي سَيِّئَهَا لَا يَصْرِفُ
عَنِّي سَيِّئَهَا إِلَّا أَنْتَ لَبَّيْكَ وَسَعْدَيْكَ وَالْخَيْرُ كُلُّهُ فِي يَدَيْكَ وَالشَّرُّ
لَيْسَ إِلَيْكَ أَنَا بَكَ وَالْيَكُ تَبَارَكْتَ وَتَعَالَيْتَ اسْتَغْفِرُكَ وَأَتُوبُ
إِلَيْكَ-

E ktheva vëmendjen time duke ia përkushtuar Atij që ka krijuar qiejt dhe Tokën dhe unë nuk jam ndër idhujtarët. Namazi im, sakrifica ime, jeta ime dhe vdekja ime me të vërtetë janë për Allahun, Zotin e botëve. Ai nuk ka ortak. Për këtë jam urdhëruar dhe jam ndër të bindurit. O Allah! Ti je Sunduesi. Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Teje. Ti je Zoti im e unë robi Yt. I kam bërë padrejtësi vetes dhe e pranoj gjynahun tim. Prandaj, më fal të gjitha gjynahet e mia, sepse askush nuk mund të m'i falë gjynahet përveç Teje. Udhëzomë për virtytet më të mira, sepse askush nuk mund të më udhëzojë për këtë përveç Teje. Largomë nga veset, sepse askush nuk mund të më largojë nga ato përveç Teje. Kam ardhur te Ti dhe ky nder më erdhi prej Teje. E gjithë mirësia është në duart e Tua, kurse e keqja nuk mund të jetë prej Teje. Jam me Ty dhe vij drejt Teje. Ti zotëron bekime e madhështi. Ty të kërkoj falje dhe te Ti kthehem i përrulur.¹⁵²

152. Muslimi, Kitabus-salatil-musafirin, bab ed-dua fi salatil-lejli ue kijamihi.

(2) Hazret Ebu Seid Hudriju^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} në fillim të namazit, para se të recitonte suren *El-Fatiha*, bënte këtë lutje:

سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ وَبِحَمْدِكَ وَتَبَارَكَ اسْمُكَ وَتَعَالَى جَدُّكَ وَلَا إِلَهَ
غَيْرُكَ -

I Shenjtë je, o Allah, me gjithë lavdinë Tënde! I bekuar është emri Yt, e lartë është madhështia Jote dhe nuk ka të adhuruar tjetër përveç Teje!¹⁵³

(3) Hazret Ebu Hurejrah^{ra} rrëfen: “Pyeta të Dërguarin e Allahut^{sas}: “Shoh që qëndroni i heshtur midis tekbitit dhe recitimit të sures *El-Fatiha*. Çfarë thoni gjatë kësaj kohe?” I Dërguari i Allahut^{sas} më tregoi këtë lutje:

اللَّهُمَّ بَاعِدْ بَيْنِي وَبَيْنَ خَطَايَايَ ، كَمَا بَاعَدْتَ بَيْنَ الْمَشْرِقِ وَالْمَغْرِبِ ،
اللَّهُمَّ نَقِّنِي مِنَ الْخَطَايَا كَمَا يُنْقَى الثَّوْبُ الْأَبْيَضُ مِنَ الدَّنَسِ ، اللَّهُمَّ
اغْسِلْ خَطَايَايَ بِالْمَاءِ وَالثَّلْجِ وَالْبَرَدِ -

O Allah! Më largo nga mëkatet e mia, ashtu siç e ke larguar Lindjen nga Perëndimi. O Allah! Më pastro nga mëkatet e mia, ashtu siç pastrohet papastërtia nga rroba e bardhë. O Allah! Laji me ujë, borë dhe akull mëkatet e mia!¹⁵⁴

Lutje të ndryshme në ruku

(1) Hazret Hudhejfa^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} në ruku thoshte:

سُبْحَانَ رَبِّيَ الْعَظِيمِ

I Shenjtë është Zoti im, i Madhërishmi!¹⁵⁵

153. Tirmidhiu, Kitabus-salat, ma jekulu enda iftitahis-salat.

154. Buhariu, Kitab sifatis-salat, bab ma jekulu ba'det-takbir.

155. Tirmidhiu, Kitabus-salat, bab et-tasbih fir-ruku ues-suxhud.

(2) Hazret Ajshja^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} në rùku e në sexhde thoshte:

سُبُوحٌ قُدُّوسٌ رَبُّ الْمَلَائِكَةِ وَالرُّوحِ-

I denjë për t'u përkujtuar shumë, shumë i Pastër, Zoti i engjëjve dhe i shpirtit!¹⁵⁶

(3) Hazret Ajshja^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} në rùku e në sexhde bënte edhe këtë lutje:

سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ رَبَّنَا وَبِحَمْدِكَ اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي -

O Allah! O Zoti ynë! I Shenjtë je Ti me gjithë lavdinë Tënde! O Allah! Më fal mua!¹⁵⁷

(4) Hazret Auf Ibni Maliku^{ra} e dëgjoji të Dërguarin e Allahut^{sas} duke bërë këtë lutje në rùku:

سُبْحَانَ ذِي الْجَبُرُوتِ وَالْمَلَكُوتِ وَالْكِبْرِيَاءِ وَالْعَظَمَةِ-

I Shenjtë është Ai që zotëron fuqinë, sundimin, krenarinë dhe madhësitinë!¹⁵⁸

(5) Hazret Aliu^{ra} dhe Hazret Xhabir Ibni Abdullahu thonë se i Dërguari i Allahut^{sas} bënte këtë lutje në rùku:

اللَّهُمَّ لَكَ رَكَعْتُ، وَبِكَ اٰمَنْتُ، وَلَكَ اَسْلَمْتُ وَعَلَيْكَ تَوَكَّلْتُ ،
أَنْتَ رَبِّي، خَشَعَ سَمْعِي وَبَصْرِي وَلِحْمِي وَدَبِّي وَعَظْمِي وَمُخِّي وَ
عَضِي لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ

O Allah! Për ty u përkula (bëra rùku). Ty të besova. Ty t'u dorëzova. Te Ti u mbështeta. Ti je Zoti im. Për Allahun, Zotin

156. Muslimi, Kitabus-salat, bab ma jekulu fir-ruku.

157. Buhariu, Kitab sifatis-salat, bab dua fir-ruku.

158. Ebu Daud, Kitabus-salat, bab ma jekuluhur-rexhul fi rukuihi ue suxhudih.

e botëve, po përuken dëgjimi dhe shikimi im, mishi dhe gjaku im, kockat dhe truri im dhe të gjitha gjymtyrët e mia.¹⁵⁹

Lutje gjatë qëndrimit (*kijamit*) pas rûku-së

(1) Hazret Ebu Seid Hudriju^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} pasi ngrinte kokën nga rûkuja, bënte këtë lutje:

اللَّهُمَّ رَبَّنَا لَكَ الْحَمْدُ، بِلَاءِ السَّمَاوَاتِ وَبِلَاءِ الْأَرْضِ، وَبِلَاءِ مَا بَشِئَتْ
مِنْ شَيْءٍ بَعْدَ، أَهْلِ الشَّنَاءِ وَالْمَجْدِ أَحَقُّ مَا قَالَ الْعَبْدُ وَكُلْنَا لَكَ عَبْدًا،
اللَّهُمَّ لَا مَنَاعَ لِمَا أَعْطَيْتَ، وَلَا مُعْطَى لِمَا مَنَعْتَ، وَلَا يَنْفَعُ ذَا الْجَدِّ مِنْكَ
الْجَدُّ

O Allah, o Zoti ynë! E Jotja është lavdia. Të gjithë qiejt dhe toka janë të mbushura me lavdinë ndaj Teje dhe çfarëdo tjetër që të sjellësh pas kësaj, sërish mund të mbushet me lavdinë ndaj Teje. Mirënjohja dhe nderi të takojnë Ty. Sado që të falënderon robi, Ti e meriton falënderimin e tij. Të gjithë jemi robërit e Tu. O Allah! Askush nuk mund ta pengojë atë që Ti jep, as nuk mund të japë ndokush diçka që Ti e refuzon. Asnjë i nderuar nuk mund të përfitojë nga nderi i vet përballë Teje.¹⁶⁰

(2) Hazret Ebu Hurejrah^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} gjatë kohës kur ngrihej nga rûku thoshte:

سَمِعَ اللَّهُ لِمَنْ حَمِدَهُ

(*Samiallahu limen hamida*)

Allahu e dëgjoi atë, që e lavdëroi Atë!

159. Nisai, Kitab sifatis-salat, bab neu akhir minedh-dhikr.

160. Muslimi, Kitabus-salat, bab ma jekulu idha rafa'a ra'sahu miner-ruku.

Dhe më pas bënte këtë lutje:

اللَّهُمَّ رَبَّنَا وَلَكَ الْحَمْدُ

O Allah! O Zoti ynë! Lavdia është e Jotja!¹⁶¹

(3) Hazret Rafia Ibni Zerki^{ra} rrëfen:

Një ditë falëm namazin pas të Dërguarit të Allahut^{sas}. Kur ai e ngriti kokën nga ruku dhe tha *semiallahu limen hamida*, një njeri tha:

رَبَّنَا وَلَكَ الْحَمْدُ حَمْدًا كَثِيرًا طَيِّبًا مُبَارَكًا فِيهِ-

O Zoti ynë! Lavdia është e Jotja! Lavdi e shumtë, e pastër dhe e bekuar!¹⁶²

Pas namazit, i Dërguari i Allahut^{sas} tha:

Pashë më shumë se 30 engjëj dhe secili prej tyre nxitonte të ishte i pari për t'i shkruar këto fjalë.

Lutje të ndryshme në sexhde

(1) Hazret Hudhejfa^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} në sexhde thoshte:

سُبْحَانَ رَبِّيَ الْأَعْلَى

I Shenjtë është Zoti im, i Lartësuari.¹⁶³

(2) Hazret Ajshja^{ra} rrëfen: “Një natë, kur nuk e gjeta të Dërguarin e Allahut^{sas} në shtrat, u shqetësova. Fillova ta kërkoja në errësirë duke

161. Buhariu, Kitab sifatis-salat, bab fadli “Allahuma rabana ue lakel hamd”.

162. Po aty.

163. Tirmidhiu, Kitabus-salat, bab et-tesbih fir-ruku ues-suxhud.

prekur me duar andej-këtej dhe më në fund e gjeta, ndërkohë ai ishte në sexhde dhe po bënte këtë lutje:

اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي مَا أَسْرَرْتُ وَمَا أَعْلَنْتُ-

O Allah! Më fal mëkatet e mia, edhe ato që kam fshehur, edhe ato që kam zbuluar”.¹⁶⁴

(3) Sipas rrëfimit të Ebu Hurejras^{ra}, i Dërguari i Allahut^{sas} në sexhdet e tij bënte këtë lutje:

اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي ذَنْبِي كُلَّهُ، دِقَّةَ وَجِلِّهِ، وَأَوَّلَهُ وَالْآخِرَةَ وَعَلَانِيَتَهُ وَسِرَّهُ-

O Allah! Më fal të gjitha mëkatet e mia, edhe të voglat, edhe të mëdhatë, edhe të parat, edhe të fundit, edhe të fshehtat, edhe jo të fshehtat!¹⁶⁵

(4) Hazret Muhammed Ibni Muslima^{ra} rrëfen se i Dërguari i Allahut^{sas} në sexhdet e *tehexhudit* (të namazit të natës) bënte këtë lutje:

اللَّهُمَّ لَكَ سَجَدْتُ، وَبِكَ آمَنْتُ، وَلَكَ أَسَلْتُ اللَّهُمَّ أَنْتَ رَبِّي سَجَدَ
وَجْهِي لِلَّذِي خَلَقَهُ وَصَوَّرَهُ وَشَقَّ سَمْعَهُ وَبَصَرَهُ تَبَارَكَ اللَّهُ أَحْسَنُ
الْخَالِقِينَ-

**O Allah! Për Ty rashë në sexhde. Ty të besova. Ty t’u dorëzova.
O Allah! Ti je Zoti im. Fytyra ime po i bën sexhde Atij që e krijoi, e zbukuroi dhe i dhuroi veshët dhe sytë. I Bekuar është Allahu, Krijuesi më i përsosur!**¹⁶⁶

164. Muslimi, Kitabus-salat, bab ed-dua fis-suxhud.

165. Muslimi, Kitabus-salat, bab ma jekulu fir-ruku, ues-suxhud.

166. Muslimi, Kitab salat-il-musafirin, bab ed-dua fi salat-il-lejl.

(5) Hazret Ajshja^{ra} rrëfen:

Një natë të Dërguarin e Allahut^{sas} nuk e gjeta në shtëpi. Duke e kërkuar shkova deri në xhami, ku e gjeta në sexhde. Gjunjët i kishte të ngulura në dhë dhe po lutej:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِرِضَاكَ مِنْ سُخْطِكَ، وَبِمَعَاذِكَ مِنْ
عُقُوبَتِكَ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْكَ، لَا أَحْصِي ثَنَاءً عَلَيْكَ أَنْتَ كَمَا أَثْنَيْتَ
عَلَى نَفْسِكَ -

O Allah! Kërkoj mbrojtjen e pëlqimit Tënd nga mospëlqimi Yt; të faljes Tënde nga ndëshkimi Yt. Kërkoj mbrojtjen Tënde prej Teje. Nuk mund ta përmbledh lavdërimin Tënd. Ti je ashtu siç e ke përshkruar Vetën Tënde!¹⁶⁷

Lutje midis dy sexhdeve

Hazret Abdullah Ibni Abasi^{ra} rrëfen se i Dërguari i Allahut^{sas} bënte këtë lutje midis dy sexhdeve:

اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي وَأَرْحَمْنِي وَاهْدِنِي وَعَافِنِي وَأَجِرْنِي وَأَرْزُقْنِي وَأَرْفَعْنِي -

O Allah! Më fal, më mëshiro, më udhëzo, më dhuro shëndet, më përmirëso, më ushqe dhe më lartëso!¹⁶⁸

Lutje në *teshehud*

Hazret Abdullah Ibni Mesudi^{ra} rrëfen:

Kur falnim namaz pas të Dërguarit të Allahut^{sas}, thoshim: “Paqja

167. Po aty.

168. Ibni Maxha, Ikamatus-salat, bab ma jekulu bejnas-sexhdatejn; Mustadrik Hakim, vëll. 1, f. 262, 271.

qoftë mbi Allahun!” I Dërguari i Allahut^{sas} tha: “Allahu Vetë është paqe [domethënë burimi i paqes], ndaj, kur të jeni të ulur në namaz, lutuni me këto fjalë:

التَّحِيَّاتُ لِلَّهِ وَالصَّلَوَاتُ وَالطَّيِّبَاتُ السَّلَامُ عَلَيْكَ أَيُّهَا النَّبِيُّ وَرَحْمَةُ
اللَّهِ وَبَرَكَاتُهُ السَّلَامُ عَلَيْنَا وَعَلَىٰ عِبَادِ اللَّهِ الصَّالِحِينَ أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا
اللَّهُ وَأَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ-

Për Allahun janë dhuratat, adhurimet dhe të pastrat (lavdërimet). Paqja qoftë mbi ty, o Profet, dhe mëshira dhe bekimet e Allahut po ashtu! Paqja qoftë mbi ne dhe mbi të gjithë robërit e sinqertë të Allahut! Dëshmoj se nuk ka të adhurar tjetër përveç Allahut dhe dëshmoj se Muhammedi është robi dhe i Dërguari i Tij.¹⁶⁹

Salavatet

Hazret Abdurrahman Ibni Ebi Lejla rrëfen: “Më takoi Hazret Kab Ibni Uxhrah dhe më tha: “A të jap një dhuratë? “Patjetër”, – i thashë. Atëherë ai më tregoi se ata e kishin pyetur një ditë të Dërguarin e Allahut^{sas}: “Ne e dimë se si duhet t’ju dërgojmë *selam* [paqja, mëshira dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ty, o i Dërguar!], por nuk e dimë se si duhet t’ju dërgojmë *salavate* [sepse në porosinë e Kuranit thuhet “Dërgojini *salavate* dhe shumë *selam*” (Kurani Famëlartë 33:57)] I Dërguari i Allahut^{sas} u përgjigj: “Mund të më dërgoni *salavate* në këtë mënyrë”:

169. Buhariu, Kitab sifatis-salat, bab et-teshehed fil-akhira

اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ كَمَا صَلَّيْتَ عَلَى إِبْرَاهِيمَ
وَعَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ إِنَّكَ حَمِيدٌ مَّجِيدٌ، اللَّهُمَّ بَارِكْ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ
مُحَمَّدٍ كَمَا بَارَكْتَ عَلَى إِبْرَاهِيمَ وَعَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ إِنَّكَ حَمِيدٌ مَّجِيدٌ-

O Zot! Lartësoje Muhammedin dhe popullin e tij, ashtu siç e lartësove Ibrahimin dhe popullin e tij! Me të vërtetë, Ti je i Lavdëruar dhe i Nderuar!

O Zot! Bekoje Muhammedin dhe popullin e tij, ashtu siç e bekove Ibrahimin dhe popullin e tij! Me të vërtetë, Ti je i Lavdëruar dhe i Nderuar!¹⁷⁰

Lutje për të kërkuar të mirat e botës dhe të besimit

E pyetën Hazret Enesin^{ra}, shërbëtorin e të Dërguarit të Allahut^{sas}, se cilën lutje bënte më së shumti i Dërguari i Allahut^{sas}? Ai u tregoi këtë lutje (që thuhet pas *teshehudit*).

اللَّهُمَّ رَبَّنَا اتِّبَانِي الدُّنْيَا حَسَنَةً وَفِي الآخِرَةِ حَسَنَةً وَقِنَا عَذَابَ النَّارِ-

O Allah, o Zoti ynë! Jepna të mirën në këtë botë, të mirën në ahiret dhe shpëtona nga ndëshkimi i zjarrit!¹⁷¹

Lutje për të kërkuar mbrojtje nga ndëshkimi i varrit dhe nga fatkeqësitë e tjera

Sipas Hazret Ajshes^{ra}, i Dërguari i Allahut^{sas} bënte këtë lutje gjatë namazit, kurse sipas Ebu Hurejrasë e bënte gjatë namazit pas

170. Buhariu, Kitabul-ambija, bab keulil-lahi “Uet-takhadhallahu Ibrahimia khlila”.

171. Buhariu, Kitabud-da’vat, bab keulin-Nebij^{sas}, “Rabana atina”.

teshehudit:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ عَذَابِ الْقَبْرِ وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ فِتْنَةِ الْمَسِيحِ الدَّجَالِ
وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ فِتْنَةِ الْمَحْيَا وَالْمَمَاتِ، اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْمَأْثِمِ
وَالْمَغْرَمِ -

O Allah! Më mbro nga ndëshkimi i varrit! Më mbro nga trazira e Dexhallit të kohës së Mesihut! Më mbro nga trazira e jetës e nga trazira e vdekjes! O Allah! Më mbro nga mëkatet dhe nga barra e borxheve!¹⁷²

Edhe një lutje tjetër e përsosur

Hazret Abdullah Ibni Mesudi^{ra} rrëfen se i Dërguari i Allahut^{sas} ia mësoi këtë lutje që ta bënte pas *teshehudit*:

أَلْفَ اللَّهُمَّ عَلَى الْخَيْرِ قُلُوبَنَا، وَأَصْلِحْ ذَاتَ بَيْنِنَا وَاهْدِ سُبُلَ السَّلَامِ،
وَنَجِّنَا مِنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ، وَجَنِّبْنَا الْفَوَاحِشَ وَالْفِتْنَ، مَا ظَهَرَ مِنْهَا
وَمَا بَطَّنَ، وَبَارِكْ لَنَا فِي أَسْمَاعِنَا وَأَبْصَارِنَا وَقُلُوبِنَا وَأَزْوَاجِنَا
وَذُرِّيَّاتِنَا، وَتُبَّ عَلَيْنَا إِنَّكَ أَنْتَ التَّوَّابُ الرَّحِيمُ، وَاجْعَلْنَا شَاكِرِينَ
لِنِعْمَتِكَ مُشِينِينَ بِهَا قَابِلِينَهَا وَأَتَمِّهَا عَلَيْنَا

O Allah! Na bashko zemrat në mirësi! Na pajto! Na udhëzo në rrugën e paqes! Na liro nga errësitat për të shkuar drejt dritës! Na shpëto nga ligësitë, sherret dhe çrregullimet, të hapëta apo të fshehta! Na beko dëgjimin, shikimin, zemrat, bashkëshortët, fëmijët dhe na prano pendimin me mëshirë! Ti je me të vërtetë Pendimpranuesi, Mëshirëploti. Na bëj mirënjohës të Tu për

172. Buhariu, Kitab sifatis-salat, bab dua kables-salam.

bekimin Tënd dhe na mundëso ta vlerësojmë bekimin Tënd siç duhet, ta përvetësojmë atë dhe Ti Vetë plotësoje atë për ne!¹⁷³

Lutje të ndryshme në namazin e *tehexhudit*

(1) Hazret Ajshja^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} kur zgjohej gjatë natës, bënte këtë lutje:

لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ اسْتَغْفِرُكَ لِذَنْبِي وَأَسْأَلُكَ رَحْمَتَكَ
اللَّهُمَّ زِدْنِي عِلْمًا وَلَا تَزِغْ قَلْبِي بَعْدَ إِذْ هَدَيْتَنِي وَهَبْ لِي مِنْ لَدُنْكَ
رَحْمَةً إِنَّكَ أَنْتَ الْوَهَّابُ.

Nuk ka të adhurar tjetër përveç Teje. I Shenjtë je o Allah! Të kërkoj falje për gjynahun tim dhe kërkoj mëshirën Tënde! O Allah! Më shto diturinë! Mos më devijoj zemrën pasi më ke udhëzuar dhe më dhuro mëshirë prej Vetes! Ti je me të vërtetë Dhuruesi i madh!¹⁷⁴

(2) Hazret Abdullah Ibni Abasi^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} kur çohet për namazin e *tehexhudit*, bënte këtë lutje:

اللَّهُمَّ لَكَ الْحَمْدُ أَنْتَ قَيِّمُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَنْ فِيهِنَّ وَلَكَ الْحَمْدُ
لَكَ مُلْكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَنْ فِيهِنَّ وَلَكَ الْحَمْدُ أَنْتَ نُورُ
السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَنْ فِيهِنَّ وَلَكَ الْحَمْدُ أَنْتَ مَلِكُ السَّمَوَاتِ
وَالْأَرْضِ وَمَنْ فِيهِنَّ وَلَكَ الْحَمْدُ أَنْتَ الْحَقُّ وَوَعْدُكَ الْحَقُّ وَلِقَائُكَ
حَقٌّ وَقَوْلُكَ حَقٌّ وَالْجَنَّةُ حَقٌّ وَالنَّارُ حَقٌّ وَالنَّبِيُّونَ حَقٌّ وَمُحَمَّدٌ ﷺ
حَقٌّ وَالسَّاعَةُ حَقٌّ اللَّهُمَّ لَكَ أَسْلَمْتُ وَبِكَ أَمَنْتُ وَعَلَيْكَ تَوَكَّلْتُ

173. Ebu Daud, Kitabus-salat, bab teshehud.

174. Ebu Daud, Kitabul-adab, bab jekulur-raxhul idha ta'ra minel-lejl.

وَالَيْكَ أَنْبُتُ وَبِكَ خَاصَمْتُ وَإِلَيْكَ حَاكَمْتُ فَاعْفُ عَنِّي مَا قَدَّمْتُ
وَمَا أَخَّرْتُ وَمَا سَرَرْتُ وَمَا أَعْلَنْتُ أَنْتَ الْمُقَدِّمُ وَأَنْتَ الْمُؤَخِّرُ لَا إِلَهَ إِلَّا
أَنْتَ -

O Allah! E Jotja është lavdia. Ti i bëre të qëndrojnë qiejt, Toka dhe gjithçka që gjendet në to. E Jotja është lavdia. I Yti është sundimi i qiejve dhe i Tokës dhe i gjithçkaje që gjendet në to. E Jotja është lavdia. Ti je drita e qiejve dhe e Tokës dhe e gjithçkaje që gjendet në to. E Jotja është lavdia. Ti je Mbreti i qiejve dhe i Tokës dhe i gjithçkaje që gjendet në to. E Jotja është lavdia. Ti je i Vërteti. Premtimi Yt është i vërtetë, takimi me Ty është i vërtetë, fjala Jote është e vërtetë, xheneti është i vërtetë, zjarri është i vërtetë, profetët janë të vërtetë, Muhammedi është i vërtetë dhe Ora është e vërtetë. O Allah! Ty t’u dorëzova, Ty të besova, te Ti u mbështeta, nga Ti anova, me ndihmën Tënde u përballa me armikun dhe Ty të solla çështjen për gjykim. Më fal mua edhe atë që kam bërë më parë, edhe atë që do të bëj, edhe atë që e fsheha, edhe atë që e zbulova. Ti je Nismëtari dhe Përmbyllësi. Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Teje.¹⁷⁵

(3) Duke treguar rreth lutjeve që i Dërguari i Allahut^{sas} bënte në fillim të namazit të tehexhudit, Hazret Ajshja^{ra} thotë se Profeti^{sas} çohet në këmbë dhe thoshte nga 10 herë: *Allahu Ekber, Elhamdulillah, Subhanallah, Lailaha il-lallah* dhe 10 herë kërkonte falje prej Zotit. Më pas bënte disa lutje të tjera.¹⁷⁶

175. Buhariu, Kitabut-tehexhud, bab et-tehexhud bil-lejl.

176. Nisai, Kitab kijamil-lejl, bab dhikr ma jesteftihu bihil-kijam.

(4) Hazret Abdullah Ibni Omeri^{ra} rrëfen: “Teksa po faleshim një ditë me të Dërguarin e Allahut^{sas}, erdhi një njeri dhe nisi namazin me këto fjalë:

اللَّهُ أَكْبَرُ كَثِيرًا وَالْحَمْدُ لِلَّهِ كَثِيرًا وَسُبْحَانَ اللَّهِ بُكْرَةً وَأَصِيلًا

Allahu është më i madhi, Allahut i takon lavdia më së shumti! I lartësuar është Allahu edhe në agim, edhe në mbrëmje.

Pas namazit, i Dërguari i Allahut^{sas} tha: Kaq shumë i pëlqyen Zotit këto fjalë, saqë Ai i hapi dyert e xhenetit. Ibni Omeri^{ra} thotë se pas kësaj ngjarjeje, ai gjithmonë i përsëriste këto fjalë në namazin e tij”.¹⁷⁷

(5) Hazret Ajshja^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas}, në përgjithësi, tehexhudin e fillonte me këtë lutje:

اللَّهُمَّ رَبَّ جِبْرِيلَ وَمِيكَالَ وَإِسْرَافِيلَ فَاطْرَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ، عَلِيمَ
الْغَيْبِ وَالشَّهَادَةِ، أَنْتَ تَحْكُمُ بَيْنَ عِبَادِكَ، فِيمَا كَانُوا فِيهِ يَخْتَلِفُونَ، اهْدِنِي
لِمَا اخْتَلَفَ فِيهِ مِنْ الْحَقِّ بِإِذْنِكَ، إِنَّكَ تَهْدِي مَنْ تَشَاءُ إِلَى صِرَاطٍ
مُسْتَقِيمٍ

O Allah! Zoti i Xhibrailit, i Mikailit dhe i Israfilit. Krijuesi i qiejve dhe i Tokës. I Dijshmi i së padukshmes dhe i së dukshmes. Ti do të gjykosh robërit e Tu në çështjet, të cilat ata kundërshtojnë njëri-tjetrin. Me lejen Tënde më udhëzo drejt vërtetësisë në çështjet që janë kundërshtuar. Me të vërtetë, Ti e udhëzon në rrugën e drejtë kë të duash.¹⁷⁸

(6) Hazret Asimi^{ra} rrëfen: “Pyeta Hazret Ajshen^{ra} se si e fillonte i Dërguari i Allahut^{sas} namazin e natës. Ajo m’u përgjigj: Më ke pyetur

177. Tirmidhiu, Kitabud-da’vat, bab dua umi selma.

178. Muslimi, Kitab salatil-musafirin, bab dua fi salatil-lejl.

për diçka, për të cilën nuk më ka pyetur askush para teje. I Dërguari i Allahut^{sas} kur çohet për të falur namazin, përsëriste nga 10 herë *Subhanallah, Elhamdulil-lah* dhe *Estagfirullah* dhe më pas bënte këtë lutje¹⁷⁹:

اَللّٰهُمَّ اغْفِرْ لِيْ وَاهْدِنِيْ وَاَرْزُقْنِيْ وَعَافِنِيْ وَاَعُوْذُ بِكَ مِنْ ضِيْقِ الْمَقَامِ
يَوْمَ الْقِيَامَةِ -

O Allah! Më fal! Më udhëzo! Më ushqe! Më jep shëndet! Më mbro nga shtrëngimi në ditën e kiametit!¹⁷⁹

(7) Hazret Ebu Seid Hudriju^{ra} thotë se i Dërguari i Allahut^{sas} kur çohet gjatë natës për të adhuruar Zotin, pas tekbirit dhe lavdërimit të Allahut, bënte këtë lutje:

اَعُوْذُ بِاللّٰهِ السَّمِيْعِ الْعَلِيْمِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيْمِ، مِنْ هَمَزِهِ وَنَفْحِهِ وَنَفْثِهِ

Kërkoj mbrojtjen e Allahut, Dëgjuesit e të Gjithëdijshtit nga shejtani i mallkuar, nga nxitja e tij, nga fryma e tij dhe nga ligësia e tij.¹⁸⁰

(8) Me kërkesën e Hazret Ebu Bekrit^{ra} i Dërguari i Allahut^{sas} i mësoi këtë lutje, që ai ta bënte në namaz:

اَللّٰهُمَّ اِنِّيْ ظَلَمْتُ نَفْسِيْ ظُلْمًا كَثِيْرًا، وَلَا يَغْفِرُ الذُّنُوْبَ اِلَّا اَنْتَ،
فَاغْفِرْ لِيْ مَغْفِرَةً مِّنْ عِنْدِكَ وَاَرْحَمِنِيْ، اِنَّكَ اَنْتَ الْغَفُوْرُ الرَّحِيْمُ -

O Allah! Kam shkelur shumë veten time dhe askush nuk m'i fal mëkatet përveç Teje. Andaj më dhuro faljen Tënde dhe më mëshiro! Ti je me të vërtetë Mëkatfalësi, Mëshirëbërësi.¹⁸¹

179. Nisai, Kitab kijamil-lejl, bab ma dhakara ma jesaftihu bihil-lejl.

180. Tirmidhiu, Kitabus-salat, bab ma jekulu enda iftitahis-salat.

181. Buhariu, Kitabud-da'vat, bab dua fis-salat.

(9) Hazret Shedad Ibni Eusi^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} bënte këtë lutje në namazet *nafile*:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الثَّبَاتَ فِي الْأَمْرِ، وَالْعَزِيمَةَ عَلَى الرَّشْدِ، وَأَسْأَلُكَ
شُكْرَ نِعْمَتِكَ، وَحُسْنَ عِبَادَتِكَ وَأَسْأَلُكَ قَلْبًا سَلِيمًا، وَلِسَانًا صَادِقًا،
وَأَسْأَلُكَ مِنْ خَيْرِ مَا تَعَلَّمَ وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ مَا تَعَلَّمَ وَأَسْتَغْفِرُكَ لِمَا
تَعَلَّمُ-

O Allah! Po të lutem për qëndrueshmërinë në të gjitha çështjet, për vendosmërinë në sjelljet e drejta. Më mundëso të falënderoj për bekimin Tënd e të të adhuroj Ty në mënyrën më të bukur. Po të lyp zemër të sinqertë, gjuhë të drejtë dhe çdo të mirë që Ti di. Kërkoj mbrojtjen Tënde nga çdo ligësi që Ti di dhe kërkoj faljen për çdo mëkat timin që Ti di.¹⁸²

(10) Hazret Amar Ibni Jasiri^{ra} thotë se i Dërguari i Allahut^{sas} i mësoi këtë lutje që ta bënte në namaz:

اللَّهُمَّ بِعِلْمِكَ الْغَيْبِ وَقُدْرَتِكَ عَلَى الْخَلْقِ أَحْبَبْتَنِي مَا عَلِمْتِ الْحَيَاةَ خَيْرًا
لِي، وَتَوَفَّنِي إِذَا عَلِمْتِ الْوَفَاةَ خَيْرًا لِي اللَّهُمَّ وَأَسْأَلُكَ خَشْيَتَكَ فِي الْغَيْبِ
وَالشَّهَادَةِ وَأَسْأَلُكَ كَلِمَةَ الْحَقِّ فِي الرِّضَى وَالْغَضَبِ، وَأَسْأَلُكَ الْقَصْدَ
فِي الْفَقْرِ وَالْغِنَى، وَأَسْأَلُكَ نَعِيمًا لَا يَنْفَدُ، وَأَسْأَلُكَ قُرَّةَ عَيْنٍ لَا تَقْطَعُ
وَأَسْأَلُكَ الرِّضَا بَعْدَ الْقَضَاءِ، وَأَسْأَلُكَ بَرْدَ الْعَيْشِ بَعْدَ الْمَوْتِ وَأَسْأَلُكَ
لَذَّةَ النَّظَرِ إِلَى وَجْهِكَ، وَالشُّوقَ إِلَى لِقَائِكَ فِي غَيْرِ ضَرَاءٍ مُضِرَّةٍ وَلَا
فِتْنَةٍ مُضِلَّةٍ، اللَّهُمَّ زَيِّنَا بِرَبِّتِهِ الْإِيمَانَ، وَاجْعَلْنَا هُدَاةً مُهْتَدِينَ -

O Allah! Për hir të dijes Sate për të padukshmen dhe të fuqisë Sate mbi krijesat, më mbaj gjallë gjersa jeta është e mirë për mua

182. Tirmidhiu, Kitabud-da'vat, bab fi men-jekraul-Kur'an endal-manam.

sipas dijes Sate dhe ma merr shpirtin atëherë kur vdekja është e mirë për mua sipas dijes Sate. O Allah! Të kërkoj frikën ndaj Teje edhe kur nuk më sheh askush, edhe kur jam para të tjerëve. Më mundëso të them fjalën e vërtetë edhe gjatë pëlqimit, edhe gjatë zemërimit. Të kërkoj rrugën e mesme edhe gjatë skamjes, edhe gjatë kamjes. Të kërkoj bekimin që nuk përfundon. Të kërkoj prehjen e syve që nuk shteron. Të kërkoj kënaqësinë mbi vendimet e Tua. Të kërkoj jetë të lumtur pas vdekjes. Të kërkoj kënaqësinë e shikimit për të parë fytyrën Tënde dhe dëshirën për të të takuar Ty dhe që këto të m'i japësh pa më kaluar në ndonjë vështirësi të mundimshme dhe pa më vënë në ndonjë provë devijuese. O Allah! Na zbukuro me stolinë e besimit dhe na bëj udhëheqës të udhëzuar!¹⁸³

Lutja e kunutit

(1) I Dërguari i Allahut^{sas} i mësoi Hazret Hasan Ibni Aliut^{ra} këtë lutje të *kunutit* për të bërë në namazin e vitrit:

اللَّهُمَّ اهْدِنِي فِيمَنْ هَدَيْتَ وَعَافِنِي فِيمَنْ عَافَيْتَ وَتَوَلَّنِي فِيمَنْ تَوَلَّيْتَ
وَبَارِكْ لِي فِيمَا أَعْطَيْتَ وَفِي شَرِّ مَا قَضَيْتَ فَإِنَّكَ تَقْضِي وَلَا يُقْضَى
عَلَيْكَ إِنَّهُ لَا يُدْرَأُ مَنْ وَالَيْتَ وَلَا يَعْرُزُ مَنْ عَادَيْتَ تَبَارَكْتَ رَبَّنَا
وَتَعَالَيْتَ صَلَّى اللَّهُ عَلَى النَّبِيِّ مُحَمَّدٍ

O Allah! Më udhëzo si ata që Ti i ke udhëzuar! Më jep shëndet si ata që u ke dhënë shëndet! Miqësohu me mua, si me ata me të cilët je miqësuar! Më beko në atë që më ke dhënë! Më shpëto nga e keqja e asaj që ke caktuar, sepse Ti cakton dhe kundër

183. Nisai, Kitab sifatis-salat, bab neu akhir mined-dua.

Teje nuk caktohet. Përnjëmend, nuk poshtërohet ai që Të bën mik dhe nuk nderohet ai që Të bën armik. Ti je bekues dhe i madhërisëm, o Zoti ynë. Paqja e Allahut qoftë mbi Profetin Muhammed!¹⁸⁴

(2) Hazret Halid Ibni Ebi Omer^{ra} tregon se të Dërguarit të Allahut^{sas} Xhibraili^{as} i mësoi këtë lutje të kunutit:

اللَّهُمَّ إِنَّا نَسْتَعِينُكَ وَنَسْتَغْفِرُكَ وَنُؤْمِنُ بِكَ وَنَتَوَكَّلُ عَلَيْكَ وَنُثْنِي عَلَيْكَ
الْحَيْرَ وَنَشْكُرُكَ وَلَا نَكْفُرُكَ وَنَخْلَعُ وَنَتْرِكُ مَنْ يَفْجُرُكَ اللَّهُمَّ أَيَّاكَ نَعْبُدُ
وَلَاكُ نُصَلِّيُ وَنَسْجُدُ وَالْيَاكَ نَسْعَى وَنَحْفِدُ وَرَجُورَ حَمَتِكَ وَنَحْسُنِي
عَذَابِكَ إِنَّ عَذَابَكَ بِالْكَفَّارِ مُلْحِقٌ -

**O Allah! Të kërkojmë ndihmë! Të kërkojmë falje! Të besojmë!
Te Ti mbështetemi! Të lavdërojmë në mënyrën më të mirë!
Të falënderojmë dhe nuk Të jemi mosmirënjohës. Ne e lëmë
dhe e braktisim atë që nuk Të bindet. O Allah! Vetëm Ty të
adhurojmë. Ty të lutemi. Ty të bëjmë sexhde. Drejt Teje
vrapojmë. Ty të shërbejmë. Shpresojmë mëshirën Tënde dhe
frikësohemi nga ndëshkimi Yt. Ndëshkimi Yt pa dyshim që u
bie mohuesve.¹⁸⁵**

Shënim: Lutja e famshme e shënuar më sipër, me ndryshime shumë të vogla, përmendet në këta libra: “Marasil Ebu Daud”; “Sunen Bejhaki”; “Sherhus-sinah”; “Kitabul-vitr, Shejh Muhammed Ibni Nesr El-Meruzi”.

184. Ebu Daud, Kitab el-vitr; Nisai, Kitab kijamil-lejl bab ed-dua fil-vitr.

185. Tuhfatul-fukaha, bab salatil-vitr, Damask.

Lutje pas dhënies së selamit nga namazi

(1) Sipas Theubanit^{ra}, skllavit të liruar nga i Dërguari i Allahut^{sas}, pas namazit i Dërguari i Allahut^{sas} thoshte tri herë “*estagfirullah*” (i kërkoj falje Allahut) dhe bënte këtë lutje:

اللَّهُمَّ أَنْتَ السَّلَامُ وَمِنْكَ السَّلَامُ، تَبَارَكْتَ يَا ذَا الْجَلَالِ وَالْإِكْرَامِ-

O Allah! Ti je paqja dhe prej Teje vjen paqja! Je bekimplotë, o zotërues i madhështisë dhe i nderit!¹⁸⁶

(2) Hazret Mugira Ibni Shi’ba^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} pas dhënies së selamit nga namazi, thoshte tri herë këto fjalë:

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ-

Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut. Ai është i vetëm dhe i pashoq. Të Atij janë sundimi dhe lavdia. Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë.

E më pas lutej:

اللَّهُمَّ لَا مَانِعَ لِمَا أَعْطَيْتَ وَلَا مُعْطَى لِمَا مَنَعْتَ وَلَا يَنْفَعُ ذَا الْجُدِّ مِنَ الْجُدِّ-

O Allah! Askush nuk mund të pengojë atë që Ti e dhuron dhe askush nuk mund të japë atë që Ti e refuzon dhe nuk mund të bëjë dobi madhështia e askujt përballë Teje.¹⁸⁷

186. Muslimi, Kitabul-mesaxhid, bab istihbab edh-dhikr ba’das-salat.

187. Buhariu, Kitabud-da’vat, bab dua ba’das-salat.

Madhërimi e lavdërimi (*tesbihu e tahmidi*)

(1) Hazret Ebu Hurejrah^{ra} tregon se disa sahabë të varfër muhaxhirë erdhën tek i Dërguari i Allahut^{sas} dhe thanë: “Të pasurit na parakaluan, sepse bashkë me namazet dhe agjërimet, ata shpenzojnë edhe pasurinë në rrugë të Allahut!” I Dërguari i Allahut^{sas} iu përgjigj: “A t’ju tregoj diçka, të cilën nëse e zbatoni, do të barazoheni me ta dhe nuk mund t’ju tejkalojnë edhe ata që do të vijnë më vonë?” “Na e tregoni, o i Dërguari i Allahut!”, iu përgjigjën sahabët. Ai tha: “Pas çdo namazi, thoni 33 herë *Subhanallah* (i Shenjtë është Allahu), 33 herë *Elhamdulil-lah* (lavdia është e Allahut) dhe 33 herë *Allahu ekber*” (Allahu është më i Madhi) ose 34 herë Allahu ekber, siç thuhet në një rrëfim tjetër.¹⁸⁸

(2) Nëna e besimtarëve, Hazret Xhujejrija^{ra}, pas namazit të sabahut, duke qëndruar ulur po përkujtonte Allahun. Ndërkohë, pranë saj kaloi i Dërguari i Allahut^{sas}. Më vonë, kur ai u kthye, dielli ishte ngritur mjaft, ndërkohë, Hazret Xhujejrija^{ra} vazhdonte ta përkujtonte Allahun. I Dërguari i Allahut^{sas} i tha: “Që kur kalova pranë teje, kam thënë katër fjalë nga tri herë, të cilat në ndikim e shpërblim janë shumë më të mëdha sesa përkujtimi që ke bërë”. Më pas ia tregoi këto fjalë:

سُبْحَانَ اللَّهِ وَبِحَمْدِهِ وَعَدَدَ خَلْقِهِ وَرِضَا نَفْسِهِ وَزِينَةَ عَرْشِهِ وَمِدادَ
كَلِمَاتِهِ -

I Shenjtë është Allahu me gjithë lavdinë e Tij, aq shumë sa janë krijesat e Tij. I Shenjtë është Allahu aq sa e do Vetë Ai. I Shenjtë është Allahu aq sa peshon arshi i Tij. I Shenjtë është Allahu aq

188. Buhariu, Kitab sifatis-salat, bab man lem jeruddus-salam al-el-imam.

sa janë fjalët që ka krijuar Ai.¹⁸⁹

(3) Hazret Ebu Seid Hudriju^{ra} dhe Hazret Ebu Hurejrah^{ra} tregojnë se i Dërguari i Allahut^{sas} ka thënë: “Janë katër fjalë që Allahu i Madhërishëm i ka zgjedhur për Vete:

Subhanallah (I Shenjtë është Allahu)

Elhamdulil-lah (Lavdia është e Allahut)

La ilaha il-lallah (Nuk ka të adhurar tjetër përveç Allahut) dhe

Allahu ekber (Allahu është më i Madhi)

... Ai që thotë *Subhanallah* i shkruhen 20 vepra të mira dhe i falen po aq gjynahe. I njëjtë është shpërblimi edhe për atë që thotë *Allahu ekber*, dhe edhe për atë që thotë *La ilaha il-lallah*. Kurse ai që thotë *Elhamdulil-lah* dhe shton edhe *Rabil alamin*, i shkruhen 30 vepra të mira dhe i falen po aq gjynahe.¹⁹⁰

(4) Hazret Ebu Hurejrah^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} ka thënë:

Janë dy fjalë që janë të lehta për gjuhën, por të rënda për peshën. Ato janë:

سُبْحَانَ اللَّهِ وَبِحَمْدِهِ سُبْحَانَ اللَّهِ الْعَظِيمِ -

Subhanallahi ue bihamdihi subhanallahil ezim

I Shenjtë është Allahu me lavdinë e Tij; i Shenjtë është Allahu, i Madhërishmi!¹⁹¹

189. Muslimi, Kitabudh-dhikr, bab et-tasbih euelun-nahar.

190. Musned Ahmedi, vëll. 2, f. 35.

191. Buhariu, Kitabud-da'vat, bab fadlit-tasbih.

(5) Hazret Ebu Musa Esh'ariji rrëfen: I Dërguari i Allahut^{sas} më pyeti: “A të tregoj një ndër thesaret e xhenetit?” “Patjetër, o i Dërguari i Allahut”, iu përgjigja. Më tha: “Një thesar i xhenetit është:

لَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ الْعَلِيِّ الْعَظِيمِ-

Sundim dhe fuqi s'ka askush tjetër përveç Allahut të Lartësuar, të Madhërishëm.¹⁹²

(6) Hazret Muadh Ibni Xhebeli tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} i tha të bëjë këtë lutje në çdo namaz, dhe sipas një rrëfimi tjetër, pas çdo namazi:

اللَّهُمَّ اعْنِنِي عَلَى ذِكْرِكَ وَشُكْرِكَ وَحُسْنِ عِبَادَتِكَ -

O Allah! Më ndihmo për të të kujtuar Ty, për të të falënderuar Ty dhe për të të adhuruar Ty në mënyrën më të bukur!¹⁹³

(7) Hazret Muslim Ibni Harith Tejmi thotë se i Dërguari i Allahut^{sas} e këshilloi ta bënte shtatë herë këtë lutje pas namazit të sabahut dhe të akshamit, që të mbrohej nga zjarri:

اللَّهُمَّ اجْرِنِي مِنَ النَّارِ-

O Allah! Më streho nga zjarri!¹⁹⁴

Lutje për të pasur emocione në lutje

Hazret Abdullahu^{ra} kujton nga babai i tij, Hazret Omer Ibni Hatab^{ra},

192. Buhariu, Kitabud-da'vat, bab keulu “la heula uela kuvata; Maxhmauz-zavaid, vëll. 7, f. 523.

193. Ebu Daud, Kitabul-vitr, bab fil-istigfar.

194. Ebu Daud, Kitabul-adab, bab ma jekulu idha asbaha.

i cili thotë se i Dërguari i Allahut^{sas} bënte këtë lutje:

اللَّهُمَّ ارْزُقْنِي عَيْنَيْنِ هَطَّالَتَيْنِ، تَشْفِيَانِ الْقَلْبَ بِدُرُوفِ الدُّمُوعِ مِنْ
خَشْيَتِكَ، قَبْلَ أَنْ تَكُونَ الدُّمُوعُ دُمًا، وَالْأَجْرَاسُ جَمْرًا-

**O Allah! Dhuromë sytë që lotojnë, që më shërojnë zemrën
përmes lotëve të derdhur nga druajtja ndaj Teje, përpara se
lotët të shndërrohen në gjak dhe gurët në prush.**¹⁹⁵

Lutje të ndryshme pas namazit

Hazret Abdullah Ibni Abasi^{ra} rrëfen: “Një natë e dëgjova të Dërguarin
e Allahut^{sas} duke bërë lutjen vijuese, pasi kishte mbaruar namazin”.

Siç tregon Buhariu, pjesën e nënvizuar të kësaj lutjeje, pra atë të
dritës, i Dërguari i Allahut^{sas} e thoshte edhe para namazit të sabahut:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ رَحْمَةً مِّنْ عِنْدِكَ تَهْدِي بِيهَا قَلْبِي وَتَجْمَعُ بِهَا
أَمْرِي، وَتَلْمُ بِهَا شَعْيِي، وَتَصْلِحَ بِهَا غَائِبَتِي، وَتَرْفَعَ بِهَا شَاهِدِي
، وَتُرَكِّي بِهَا عَمَلِي وَتُلْهِمْنِي بِهَا رُشْدِي، وَتَرُدُّ بِهَا الْفِتَى، وَتَعْصِمْنِي بِهَا
مِنْ كُلِّ سُوءٍ اللَّهُمَّ أَعْطِنِي إِيمَانًا وَيَقِينًا لَيْسَ بَعْدَهُ كُفْرٌ وَرَحْمَةً أَنَالَ بِهَا
شَرَفَ كَرَامَتِكَ فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ، اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْفَوْزَ فِي الْعَطَاءِ
(وَالْقَضَاءِ) وَنُزُلَ الشُّهَدَاءِ، وَعَيْشَ السُّعَدَاءِ، وَالنَّصْرَ عَلَى
الْأَعْدَاءِ، اللَّهُمَّ إِنِّي أَنْزِلْ بِكَ حَاجَتِي، وَإِنْ قَصُرَ رَأْيِي وَضَعُفَ عَمَلِي،
وَافْتَقَرْتُ إِلَى رَحْمَتِكَ فَاسْأَلُكَ يَا قَاضِيَ الْأُمُورِ، وَيَا شَافِي

195. Kitabud-dua, vëll. 3, f. 1480, lit-Tibrani 360 hixhri.

الصُّدُورِ، كَمَا تُجِيرُ بَيْنَ الْبُحُورَانِ تُجِيرِنِي مِنْ عَذَابِ السَّعِيرِ، وَمِنْ
 دَعْوَةِ الثُّبُورِ وَمِنْ فِتْنَةِ الْقُبُورِ، اللَّهُمَّ مَا قَصَرَ عَنْهُ رَأْيِي، وَلَمْ تَبْلُغْهُ بَيْتِي
 وَلَمْ تَبْلُغْهُ مَسْأَلَتِي مِنْ خَيْرٍ وَعَدَّتْهُ أَحَدًا مِنْ خَلْقِكَ، أَوْ خَيْرِ أَنْتَ
 مُعْطِيهِ أَحَدًا مِنْ عِبَادِكَ فَانِّي أَرْغَبُ إِلَيْكَ فِيهِ وَأَسْأَلُكَ بِرَحْمَتِكَ رَبَّ
 الْعَالَمِينَ، اللَّهُمَّ ذَا الْحَبْلِ الشَّدِيدِ، وَالْأَمْرِ الرَّشِيدِ، أَسْأَلُكَ الْآمَنَ يَوْمَ
 الْوَعِيدِ وَالْحِجَّةِ يَوْمَ الْخُلُودِ مَعَ الْمُقَرَّبِينَ الشُّهُودِ، الرَّكْعِ السُّجُودِ
 الْمُؤَفِّينَ بِالْعُهُودِ، إِنَّكَ رَحِيمٌ وَدُودٌ، وَأَنْتَ تَفْعَلُ مَا تُرِيدُ، اللَّهُمَّ اجْعَلْنَا
 هَادِينَ مُهْتَدِينَ، غَيْرَ ضَالِّينَ وَلَا مُضِلِّينَ سَلْمًا لِأَوْلِيَايَاكَ، عَدُوًّا
 لِأَعْدَائِكَ، نَحْبُ بِحَبِّكَ مَنْ أَحَبَّكَ، وَنَعَادِي بِعَدَاوَتِكَ مَنْ
 خَالَفَكَ، اللَّهُمَّ هَذَا الدُّعَاءُ وَعَلَيْكَ الْإِجَابَةُ وَهَذَا الْجُهْدُ وَعَلَيْكَ
 التُّكْلَانِ، اللَّهُمَّ اجْعَلْ لِي نُورًا فِي قَلْبِي وَنُورًا فِي قَبْرِي، وَنُورًا مِنْ بَيْنِ
 يَدَيَّ، وَنُورًا مِنْ خَلْفِي وَنُورًا عَنْ يَمِينِي وَنُورًا عَنْ شِمَالِي، وَنُورًا مِنْ
 فَوْقِي، وَنُورًا مِنْ تَحْتِي وَنُورًا فِي سَمْعِي، وَنُورًا فِي بَصْرِي، وَنُورًا فِي
 شَعْرِي، وَنُورًا فِي بَشْرِي، وَنُورًا فِي لَحْمِي وَنُورًا فِي دَمِي، وَنُورًا فِي
 عِظَامِي، اللَّهُمَّ أَعْظِمْ لِي نُورًا، وَأَعْظِمْنِي نُورًا وَاجْعَلْ لِي نُورًا، سُبْحَانَ
 الَّذِي تَعَطَّفَ الْعِزَّ وَقَالَ بِهِ، سُبْحَانَ الَّذِي لَيْسَ الْمَجْدُ وَتَكَرَّمَ بِهِ، سُبْحَانَ
 الَّذِي لَا يَنْبَغِي التَّشْبِيحُ إِلَّا لَهُ سُبْحَانَ ذِي الْفَضْلِ وَالنِّعَمِ، سُبْحَانَ ذِي
 الْمَجْدِ وَالْكَرَمِ، سُبْحَانَ ذِي الْجَلَالِ وَالْإِكْرَامِ-

O Allah! Kërkoj prej Teje mëshirën që ma drejton zemrën, që ma rregullon problemin, që ma zgjidh të pazgjidhurën, që ma kthen të humburën, që më lartëson atë që kam, që ma pastron

veprën, që më dikton urtësinë, që më kthen atë që dua, që më shpëton nga çdo e keqe.

O Allah! Më dhuro besimin dhe bindjen, të cilën nuk e pason asnjë mosbesim. Më dhuro mëshirën që më sjell bujarinë Tënde në këtë botë dhe në botën tjetër. O Allah! Të kërkoj sukses në çdo dhuratë e caktim, të kërkoj mikpritjen që u bëhet dëshmorëve, jetën e faqebardhëve, ndihmën kundër armiqve!

O Allah! Kam ardhur te Ti për problemin tim. Nëse kam mendimin të mangët dhe veprën të dobët, Ty të lyp mëshirën. Ty të kërkoj, o Gjykuesi i të gjitha çështjeve dhe Shëruesi i zemrave që, ashtu siç shpëton dikë nga deti i tërbuar, të më shpëtosh edhe mua nga ndëshkimi i zjarrit, nga thirrja e gjëmës dhe nga dënimi e varrit.

O Allah! Të mirën që nuk ka menduar dot mendja ime dhe që nuk e kam imagjinuar dot dhe që nuk ta kam kërkuar dot, por Ti ia ke premtuar ndokujt prej krijesave të Tua ose të mirën që Ti ia ke dhuruar ndokujt prej robërve të Tu, ta kërkoj falë mëshirës Sate, o Zoti i të gjitha botëve, sepse e dua atë.

O Allah! O Ti që mban lidhje të fortë! O Ti që zotëron urtësinë! Të kërkoj paqen në ditën e dënimit dhe xhenetin gjatë kohës që do të jetë e përhershme, bashkë me robërit e Tu të afërt, me ata që bëjnë ruku dhe sexhde dhe që përmbushin premtimet e tyre. Me të vërtetë, Ti je Mëshirëplotë dhe burim i dashurisë. Ti bën atë që do.

O Allah! Na bëj të udhëzuar dhe udhëzues e jo të devijuar e devijues dhe na bëj paqe për miqtë e Tu, luftë për armiqtë

e Tu. Për hir të dashurisë Sate, ne duam çdokënd që Ti e do dhe për hir të armiqësisë Sate, kemi armik çdokënd që të ka kundërshtuar. Kjo është e gjithë lutja, e pranimi të takon Ty. O Allah! Kjo është e gjithë përpjekja, e mbështetjen e kemi vetëm te Ti.

O Allah! Bëj dritë në zemrën time, dritë në varrin tim, dritë para meje, dritë pas meje, dritë në të djathtën time, dritë në të majtën time, dritë mbi mua, dritë poshtë meje, dritë në dëgjimin tim, dritë në shikimin tim, dritë në flokët e mi, dritë në lëkurën time, dritë në mishin tim, dritë në gjakun tim dhe dritë në kockat e mia. O Allah! Më bëj të kuptoj rëndësinë e dritës, më dhuro dritë dhe më bëj mua dritë!

I Shenjtë është Ai, që na shfaqet i Respektueshëm me veshjen e Tij të fisnikërisë e bujarisë. I Shenjtë është Ai, përballë të cilit nuk mund të përshkruhet shenjtëria e askujt tjetër. I Shenjtë është Ai, që zotëron dhuntinë dhe bekimin. I Shenjtë është Ai, që zotëron shenjtërinë dhe bujarinë. I Shenjtë është Ai, që zotëron madhështinë dhe nderin.¹⁹⁶

Namazi dhe lutja kur je në nevojë

Hazret Abdullah Ibni Eufar^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} ka thënë:

Ai që ka nevojë për diçka prej Zotit të Madhërishëm ose prej ndonjë njeriu, le të marrë abdes sa më mirë e të falë dy nafle si “namaz për nevojë”. Pas lavdërimit dhe falënderimit të Zotit të Madhërishëm dhe dërgimit të *salavateve*, le të bëjë këtë lutje:

196. Tirmidhiu, Kitabud-da'vat, bab ma jekulu idha kama minel-lejl.

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ الْحَلِيمُ الْكَرِيمُ سُبْحَانَ اللَّهِ رَبِّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ، الْحَمْدُ لِلَّهِ
رَبِّ الْعَالَمِينَ، أَسْأَلُكَ مُوجِبَاتِ رَحْمَتِكَ، وَعَزَائِمَ مَغْفِرَتِكَ وَالْغَنِيمَةَ
مِنْ كُلِّ بَرٍّ وَالسَّلَامَةَ مِنْ كُلِّ إِثْمٍ، لَا تَدْعُ لِي ذَنْبًا إِلَّا غَفَرْتَهُ وَلَا هَمًّا
إِلَّا فَرَجْتَهُ، وَلَا حَاجَةً هِيَ لَكَ رَضِيَ إِلَّا أَقْضَيْتَهَا يَا أَرْحَمَ الرَّاحِمِينَ-

Nuk ka të adhurar tjetër përveç Allahut, të Dhembshurit dhe Bujarit! I Shenjtë është Allahu, Zoti i arshit madhështor! Lavdia është e Allahut, Zotit të botëve. Të kërkoj gjërat që tërheqin mëshirën Tënde, shkaktarët e faljes Sate, mundësinë për të bërë çdo vepër të mirë, mbrojtjen nga çdo mëkat. Mos më lër gjynah pa falur, brengë pa larguar dhe nevojë që përputhet me pëlqimin Tënd, pa plotësuar, o më i Mëshirshmi nga të gjithë mëshiruesit.¹⁹⁷

***Istihara* - namazi dhe lutje për të kërkuar mirësi në çështje të caktuara**

I Dërguari i Allahut^{sas} i udhëzoi sahabët e tij të luten për mirësi para se të bënin çdo punë, qoftë të kësaj bote, qoftë të besimit, në mënyrë që të gëzojnë bekimin e Zotit dhe sukses në punët e tyre. Kjo lutje quhet “*Salatul istihara*” (namazi për të kërkuar mirësi). Në këtë namaz falen dy nafilë. Në rekatën e parë recitohet surja *El-Kafirun* pas sures *El-Fatiha* dhe në të dytin surja *El-Ihlas* pas *El-Fatihës*. Në rekatën e fundit kur jeni të ulur, pasi të keni thënë *teshehudin*, *salavatet* dhe lutjet e praktikuara, të bëni lutjen e mëposhtme me shumë përpulësi e përgjërime:

197. Tirmidhiu, Kitabul-vitr, bab salatit-haxhah.

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْتَخِيرُكَ بِعِلْمِكَ وَأَسْتَقْدِرُكَ بِقُدْرَتِكَ وَأَسْأَلُكَ بِمَنْ
فَضْلِكَ الْعَظِيمِ، فَإِنَّكَ تَقْدِرُ وَلَا أَقْدِرُ وَتَعْلَمُ وَلَا أَعْلَمُ وَأَنْتَ عَلَّامُ
الْغُيُوبِ، اللَّهُمَّ إِنْ كُنْتَ تَعْلَمُ أَنَّ هَذَا الْأَمْرَ خَيْرٌ لِي فِي دِينِي وَمَعَاشِي
وَعَاقِبَةِ أَمْرِي فَاقْدُرْهُ لِي وَيَسِّرْهُ لِي ثُمَّ بَارِكْ لِي فِيهِ وَإِنْ كُنْتَ تَعْلَمُ
أَنَّ هَذَا الْأَمْرَ شَرٌّ لِي فِي دِينِي وَمَعَاشِي وَعَاقِبَةِ أَمْرِي فَاصْرِفْهُ عَنِّي
وَاصْرِفْ بِنِعْمَتِكَ وَأَقْدِرْ لِي الْخَيْرَ حَيْثُ كَانَ ثُمَّ رَضِّنِي بِهِ -

O Allah! Të kërkoj të mirën sipas dijeve Sate dhe Të kërkoj fuqinë me anë të fuqisë Sate. Të kërkoj bekimin Tënd madhështor. Sepse Ti ke fuqi e unë nuk e kam, Ti di e unë nuk di dhe Ti zotëron dije të plotë për të padukshmet. O Allah! Nëse Ti e di se kjo çështje është e mbarë për mua, për besimin tim, për jetën time dhe për përfundimin e saj, caktoje për mua, lehtësoje për mua dhe, më pas, edhe bekoje për mua. Dhe nëse Ti e di se kjo çështje është e keqe për mua, për besimin tim, për jetën time dhe për përfundimin e saj, largoje prej meje, edhe mua më largo prej saj dhe më cakto të mirën kudo që të gjendet ajo dhe më pas bëje atë të pëlqyeshme për mua.¹⁹⁸

Namaz i *tesbihut*

Është një hadith i vetëm dhe i dobët që vjen nga Hazret Ebu Rafi^{ra}, sipas të cilit i Dërguari i Allahut^{sas} i mësoi xhaxhait të tij, Hazret Abas^{ra}, mënyrën e namazit të *tesbihut* dhe duke i treguar rëndësinë e tij, i tha: “O xhaxha! A të jap një gjë, me anë të së cilës ty do të të falen të gjitha mëkatet, të mëparshme dhe të mëvonshme, të

198. Tirmidhiu, Kitabul-vitr, bab salat-il-istihara; Ibni Maxha, Kitabus-salat, bab ma xha'a fis-salat.

reja dhe të vjetra, të bëra me pavetëdije dhe të bëra me vetëdije, të vogla e të mëdha, të fshehta e të hapëta?” Kur Hazret Abasi^{ra} e pyeti për vështirësinë që ka ky namaz për ta falur çdo ditë, i Dërguari i Allahut^{sas} iu përgjigj: “Këtë namaz mund ta falësh sipas mundësisë: çdo ditë, çdo javë, çdo muaj, çdo vit apo një herë në jetë”. Duke treguar mënyrën e këtij namazi nafil 4-rekatësh, sipas rrëfimit, i Dërguari i Allahut^{sas} tha se namazfalësi në çdo rekat pas recitimit të sures *El-Fatiha* dhe të ndonjë pjese tjetër të Kuranit, nga 15 herë të thotë:

سُبْحَانَ اللَّهِ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ وَلَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاللَّهُ أَكْبَرُ

Subhanallahi uelhamdulil-lah ue la ilaha il-lallah ue Allahu ekber.

(I Shenjtë është Allahu, lavdia është e Allahut, nuk ka të adhurar tjetër përveç Allahut dhe Allahu është më i madhi)

Veç kësaj, edhe në ruku pas lutjes së caktuar, edhe në qëndrim pas lutjes së caktuar, në çdo sexhde pas fjalëve të caktuara, në qëndrim midis dy sexhdeve pas lutjes së caktuar, si dhe në çdo rekat pas sexhdes së dytë duke qëndruar i ulur të thotë nga 10 herë fjalët e sipërpërmendura. Në këtë mënyrë, ky përkujtim në çdo rekat bëhet nga 75 herë dhe në katër rekate 300 herë gjithsej.¹⁹⁹

Lutje të ndryshme të përditshmërisë

(1) Çdo punë të rëndësishme fillojeni me “*Bismil-lah*” (me emrin e Allahut). Nëse harroni të thoni *Bismil-lah* para buke, në fund të saj mund të thoni:

199. Tirmidhiu, Kitabul-vitr, bab salatit-tesbih.

بِسْمِ اللَّهِ فِي أَوَّلِهِ وَآخِرِهِ

Bismil-lahi fi eualihi ue ahirih

Me emrin e Allahut edhe në fillim, edhe në fund.²⁰⁰

Pas buke, duke falënderuar Zotin e Madhërishëm, thoni:

El-hamdulil-lah

Lavdia është e Allahut!²⁰¹

(2) Duke ecur në rrugë ose duke hyrë në shtëpi a në mbledhje, të thoni lutjen *Es-selam alejkum*: kalimtari atij që është ulur, udhëtari në mjet atij që ecën në këmbë. Lutja e plotë përshëndetëse, e cila i siguron shpërblimin e 30 veprave të mira atij që e bën, është:

السَّلَامُ عَلَيْكُمْ وَرَحْمَةُ اللَّهِ وَبَرَكَاتُهُ

Es-selam alejkum ue rahmatullahi ue barakatuhu

“Paqja, mëshira dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ju!”

Edhe dëgjuesi t’ia kthejë duke thënë: *Ue alejkum selam* (Paqja qoftë edhe mbi ju!).²⁰²

(3) Kur dikush ju bën mirësi, lutuni për të duke i thënë:

Xhezakallahu hair

Allahu të shpërbleftë me të mira!²⁰³

(4) Kur të dëgjoni këndesin, t’i luteni Allahut për bekimet e Tij. Kur të dëgjoni lehjen e qenit apo pëllitjen e gomarit, të thoni:

200. Tirmidhiu, Kitabul-at’imah, bab et-tesmija alet-ta’am.

201. Buhariu, Kitabul-at’imah, bab ma jekulu idha faraga min ta’amih.

202. Musned Ahmed, vëll. 3, f. 158.

203. Tirmidhiu, Kitabul-birr, bab ma xha’a fil-mutashab’i.

Eudhu bil-lah

Kërkoj mbrojtjen e Allahut!²⁰⁴

(5) I Dërguari i Allahut^{sas} kur pa një njeri shumë të zemëruar, tha: Unë di një fjalë që do të ta largojë zemërimin dhe ajo është:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ-

O Allah! Më mbro nga shejtani i mallkuar!²⁰⁵

(6) Nëse shihni një ëndërr të mirë, thoni “*Elhamdulillah-lah!*”, “Lavdia është e Allahut!” Nuk ka asgjë të keqe nëse ua tregoni ëndrën të tjerëve. Ndërsa kur shihni një ëndërr të keqe, thoni “*Eudhubil-lah!*”, “Kërkoj mbrojtjen e Allahut”, dhe mos ia tregoni ndokujt.²⁰⁶

(7) Ai që teshtin, le të thotë “*Elhamdulillah-lah*” (Lavdia është e Allahut!), ndërsa dëgjuesi të lutet për të duke i thënë “*Jerhamukallah*” (Allahu të mëshiroftë!) dhe teshtitësi t’ia kthejë duke thënë:

يَهْدِيكُمْ اللَّهُ وَ يُصْلِحْ بَالَكُمْ

“*Jahdikumallahu ue juslihu balekum*”

Zoti të udhëzoftë dhe ta rregulloftë jetën!²⁰⁷

Lutje gjatë recitimi të Kuranit Famëlartë

(1) Para se të filloni recitimin e Kuranit Famëlartë, duhet të kërkonti mbrojtjen e Allahut duke thënë:

204. Buhariu, Kitab badail-khalki, bab khejr malil-lmuslim.

205. Ebu Daud, Kitabul-adab, bab ma jekulu endal-gazab.

206. Tirmidhiu, Kitabud-da’vat, bab ma jekulu idha ra’u ru’ja.

207. Tirmidhiu, Kitabul-adeb, bab ma xha’a fi teshmijetil-atis.

أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ

Eudhu bil-lahi minesh shejtanir-raxhim

Kërkoj mbrojtjen e Allahut nga shejtani i mallkuar!

Siç filloni çdo punë të rëndësishme me bismil-lahun, është e bekuar që edhe recitimin e Kuranit ta filloni me:

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Bismil-lahirrahmanirrahim

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

(2) Hazret Euf Ibni Malik Eshxhei^{ra} rrëfen: “Unë bashkë me të Dërguarin e Allahut^{sas} filluam namazin *nafil*. Ai recitoi suren *El-Bekare*. Sa herë që kalonte nga ndonjë ajet që fliste për mëshirë, ai ndalej dhe kërkonte mëshirë dhe sa herë që kalonte nga ndonjë ajet që fliste për ndëshkim, prapë ndalej dhe kërkonte mbrojtje prej tij”.²⁰⁸

(3) Në një rrëfim tjetër që vjen nga Hazret Hudhejfa^{ra} përmendet që, sa herë që vinte ndonjë ajet ku përmendej shenjtëria e Zotit, i Dërguari i Allahut^{sas} thoshte “*subhanallah*”, domethënë “i Shenjtë është Allahu”.²⁰⁹

(4) Hazret Uail^{ra} Ibni Hexher thotë: “Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut^{sas} duke recituar suren *El-Fatiha*. Pasi lexoi fjalët “*ueled dal-lin*”, ai me zë të zgjatur tha “*Amin!*”, domethënë “pranoje!”²¹⁰

(5) Hazret Ebu Mejsira^{ra} rrëfen se të Dërguarin e Allahut^{sas} e ka

208. Ebu Daud, Kitabus-salat, bab ma jekulur-rexhul fi rukuihi ue suxhudihi.

209. Muslimi, Kitab salatil-musafirin, bab istihbab tetvilil-kir’at.

210. Ebu Daud, Kitabus-salat, bab et-ta’min uera’al imam.

porositur Xhibraili^{as} të thotë “Amin!” në ajetet e fundit të sures *El-Bekare*.²¹¹

(6) Hazret Xhabir Ibni Abdullah^{ra} rrëfen: “I Dërguari i Allahut^{sas} para sahabëve të tij recitoi suren *Er-Rahman*. Sahabët e dëgjuan dhe heshtën. Më pas i Dërguari i Allahut^{sas} u tha: “Më mirë se ju ishte grupi i xhindëve, të cilët gjatë recitimit të kësaj sureje, çdo herë kur e dëgjonin ajetin “*Febi ej-ji alai Rab-bikuma takedh-dhiban*” (domethënë, ju të dy cilin nga bekimet e Zotit do të mohoni?), thoshin:

لَا بِشَيْءٍ مِّنْ نَّعْمِكَ رَبَّنَا نَكَدُّبُ وَلَكَ الْحَمْدُ

O Zoti ynë! Nuk mohojmë asnjë nga bekimet e Tua dhe e Jotja është lavdia.”²¹²

(7) Hazret Akba Ibni Amiri rrëfen: Kur zbriti ajeti i 97-të i sures 56 *El-Uakia*

فَسَبِّحْ بِاسْمِ رَبِّكَ الْعَظِيمِ

“Përkujtoje shenjtërinë e Zotit tënd të Madhërishëm”, i Dërguari i Allahut^{sas} tha: “Kjo le të jetë në *ruku*”, domethënë në ruku të themi “*Subhana rabijel azim*”, që do të thotë “**I Shenjtë është Zoti im, i Madhërishmi**”. (Veç kësaj, edhe gjatë recitimit të këtij ajeti, i Dërguari i Allahut^{sas} thoshte “*Subhana rabijel azim*”.

(8) Në të njëjtën mënyrë, kur zbriti ajeti i 2-të i sures 87 *El-A’la*:

سَبِّحْ اسْمَ رَبِّكَ الْأَعْلَى

“Përkujto emrin e Zotit tënd të Lartësuar”, i Dërguari i Allahut^{sas}

211. Sujuti, *El-Itkan*, pjesa I, Bejrut, f. 107.

212. Tirmidhiu, *Kitabut-tefsir*, suretur-Rahman.

tha: “Këtë thojeni në sexhde” (domethënë, “*Subhana Rabijel A’la*”, “**I Shenjtë është Zoti im, i Lartësuar!**”).²¹³

(9) Pas recitimit të ajetit të fundit të sures 67 *El-Mulk*:

فَمَنْ يَأْتِيكُمْ بِمَاءٍ مَّعِينٍ

“Nëse uji juaj do të shkojë në fund, kush mund t’ju sjellë (sërish) ujin e burimeve?”

është mirë të thoni:

اللَّهُ رَبُّ الْعَالَمِينَ

Allahu, Zoti i botëve.²¹⁴

(10) Hazret Musa Ibni Ajshja^{ra} rrëfen: “Një njeri po falte namaz në çatinë e shtëpisë së tij. Kur ai recitoi ajetin e fundit të sures 75 *El-Kijamah*, që është:

الَّذِينَ ذَالِكًا بَقَاذِيرَ عَلَىٰ أَنْ يُحْيِيَ الْمَوْتَىٰ

“**A nuk ka fuqi Zoti të ringjallë të vdekurit?!”,** tha:

سُبْحَانَكَ

“**I Shenjtë je Ti**” dhe filloi të qante. Kur dikush e pyeti shkaku se pse i kishte thënë ato fjalë, ai u përgjigj se kështu e kishte dëgjuar të Dërguarin e Allahut^{sas} të thoshte.²¹⁵

(11) Ai që reciton suren 75 *El-Kijamah* dhe vjen tek ajeti i fundit që është:

213. Ebu Daud, Kitabus-salat, bab ma jekulur-rexhul fi rukuihi ue suxhudihi.

214. Tefsir Xhelalejn, surja El-mulk.

215. Ebu Daud, Kitabus-salat, bab ed-dua fis-salat.

أَلَيْسَ ذَلِكَ بِقَادِرٍ عَلَىٰ أَنْ يُحْيِيَ الْمَوْتَىٰ

“A nuk ka fuqi Zoti të ringjallë të vdekurit?!”, le të thotë:

بَلَىٰ

“Patjetër që po!”.²¹⁶

(12) Ai që reciton suren 77 *El-Murselat* dhe vjen tek ajeti i fundit që është:

قَبَائِلُ حَدِيثٍ بَعْدَهُ يُؤْمِنُونَ

“Cilën fjalë do të besoni pas kësaj?”, le të thotë

آمَنَّا بِاللَّهِ

“Ne e besuam Allahun”.²¹⁷

(13) Hazret Abdullah Ibni Abasi^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} kur recitonte ajetin e parë të sures 87 *El-A'la*

سَبِّحْ اسْمَ رَبِّكَ الْأَعْلَىٰ

duke iu përgjigjur thoshte:

سُبْحَانَ رَبِّيَ الْأَعْلَىٰ

që do të thotë: “I Shenjtë është Zoti im, i Lartësuari”.²¹⁸

(14) Hazret Ebu Hrejah^{ra} rrëfen se i Dërguari i Allahut^{sas} ka thënë: “Çdokush nga ju që reciton suren 95 *Uet-Tin* deri në fund, t'i përgjigjet ajetit

216. Ebu Daud, Kitabus-salat, bab mikdarir-ruku.

217. Po aty.

218. Ebu Daud, Kitabus-salat, bab ma jekulur-rexhul, fir-rukui ues-suxhud.

أَلَيْسَ اللَّهُ بِأَحْكَمَ الْحَاكِمِينَ

“A nuk është Zoti gjykatësi më i drejtë?!”) duke thënë:

بَلَىٰ وَأَنَاظِي ذَٰلِكَ مِنَ الشَّاهِدِينَ

“Patjetër që po dhe unë jam një ndër dëshmitarët e këtij fakti”.²¹⁹

(15) Hazret Ajshja^{ra} tregon se pas zbritjes së sures 110 En-Nasr, kurdoherë që i Dërguari i Allahut^{sas} e recitoi këtë sure, iu përgjigj ajetit:

أَسْتَسْمِعُ بِحَمْدِ رَبِّكَ وَاسْتَعْفِرُكَ

“Përkujtoje lavdinë e Zotit tënd dhe kërkoji falje Atij”, duke thënë:

سُبْحَانَكَ رَبَّنَا وَبِحَمْدِكَ اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي -

“I Shenjtë je Ti, o Zoti ynë, me gjithë lavdinë Tënde. O Allah! Më fal mua”.²²⁰

Lutje gjatë sexhdes së recitimit të Kuranit

Në ajetet e Kuranit Famëlartë, aty ku vjen sexhdja e recitimit, duhet bërë sexhde. Për këtë nuk ka nevojë as për abdes, as për kiblen. Në hadithe përmendet që i Dërguari i Allahut^{sas} në sexhden e recitimit, përveç përkujtimit të Zotit që bënte në sexhdet e zakonshme, shpesh bënte edhe lutjet që vijojnë:

219. Ebu Daud, Kitabus-salat, bab duau fis-salat.

220. Buhariu, Kitabut-tefsir, suretun-Nasr.

(1) سَجَدَ وَجْهِي لِلَّذِي خَلَقَهُ وَشَقَّ سَمْعَهُ وَبَصَرَهُ بِحَوْلِهِ وَقُوَّتِهِ-

Fytyra ime po i bën sexhde Atij që e krijoi, i dhuroi veshët dhe sytë përmes mrekullisë dhe fuqisë së Tij.²²¹

(2) اَللّٰهُمَّ اَكْتُبْ لِيْ بِهَا عِنْدَكَ اَجْرًا وَصَعِّ عَنِّيْ بِهَا وِزْرًا
وَاجْعَلْهَا لِيْ عِنْدَكَ ذُخْرًا وَتَقَبَّلْهَا مِنِّيْ كَمَا تَقَبَّلْتَهُمَا مِنْ عَبْدِكَ دَاوِدَ-

O Allah! Këtë sexhde timen shkruaje te Ti si shpërblim (për mua), më lehtëso një barrë falë saj, më ofro një thesar falë saj pranë Teje dhe ma prano këtë, ashtu siç e ke pranuar prej robit Tënd Daud.²²²

Lutje për mbarimin e recitimit të Kuranit

Hazret Hudhejfa^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} kur përfundonte recitimin e gjithë Kuranit, bënte këtë lutje:

اَللّٰهُمَّ اَرْحَمْنِيْ بِالْقُرْآنِ وَاجْعَلْهُ لِيْ اِمَامًا وَنُوْرًا وَهُدًى وَرَحْمَةً اَللّٰهُمَّ
ذَكِّرْنِيْ بِسُنَّةِ مَا نَسِيْتُ وَعَلِّمْنِيْ مِنْهُ مَا جَهِلْتُ وَاَرزُقْنِيْ تِلَاوَتَهُ اَنَاءَ
الَّيْلِ وَاَطْرَافِ النَّهَارِ وَاجْعَلْهُ لِيْ حُجَّةً يَا رَبَّ الْعَالَمِيْنَ

O Allah! Më mëshiro në saje të Kuranit. Bëje atë për mua drejtues, dritë, udhërrëfyes dhe mëshirë. O Allah! Më kujto atë që kam harruar prej tij dhe më mëso atë që nuk e kam kuptuar prej tij. Më mundëso recitimin e tij gjatë orëve të natës dhe gjatë orëve të ditës. Bëje atë argument për mua, o Zoti i botëve.²²³

221. Tirmidhiu, Kitabut-da'vat, bab ma jekulu fi suxhudil-Kur'an.

222. Po aty.

223. Ihja ulumid-din, lil-Gazali, pj. 1, f. 278.

Lutje kur sheh hënën e re

(1) Sipas rrëfimit të Hazret Talha Ibni Abejdaullahut dhe atij të Hazret Katadasë, i Dërguari i Allahut^{sas} këtë lutje e bënte kur shikonte hënën e re:

اللَّهُمَّ أَهْلُهُ عَلَيْنَا بِالْأَمْنِ وَالْإِيمَانِ وَالسَّلَامَةِ وَالْإِسْلَامِ رَبِّيَ وَرَبُّكَ اللَّهُ،
هَلَالٌ خَيْرٌ وَرُشْدٌ، هَلَالٌ خَيْرٌ وَرُشْدٌ، هَلَالٌ خَيْرٌ وَرُشْدٌ، أَمَنْتُ بِاللَّهِ
الَّذِي خَلَقَكَ -

O Allah! Bëje këtë hënë të lindë mbi ne me paqen dhe besimin, me sigurinë dhe Islamin. O hënë! Zoti im dhe Zoti yt është Allahu! Qofsh një hënë e mbarë dhe udhëzuese! Qofsh një hënë e mbarë dhe udhëzuese! Qofsh një hënë e mbarë dhe udhëzuese! Besoj në Allahun që të ka krijuar ty.²²⁴

(2) Raportohet se i Dërguari i Allahut^{sas} kur shikonte hënën e re bënte edhe këtë lutje:

اللَّهُمَّ بَارِكْ لَنَا فِي رَجَبٍ وَشَعْبَانَ وَبَلِّغْنَا رَمَضَانَ -

O Allah! Na beko gjatë rexhepit dhe shabanit dhe na ço deri në ramazan.²²⁵

Lutje për të çelur agjërimin

Hazret Muadh Ibni Zuhra^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} gjatë çeljes së agjërimit bënte këtë lutje:

224. Tirmidhiu, Ed-da'vat, bab ma jekulu enda ru'jetil-hilal.

225. Kenzul-umal, vëll. 7, f. 79.

اللَّهُمَّ لَكَ صُمْتُ وَعَلَى رِزْقِكَ أَفْطَرْتُ-

O Allah! Për Ty agjërova dhe me riskun Tënd po e çel agjërimin.²²⁶

Hazret Amr Ibnil-Asi^{ra} e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut^{sas} duke thënë se koha gjatë çeljes së agjërimit është e veçantë për pranimin e lutjes. Më pas, sipas tij, ai bëri këtë lutje:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ بِرَحْمَتِكَ الَّتِي وَسِعَتْ كُلَّ شَيْءٍ أَنْ تَغْفِرَ لِي
ذُنُوبِي-

O Allah! Në saje të mëshirës Sate që shtrihet mbi çdo gjë, Të kërkoj të m'i falësh gjynahet!²²⁷

Lutje për Natën e Kadrit

Hazret Ajshja^{ra} e pyeti të Dërguarin e Allahut^{sas}: “Nëse gjej Natën e Kadrit, ç’lutje duhet të bëj?” Ai i tregoi këtë lutje:

اللَّهُمَّ إِنَّكَ عَفُوٌّ كَرِيمٌ تُحِبُّ الْعَفْوَ فَاعْفُ عَنِّي-

O Allah! Ti Je Falës, shumë Bujar. Të pëlqen falja. Më fal mua!²²⁸

Lutje telbija gjatë ihramit

Hazret Abdullah Ibni Omeri^{ra} rrëfen: “E kam parë të Dërguarin e Allahut^{sas} kur lidhi Ihramin, bëri këtë lutje:

226. Ebu Daud, Kitabus-saum, bab keuli endal-iftar.

227. Mustadrik Hakim, Kitabus-saum.

228. Tirmidhiu, Kitabut-da'vat, bab 85.

لَبَّيْكَ اللَّهُمَّ لَبَّيْكَ لَبَّيْكَ لَا شَرِيكَ لَكَ لَبَّيْكَ إِنَّ الْحَمْدَ وَالنِّعْمَةَ لَكَ
وَالْمُلْكَ لَا شَرِيكَ لَكَ-

Erdha te Ti o Allah, erdha. Erdha te Ti. Ti je i Pashoq. Erdha te Ti. Lavdia, bekimi dhe sundimi janë të Tutë. Ti je i Pashoq.²²⁹

Lutje kur sheh Qaben, Shtëpinë e Allahut

Hazret Hudhejfa Ibni Usaid^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} kur shikonte Shtëpinë e Allahut, bënte këtë lutje:

اللَّهُمَّ زِدْ بَيْتَكَ هَذَا تَشْرِيفًا وَتَعْظِيمًا وَتَكْرِيمًا وَبِرًّا وَمَهَابَةً وَزِدْ مَنْ
شَرَّفَهُ وَعَظَّمَهُ بِمَنْ حَجَّهَ وَاعْتَمَرَهُ تَعْظِيمًا وَتَشْرِيفًا وَبِرًّا وَمَهَابَةً-

O Allah! Shtoji Shtëpisë Sate nderin, madhështinë, fisnikërinë, mirësinë dhe ndikimin. Shtoji edhe atij që bën haxhin dhe umranë e saj madhështinë dhe nderin, mirësinë dhe ndikimin.²³⁰

Lutje për të bërë tevfat rreth Qabes

Hazret Abdullah Ibni Saibi^{ra} ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut^{sas} duke bërë lutjen mëposhtme gjatë tevfatit rreth Qabes:

رَبَّنَا إِنَّا فِي الدُّنْيَا حَسَنَةٌ وَفِي الآخِرَةِ حَسَنَةٌ وَقَدْ آتَيْنَاكَ الْغَنَاءَ-

O Zoti ynë! Na jep të mirën në këtë botë, të mirën në ahiret dhe na shpëto nga ndëshkimi i zjarrit!²³¹

229. Buhariu, Kitabul-haxh, bab et-talbijah

230. Maxhmaul-ausat, lit-Tibrani, vëll. 6, f. 183.

231. Ebu Daud, Kitabul-manasik, bab ed-dua fit-tavaf.

Raportohet se i Dërguari i Allahut^{sas} po këtë lutje e bënte edhe në vendin Muzdelfa.

Lutje gjatë ecjes midis kodrave Safa dhe Marva

Hazret Abdullah Ibni Ebi Aufa^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} gjatë ecjes midis kodrave Safa dhe Marva, thoshte 21 herë *Allahu Ekber* (Allahu është më i Madhi).²³²

Hazret Xhabiri^{ra} rrëfen: Gjatë haxhit të tij, i Dërguari i Allahut^{sas} u ngjit në kodrën Safa. Kur atij iu duk Qabja, tha tri herë këto fjalë:

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ-

Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut të Vetëm. Ai është i Pashoq. I Atij është sundimi, e Atij është lavdia dhe Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë.²³³

Në rrëfime të tjera raportohet se i Dërguari i Allahut^{sas} këto fjalë i tha edhe në fushën e Arafatit.

Lutje në kodrën Safa

Gjatë haxhit, duke qëndruar në kodrën Safa, Hazret Omeri^{ra} bëri këtë lutje:

اللَّهُمَّ إِنَّكَ قُلْتَ (أَدْعُونِي أَسْتَجِبْ لَكُمْ) وَإِنَّكَ لَا تُخَلِّفُ الْبَيْعَةَ، وَإِنِّي أَسْأَلُكَ كَمَا هَدَيْتَنِي لِلْإِسْلَامِ أَنْ لَا تَنْزِعَهُ مِنِّي، حَتَّى تَتَوَقَّأَنِي وَأَنَا مُسْلِمٌ-

232. Musanif Ibni Ebi Shejba, vëll. 10, f. 367.

233. Muslimi, Kitabul-haxh, bab haxhatin-Nebij^{sas}

O Allah! Ti ke thënë “Më thërrisni dhe unë do t’ju përgjigjem”, dhe Ti e nuk shkel premtimin. Ashtu siç më ke udhëzuar tek Islami, Të kërkoj që të mos ma marrësh këtë dhe unë të jem musliman derisa të vdes.²³⁴

Një lutje shumë e përlurur dhe përgjëruese në fushën e Arafatit

Hazret Abdullah Ibni Abasi^{ra} tregon se gjatë haxhit të fundit, në mbrëmjen e Arafatit, i Dërguari i Allahut^{sas} bëri këtë lutje:

اللَّهُمَّ إِنَّكَ تَسْمَعُ كَلَامِي وَتَرَى مَكَانِي وَتَعْلَمُ سِرِّي وَعَلَانِيَتِي لَا يَخْفَى عَلَيْكَ شَيْءٌ مِنْ أَمْرِي وَأَنَا الْبَائِسُ الْفَقِيرُ الْمُسْتَغِيثُ الْمُسْتَجِيرُ الْوَجِلُ الْمُسْتَفِيقُ الْمُقَرُّ الْمُعْتَرِفُ بِذَنْبِهِ أَسْأَلُكَ مَسْئَلَةَ الْمِسْكِينِ، وَأَبْتَهَلُ إِلَيْكَ ابْتِهَالَ الْمُذْنِبِ الدَّلِيلِ وَأَدْعُوكَ دُعَاءَ الْخَائِفِ الضَّرِيرِ مَنْ خَضَعَتْ لَكَ رَقَبَتُهُ وَفَاضَتْ لَكَ عَرَّتُهُ وَذَلَّ لَكَ جِسْمُهُ وَرَغِمَ لَكَ أَنْفُهُ، اللَّهُمَّ لَا تَجْعَلْنِي بِدُعَائِكَ شَقِيًّا وَكُنْ بِي رَوْفًا رَحِيمًا خَيْرَ الْمَسْئُولِينَ وَيَا خَيْرَ الْمُعْطِينَ -

O Allah! Ti më dëgjon dhe e sheh gjendjen time. Ti e di të fshehtën dhe të dukshmen time. Asgjë nga gjërat e mia nuk është e fshehur nga Ti. Ndërsa unë jam i varfër, lypës, kërkues i strehimit dhe i ndihmës Tënde, i ndrojtur, i frikësuar dhe pranues i fajit tim. Po të lyp siç lyp një nevojtar. Po qaj para Teje si një mëkatar i poshtër dhe po të lutem siç lutet një i verbër, i frikësuar. Koka ime është e ulur para Teje, për Ty po më lotojnë sytë, trupi im është gjunjëzuar para Teje dhe për Ty kam vënë hundën në tokë. O Allah! Mos më bëj të pafat kur të lutem Ty dhe trego dashuri e

234. Muata, Kitabul-haxh, bab el-balau bis-safafil-meshi.

mëshirë ndaj meje, o Ti që je më i miri për t'u lutur dhe më Bujari se kushdo tjetër!²³⁵

Lutje e ditës së kurbanit

Hazret Xhabir Ibni Abdullahu^{ra} ditën e kurbanit (më 10 dhulhaxha) ka parë të Dërguarin e Allahut^{sas} duke qëndruar në vendin e quajtur Kernuth-Thaleb dhe duke bërë lutjen që vijon:

يَا حَيُّ يَا قَيُّوْمُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ بِرَحْمَتِكَ أَسْتَغِيْثُ فَآكْفِنِيْ شَأْنِيْ كُلَّهُ وَلَا تَكْلِبْنِيْ إِلَى نَفْسِيْ طَرْفَةَ عَيْنٍ -

O i Gjallë! O i Qëndrueshëm! Nuk ka të adhurar tjetër përveç Teje. Me mëshirën Tënde Të lyp. Bëhu i Mjaftueshëm për gjithë gjendjen time dhe mos më dorëzo mua te vetja ime as edhe për një çast të vetëm.²³⁶

Lutje gjatë hedhjes së gurëve, gjatë haxhit

Hazret Abdullah Ibni Omeri^{ra} për çdo gur që hidhte gjatë haxhit, thoshte Allahu Ekber dhe bënte këtë lutje:

اللَّهُمَّ اجْعَلْهُ حَجًّا مَبْرُورًا وَذَنْبًا مَغْفُورًا -

O Allah! Bëje këtë haxh, të pranuar dhe largues të gjynaheve!²³⁷

235. Maxhmauz-zavaid, Hejthmi, vëll. 3, f. 560; El-Muxhamul-Kebir, lit-Tibrani, vëll. 11, f.174.

236. Kitabud-dua, lit-Tibrani, vëll. 2, f. 1209.

237. Kitabud-dua, lit-Tibrani, vëll. 2, f. 1209.

Tekbiret e bajrameve

Hazret Abdullah Ibni Omeri^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} në dhjetë ditët e muajit dhulhaxha na këshillonte të përsërisnim shpesh *tekbirin*, që është “*Allahu Ekber*” (Allahu është më i Madhi), *tahmidin*, që është *Elhamdulil-lah* (Lavdia është e Allahut), si dhe *Lailaha il-lallah* (Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut).²³⁸

Hazret Abdullah Ibni Mesudi^{ra} i thoshte *tekbiret* në formën si vijon:

اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ وَلِلَّهِ الْحَمْدُ-

Allahu Ekber, Allahu Ekber. Lailaha il-lallah, Uellahu Ekber, Allahu Ekber ue lil-lahil hamd.

Allahu është më i Madhi, Allahu është më i Madhi. Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut dhe Allahu është më i Madhi. Allahu është më i Madhi dhe lavdia është e Allahut.²³⁹

Hazret Omeri^{ra}, Hazret Aliu^{ra} dhe Hazret Ibni Abasi^{ra} i thoshin këto *tekbire* nga sabahu i datës 9 dhulhixha deri në ikindinë e datës 13 dhulhixha.²⁴⁰

Sipas Hazret Ibni Omerit^{ra} i Dërguari i Allahut^{sas} këto *tekbire* i thoshte edhe ditën e Fiter Bajramit nga momenti kur dilte nga shtëpia deri kur mbërrinte në vendin ku do të falej namazi i Bajramit.²⁴¹

238. Musned Ahmed Ibni Hanbel, vëll. 2, f. 75.

239. Musanif Ibni Ebi Shiba, vëll. 1, f. 490.

240. Mustadrik Hakim, vëll. 1, f. 299.

241. Mustadrik Hakim, vëll. 1, f. 298.

Lutjet e Bajramit

(1) Hazret Uathila^{ra} rrëfen: “Takova të Dërguarin e Allahut^{sas} ditën e Bajramit. E urova:

تَقَبَّلَ اللهُ مِنِّي

Allahu na e pranofte neve dhe juve!

Të Dërguarit të Allahut^{sas} i pëlqyen këto fjalë urimi dhe, edhe ai i përsëriti duke thënë: Po, Allahu na e pranofte neve dhe juve! Amin!”²⁴²

(2) Hazret Abdullah Ibni Mesudi^{ra} tregon se gjatë bajrameve i Dërguari i Allahut^{sas} bënte lutjen e mëposhtme:

اللَّهُمَّ إِنَّا نَسْأَلُكَ عَيْشَةً تَقِيَّةً، وَبَيْتَةً سَوِيَّةً، وَمَرَدًّا غَيْرَ مُخْزٍ وَلَا
فَاضِحٍ، اللَّهُمَّ لَا تَهْلِكْنَا فَجْأَةً، وَلَا تَأْخُذْنَا بَعْتَةً، وَلَا تُعْجِلْنَا عَنْ حَقِّ وَلَا
وَصِيَّةٍ، اللَّهُمَّ إِنَّا نَسْأَلُكَ الْعَفَافَ وَالْغِنَى وَالْتَقَى وَالْهُدَى وَحُسْنَ
عَاقِبَةِ الْآخِرَةِ وَالْدُّنْيَا، وَنُعُوذُ بِكَ مِنَ الشَّكِّ وَالشَّقَاقِ وَالرِّيَاءِ وَالسُّمْعَةِ
فِي دِينِكَ، يَا مُقَلِّبَ الْقُلُوبِ لَا تَزِغْ قُلُوبَنَا بَعْدَ إِذْ هَدَيْتَنَا وَهَبْ لَنَا مِنْ
لَدُنْكَ رَحْمَةً، إِنَّكَ أَنْتَ الْوَهَّابُ-

O Allah! Të kërkojmë jetë me takva, vdekje të pastër, vendkthim jo poshtërues dhe jo turpërues. O Allah! Mos na shkatërro me ndonjë aksident, mos na kap papritmas, mos na merr nxitimthi, përpara se ta përmbushim detyrën dhe testamentin tonë. O Allah! Të kërkojmë dëlirësinë, vetëmjaftueshmërinë, takvanë, udhëzimin, përfundimin e mirë në përtejbotën dhe në këtë botë dhe Të kërkojmë mbrojtje nga dyshimi, përçarja,

242. Maxhmauz-zavaid, vëll. 2, f. 206.

dukja dhe vetëpëlqimi në besimin ndaj Teje. O Kontrollues i zemrave! Mos na shtrembëro zemrat, pasi na ke udhëzuar dhe dhurona mëshirë prej Teje! Me të vërtetë Ti je Dhuruesi i madh!²⁴³

Hytbja e së premtes dhe e Bajramit

Hazret Xhabir Ibni Sumra^{ra} tregon se, në ditën e xhumasë dhe të Bajramit i Dërguari i Allahut^{sas} mbante dy hytbe, midis të cilave ai qëndronte i ulur (i heshtur). Në hytbe ai recitonte ajete të Kuranit Famëlartë dhe i këshillonte të pranishmit.²⁴⁴

Hazret Xhabir Ibni Abdullah^{ra} rrëfen: Në hytben e tij të së premtes i Dërguari i Allahut^{sas}, së pari lavdëronte dhe falënderonte Allahun e Madhërishëm e më pas me zë të lartë mbante hytbe.²⁴⁵ Kështu bënte edhe ditën e Bajramit.

Sipas rrëfimit të Hazret Abdullah Ibni Mesudit^{ra} dhe të Abdullah Ibni Abasit^{ra}, fjalët e hytbes së praktikuar nga i Dërguari i Allahut^{sas} janë si më poshtë:

الْحَمْدُ لِلَّهِ نَحْمَدُهُ وَنَسْتَعِينُهُ وَنَسْتَغْفِرُهُ وَنَعُوذُ بِاللَّهِ مِنْ شُرُورِ أَنْفُسِنَا وَمِنْ
سَيِّئَاتِ أَعْمَالِنَا مَنْ يَهْدِهِ اللَّهُ فَلَا مُضِلَّ لَهُ وَمَنْ يَضِلَّ فَلَا هَادِيَ لَهُ
وَأَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ وَأَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ
وَرَسُولُهُ -

Lavdia është e Allahut. Atë e lavdërojmë, Atij i kërkojmë ndihmë dhe Atij i kërkojmë falje. Kërkojmë mbrojtjen e

243. Maxhmauz-zavaid, vëll. 6, f. 201

244. Musned Ahmed, vëll. 5, f. 92.

245. Muslimi, Kitabul-xhuma, bab takhfif mines-salat uel-khutba.

Allahut nga sherret e vetvetes sonë dhe nga të këqijat e veprave tona. Atë që udhëzon Allahu, s'ka kush ta devijojë dhe atë që e devijon Allahu, s'ka kush ta udhëzojë. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut, të Vetëm e të Pashoq dhe dëshmoj se Muhammedi është robi dhe i dërguari i Tij.²⁴⁶

Hytbja e xhumasë mbahet para namazit, ndërsa hytbja gjatë Bajrameve mbahet pas namazit.²⁴⁷

Në hytben e praktikuar nga i Dërguari i Allahut^{sas}, përveç fjalëve të përmendura më sipër, në disa rrëfime raportohen edhe fjalët që vijojnë:

إِنَّ أَصْدَقَ الْحَدِيثِ كِتَابُ اللَّهِ وَإِنَّ أَفْضَلَ الْهَدْيِ هَدْيُ مُحَمَّدٍ وَشُرُّ
الْأُمُورِ مُحَدَّثَاتُهَا وَكُلُّ مُحَدَّثَةٍ بَدْعَةٌ وَكُلُّ ضَلَالَةٍ فِي النَّارِ-

Pa dyshim, fjala më e vërtetë është libri i Allahut dhe udhërrëfimi më i mirë është udhërrëfimi i Muhammedit. Ndërsa gjëja më e keqe janë risitë dhe çdo risi është bidat dhe çdo devijim çon në zjarr.²⁴⁸

Hytbja e *nikahut* (martesës)

(a) Për nikah, hytbja nuk është e domosdoshme, ashtu siç edhe i Dërguari i Allahut^{sas} kishte bërë kurorëzimin e hallës së vet, Amama Bint Abdulmutalib, me një njeri të fisit Beni Sulejm, pa mbajtur ndonjë hytbe.²⁴⁹

246. Muslimi, Kitabul-xhuma, bab tekhfifis-salat; Tirmidhiu, Kitabun-nikah, bab khutbatin-nikah.

247. Muslimi, Kitabul-idein, bab 1.

248. Nisai, Kitab salatil-idein, bab kejfal-khutba.

249. Ebu Daud, Kitabun-nikah, bab khutbatun-nikah.

(b) Në hadithe nuk përmendet ndonjë hytbe e posaçme për kurorëzimin, por përmendet një “hytbe për nevojë”, e cila praktikohet edhe gjatë kurorëzimit.

(c) Hazret Abdullah Ibni Mesudi^{ra} tregon se të Dërguarit të Allahut^{sas} i ishin dhuruar “*xheuamiul-hejr*”, domethënë, “fjalët që përmbledhin të gjitha mirësitë në mënyrë të përsosur dhe elokumente”. Ai na kishte mësuar një hytbe të posaçme për nevoja të veçanta. Kjo hytbe përbëhet nga lavdërimi dhe falënderimi i Allahut, dëshmia dhe disa ajete të Kuranit Famëlartë. Sipas Sufjan Suriut, në këtë hytbe recitohen ajetet që janë si më poshtë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ حَقَّ تَقَاتِهِ وَلَا تَمُوتُنَّ إِلَّا وَأَنتُمْ مُسْلِمُونَ ﴿١﴾

(1) O ju që besuat! Kini druajtjen e Allahut ashtu siç duhet t'i druheni Atij dhe vdisni vetëm kur të jeni të nënshtruar.²⁵⁰

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَخَلَقَ
بَيْنَهُمْ زُرُوجًا وَبَنَى بَيْنَهُمْ رَجُلًا كَثِيرًا وَبَنَى اللَّهُ الَّذِي تَسْتَأْذِنُونَ
بِهِ وَالْأَرْحَامَ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلَيْكُمْ رَقِيبًا

(2) O njerëz! Kini druajtje ndaj Zotit tuaj që ju krijoi prej një fryme të vetme dhe prej saj krijoi çiftin dhe përmes atyre të dyve, përhapri shumë burra e gra. Kini druajtje ndaj Allahut, (në emër të) të cilit ju i kërkoni njëri-tjetrit dhe ruani lidhjet farefisnore! Allahu pa dyshim është Mbikëqyrësi juaj.²⁵¹

250. Kurani Famëlartë 3:103.

251. Kurani Famëlartë 4:2.

(iii) يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ قُولُوا قَوْلًا سَدِيدًا لَا يُضْلِحْ لَكُمْ
أَعْمَالَكُمْ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ وَمَنْ يُطِيعِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ فَقَدْ فَازَ فَوْزًا عَظِيمًا

(3) O ju që besuat! Kini druajtjen e Allahut dhe thoni fjalë të drejta! Ai do t'ju përmirësojë veprat dhe do t'ju falë gjynahet. Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, ka arritur një sukses madhor.^{252,253}

(4) Sipas një rrëfimi tjetër autentik, një herë për të nxitur besimtarët për sakrificat financiare, i Dërguari i Allahut^{sas} në hytben e tij ka recituar ajetin 19-të të sures *El-Hashr*, duke përfshirë ajetet e sipërpërmendura.²⁵⁴ Ajeti në fjalë është si më poshtë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَلْتَنْظُرْ نَفْسٌ مَّا قَدَّمَتْ لِغَيْرِ اللَّهِ إِنْ اللَّهَ
خَيْرٌ بِمَا تَعْمَلُونَ

O ju që besuat! Kini druajtjen e Allahut! Çdo shpirt duhet të ketë parasysh atë që ka dërguar përpara për të nesërmen. Kini druajtjen e Allahut! Allahu pa dyshim është i Dijshëm për çdo gjë që bëni.²⁵⁵

Hytbja e dytë

Kalifi Umavi Hazret Omer Ibni Abdul Azizi (që ndërroi jetë në vitin 101 hixhri) ka shtuar këto fjalë në hytben e dytë, të cilat vazhdojnë të praktikohen deri më sot:

252. Kurani Famëlartë 33:71-72.

253. Tirmidhiu, Kitabun-nikah, bab khutbatun-nikah.

254. Muslimi, Kitabuz-zekat, bab El-heth ales-sadaka.

255. Kurani Famëlartë 59:19.

عِبَادَ اللَّهِ رَجِمْتُكُمْ اللَّهُ إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُ بِالْعَدْلِ وَالْإِحْسَانِ وَإِيتَاءِ ذِي
الْقُرْبَىٰ وَيَنْهَىٰ عَنِ الْفَحْشَاءِ وَالْمُنْكَرِ وَالنَّفْيِ يَعْظُمُ لِعَلُّكُمْ
تَذَكُّرُونَ
أَذْكُرُوا اللَّهَ يَذْكُرْكُمْ وَادْعُوهُ يُسْتَجِبْ لَكُمْ وَلَذِكْرُ اللَّهِ أَكْبَرُ -

O robërit e Allahut! Allahu ju mëshiroftë! “Në të vërtetë, Allahu urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe dhënien si ajo që u jepet të afërmve, dhe ndalon imoralitetin, veprat e shëmtuara dhe dhunën. Ai ju këshillon, në mënyrë që ju të kuptoni”.²⁵⁶

Kujtojeni Allahun, Ai do t’ju kujtojë ju! Thërriteni Atë, Ai do t’ju përgjigjet dhe kujtimi i Allahut pa dyshim është gjëja më madhore.²⁵⁷

Lutje për haxhinjtë e Shtëpisë së Allahut

Hazret Ebu Hurejrah^{ra} përmend lutjen e mëposhtme të të Dërguarit të Allahut^{sas} që ai kishte bërë për haxhinjtë:

اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِلْحَاجِّ، وَلِمَنْ اسْتَغْفَرَ لَهُ الْحَاجُّ -

O Allah! Fali haxhinjtë dhe ata, për të cilët haxhinjtë Të kërkuan falje.²⁵⁸

Lutje gjatë kthimit nga Qabja, Shtëpia e Allahut

Hazret Abdullah Ibni Abasi^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas}, (për të qenë i vetëmjaftueshëm dhe për të pasur bereqet në risk), bënte

256. Kurani Famëlartë 16:91.

257. Tarikhul-khulafa, lis-Sujuti, botuar në Lahor, f. 244.

258. Mustadrik Hakim, vëll. 1, f. 441.

lutjen që është në vijim. Sipas Hazret Seid Ibni Xhebir^{ra}, është mirë ta bëni këtë lutje në çastin kur i thoni lamtumirë Shtëpisë së Allahut:

اَللّٰهُمَّ قِنِّعْنِيْ بِمَا رَزَقْتَنِيْ وَبَارِكْ لِيْ فِيْهِ وَاخْلُفْ عَلَيَّ كُلِّ غَائِبَةٍ لِّيْ
بِخَيْرٍ-

O Allah! Më bëj të ndihem i vetëmjaftueshëm me riskun që më dhurove, më shto bereqet në të dhe atë që nuk e kam dhe bëhu zëvendës i saj.²⁵⁹

Lutje të ndryshme për të ngrënë bukë

(1) Hazret Ibni Abasi^{ra} tregon se njëherë, i Dërguari i Allahut^{sas}, Hazret Ebu Bekri^{ra} dhe Hazret Omeri^{ra} shkuan në shtëpinë e Hazret Ebu Ejub Ensarit^{ra}. Kur u shtrua buka, i Dërguari i Allahut^{sas} i porositi të hanin duke thënë:

بِسْمِ اللّٰهِ وَبَرَكَاتِهِ

Me emrin e Allahut dhe me bereqetin e Allahut!²⁶⁰

(2) Hazret Ajshja^{ra} thotë se i Dërguari i Allahut^{sas} ka thënë: “Kur dikush prej jush ushqehet, le të përmendë emrin e Allahut. Nëse ai ka harruar ta përmendë në fillim, le të thotë:

بِسْمِ اللّٰهِ اَوَّلَهُ وَاٰخِرَهُ-

Me emrin e Allahut, edhe para ushqimit, edhe pas tij.²⁶¹

259. Mustadrik Hakim, Kitabut-tefsir, vëll. 2, f. 356.

260. Mustadrik Hakim, vëll. 4, f. 120.

261. Ebu Daud, Kitabul-at'ima, bab tesmija alat-ta'am.

(3) Hazret Abu Seid Hudriju^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} kur hante bukë dhe pinte ujë, bënte lutjen që vijon:

الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي أَطْعَمَنَا وَسَقَانَا وَجَعَلَنَا مُسْلِمِينَ۔

Lavdia është e Allahut që na ushqeu, na dha për të pirë dhe na bëri muslimanë.²⁶²

(4) Hazret Ebu Ejub Ensari^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} kur hante bukë ose kur pinte ujë, bënte lutjen që është në vijim:

الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي أَطْعَمَ وَسَقَى وَسَوَّغَهُ وَجَعَلَ لَهُ مَخْرَجًا

Lavdia është e Allahut që ushqen, jep për të pirë, e bën ushqimin të kapërdishëm dhe rregullon edhe daljen e tij.²⁶³

(5) Hazret Ebu Amama Bahli^{ra} tregon se pas buke, kur i hiqte sofrën të Dërguarit të Allahut^{sas}, ai bënte lutjen e mëposhtme:

الْحَمْدُ لِلَّهِ كَثِيرًا طَيِّبًا مُبَارَكًا فِيهِ، الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي كَفَانَا وَآوَانَا، لَكَ الْحَمْدُ رَبَّنَا غَيْرَ مَكْفِيٍّ وَلَا مُودِعٍ وَلَا مَكْفُورٍ وَلَا مُسْتَعْنَى عَنْهُ رَبَّنَا۔

Lavdia është e Allahut (që na dha ushqim), lavdi e shumtë, e sinqertë dhe e bekuar. Lavdia është e Allahut që na u bë i Mjaftueshëm dhe na strehoi. Lavdia është e Jotja, o Zoti ynë. Ky ushqim asnjëherë mos u bëftë i pamjaftueshëm për ne! Mos lënçim të kërkuarit dhe të lypurit prej Teje! Mos u bëfshim mosmirënjohës ndaj riskut Tënd e as mos u bëfshim të pavarur prej Teje!²⁶⁴

262. Tirmidhiu, Kitabud-da'vat, bab ma jekulu idha faragat-ta'am.

263. Ebu Daud, Kitabul-at'ima, bab ma jekulur-raxhulu idha at'ama.

264. Buhariu, Kitabul-at'ima, bab ma jekulu idha faraga min ta'amih; Tirmidhiu, Kitabul-at'ima, bab ma jekulu idha faraga min ta'amih.

(6) Hazret Muadh Ibni Enesi^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} ka thënë: Ai që bën këtë lutje pas buke, Allahu i Madhërishëm ia fal gjynahet:

أَلْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي أَطْعَمَنِي هَذَا الطَّعَامَ وَرَزَقَنِيهِ مِنْ غَيْرِ حَوْلٍ مِنِّي وَلَا قُوَّةَ -

Lavdia është e Allahut që më dha këtë ushqim dhe më dha risk, edhe pse nuk kisha asnjë fuqi dhe forcë për ta arritur atë.²⁶⁵

Lutje për të ngrënë bukë kur je i ftuar diku

Hazret Abdullah Ibni Abasi^{ra} rrëfen: Mua dhe Halid Ibni Uelidin i Dërguari i Allahut^{sas} na mori në shtëpinë e tij dhe na dha qumësht për të pirë dhe na tha: Kur Allahu i Madhërishëm ju jep risk, bëni këtë lutje:

اللَّهُمَّ بَارِكْ لَنَا فِيهِ وَأَطْعِمْنَا خَيْرًا مِنْهُ -

O Allah! Na beko këtë ushqim dhe na ushqe me ushqime edhe më të mira sesa këto.²⁶⁶

Lutje kur pi qumësht

Hazret Abdullah Ibni Abasi^{ra} rrëfen: I Dërguari i Allahut^{sas} na dha qumësht për të pirë dhe na tha: Ai, të cilit Zoti i Madhërishëm i jep qumësht për të pirë, le të bëjë këtë lutje:

اللَّهُمَّ بَارِكْ لَنَا فِيهِ وَزِدْنَا مِنْهُ -

O Allah! Na e beko këtë ushqim dhe na shto prej tij.²⁶⁷

265. Ebu Daud, Kitabul-libas, bab ma jekulu idha labisa theuban xhedidan.

266. Tirmidhiu, Kitabud-da'vat, bab ma jekulu idha akalat-ta'am.

267. Tirmidhiu, Kitabud-da'vat, bab ma jekulu idha akalat-ta'am.

Lutje kur vesh rroba të reja

(1) Hazret Abu Seid Hudriju^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} kur vishte rroba të reja, duke përmendur llojin e rrobës (këmishë, çarçaf, çallmë etj.) bënte lutjen që vijon:

اللَّهُمَّ لَكَ الْحَمْدُ أَنْتَ كَسَوْتَنِيهِ أَسْأَلُكَ مِنْ خَيْرِهِ وَخَيْرِ مَا صُنِعَ لَهُ وَ
أَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّهِ وَشَرِّ مَا صُنِعَ لَهُ-

O Allah! Lavdia është e Jotja. Ti më ke veshur me këtë veshje. Të kërkoj të mirën e saj dhe të mirën për të cilën është bërë kjo. Më mbro nga e keqja e saj dhe nga e keqja që mund të dalë prej saj.²⁶⁸

(2) Hazret Omeri^{ra} kur vishej me rroba të reja, bënte lutjen e mëposhtme duke iu referuar të Dërguarit të Allahut^{sas} që thoshte:

Duke veshur rroba të reja, ai që fal rrobat e tij të vjetra dhe bën këtë lutje, në rroftë a në mos rroftë, në të dyja rastet hyn në mbrojtjen e Allahut, i cili e mbulon dhe ia fal mëkatet:

الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي كَسَانِي مَا أُوَارِي بِهِ عَوْرَتِي، وَأَتَجَمَّلُ بِهِ فِي حَيَاتِي
وَرَزَقَنِيهِ مِنْ غَيْرِ حَوْلٍ مِنِّي وَلَا قُوَّةٍ -

Lavdia është e Allahut që më veshi me veshje, me të cilën mbuloj të fshehtën dhe zbukuroj jetën dhe që më dha veshje edhe pse nuk kisha asnjë fuqi dhe forcë për ta arritur atë.²⁶⁹

268. Ebu Daud, Kitabul-libas, bab ma jekulu idha labisa theuban xhedidan.

269. Tirmidhiu, Kitabud-da'vat, bab 108; Ebu Daud, Kitabul-libas, bab ma jekulu idha labisa theuban xhedidan.

Lutje kur shihesh në pasqyrë

Hazret Ajshja^{ra} tregon lutjen e mëposhtme të të Dërguarit të Allahut^{sas}:

اللَّهُمَّ كَمَا أَحْسَنْتَ خَلْقِي فَأَحْسِنْ خُلُقِي -

O Allah! Ashtu siç më ke zbukuruar fizikisht, zukuromë edhe moralisht!²⁷⁰

Lutje kur del nga shtëpia

Hazret Enes Ibni Malilki^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} ka thënë: Ai që bën lutjen vijuese gjatë kohës kur del nga shtëpia, shejtani i largohet dhe lutësit i thuhet:

*“Ty të është mjaftuar kjo lutje. Je i udhëzuar dhe i shpëtuar”.*²⁷¹

Ajo lutje është:

بِسْمِ اللَّهِ تَوَكَّلْتُ عَلَى اللَّهِ لَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ

Me emrin e Allahut! U mbështeta tek Allahu. Sundim dhe fuqi s’ka askush tjetër përveç Allahut.

Sipas Hazret Ume Selmasë^{ra}, kjo lutje ka disa fjalë shtesë dhe duke i përfshirë edhe ato, lutja del si më poshtë:

بِسْمِ اللَّهِ تَوَكَّلْتُ عَلَى اللَّهِ لَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ اللَّهُمَّ إِنَّا نَعُوذُ بِكَ مِنْ أَنْ نَزَلَ أَوْ نُضَلَّ، أَوْ نُظْلِمَ أَوْ نُظْلَمَ، أَوْ نَجْهَلَ أَوْ يُجْهَلَ عَلَيْنَا -

Me emrin e Allahut! U mbështeta tek Allahu. Sundim dhe fuqi s’ka askush tjetër, përveç Allahut. O Allah! Të kërkojmë

270. Musnad Ahmedi, vëll. 6, f. 150.

271. Tefsir Tha’labi, vëll. 2, f. 382.

mbrojtje që të mos rrëshqasim, të mos humbasim, të mos bëjmë padrejtësi, të mos na bëhet padrejtësi, të mos injorojmë dhe të mos injorohemi.²⁷²

Lutje për të hyrë në shtëpi

Hazret Ebu Malik Ash'ariji^{ra} thotë se kur të hyni në shtëpi, bëni lutjen e mëposhtme dhe jepuni selam banorëve të shtëpisë:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ خَيْرَ الْمَوْلِجِ، وَخَيْرَ الْمَخْرَجِ بِسْمِ اللَّهِ وَلَجْنَا وَبِسْمِ اللَّهِ خَرَجْنَا، وَعَلَى اللَّهِ رَبَّنَا تَوَكَّلْنَا.

O Allah! Të kërkoj hyrjen e mbarë dhe daljen e mbarë. Me emrin e Allahut kemi hyrë dhe me emrin e Allahut kemi dalë. Jemi mbështetur tek Allahu, Zoti ynë.²⁷³

Lutje për të dalë në pazar

Hazret Burejda^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} kur dilte në treg bënte lutjen vijuese:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ خَيْرَ هَذِهِ السُّوقِ وَخَيْرَ مَا فِيهَا وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّهَا وَشَرِّ مَا فِيهَا اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ أَنْ أُصِيبَ فِيهَا يَمِينًا فَاجْرَةً أَوْ صَفْقَةً خَاسِرَةً.

O Allah! Të kërkoj mbarësinë e këtij tregu dhe të mirën që gjendet në të. Të kërkoj mbrojtje nga e keqja e tij dhe e keqja që gjendet në të. O Allah! Të kërkoj mbrojtje nga mundësia për të bërë be të rreme ose për të bërë pazar të humbur.²⁷⁴

272. Tirmidhiu, Kitabud-da'vat, bab ma jekulu idha kharaxha min bejtih; Ebu Daud, Kitabul-adab, bab ma jekulu idha kharaxha min bejtih.

273. Ebu Daud, Kitabul-adab, bab ma jekulu, idha dakhala min bejtih.

274. Kitabud-dua, lit-Tibrani, vëll. 2, f. 1168.

Lutje të ndryshme për udhëtim

(1) Hazret Abdullah Ibni Omeri^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas}, gjatë kthimit nga ndonjë betejë, haxh apo umra, kur ngjitej në vend të lartë, thoshte tri herë *Allahu Ekber* (Allahu është më i Madhi) dhe kur zbriste prej tij, thoshte fjalët që vijojnë:

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ، وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ آتِبُونَ، تَائِبُونَ، عَابِدُونَ، لِرَبِّنَا حَامِدُونَ-

Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut, të Vetëm dhe të Pashoq. I Atij është sundimi, e Atij është lavdia dhe Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë. Po kthehemi të penduar, duke e adhuruar dhe duke e falënderuar Zotin tonë.²⁷⁵

(2) Hazret Abdullah Ibni Omeri^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} kur udhëtonte, bënte këtë lutje (kjo lutje po jepet këtu duke mbledhur rëfimin e Abdullah Ibni Omerit dhe atë të Ebu Hurejras^{ra}):

اللَّهُمَّ إِنَّا نَسْأَلُكَ فِي سَفَرِنَا هَذَا الْبِرَّ وَالتَّقْوَى، وَمِنَ الْعَمَلِ مَا تَرْضَى
اللَّهُمَّ اصْحَبْنَا بِصِحْحِكَ، وَأَقْلِبْنَا بِذِمَّتِكَ، اللَّهُمَّ ارْزُقْنَا الْأَرْضَ، اللَّهُمَّ
هَوِّنْ عَلَيْنَا فِي سَفَرِنَا هَذَا، وَأَطْوِ عَنَّا بُعْدَ الْأَرْضِ، اللَّهُمَّ أَنْتَ
الصَّاحِبُ فِي السَّفَرِ، وَالْخَلِيفَةُ فِي الْأَهْلِ، اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ
وَعَثَاءِ السَّفَرِ، وَكَآبَةِ الْمَنْظَرِ وَسُوءِ الْمُنْقَلَبِ فِي الْأَهْلِ وَالْمَالِ-

O Allah! Në udhëtimin tonë Të kërkojmë mirësinë, takvanë dhe veprën që Të pëlqen. O Allah, na shoqëro me dashamirësinë Tënde dhe na kthe në përgjegjësinë Tënde. O Allah! Zvogëlo tokën për ne! O Allah! Na lehtëso udhëtimin tonë dhe zvogëlo largësinë e tokës për ne. O Allah! Ti je Shoqëruesi në udhëtim

275. Buhariu, Kitabud-da'vat, bab ed-dua idha asfara eu raxha'a.

dhe Zëvendësi në shtëpi. O Allah! Më mbro nga vështirësia e udhëtimit, nga pamja shqetësuese dhe nga kthimi i keq në familje e në pasuri.²⁷⁶

Lutje për të hipur në mjet transporti

Hazret Abdullah Ibni Omeri^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} kur i hipte devesë, thoshte tri herë *Allahu Ekber* dhe bënte këtë lutje (të Kuranit):

سُبْحَانَ الَّذِي سَخَّرْنَا هَذَا وَمَا كُنَّا لَهُ مُقْرِبِينَ وَإِنَّا إِلَىٰ رَبِّنَا لَمُنْقَلِبُونَ-

I Shenjtë është Ai që na e nënshtroi këtë (mjet), sepse ne vetë nuk e kontrollonim dot. Ne pa dyshim te Zoti ynë kemi për t'u kthyer. (Kurani Famëlartë 43:14-15)²⁷⁷

Lutje për t'u mbrojtur nga e keqja në udhëtim

Hazret Heula Bint Hekim^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} ka thënë: Nëse ndaloni gjatë udhëtimit, bëni këtë lutje:

أَعُوذُ بِكَلِمَاتِ اللَّهِ التَّامَّاتِ مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ-

Kërkoj mbrojtjen e fjalëve të përsosura të Allahut nga e keqja e çdo gjëje që ka krijuar Ai.²⁷⁸

Lutje gjatë natës së tmerrshme, gjatë udhëtimit

Hazret Abdullah Ibni Omeri^{ra} tregon se të Dërguarin e Allahut^{sas} kur e zinte nata gjatë udhëtimit, ai lutej:

276. Tirmidhiu, Kitabud-da'vat, bab ma jekulu idha kharaxha musafirin; Ebu Daud, Kitabul-xihad, bab ma jekulur-raxhulu idha asfara.

277. Muslimi Kitabul-haxh, bab ma jekulu idha rakiba ila safaril-haxh.

278. Muslimi, Kitabudh-dhikr, bab et-tavudh mines-sui.

يَا أَرْضِ رَبِّي وَرَبِّكَ اللَّهُ، أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنْ شَرِّكَ، وَشَرِّ مَا فِيكَ وَشَرِّ مَا
خَلَقَ فِيكَ، وَمِنْ شَرِّ مَا يَدُبُّ عَلَيْكَ أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنْ أَسَدٍ وَأَسْوَدٍ، وَمِنْ
الْحَيَّةِ وَالْعَقْرَبِ، وَمِنْ سَاكِنِ الْبَلَدِ، وَمِنْ وَالِدٍ وَمَا وُلِدَ-

O Tokë! Zoti im dhe Zoti yt është Allahu! Kërkoj mbrojtjen e Allahut nga e keqja jote, nga e keqja që gjendet brenda teje, nga e keqja e çdo gjëje që Ai ka krijuar te ti, nga e keqja e çdo gjallesë që ecën mbi ty. Kërkoj mbrojtjen e Allahut nga luani, pitoni, gjarpri, akrepi, nga banori i këtij vendi dhe nga çdo njeri i madh apo i vogël.²⁷⁹

Lutje gjatë ngjitjes në lartësi

Hazret Enesi^{ra} ka rrëfyer këtë lutje të të Dërguarit të Allahut^{sas}, që ai e bënte kur ngjitej në rrafshnaltë:

اللَّهُمَّ لَكَ الشَّرْفُ عَلَى كُلِّ شَرَفٍ وَلَكَ الْحَمْدُ عَلَى كُلِّ حَالٍ-

O Allah! Lartësimi është i Yti mbi çdo lartësim dhe lavdia është e Jotja në çdo rrethanë.²⁸⁰

Lutje kur shkon në luftë

Hazret Enes Ibni Maliku^{ra} rrëfen se i Dërguari i Allahut^{sas} kur shkante për të marrë pjesë në ndonjë betejë, bënte këtë lutje:

اللَّهُمَّ أَنْتَ عَضُدِي وَنَصِيرِي بِكَ أَحُولُ وَبِكَ أَصُولُ وَبِكَ أَقَاتِلُ-

O Allah! Ti je mbështetja ime dhe ndihmësi im. Përmes Teje bëj strategji, përmes Teje sulmoj dhe përmes Teje luftoj.²⁸¹

279. Ebu Daud, Kitabul-xhihad, bab ma jekulur-raxhulu idha anzala munzilun.

280. Musned Ahmed, vëll. 3, f. 239.

281. Ebu Daud, Kitabul-xhihad, bab ma jud'a endal-lika.

Lutje e lamtumirës

(1) I Dërguari i Allahut^{sas}, duke i dhënë lamtumirën Abdullah Ibni Omerit^{ra}, bëri këtë lutje:

أَسْتَوِدُّعُ اللَّهَ دِينَكَ وَ أَمَانَتَكَ وَ خَوَاتِيمَ عَمَلِكَ -

Allahut ia dorëzoj besimin tënd, amanetin tënd dhe fundin e veprave të tua.²⁸²

(2) Hazret Enesi^{ra} ka rrëfyer këtë lutje lamtumire të të Dërguarit të Allahut^{sas}:

رَوَدَكَ اللَّهُ التَّقْوَى وَ غَفَرَ اللَّهُ ذَنْبَكَ وَ يَسِّرَكَ الْخَيْرَ حَيْثُمَا كُنْتَ -

Allahu ta përgatitë trastën me takua, të faltë gjynahet dhe të mundësoftë të mirën kudo që të jesh!²⁸³

Lutje për të hyrë në fshat a qytet të ri

Hazret Suhejbi^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} kur hynte në ndonjë qytet të ri, nuk harronte kurrë të bënte lutjen që vijon:

اللَّهُمَّ رَبَّ السَّمَوَاتِ السَّعِ وَ مَا أظَلَّنَ وَ رَبَّ الْأَرْضِينَ وَ مَا أَقْلَنَ وَ رَبَّ الشَّيَاطِينِ وَ مَا أَضَلَّلَنَ وَ رَبَّ الرِّيَّاحِ وَ مَا دَزَيْنَ فَ إِنَّا نَسْأَلُكَ خَيْرَ هَذِهِ الْقَرْيَةِ وَ خَيْرَ أَهْلِهَا وَ خَيْرَ مَا فِيهَا وَ نَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّهَا وَ مِنْ شَرِّ أَهْلِهَا وَ شَرِّ مَا فِيهَا -

اللَّهُمَّ بَارِكْ لَنَا فِيهَا - اللَّهُمَّ بَارِكْ لَنَا فِيهَا - اللَّهُمَّ بَارِكْ لَنَا فِيهَا - اللَّهُمَّ ارزُقْنَا جَنَاهَا وَ حَبِّبْنَا إِلَى أَهْلِهَا وَ حَبِّبْ صَالِحِي أَهْلِهَا إِلَيْنَا -

282. Ebu Daud, Kitabul-xihad, bab ed-dua endal-vida.

283. Tirmidhiu, Kitabud-da'vat, bab ma jekulu idha euda'a insanan.

O Allah! O Zoti i shtatë qiejve dhe i gjithçkaje që qëndron nën hijen e tyre! O Zoti i tokave dhe i gjithçkaje që mbajnë ato! O Zoti i djajve dhe i gjithçkaje që e devijojnë ata! O Zoti i erërave dhe i gjithçkaje që sjellin ato! Të kërkojmë të mirën e këtij qyteti, të mirën e banorëve të tij dhe të mirën që gjendet në të. Të kërkojmë mbrojtje nga e keqja e tij, nga e keqja e banorëve të tij dhe nga e keqja që gjendet në të.

O Allah! Na beko në këtë qytet! O Allah! Na beko në këtë qytet!
O Allah! Na beko në këtë qytet! O Allah! Na ushqe me frutat e tij, na bëj të dashur te banorët e tij dhe na jep dashuri ndaj banorëve të tij të sinqertë.²⁸⁴

Lutje të ndryshme të mëngjesit e të mbrëmjes

(1) Hazret Abdullah Ibni Mesudi^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} në mëngjes bënte këtë lutje:

أَصْبَحْنَا وَأَصْبَحَ الْمُلْكُ لِلَّهِ، وَالْحَمْدُ لِلَّهِ، وَلَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ، وَلَهُ الْحَمْدُ، وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ، رَبِّ أَسْأَلُكَ خَيْرَ مَا فِي هَذَا الْيَوْمِ وَخَيْرَ مَا بَعْدَهُ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ مَا فِي هَذَا الْيَوْمِ وَشَرِّ مَا بَعْدَهُ، رَبِّ أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْكَسَلِ وَسُوءِ الْكِبَرِ، رَبِّ أَعُوذُ بِكَ مِنْ عَذَابٍ فِي النَّارِ وَعَذَابٍ فِي الْقَبْرِ-

U gdhimë dhe u gdhi edhe i gjithë kombi për Allahun. Lavdia është e Allahut. Nuk ka të adhurar tjetër përveç Allahut! Ai është i Vetëm dhe i Pashoq. I Atij është sundimi. E Atij është lavdia dhe Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë. O Zoti im! Të kërkoj të mirën që ka kjo ditë dhe të mirën që vjen pas saj.

284. Mustadrik Hakim, vëll. 1, f. 614; Maxhmaul-ausat, Tibrani; vëll. 5, f. 379.

Të kërkoj mbrojtje nga e keqja që ka kjo ditë dhe nga e keqja që vjen pas saj. O Zoti tim! Më mbro nga përtacia dhe nga mendjemadhësia! O Zoti im! Më mbro nga ndëshkimi i zjarrit dhe nga ndëshkimi i varrit.²⁸⁵

(2) I Dërguari i Allahut^{sas} të njëjtën lutje bënte edhe në mbrëmje, por duke zëvendësuar fjalën “ditë” me fjalën “natë”:

أَمْسَيْنَا وَأَمْسَى الْمَلِكُ لِلَّهِ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ وَلَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ، رَبِّ أَسْأَلُكَ خَيْرَ مَا فِي هَذِهِ اللَّيْلَةِ وَخَيْرَ مَا بَعْدَهَا، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ مَا فِي هَذِهِ اللَّيْلَةِ وَشَرِّ مَا بَعْدَهَا، رَبِّ أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْكَسَلِ وَمِنْ سُوءِ الْكِبَرِ، رَبِّ أَعُوذُ بِكَ مِنْ عَذَابِ فِي النَّارِ وَعَذَابِ فِي الْقَبْرِ-

U ngrysem dhe u ngrys i gjithë kombi për Allahun. Lavdia është e Allahut. Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut! Ai është i Vetëm dhe i Pashoq. I Atij është sundimi. E Atij është lavdia dhe Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë. O Zoti im! Të kërkoj të mirën që ka kjo natë dhe të mirën që vjen pas saj. Më mbro nga e keqja që ka kjo natë dhe nga e keqja që vjen pas saj. O Zoti tim! Më mbro nga përtacia dhe nga mendjemadhësia. O Zoti im! Më mbro nga ndëshkimi i zjarrit dhe nga ndëshkimi i varrit.²⁸⁶

(3) Hazret Ebu Hurejrah^{ra} thotë se i Dërguari i Allahut^{sas} u mësonte sahabëve që ta bënin këtë lutje në mëngjes:

285. Muslimi, Kitabudh-dhikr, bab et-tavudh min sherri ma amala.

286. Muslimi, Kitabudh-dhikr, bab et-tavudh min sherri ma amala.

اللَّهُمَّ بِكَ أَصْبَحْنَا وَبِكَ نَحْيَا، وَبِكَ نَمُوتُ، وَالْبَيْتُ الْمَقْدِسِيُّ -

O Allah! Për Ty u gdhimë, për Ty jetojmë, për Ty vdesim dhe te Ti kthehemi.²⁸⁷

(4) Shërbëtori i të Dërguarit të Allahut^{sas} Hazret Enes Ibni Maliku^{ra} rrëfen:

I Dërguari i Allahut^{sas} ka thënë se ai që bën këtë lutje në mëngjes, Zoti ia fal mëkatet që bën gjatë asaj dite dhe nëse e bën këtë lutje gjatë natës, Zoti ia fal mëkatet që bën gjatë asaj nate dhe e liron nga zjarri:

اللَّهُمَّ أَصْبَحْنَا نَشْهَدُكَ وَنُشْهَدُ حَمَلَةَ عَرْشِكَ وَمَلَائِكَتَكَ وَجَمِيعَ خَلْقِكَ بِأَنَّكَ أَنْتَ اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ وَحَدِّكَ لَا شَرِيكَ لَكَ وَأَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُكَ وَرَسُولُكَ -

O Allah! U gdhimë. Të kemi dëshmitar, i kemi dëshmitarë edhe ata që e mbajnë arshin Tënd, i kemi dëshmitarë engjëjt e Tu dhe të gjitha krijesat e Tua, që me të vërtetë Ti je Allahu e nuk ka të adhurar tjetër përveç Teje, je i Vetëm dhe i Pashoq dhe me të vërtetë Muhammedi është robi dhe i Dërguari Yt.²⁸⁸

Shënim: E njëjta lutje bëhet edhe në mbrëmje, por duke zëvendësuar fjalët “O Allah! U gdhimë”, me fjalët “O Allah! Kaluam ditën”.

(5) Hazret Abani^{ra} transmeton nga i ati, Hazret Othman Ganij^{ra}, se i Dërguari i Allahut^{sas} ka thënë se ai që bën këtë lutje çdo ditë nga tri herë, në mëngjes ose në mbrëmje, Allahu i Madhërishëm e shpëton

287. Ibni Maxha, Kitabud-dua, bab ma jed'u bihir-raxhul idha asbaha.

288. Tirmidhiu, Kitabud-da'vat, bab 79.

atë gjatë asaj dite ose gjatë asaj nate nga cilado fatkeqësi që e pret. Më vonë Hazret Abanin^{ra} e zuri paraliza dhe një ditë në këtë gjendje kur ai ua tregonte këtë lutje njerëzve, njëri prej të pranishmëve e vështroi i habitur gjendjen e tij të paralizuar. Abani e vuri re dhe tha: “Pasha Zotin! Duke jua treguar këtë lutje, nuk kam shpifur as për Hazret Osmanin^{ra} dhe as Hazret Osmanin^{ra}, nuk kishte shpifur për të Dërguarin e Allahut^{sas}. Por, një ditë, kur isha i zemëruar, harrova ta bëja këtë lutje. Rastësisht, të njëjtën ditë më zuri paraliza dhe kështu, për shkak të mosbërjes së kësaj lutjeje, Zoti ma çoi këtë caktim”.

بِسْمِ اللَّهِ الَّذِي لَا يَضُرُّ مَعَ اسْمِهِ شَيْءٌ فِي الْأَرْضِ وَلَا فِي السَّمَاءِ وَهُوَ
السَّمِيعُ الْعَلِيمُ -

Me emrin e Allahut, me emrin e të cilit asgjë nuk mund të sjellë dëm as në Tokë e as në qiell dhe Ai është Dëgjuesi, i Gjithëdijshmi.²⁸⁹

(6) Hazret Ebu Hurejrah^{ra} dhe Ebu Rashid El-Hirani^{ra} tregojnë se njëherë Hazret Ebu Bekri^{ra} iu lut të Dërguarit të Allahut^{sas} duke i thënë: “O i Dërguari i Allahut! Më mëso ca fjalë që t’i them në mëngjes e në mbrëmje”. I Dërguari i Allahut^{sas} i mësoi këtë lutje duke thënë që ta bënte në mëngjes e në mbrëmje ose gjatë natës para se të flinte:

اللَّهُمَّ فَاطِرَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ، عَالِمَ الْغَيْبِ وَالشَّهَادَةِ، رَبَّ كُلِّ شَيْءٍ
وَمَلِيكَ، أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ، أَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ نَفْسِي، وَشَرِّ
الشَّيْطَانِ وَشَرِّكَهٖ، وَأَنْ أَقْتَرِفَ عَلَى نَفْسِي سُوءًا، أَوْ أُجْرَهُ إِلَى مُسْلِمٍ -

O Allah! Krijuesi i qiejve dhe i Tokës. Njohësi i së padukshmes dhe i së dukshmes. Zoti dhe Sunduesi i çdo gjëje. Dëshmoj se

289. Ebu Daud, Kitabul-adab, bab ma jekulu idha asbaha.

nuk ka të adhuruar tjetër përveç Teje. Mbromë nga e keqja e vetvetes, nga e keqja e djallit dhe nga mundësia që t'i bëj dëm vetes apo t'i sjell dëm ndonjë muslimani tjetër.²⁹⁰

(7) Hazret Abdullah Ibni Omeri^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} çdo ditë në mëngjes e në mbrëmje bënte disa lutje. Njëra prej tyre është edhe kjo:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْعَافِيَةَ فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْعَفْوَ
وَالْعَافِيَةَ فِي دِينِي وَدُنْيَايَ، وَأَهْلِي وَمَالِي، اللَّهُمَّ اسْتُرْ عَوْرَاتِي، وَأَبْنَ
رَوْعَاتِي، اللَّهُمَّ احْفَظْنِي مِنْ بَيْنِ يَدَيَّ وَمِنْ خَلْفِي وَعَنْ يَمِينِي وَعَنْ
شِمَالِي وَمِنْ فَوْقِي، وَأَعُوذُ بِعَظَمَتِكَ أَنْ أُغْتَالَ مِنْ تَحْتِي -

O Allah! Të kërkoj shëndet në këtë botë dhe në përtejbotën. O Allah! Të kërkoj falje dhe shëndet në besimin tim e në botën time, në familjen time e në pasurinë time. O Allah! M'i mbulo dobësitë dhe më dhuro paqe prej shqetësimeve të mia. O Allah! Mbromë nga para e nga mbrapa, djathtas, majtas e nga sipër dhe kërkoj mbrojtjen e madhështisë Sate nga prekja e ndonjë ndëshkimi nga poshtë.²⁹¹

(8) Hazret Ebu Selam Habshi^{ra} rrëfen: I kërkoja Hazret Enesit^{ra}, shërbëtorit të të Dërguarit të Allahut^{sas}, që të më tregonte ndonjë hadith që kishte dëgjuar prej të Dërguarit të Allahut^{sas}. Ai më tha: E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut^{sas} duke thënë: “Ai që bën këtë lutje në mëngjes e në mbrëmje, Zoti merr përsipër që ta kënaqë atë ditën e kiametit.”

290. Tirmidhiu, Kitabud-da'vat, bab 95.

291. Ebu Daud, Kitabul-adab, bab ma jekulu idha asbaha.

رَضِينَا بِاللَّهِ رَبًّا، وَبِالْإِسْلَامِ دِينًا، وَبِمُحَمَّدٍ رَسُولًا -

Jemi të kënaqur duke pasur Allahun si Zot, Islamin si besim dhe Muhammedin si të Dërguar.²⁹²

(9) Hazret Abdullah Ibni Ganami^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} ka thënë se ai që lutet me këto fjalë në mëngjes e në mbrëmje, e kreu falënderimin e asaj dite ose të asaj nate:

اللَّهُمَّ مَا أَصْبَحَ بِي مِنْ نِعْمَةٍ فَمِنْكَ وَحَدِّكَ، لَا شَرِيكَ لَكَ، فَلَكَ
الْحَمْدُ وَلَكَ الشُّكْرُ -

O Allah! Çdo mirësi që më vjen mua, pa dyshim vjen vetëm prej Teje. Ti je i Pashoq. Për Ty janë lavdia dhe falënderimi.²⁹³

(10) Hazret Ebu Ajashi^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} ka thënë se ai që lutet me këto fjalë në mëngjes apo në mbrëmje, shpërblehet sikur të ketë liruar robër aq bij sa ka Hazret Ismaili^{as}, shkruhen dhjetë mirësi në llogarinë e tij, i falen dhjetë gjynahe, ai gradohet dhjetë nivele më shumë dhe mbrohet nga djalli. Hamadi, që është njëri prej transmetuesve të këtij hadithi, thoshte se një njeri pa në ëndërr të Dërguarin e Allahut^{sas} dhe i tha se këtë hadith na e tregon Ebu Ajashi dhe i Dërguari i Allahut^{sas} iu përgjigj: “Ebu Ajashi thotë të vërtetën”. Ajo lutje është si më poshtë:

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ
شَيْءٍ قَدِيرٌ -

Nuk ka të adhurar tjetër përveç Allahut. Ai është i Vetëm dhe i Pashoq. I Atij është sundimi, e Atij është lavdia dhe Ai është i

292. Ebu Daud, Kitabul-adab, bab ma jekulu idha asbaha.

293. Ebu Daud, Kitabul-adab, bab ma jekulu idha asbaha.

Plotfuqishëm për çdo gjë.²⁹⁴

(11) Nëna e besimtarëve, Hazret Umi Selma^{ra}, rrëfen:

I Dërguari i Allahut^{sas} ma mësoi këtë lutje për ta bërë në mbrëmje:

اللَّهُمَّ عِنْدَ اسْتِيقْبَالِ لَيْلِكَ، وَادْبَارِ نَهَارِكَ، وَأَصْوَاتِ دُعَاتِكَ وَحُضُورِ
صَلَوَاتِكَ أَسْأَلُكَ أَنْ تَغْفِرَ لِيْ -

O Allah! Në ardhjen e natës Sate, në largimin e ditës Sate, në kohën kur më vijnë thirrjet e Tua, në momentet e namazeve për Ty, të kërkoj të më falësh mua.²⁹⁵

(12) Hazret Ebu Bekri bënte dy lutjet që vijojnë nga tri herë çdo ditë, në mëngjes e në mbrëmje, dhe thoshte: “Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut^{sas} duke i bërë këto lutje, ndaj më pëlqen t’i bëj edhe unë duke vijuar praktikën e tij”.

(i) اللَّهُمَّ عَابِدِي فِي بَدْنِي اللَّهُمَّ عَابِدِي فِي سَمْعِي، اللَّهُمَّ عَابِدِي فِي
بَصَرِي، لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ -

(a) O Allah! Më dhuro shëndet në trupin tim! O Allah! Më dhuro shëndet në dëgjimin tim! O Allah! Më dhuro shëndet në shikimin tim! Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Teje.

(ii) اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْكُفْرِ وَالْفَقْرِ، اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ
عَذَابِ الْقَبْرِ، لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ -

(b) O Allah! Më mbro nga mosbesimi dhe skamja! O Allah!

294. Ebu Daud, Kitabul-adab, bab ma jekulu idha asbaha.

295. Tirmidhiu, Kitabud-da'vat, bab duai umi salma.

Më mbro nga dënimi i varrit! Nuk ka të adhurar tjetër përveç Teje.²⁹⁶

Kryelutje për të kërkuar falje

Hazret Burejdah^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} ka thënë se ai që bën këtë lutje në mëngjes ose në mbrëmje e nëse vdes atë ditë ose atë natë, hyjn në xhenet.

اللَّهُمَّ أَنْتَ رَبِّي لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ ، خَلَقْتَنِي ، وَأَنَا عَبْدُكَ وَأَنَا عَلَى عَهْدِكَ
وَوَعْدِكَ مَا اسْتَطَعْتُ أَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ مَا صَنَعْتُ ، أَبُوءُ لَكَ
بِنِعْمَتِكَ عَلَيَّ ، وَأَبُوءُ لَكَ بِذُنُوبِي ، فَاعْفِرْ لِي فَإِنَّهُ لَا يَغْفِرُ الذُّنُوبَ إِلَّا
أَنْتَ -

O Allah! Ti je Zoti im. Nuk ka të adhurar tjetër përveç Teje. Ti më krijove. Ndërsa unë jam robi Yt. Po mbaj premtimin dhe fjalën time me sa kam mundësi. Më mbro nga e keqja që kam bërë. E pranoj para Teje bekimin Tënd që kam dhe e pranoj para Teje edhe gjynahun tim. Prandaj, më fal mua, sepse askush nuk i fal gjynahet përveç Teje.²⁹⁷

Lutje për t'u mbrojtur nga e keqja e kohës dhe e fqinjit

Hazret Akba Ibni Amiri^{ra} ka përcjellë këtë lutje të të Dërguarit të Allahut^{sas}, që ai bënte për t'u mbrojtur nga e keqja e ditës, e natës dhe e fqinjit:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ يَوْمِ السُّوءِ وَمِنْ لَيْلَةِ السُّوءِ وَمِنْ سَاعَةِ
السُّوءِ، وَمِنْ صَاحِبِ السُّوءِ، وَمِنْ جَارِ السُّوءِ، فِي دَارِ الْمُقَامَةِ -

296. Ebu Daud, Kitabul-adab, bab ma jekulu idha asbaha.

297. Buhariu, Kitabud-da'vat, bab ma jekulu idha asbaha.

O Allah! Më mbro nga dita e keqe, nga nata e keqe, nga ora e keqe, nga shoqëruesi i keq dhe nga fqinji i keq kudo që banoj.²⁹⁸

Lutje për të kërkuar shi

Gjatë thatësirës, një ditë të premte, kur dikush i kishte kërkuar të Dërguarit të Allahut^{sas} të lutej për shi, ai bëri lutjen që është në vijim. Menjëherë pas lutjes së tij filloi të binte shi, që vijoi pa pushim deri të premtën tjetër, derisa i Dërguari i Allahut^{sas} bëri lutje që shiu të pushonte.

اللَّهُمَّ اسْقِنَا، اللَّهُمَّ اسْقِنَا، اللَّهُمَّ اسْقِنَا (١)

اللَّهُمَّ اغْثِنَا، اللَّهُمَّ اغْثِنَا، اللَّهُمَّ اغْثِنَا - (٢)

(1) O Allah! Na jep ujë! O Allah! Na jep ujë! O Allah! Na jep ujë!

(2) O Allah! Na dërgo re! O Allah! Na dërgo re! O Allah! Na dërgo re!²⁹⁹

Namazi për të kërkuar shi

Hazret Abad Ibni Temimi^{ra} transmeton nga xhaxhai i tij, i cili thotë: Gjatë një thatësire, për namazin për të kërkuar shi, i Dërguari i Allahut^{sas} doli në fushë dhe udhëhoqi dy rekate namaz, në të cilin recitoi me zë të lartë suren *El-Fatiha* dhe pastaj një pjesë të Kuranit Famëlartë. Pas namazit, ktheu çarçafin e tij, duke qëndruar në drejtim të Qabes, ngriti duart dhe u lut për shi. Për këtë ndodhi na janë përcjellë lutjet e tij të mëposhtme:

298. Maxhmaul-kebir, Tibrani, vëll. 17, f. 294.

299. Buhariu, Kitabul-istiska, bab el-istiska fi khutbatil-xhuma.

اللَّهُمَّ اسْقِنَا غَيْثًا مُغِيثًا مَرِيًّا مُرِيْعًا نَافِعًا غَيْرَ ضَارٍّ عَاجِلًا غَيْرَ آجِلٍ
اللَّهُمَّ اسْقِ عِبَادَكَ وَبَهَائِمَكَ وَأَنْشُرْ رَحْمَتَكَ وَأَحْيِ بَلَدَكَ الْمَيِّتِ
اللَّهُمَّ اسْقِنَا اللَّهُمَّ اسْقِنَا اللَّهُمَّ اسْقِنَا

O Allah! Na jep ujë duke dërguar re shi-lëshuese, që sjellin mbarësi, që na largojnë frikën; dobiprurëse, jo dëmsjellëse, të shpejtuara e jo të vonuara! O Allah, jepu ujë robërve të Tu, kafshëve të Tua, përhape mëshirën Tënde dhe gjallëroje qytetin Tënd të vdekur. O Allah, jepna ujë! O Allah, jepna ujë! O Allah, jepna ujë!³⁰⁰

Lutje për të shpëtuar nga zemërimi i Zotit gjatë vetëtimës

Hazret Abdullah Ibni Omeri^{ra} tregon se kur bubullinte dhe vetëtinte, i Dërguari i Allahut^{sas} bënte këtë lutje:

اللَّهُمَّ لَا تَقْتُلْنَا بِغَضَبِكَ وَلَا تُهْلِكْنَا بِعَذَابِكَ، وَوَ عَافِنَا قَبْلَ ذَلِكَ-

O Allah! Mos na vrit me zemërimin Tënd! Mos na shkatërro me ndëshkimin Tënd dhe na shpëto përpara se të ndodhë diçka e tillë.³⁰¹

Lutje për t'u mbrojtur nga shtrëngata

Hazret Ajshja^{ra} tregon se kur shpërthente shtrëngata, i Dërguari i Allahut^{sas} bënte këtë lutje:

300. Ebu Daud, Kitabul-istiska, bab raf'a jadejn.

301. Tirmidhiu, Kitabud-da'vat, bab ma jekulu idha asma'ar-ra'd.

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ خَيْرَهَا وَخَيْرَ مَا فِيهَا، وَخَيْرَ مَا أُرْسِلْتُ بِهِ وَأَعُوذُ
بِكَ مِنْ شَرِّهَا وَشَرِّ مَا فِيهَا، وَشَرِّ مَا أُرْسِلْتُ بِهِ

O Allah! Të kërkoj të mirën e saj, të mirën që gjendet në të, të mirën që sjell ajo dhe më mbro nga e keqja e saj, nga e keqja që gjendet në të dhe nga e keqja që sjell ajo.³⁰²

Lutje për t'u mbrojtur nga përmbytjet

Hazret Enes Ibni Maliku^{ra} tregon: “Me lutjen e të Dërguarit të Allahut^{sas} kur ra shi vazhdimisht për një javë, ditën e premte, dikush i kërkoi të Dërguarit të Allahut^{sas} të lutej që shiu të ndalej. I Dërguari i Allahut^{sas} bëri lutjen që vijon dhe shiu pushoi menjëherë”:

اللَّهُمَّ حَوَالَيْنَا وَلَا عَلَيْنَا، اللَّهُمَّ عَلَى الْآكَامِ وَالطَّرَابِ وَالْأَوْدِيَةِ وَمَنَابِتِ
الشَّجَرِ-

O Allah! Rreth e përqark nesh e jo mbi ne! O Allah! Mbi kodrat, malet, luginat dhe pyjet!³⁰³

Lutje të ndryshme para gjumit

(1) Hazret Hudhejfa Ibni El-Jamani^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} kur shtrihej për të fjetur, bënte këtë lutje:

اللَّهُمَّ بِاسْمِكَ أَمُوتُ وَأَحْيَا-

O Allah! Me emrin Tënd vdes dhe ringjallem.³⁰⁴

302. Muslimi, Kitabul-istiska, bab tavudh enda ru'jetir-rih.

303. Buhariu, Kitabul-istiska, bab ma istiska fil-masxhidil-xhami.

304. Buhariu, Kitabud-da'vat, bab ma jekulu idha anama.

(2) Hazret Bara' Ibni Azibi tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} i mësoi një njeriu këtë lutje për ta bërë në kohën e gjumit dhe i tha: Nëse vdes gjatë natës kur e ke bërë këtë lutje, do të vdesësh me natyrshmëri të pastër dhe nëse do ta bësh këtë lutje në mëngjes, do të gjesh mirësi e bekime:

اللَّهُمَّ أَسَلَمْتُ نَفْسِي إِلَيْكَ، وَوَجَّهْتُ وَجْهِي إِلَيْكَ وَفَوَّضْتُ أَمْرِي
إِلَيْكَ، وَأَلْجَأْتُ ظَهْرِي إِلَيْكَ، رَغْبَةً وَرَهْبَةً إِلَيْكَ، لَا مَلْجَأَ وَلَا مَنَاجَا
مِنْكَ إِلَّا إِلَيْكَ آمَنْتُ بِكِتَابِكَ الَّذِي أَنْزَلْتَ وَبِنَبِيِّكَ الَّذِي أَرْسَلْتَ

O Allah! Ty ta dorëzova veten time. Nga Ti e drejtova fytyrën time. Te Ti e solla çështjen time. Te Ti u mbështeta duke shpresuar e duke u druajtur ndaj Teje. Nuk ka strehë dhe nuk ka shpëtim nga Ti përveç Teje. Besova në librin që ke zbritur dhe në profetin që ke dërguar.³⁰⁵

(3) Hazret Ebu Hurejrah^{ra} rrëfen se i Dërguari i Allahut^{sas} tha: Kur të shkoni në shtrat, pastrojeni një herë atë dhe bëni këtë lutje para se të flini:

بِأَسْمِكَ رَبِّي وَضَعْتُ جَنْبِي، وَبِكَ أَرْفَعُهُ، إِنْ أَمْسَكْتَ نَفْسِي
فَارْحَمْهَا، وَإِنْ أَرْسَلْتَهَا فَاخْفِظْهَا بِمَا تَحْفَظُ بِهِ عِبَادَكَ الصَّالِحِينَ -

Me emrin Tënd, o Zoti im, shtrihem dhe po me emrin Tënd do të çohem. Nëse do të ma mbash shpirtin, mëshiroje, e nëse do të ma kthesh, mbroje atë ashtu siç i mbron robërit e Tu të sinqertë.³⁰⁶

305. Buhariu, Kitabud-da'vat, bab ued'il-jedil-jumna, tahta khadil-jumna.

306. Buhariu, Kitabud-da'vat, bab tavudh uel-kirat endan-neum.

(4) Hazret Abdullah Ibni Omeri^{ra} i tha një njeriu të bënte këtë lutje kur të shkonte në shtrat dhe i tregoi se këtë lutje ai e kishte mësuar prej të Dërguarit të Allahut^{sas}:

اللَّهُمَّ أَنْتَ خَلَقْتَ نَفْسِي، وَأَنْتَ تَوَفَّأَهَا، لَكَ مَمَاتُهَا وَمَحْيَاهَا، إِنْ أَحْيَيْتَهَا فَأَحْفَظْهَا، وَإِنْ أَمَتَّهَا فَاغْفِرْ لَهَا اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْعَافِيَةَ-

O Allah! Ti ma krijove shpirtin dhe Ti do të ma marrësh. Për Ty është edhe vdekja e tij, edhe jeta e tij. Nëse do ta ringjallësh, mbroje e nëse do t'i japësh vdekje, fale atë. O Allah! Të kërkoj shëndet.³⁰⁷

(5) Hazret Abdullah Ibni Omeri^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} kur shkonte në shtrat, bënte këtë lutje:

الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي كَفَانِي وَآوَانِي وَأَطْعَمَنِي وَسَقَانِي وَالْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي مَنَّ عَلَيَّ فَأَفْضَلَ، وَالَّذِي أَعْطَانِي فَأَجَزَلَ، الْحَمْدُ لِلَّهِ عَلَى كُلِّ حَالٍ اللَّهُمَّ رَبِّ كُلِّ شَيْءٍ وَمَلِيكُهُ وَإِلَهُ كُلِّ شَيْءٍ أَعُوذُ بِكَ مِنَ النَّارِ-

Lavdia është e Allahut që më mjaftoi, më strehoi, më ushqeu dhe më dha ujë për të pirë. Lavdia është e Allahut që më dha mirësi, mirësi me bollëk, më fali (gjëra të ndryshme) e më fali pafund. Lavdia është e Allahut në çdo rrethanë. O Allah! O Zoti, Sunduesi dhe i Adhuruari i çdo gjëje! Më mbro nga zjarri!³⁰⁸

(6) Nëna e besimtarëve, Hazret Hafsa^{ra}, thotë se i Dërguari i Allahut^{sas} kur flinte, faqen e mbështeste në dorën e djathtë dhe bënte tri herë këtë lutje:

307. Muslimi, Kitabudh-dhikr, bab ma jekulu endan-neum.

308. Ebu Daud, Kitabul-adab, bab ma jekulu endan-neum.

اللَّهُمَّ قِنِي عَذَابَكَ يَوْمَ تَبْعُثُ عِبَادَكَ-

O Allah! Shpëtomë nga ndëshkimi Yt ditën kur do të ringjallësh robërit e Tu.³⁰⁹

(7) Hazret Aliu^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas}, para se të flinte, bënte këtë lutje:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِوَجْهِكَ الْكَرِيمِ وَكَلِمَاتِكَ التَّامَّاتِ مِنْ شَرِّ مَا أَنْتَ
أَخِذٌ بِنَاصِيَّتِهِ، اللَّهُمَّ أَنْتَ تَكْتَسِبُ الْمَغْرَمَ وَالْمَأْتَمَ اللَّهُمَّ لَا يُهْزَمُ
جُنْدُكَ، وَلَا يُخْلَفُ وَعَدُّكَ، وَلَا يَنْفَعُ ذَا الْجَدِّ مِنْكَ الْجَدُّ سُبْحَانَكَ
وَبِحَمْدِكَ-

O Allah! Kërkoj mbrojtjen e fytyrës Sate të nderuar e të fjalëve të Tua të përsosura nga dëmi i çdo krijese, koka e së cilës është në dorën Tënde. O Allah! Vetëm Ti e largon skamjen dhe mëkatin. O Allah! Ushtria Jote nuk mposhtet, premtimi Yt nuk mbetet i papërbushur. Shenjtëria e askujt nuk bën dobi përballë shenjtërisë Sate. I Shenjtë je Ti me gjithë lavdinë Tënde.³¹⁰

(8) Hazret Ebul Ez'her^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas}, para se të flinte, bënte këtë lutje:

بِسْمِ اللَّهِ، وَضَعْتُ جَنِبِي، اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي ذَنْبِي، وَاخْسِئْ شَيْطَانِي، وَ
فُكِّ رِهَانِي، وَاجْعَلْنِي فِي النَّدِيِّ الْأَعْلَى-

Me emrin e Allahut u shtriva. O Allah! Më fal mëkatin dhe më mund djallin, më mundëso të përmbush detyrën dhe më bëj të

309. Ebu Daud, Kitabul-adab, bab ma jekulu endan-neum.

310. Ebu Daud, Kitabul-adab, bab ma jekulu endan-neum.

jem në parinë e lartë (të engjëjve).³¹¹

Lutje të ndryshme kur zgjohesh nga gjumi

(1) Hazret Hudhejfa^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} kur zgjohej nga gjumi bënte këtë lutje:

الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي أَحْيَانَا بَعْدَ مَا أَمَاتَنَا وَإِلَيْهِ النُّشُورُ.

Lavdia është e Allahut që na ringjalli pasi na dha vdekje dhe ne tek Ai do të kthehemi.³¹²

(2) Hazret Ebu Hurejrah^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} i ka thënë: Kur zgjohesh nga gjumi, bëj këtë lutje:

الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي عَافَانِي فِي جَسَدِي وَرَدَّ عَلَيَّ رُوحِي، وَأَذِنَ لِي بِذِكْرِهِ.

Lavdia është e Allahut që i dha shëndet trupit tim, më ktheu shpirtin tim dhe më mundësoi ta përkujtoj Atë.³¹³

(3) Hazret Obada Ibni Samiti^{ra} tregon se ai që zgjohet nga ndonjë ankth dhe bën këtë lutje, Zoti ia pranon lutjen dhe nëse merr abdes dhe grihet për të falur namaz, ia pranon edhe namazin:

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ، وَالْحَمْدُ لِلَّهِ، سُبْحَانَ اللَّهِ وَلَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاللَّهُ أَكْبَرُ، وَلَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ، اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي -

Nuk ka të adhurar tjetër përveç Allahut. Ai është i Vetëm dhe i Pashoq. I Atij është Sundimi, e Atij është lavdia e Ai është

311. Ebu Daud, Kitabul-adab, bab ma jekulu endan-neum.

312. Buhariu, Kitabud-da'vat, bab ma jekulu idha nama.

313. Tirmidhiu, Kitabud-da'vat, bab ed-dua idha ava ila firashihi.

i Plotfuqishëm për çdo gjë. Lavdia është e Allahut! I Shenjtë është Allahu dhe nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut. Allahu është më i Madhi. Sundim dhe fuqi s’ka askush tjetër, përveç Allahut. O Allah! Më fal mua!³¹⁴

Lutje për të larguar pagjumësinë

Hazret Burejdah^{ra} tregon se Hazret Halid Ibni Uelidi^{ra} i ishte ankuar të Dërguarit të Allahut^{sas} për pagjumësinë dhe Profeti^{sas} i kishte mësuar këtë lutje, që ai ta bënte gjatë natës:

اللَّهُمَّ رَبَّ السَّمَوَاتِ السَّبْعِ وَمَا أَظْلَمَتْ، وَرَبَّ الْأَرْضَيْنِ وَمَا أَقْلَمَتْ، وَرَبَّ الشَّيَاطِينِ وَمَا أَضَلَّتْ، كُنْ لِي جَارًا مِنْ شَرِّ خَلْقِكَ
كُلِّهِمْ جَمِيعًا، أَنْ يَفْرُطَ عَلَيَّ أَحَدٌ، أَوْ أَنْ يُبَغِيَ عَلَيَّ، عَزَّ جَارُكَ وَجَلَّ
ثَنَاؤُكَ، وَلَا إِلَهَ غَيْرُكَ، لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ.

O Allah! O Zoti i shtatë qiejve dhe i gjithçkaje që qëndron nën hijen e tyre! O Zoti i Tokave dhe i gjithçkaje që mbajnë ato! O Zoti i djajve dhe i gjithçkaje që e devijojnë! Bëhu strehë për mua nga sherri i të gjitha krijesave të Tua, që askush të mos më cenojë mua e që askush të mos rebelohet me mua. Streha Jote është fisnike. Lavdia Jote është madhështore dhe nuk ka të adhuruar tjetër përveç Teje! Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Teje!³¹⁵

Lutje kur trembesh në ëndërr

Hazret Abdullah Ibni Amri tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} ka thënë: Nëse dikush trembet në gjumë, le të bëjë këtë lutje. Asgjë nuk do t’i bëjë dëm atij. Hazret Abdullahu^{ra} ua mësonte fëmijëve të tij këtë

314. Buhariu, Kitabut-tehexhud, bab fadli man ta’ara minel-lejl.

315. Tirmidhiu, Kitabud-da’vat, bab 91.

lutje. Po ashtu edhe Malik Ibni Enesi^{ra} rrëfen se Halid Ibni Uelidi^{ra} trembej në gjumë dhe i Dërguari i Allahut^{sas} ia kishte mësuar këtë lutje:

أَعُوذُ بِكَلِمَاتِ اللَّهِ التَّامَّةِ مِنْ غَضَبِهِ وَشَرِّ عِبَادِهِ ، وَمِنْ هَمَزَاتِ الشَّيْطَانِ
وَأَنْ يَحْضُرُونِ -

Kërkoj mbrojtjen e fjalëve të përsosura të Allahut nga zemërimi i Tij, nga sherri i robërve të Tij dhe nga nxitjet e dajave dhe nga prania e tyre.³¹⁶

Lutje për çiftin e sapomartuar

Hazret Amr Ibni Shuejbi^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} ka thënë: “Kur të martoheni ose të merrni ndonjë shërbëtor në shtëpi, bëni këtë lutje:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ خَيْرَهَا وَخَيْرَ مَا جَبَلْتَهَا عَلَيْهِ وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّهَا وَشَرِّ مَا جَبَلْتَهَا عَلَيْهِ -

O Allah! Të kërkoj të mirën e saj dhe të mirën që ke lënë në natyrën e saj dhe më mbro nga e keqja e saj dhe nga e keqja që e ke lënë në natyrën e saj.³¹⁷

Shënim: Për martesë, nëse lutjen e bën një femër, le ta zëvendësojë gjininë e përemrit nga femërore në mashkullore (në arabisht duke e zëvendësuar përemrin “*ha*” në “*hu*”).

316. Muata Imam Malik, Kitabul-xhami’, bab ma ju’maru minet-tehexhud.

317. Ebu Daud, Kitabun-nikah, bab fi xhami’in-nikah.

Lutje para se të kryhen marrëdhëniet bashkëshortore

Hazret Abdullah Ibni Abasi^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} thoshte se, kur ndokush nga ju i afrohet bashkëshortes dhe bën këtë lutje, Zoti i Madhërishëm i dhuron fëmijë të mbrojtur nga e keqja e shejtanit:

بِسْمِ اللَّهِ اللَّهُمَّ جَنِّبْنَا الشَّيْطَانَ وَجَنِّبِ الشَّيْطَانَ مَا رَزَقْتَنَا

Me emrin e Allahut! O Allah! Mbrona nga shejtani dhe mbroje nga shejtani edhe atë që do të na dhurosh.³¹⁸

Lutje për të kërkuar ndihmë gjatë agonisë së vdekjes

Hazret Ajshja^{ra} rrëfen këtë lutje të të Dërguarit të Allahut^{sas}:

اللَّهُمَّ اَعِنِّي عَلَى غَمَرَاتِ الْمَوْتِ وَ سَكَرَاتِ الْمَوْتِ -

O Allah! Ndhimmomë gjatë agonisë së vdekjes, gjatë grahmave të vdekjes.³¹⁹

Lutje në momentin e vdekjes

Hazret Umi Selma^{ra} rrëfen: “I Dërguari i Allahut^{sas} erdhi kur ndërroi jetë Ebu Selma^{ra}. Ebu Selmait i kishin mbetur sytë të hapur. I Dërguari i Allahut^{sas} ia mbylli dhe iu drejtua atyre që vajtonin dhe tha: Kjo është koha e lutjes për të kërkuar mirësi, sepse edhe engjëjt po thonë “Amin” për lutjet (tona). Më pas ai bëri lutjen që vijon:

318. Buhariu, Kitabud-da'vat, bab ma jekulu idha ata ahluhu.

319. Tirmidhiu, Kitabul-xhenaiz, bab et-teshdid endal-maut.

اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِأَيِّ سَلَمَةٍ وَأَرْفَعْ دَرَجَتَهُ فِي الْمَهْدِيِّينَ وَأَخْلَفُهُ فِي عَقِبِهِ
فِي الْغَابِرِينَ وَاغْفِرْ لَنَا وَلَهُ يَا رَبَّ الْعَالَمِينَ وَأَفْسَحْ لَهُ فِي قَبْرِهِ وَنَوِّرْ لَهُ
فِيهِ -

**O Allah! Fale Ebu Selmanë, ngrije në gradën midis të udhëzuarve dhe mundësoju zëvendës njerëzve që ka lënë pas!
O Zoti i botëve! Na fal edhe ne, edhe atë! Zgjeroja varrin dhe ndritja!³²⁰**

(Kjo lutje kur bëhet për dikë tjetër, le të zëvendësohet emri i Ebu Salmasë me emrin e tij).

Lutje për të pasur shpërblim të mirë gjatë vështirësisë

Hazret Umi Selma^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas}, në kohën kur vdiq Ebu Selma^{ra}, i tha: Gjatë vështirësisë, thuaj “Në të vërtetë, jemi të Allahut dhe tek Ai do të kthehemi” dhe bëj këtë lutje:

اللَّهُمَّ أَجْرُنِي فِي مُصِيبَتِي وَأَخْلَفْ لِي خَيْرًا مِنْهَا -

O Allah! Shpërblemë në vështirësinë time dhe zëvendësoje atë me mirësi!³²¹

Lutja e namazit të xhenazes

Hazret Ebu Hurejrah^{ra} thotë se i Dërguari i Allahut^{sas} në xhenaze bënte këtë lutje:

320. Muslimi, Kitabul-xhenaiz, bab fi igmadil-mejrit.

321. Muslimi, Kitabul-xhenaiz, bab ma jukalu endal-musibat.

اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِحَيِّنَا وَمَيِّتِنَا، وَشَاهِدِنَا وَغَائِبِنَا، وَصَغِيرِنَا وَكَبِيرِنَا،
وَدَّكْرِنَا وَأُنثَانَا، اللَّهُمَّ مَنْ أَحْيَيْتَهُ مِنَّا فَاحْيِهِ عَلَى الْإِسْلَامِ، وَمَنْ تَوَفَّيْتَهُ
مِنَّا فَتَوَفَّهُ عَلَى الْإِيمَانِ - اللَّهُمَّ لَا تَحْرِمْنَا أَجْرَهُ وَلَا تَفْتِنَّا بَعْدَهُ -

O Allah! Fale të gjallin dhe të vdekurin tonë, të pranishmin dhe të papranishmin tonë, të voglin dhe të madhin tonë, mashkullin dhe femrën tonë. O Allah! Këdo që të lësh gjallë nga ne, mbaje gjallë në Islam dhe kujtdo që t'ia marrësh shpirtin nga ne, merrja shpirtin në *iman*. O Allah! Mos na moho nga shpërblimi i këtij të vdekuri dhe mos na sprovo pas tij.³²²

(Nëse xhenazja është femër, do të ndryshojë gjinia e përemrit në dy fjalitë e fundit, gjegjësisht: “*tavafejtaha*”, “*fatavafaha*”, “*axhirha*” dhe “*ba’daha*”).

Lutje e xhenazes së të miturit

Sipas Hazret Imam Hasan Ibni Aliut^{ra}, në xhenazen e të miturit, pas sures *El-Fatiha*, bëhet kjo lutje:

اللَّهُمَّ اجْعَلْهُ لَنَا سَلَفًا وَفَرَطًا وَذُخْرًا وَأَجْرًا وَشَافِعًا وَمُسْتَفْعًا -

O Allah! Bëje këtë fëmijë për ne të parë, prijës, thesar, shpërblim, ndërmjetësues dhe të pranuar si ndërmjetësues.³²³

Në rastin e gjinisë femërore, fjalët arabe janë: “*ixh’elha*” dhe “*safieten mushfieten*”.

322. Tirmidhiu dhe Ebu Daudi, Kitabul-xhenaiz, bab ma jekulu fis-salati alel-mejit; Kitabud-dua, lit-Tibrani, vëll. 3, f. 1351.

323. Buhariu, Kitabul-xhenaiz, bab jukrau Fatihatul-kitab, alal-xhenaza; Eunul-ma’bud, Sharh Ebu Daud, Kitabul-xhenaiz, bab ed-dua lil-mejit.

Lutje kur varros të vdekurin

Hazret Abdullah Ibni Omeri^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} kur varroste ndonjë të vdekur, bënte këtë lutje:

بِسْمِ اللَّهِ وَبِاللَّهِ وَعَلَىٰ مِلَّةِ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ (i)

بِسْمِ اللَّهِ وَبِاللَّهِ وَعَلَىٰ سُنَّةِ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ (ii)

(1) Me emrin e Allahut, me ndihmën e Allahut dhe për popullin e të Dërguarit të Allahut!

(2) Me emrin e Allahut, me ndihmën e Allahut dhe për praktikën e të Dërguarit të Allahut!³²⁴

Lutje kur viziton varrezën

Hazret Ajshja^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} kur vizitonte varrezën, thoshte këto fjalë:

السَّلَامُ عَلَيْكُمْ أَهْلَ الدِّيَارِ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ وَالْمُسْلِمِينَ وَإِنَّا إِنشَاءَ اللَّهُ بِكُمْ لَاحِقُونَ أَنْتُمْ لَنَا فَرَطٌ وَنَحْنُ لَكُمْ تَبِعٌ أَسْأَلُ اللَّهَ الْعَافِيَةَ لَنَا وَلَكُمْ-

Paqja qoftë mbi ju, o banorët e shtëpisë (së ahiretit) prej besimtarëve e prej muslimanëve. Ne, në dashtë Allahu, do t'ju bashkohemi juve. Ju kemi prijës e ne jemi ndjekësit tuaj. I kërkoj Allahut mbarësi për ne dhe për ju.³²⁵

324. Tirmidhiu, Kitabul-xhenaiz, bab ma jekulu idha adkhalal-mejit.

325. Nisai, Kitabul-xhenaiz, bab el-amr bil-istigfari lil-mu'minin.

**Lutje të ndryshme të përsosura
të Profetit Muhammed**

paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të

Lutje për të kërkuar rrugën e drejtë

I Dërguari i Allahut^{sas}, duke i mësuar Hazret Aliut^{ra} lutjen që vijon, tha se me “rrugën e drejtë” duhet të kesh parasysh rrugën që është e drejtë si shtiza:

اللَّهُمَّ اهْدِنِي وَسَدِّدْنِي

O Allah! Më udhëzo dhe më mbaj në rrugën e drejtë!³²⁶

Lutje për qëndrueshmërinë në zemër

Hazret Shehr Ibni Heusheb^{ra} pyeti Hazret Umi Selman^{ra} për lutjen që i Dërguari i Allahut^{sas} e bënte më së shumti dhe ajo i tregoi lutjen që vijon. Hazret Umi Selma një herë kur e kishte pyetur të Dërguarin e Allahut^{sas} se përse e bënte kaq shumë këtë lutje, ai i qe përgjigjur: “Zemra e çdo njeriut gjendet midis dy gishtërinjve të Zotit, i cili mund ta ndryshojë kur të dojë”.

يَا مُقَلَّبَ الْقُلُوبِ ثَبِّتْ قَلْبِي عَلَى دِينِكَ-

O Kontrolluesi i zemrave! Vendorsma zemrën në besimin Tënd!³²⁷

Lutje për t’iu mbështetur tërësisht Zotit të Madhërishëm

Sipas Hazret Abdullah Ibni Abasit^{ra}, i Dërguari i Allahut^{sas} shpesh bënte këtë lutje:

326. Muslimi, Kitabudh-dhikr, bab et-tavudh minesh-sherr.

327. Tirmidhiu, Kitabud-da’vat, bab 90.

اللَّهُمَّ لَكَ أَسَلَمْتُ، وَبِكَ آمَنْتُ، وَعَلَيْكَ تَوَكَّلْتُ، وَإِلَيْكَ
أَنْبَيْتُ، وَبِكَ خَاصَمْتُ، اللَّهُمَّ أَعُوذُ بِعِزَّتِكَ، لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ، أَنْ
تُضِلَّنِي، أَنْتَ الْحَيُّ الَّذِي لَا يَمُوتُ، وَالْجِنُّ وَالْإِنْسُ يَمُوتُونَ-

O Allah! Ty t'u dorëzova, Ty të besova, te Ti u mbështeta, nga Ti anova dhe me ndihmën Tënde u përballa me armikun. O Allah! Kërkoj mbrojtjen e nderit Tënd, se nuk ka të adhuruar tjetër përveç Teje, që të mos më devijosh. Ti je i Gjalli që nuk vdes, kurse xhindet dhe njerëzit vdesin.³²⁸

Lutje për t'u përmirësuar shpirtërisht dhe materialisht

Hazret Ebu Hurejrah^{ra} ka përcjellë këtë lutje të të Dërguarit të Allahut^{sas}:

اللَّهُمَّ أَصْلِحْ لِي دِينِي الَّذِي هُوَ عِصْمَةٌ أَمْرِي وَأَصْلِحْ لِي دُنْيَايَ الَّتِي
فِيهَا مَعَاشِي، وَأَصْلِحْ لِي آخِرَتِي الَّتِي فِيهَا مَعَادِي، وَاجْعَلِ الْحَيَاةَ
زِيَادَةً لِي فِي كُلِّ خَيْرٍ، وَاجْعَلِ الْمَوْتَ رَاحَةً لِي مِنْ كُلِّ شَرٍّ-

O Allah! Më përmirëso besimin, që është forca ime në punët e mia. Më përmirëso botën, që është mjet mbijetese për mua. Më përmirëso ahiretin, që është vendkthimi im. Ma bëj jetën riprodhuese për çdo të mirë. Më bëj vdekjen qetësi nga çdo e keqe.³²⁹

328. Muslimi, Kitabudh-dhikr, bab et-tavudh minesh-sherr.

329. Muslimi, Kitabudh-dhikr, bab et-tavudh minesh-sherr.

Lutje për të pasur mirësi në botë dhe në ahiret

Hazret Enes Ibni Maliku^{ra} tri ditë radhazi e pyeti të Dërguarin e Allahut^{sas} për t'i treguar lutjen më bekuese dhe çdo herë ai i mësoi të njëjtën lutje dhe i tha: Do të kesh një sukses shumë të madh nëse do të gëzosh mirësi në botë dhe në ahiret. Të njëjtën lutje, Hazret Profeti Muhammed^{sas} ia mësoi Hazret Abasit^{ra}, si dhe Hazret Ebu Bekrit^{ra} duke thënë: “Nuk ka gjë më të çmueshme të kesh mirësi pas besimit”. Lutja në fjalë është si më poshtë:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْعَفْوَ وَالْعَافِيَةَ فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ-

O Allah! Të kërkoj faljen dhe mirësinë në këtë botë dhe në ahiret!³³⁰

Lutje për të pasur mbrojtjen e Allahut

Abdul Hamidi, skllav i liruar i fisit Benu Hashim, përcjell rrëfimin e së emës (e cila ka qenë shërbëtore tek e bija e Profetit Muhammed^{sas}), që Profeti Muhammed^{sas} i mësonte të bijës në mëngjes e në mbrëmje lutjen e mëposhtme për të kërkuar mbrojtjen e Allahut të Madhërishëm:

سُبْحَانَ اللَّهِ وَبِحَمْدِهِ لَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ مَا شَاءَ اللَّهُ كَانَ وَمَا لَمْ يَشَأْ لَمْ يَكُنْ،
أَعْلِمُ أَنَّ اللَّهَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ وَأَنَّ اللَّهَ قَدْ أَحَاطَ بِكُلِّ شَيْءٍ عِلْمًا-

I Shenjtë është Allahu me lavdinë e Tij. Askush tjetër s’ka fuqi, përveç Allahut. Bëhet ajo që do Allahu, kurse diçka që nuk e do Ai, nuk bëhet. Unë e di se Allahu me të vërtetë është i Plotfuqishëm për çdo gjë dhe se Allahu zotëron dije për çdo gjë!³³¹

330. Ibni Maxha, Kitabud-dua, bab ed-dua bil-efvi uel-afijeti.

331. Ebu Daud, Kitabul-adab, bab ma jekulu idha asbaha.

(2) Është edhe një rrëfim tjetër që tregon Hazret Taleku^{ra}: Një njeri erdhi tek Ebu Derda^{ra} dhe tha se i është djegur shtëpia. Ebu Derda^{ra} iu përgjigj: “Jo, nuk më është djegur”. Më pas erdhi një njeri tjetër, i cili i dha të njëjtin lajm, por edhe atij Ebu Derda i tha: “Jo, nuk më është djegur shtëpia”. Më pas erdhi një i tretë dhe e njoftoi: “O Ebu Darda! Ka rënë zjarr dhe është shuar kur i është afruar shtëpisë sate”. Ebu Derda tha: “E dija se Allahu i Madhërishëm nuk do të ma digjte shtëpinë”. Të pranishmit u befasuan dhe i kërkuan t’i sqaronte për të dyja përgjigjet që u kishte dhënë. Pra, së pari kur tha se “nuk më është djegur shtëpia” dhe, së dyti, kur tha “E dija se Allahu i Madhërishëm nuk do të ma digjte shtëpinë”. Ebu Derda^{ra} iu përgjigj: Këto përgjigje jua dhashë për shkak të disa fjalëve që kisha dëgjuar prej të Dërguarit të Allahut^{sas}. Ai kishte thënë se kushdo që do të lutej në mëngjes me këto fjalë, nuk do t’i ndodhë asnjë gjëmë deri në mbrëmje dhe kushdo që do të lutej në mbrëmje me këto fjalë, nuk do t’i ndodhë asnjë gjëmë deri në mëngjes. Ato fjalë janë si vijon:

اللَّهُمَّ أَنْتَ رَبِّي لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ عَلَيَّ تَوَكَّلْتُ وَأَنْتَ رَبُّ الْعَرْشِ
الْعَظِيمِ - مَا شَاءَ اللَّهُ كَانَ وَلَمْ يَشَأْ لَمْ يَكُنْ - لَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ
الْعَلِيِّ الْعَظِيمِ - أَعْلَمُ أَنَّ اللَّهَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ - وَأَنَّ اللَّهَ قَدْحَاظٌ
بِكُلِّ شَيْءٍ عِلْمًا - اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ نَفْسِي وَمِنْ شَرِّ كُلِّ
دَابَّةٍ أَنْتَ آخِذٌ بِنَاصِيَتِهَا إِنَّ رَبِّي عَلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ -

O Allah! Ti je Zoti im! Nuk ka të adhurar tjetër përveç Teje. Te ti u mbështeta dhe Ti je Zoti i arshit madhështor. Bëhet ajo që do Allahu, kurse diçka që nuk e do Ai, nuk bëhet. Sundim dhe fuqi s’ka askush tjetër, përveç Allahut të Lartësuar e të Madhërishëm. Unë e di se Allahu me të vërtetë është i Plotfuqishëm për çdo gjë dhe se Allahu zotëron dije për çdo

gjë. O Allah! Mbromë nga e keqja e vetvetes dhe nga e keqja e çdo gjallese, kokën e së cilës Ti e ke nën kontroll. Zoti im pa dyshim gjendet në rrugën e drejtë.³³²

Lutje për të pasur *takvanë* dhe dëlirësinë

Hazret Zejd Ibni Erkami ka rrëfyer këtë lutje të të Dërguarit të Allahut^{sas}:

اللَّهُمَّ آتِ نَفْسِي تَقْوَاهَا، وَزَكِّهَا أَنْتَ خَيْرُ مَنْ زَكَّاهَا، أَنْتَ وَلِيُّهَا وَمَوْلَاهَا-

O Allah! Dhuroji druajtjen nefsit tim dhe pastroje atë. Ti je më i miri që mund ta pastrosh atë. Ti je Mbrojtësi dhe Pronari i tij.³³³

Lutje për të pasur druajtjen dhe vetëmjaftueshmërinë

Hazret Abdullahu^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} shpesh bënte këtë lutje:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْهُدَىٰ وَالتَّقَىٰ وَالْعَفَافَ وَالْغِنَىٰ

O Allah! Të kërkoj udhëzimin, druajtjen, dëlirësinë dhe vetëmjaftueshmërinë.³³⁴

Lutje për t'u bërë njeri i përsipirtshëm

Hazret Ajshja^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} bënte këtë lutje:

332. El-ilelul-mutanahija, Kitabudh-dhikr, bab hadith fi thevabil-istigfar, vëll. 2, f. 837.

333. Nisai, Kitabul-istiadha, bab el-istiadha minel-exhz.

334. Muslimi, Kitabudh-dhikr, bab et-tavudh minesh-sherr.

اللَّهُمَّ اجْعَلْنِي مِنَ الَّذِينَ إِذَا أَحْسَنُوا اسْتَبَشَرُوا وَإِذَا أَسَاءُوا اسْتَغْفَرُوا -

O Allah! Më bëj ndër ata që kur veprojnë mirë, gëzohen dhe kur veprojnë keq, kërkojnë falje.³³⁵

Lutje për të pasur dëlirësinë

Të Dërguarit të Allahut^{sas} njëherë iu shfaq Zoti me fytyrë tejet të bukur dhe e porositi të bënte këtë lutje:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ فِعْلَ الْخَيْرَاتِ، وَتَرْكَ الْمُنْكَرَاتِ، وَحُبَّ الْمَسَاكِينِ، وَإِذَا أَرَدْتَ فِتْنَةَ قَوْمٍ فَأَقْبِضْنِي إِلَيْكَ غَيْرَ مُفْتُونٍ -

O Allah! Të kërkoj mundësinë për të bërë të mirat, për të hequr dorë nga të ndaluarat dhe dashurinë ndaj të varfërve. Dhe kur Ti vendos të futësh popullin në trazira, ma merr shpirtin drejt Vetes përpara se të vijë trazira.³³⁶

Lutje për të pasur shëndet dhe siguri

Hazret Ajshja^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} shpesh bënte këtë lutje:

اللَّهُمَّ عَافِنِي فِي جَسَدِي، وَعَافِنِي فِي سَمْعِي وَبَصَرِي وَاجْعَلْهُمَا الْوَارِثَ مِنِّي لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ الْحَلِيمُ الْكَرِيمُ، سُبْحَانَ اللَّهِ رَبِّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ، وَالْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ -

O Allah! Më dhuro shëndet në trup, shëndet në dëgjim, shëndet në shikim dhe këta dy të fundit bëji të jenë trashëgimtarë të

335. Musned Ahmed, vëll. 6, f. 129.

336. Tirmidhiu, Kitab tefsiril-Kur'an, surja Sad.

mi. Nuk ka të adhurar tjetër përveç Allahut, të Dhembshur dhe Bujar. I Shenjtë është Allahu, Zoti i arshit madhështor dhe lavdia është e Allahut, Zotit të botëve.³³⁷

Lutje për të shpëtuar nga ndikimi i ogurit të keq

Hazret Abdullah Ibni Omeri^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} ka thënë: “Ai që i bëhet pengesë oguri i keq në punët e tij, ka bërë shirk”. Sahabët e pyetën: “Cila është zgjidhja?” Ai u tha: “Lutuni”:

اللَّهُمَّ لَا طَيْرَ إِلَّا طَيْرُكَ وَلَا خَيْرَ إِلَّا خَيْرُكَ وَلَا إِلَهَ غَيْرُكَ -

O Allah! Nuk ka ogur të keq, përveç ogurit të keq që vjen prej Teje; nuk ka mirësi, përveç mirësisë që vjen prej Teje dhe nuk ka të adhurar tjetër përveç Teje.³³⁸

Lutje kur hasni diçka të pakëndshme

Hazret Ahmed Kershî^{ra} tregon: Në praninë e të Dërguarit të Allahut^{sas} ra fjala për ogurin e keq. Ai tha: Të nxirrni shenjë nuk është e keqe, por kushdo që sheh ndonjë gjë të pakëndshme, le të lutet:

اللَّهُمَّ لَا يَأْتِي بِالْحَسَنَاتِ إِلَّا أَنْتَ، وَلَا يَذْفَعُ السَّيِّئَاتِ إِلَّا أَنْتَ، وَلَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِكَ -

O Allah! Mirësitë askush nuk i sjell, përveç Teje dhe të këqijat askush nuk i largon, përveç Teje dhe sundim e fuqi s’ka askush tjetër, përveç Teje.³³⁹

337. Tirmidhiu, Kitabud-da’vat, bab 67.

338. Musned Ahmed, vëll. 2, f. 220.

339. Ebu Daud, Kitabut-tib, bab fit-tejrah.

Lutje për të kërkuar bekime

Hazret Omeri^{ra} tregon këtë lutje të të Dërguarit të Allahut^{sas}:

اللَّهُمَّ زِدْنَا وَلَا تَقْصُصْنَا وَآكِرْمَنَا وَلَا تُهِنَّا وَأَعْظِمْنَا وَلَا تَحْرِمْنَا وَأَذِرْنَا وَلَا تُؤْثِرْ
عَلَيْنَا وَأَرْضْنَا وَأَرْضِ عَنَّا -

**O Allah! Shtona e mos na pakëso! Jepna nder e mos na poshtëro!
Jepna e mos na privo! Jepna përparësi e mos i jep përparësi
tjetërkujt mbi ne! Jepna gëzim dhe gëzohu nga ne!³⁴⁰**

Lutje për të gjetur frikën dhe besimin e përsosur ndaj Zotit

Hazret Abdullah Ibni Omeri^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} kur
çohej nga ndonjë mbledhje, lutej patjetër për veten dhe për sahabët
e tij me këto fjalë:

اللَّهُمَّ اقْسِمْنَا بِكَ مَا يَحُولُ بَيْنَنَا وَبَيْنَ مَعْصِيكَ، وَبِ
طَاعَتِكَ مَا تَبَلَّغْنَا بِهِ جَنَّتِكَ، وَبِالْيَقِينِ مَا تُهَوِّنُ بِهِ عَلَيْنَا مُصِيبَاتِ
الدُّنْيَا، وَبِالْمَتَاعِ بِأَسْمَاعِنَا، وَبِالْبَصَارِ مَا أَحْيَيْتَنَا، وَاجْعَلْهُ الْوَارِثَ
بِنَا، وَاجْعَلْ ثَارَنَا عَلَى مَنْ ظَلَمْنَا، وَأَنْصُرْنَا عَلَى مَنْ عَادَانَا، وَلَا تَجْعَلْ
مُصِيبَتَنَا فِي دِينِنَا، وَلَا تَجْعَلِ الدُّنْيَا أَكْبَرَ هَمِّمْنَا، وَلَا مَبْلَغَ عِلْمِنَا، وَلَا
تُسَلِّطْ عَلَيْنَا مَنْ لَا يَرْحَمُنَا -

**O Allah! Na jep frikën Tënde që bëhet pengesë midis nesh dhe
ndalimeve të Tua, bindjen Tënde që na çon drejt xhenetit Tënd,
besimin që na lehtëson vështirësitë e botës, na sill dobi prej**

340. Tirmidhiu, Kitab tefsiril-Kur'an, surja El-mu'minun.

dëgjimit tonë, shikimit tonë, fuqive tona gjersa të na mbash gjallë dhe na dhuro trashëgimtarë prej tyre. Vetë hakmerru ndaj atyre që na bëjnë padrejtësi dhe ndihmona kundër atyre që armiqësohen me ne. Mos na përball me vështirësi rreth besimit tonë. Mos e bëj dynjanë as shqetësimin më të madh për ne, as pikën më të lartë të dijes sonë. Mos cakto udhëheqës mbi ne ata që nuk na mëshirojnë.³⁴¹

Lutje për të pasur bereqet në risk

Hazret Ebu Hurejrah^{ra} rrëfen: Një njeri pyeti: “O i Dërguari i Allahut! Mbrëmë ju kam dëgjuar që po bënit një lutje”. I Dërguari i Allahut^{sas} i tha të ishte i sigurt nëse i kishte dëgjuar mirë fjalët. Ajo lutje është:

اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي ذَنْبِي وَوَسِّعْ لِي فِي رِزْقِي وَبَارِكْ لِي فِيمَا رَزَقْتَنِي -

O Allah! Më fal gjynahun, më zgjero shtëpinë dhe më beko në atë që më jep Ti.³⁴²

Lutje për të pasur bereqet në risk gjatë pleqërisë

Hazret Ajshja^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} bënte këtë lutje:

اللَّهُمَّ اجْعَلْ أَوْسَعَ رِزْقِكَ عَلَيَّ عِنْدَ كِبَرِ سِنِّي، وَأَقْطَاعِ عُمْرِي -

O Allah! Më jep bereqet në riskun Tënd gjatë pleqërisë dhe moshës së thyer.³⁴³

341. Tirmidhiu, Kitabud-da'vat, bab 80.

342. Musned Ahmed, vëll. 4, f. 63.

343. Mustadrik Hakim, vëll. 1 f. 542.

Lutje për të pasur bereqet në të vjela e të lashta

Hazret Ebu Hurejrah^{ra} rrëfen se i Dërguari i Allahut^{sas} kur shikonte për herë të parë frutën e stinës, bënte këtë lutje:

اللَّهُمَّ بَارِكْ لَنَا فِي ثَمَارِنَا وَبَارِكْ لَنَا فِي مَدِينَتِنَا وَبَارِكْ لَنَا فِي صَاعِنَا
وَمُدِّنَا -

O Allah! Beko të vjelat tona, beko qytetin tonë dhe beko enët dhe matëset tona!³⁴⁴

Lutje për të kërkuar mundësinë e të vepruarit dhe të të falënderuarit

Hazret Ebu Hurejrah^{ra} rrëfen: Një lutje që kam mësuar prej të Dërguarit të Allahut^{sas}, të cilën kurrë nuk harroj ta bëj, është kjo:

اللَّهُمَّ اجْعَلْنِي أَكْثَرَ شُكْرِكَ، وَأَكْثَرَ ذِكْرِكَ وَأَتَّبِعُ نُصْحَكَ، وَأَحْفَظُ
وَصِيَّتَكَ -

O Allah! Më bëj të të falënderoj sa më shumë, të të përkujtoj sa më shumë, të ndjek këshillën Tënde sa më mirë dhe t'i përmbahem porosisë Sate sa më fort.³⁴⁵

Një lutje e përsosur

Sipas Hazret Abasit^{ra}, i Dërguari i Allahut^{sas} shpesh bënte këtë lutje:

344. Muslimi, Kitabul-haxh, bab fadli Medina.

345. Musned Ahmed, vëll. 2, f. 311.

رَبِّ أَعْيَنِي، وَلَا تُعِنِّ عَلَيَّ، وَأَنْصُرْنِي وَلَا تَنْصُرْ عَلَيَّ، وَأَمْكُرْ لِي وَلَا تَمْكُرْ
عَلَيَّ، وَاهْدِنِي وَيَسِّرِ الْهُدَى لِي، وَأَنْصُرْ عَلَيَّ مَنْ بَغَى عَلَيَّ، رَبِّ
اجْعَلْنِي لَكَ شَاكِرًا، لَكَ ذَاكِرًا، لَكَ رَاهِبًا، لَكَ مَطْوَعًا، لَكَ مُخْتَبًا،
إِلَيْكَ أَوَاهَا مُنِيبًا، رَبِّ تَقَبَّلْ تَوْبَتِي، وَأَغْسِلْ حُوبَتِي، وَأَجِبْ دَعْوَتِي،
وَتَبِّثْ حُجَّتِي وَسَدِّدْ لِسَانِي، وَاهْدِ قَلْبِي، وَأَسْأَلُ سَخِيمَةَ صَدْرِي -

O Zoti im! Më përkrah dhe mos përkrah (askënd) kundër meje! Më ndihmo dhe mos ndihmo (askënd) kundër meje! Më organizo dhe mos organizo (askënd) kundër meje! Më udhëzo dhe ma bëj të lehtë udhëzimin! Më ndihmo kundër atij që bëhet armiku im! O Zoti im! Më bëj mirënjohës ndaj Teje, përkujtues Tëndin, të druajtur prej Teje, të bindur ndaj Teje, përgjërues pranë Teje, zemërbutë dhe të anuar nga Ti! O Zoti im! Më prano pendesën! Më laj mëkatet! Përgjigju lutjes sime! Më forco argumentin! Më drejto gjuhën! Më udhëzo zemrën dhe më pastro vrerin e kraharorit tim!³⁴⁶

Lutje për të kërkuar dije të dobishme

Hazret Ebu Hurejrah^{ra} përcjell këtë lutje të të Dërguarit të Allahut^{sas}:

اللَّهُمَّ انْفَعِنِي بِمَا عَلَّمْتَنِي، وَعَلِّمْنِي مَا يَنْفَعُنِي، وَزِدْنِي عِلْمًا، الْحَمْدُ لِلَّهِ
عَلَى كُلِّ حَالٍ وَأَعُوذُ بِاللَّهِ مِنْ حَالِ أَهْلِ النَّارِ -

O Allah! Më sill dobi nga ajo që më mësove! Më mëso atë që më bën dobi dhe më shto dijen! Lavdia është e Allahut në çdo rrethanë. Kërkoj mbrojtjen e Allahut nga gjendja e banorëve të zjarrit.³⁴⁷

346. Tirmidhiu, Kitabud-da'vat, bab di duain-Nebij^{sas}

347. Tirmidhiu, Kitabud-da'vat, bab fil-afvi uel-afjati.

Mënyra dhe lutja për të mësuar Kuranin përmendsh

Hazret Abdullah Ibni Abasi^{ra} tregon se në një takim me të Dërguarin e Allahut^{sas}, Hazret Aliu iu ankua se shpesh e harronte Kuranin që kishte mësuar përmendsh. I Dërguari i Allahut^{sas} i tha: “O babai i Hasanit! A të tregoj disa fjalë që do të ta ngulitin Kuranin që ke mësuar përmendsh?” Pastaj duke ia treguar metodën i tha të falte namaz vullnetar (*nafil*) në pjesën e fundit të natës së xhumasë (pasi ajo është kohë e veçantë për pranimin e lutjes). Edhe Hazret Jakubi duke pritur pikërisht këtë kohë ishte shprehur: “Së shpejti do t’i kërkoj Zotit tim falje për ju” (Kurani Famëlartë 12:99).

Nëse nuk mund të çoheni në pjesën e fundit të natës, mund ta bëni këtë në mesnatë ose në pjesën e parë të natës. Duhet të falni katër rekate namaz. Në rekatën e parë, pas sures *El-Fatiha* të recitoni suren 36 *Jasin*; në rekatën e dytë, pas sures *El-Fatiha* të recitoni suren 44 *Ha.Mim.Ed-Duhan*; në rekatën e tretë pas *El-Fatihas* të recitoni suren 32 *Alif.Lam.Mim Tenzil Es-Sexhda* dhe në rekatën e katërt, pas sures *El-Fatiha*, të recitoni suren 67 *El-Mulk*. Në rekatën e fundit kur qëndroni të ulur, pasi të keni thënë *teshehudin*, lavdërojeni Allahun, dërgojini *salavatet* Profetit Muhammed^{sas} dhe profetëve të tjerë të Zotit, kërkojini falje Zotit për besimtarët dhe më pas bëni lutjen e mëposhtme. Kështu praktikoni të paktën tri të premtë, por nëse keni mundësi, praktikoni pesë ose shtatë të premtë. I Dërguari i Allahut^{sas} thotë: “Nëse veproni kështu, lutja juaj do të pranohet. Pasha Atë që më ka dërguar, lutja e besimtarit të vërtetë nuk refuzohet”.

Hazret Abdullah Ibni Abasi^{ra} tregon se Hazret Aliu, pasi e kishte praktikuar këtë udhëzim pesë a shtatë herë, u takua me të Dërguarin e Allahut^{sas} dhe i tha: O i Dërguari i Allahut! “Dikur ishte koha kur

nuk mund të mbaja mend as katër ajete të Kuranit, kurse tani jam në gjendje të mësoj përmendsh dyzet ajete përditë. Madje, kur i mësoj mirë, më duket sikur Kurani është vendosur përpara syve të mi. E njëjta situatë ishte me të mbajturit mend të thënieve të të Dërguarit të Allahut dhe shumë shpejt i harroja, por tani mund të rrëfej thujse të plotë çdo gjë që dëgjoj prej jush”.

I Dërguari i Allahut^{sas} tha: “Pasha Zotin e Qabes! Babai i Hasanit është besimtar i vërtetë”. Ajo lutje është:

اللَّهُمَّ ارْحَمْنِي بِتَرْكِ الْمَعَاصِي أَبَدًا مَا أَقْبَيْتَنِي، وَارْحَمْنِي، أَنْ أَنْكَلَفَ مَا لَا يَعْينُنِي، وَارْزُقْنِي حَسَنَ النَّظَرِ فِيمَا يُرِضُكَ عَنِّي، اللَّهُمَّ بَدِّعِ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ، ذَا الْجَلَالِ وَالْإِكْرَامِ، وَالْعِزَّةِ الَّتِي لَا تُرَامُ، أَسْأَلُكَ يَا اللَّهُ، يَا رَحْمَنُ، بِجَلَالِكَ وَنُورِ وَجْهِكَ أَنْ تُلْزِمَ قَلْبِي حِفْظَ كِتَابِكَ كَمَا عَلَّمْتَنِي وَارْزُقْنِي أَنْ أَتْلُوهُ عَلَى النَّحْوِ الَّذِي يُرِضُكَ عَنِّي، اللَّهُمَّ بَدِّعِ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ذَا الْجَلَالِ وَالْإِكْرَامِ، وَالْعِزَّةِ الَّتِي لَا تُرَامُ، أَسْأَلُكَ يَا اللَّهُ، يَا رَحْمَنُ، بِجَلَالِكَ وَنُورِ وَجْهِكَ، أَنْ تُنَوِّرَ بِكِتَابِكَ بَصْرِي، وَأَنْ تُطَلِّقَ بِهِ لِسَانِي، وَأَنْ تُفَرِّجَ بِهِ عَن قَلْبِي وَأَنْ تَشْرَحَ بِهِ صَدْرِي، وَأَنْ تَغْسِلَ بِهِ بَدَنِي، فَإِنَّهُ لَا يُعِينُنِي عَلَى الْحَقِّ غَيْرُكَ، وَلَا يُؤْتِيهِ إِلَّا أَنْتَ، وَلَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ الْعَلِيِّ الْعَظِيمِ-

O Allah! Gjersa të më mbash gjallë, më mëshiro që të heq dorë nga mëkatet! Më mëshiro kur bëj me vetëdije gjëra të padobishme! Më dhuro pikëpamje të bukur, në të cilën Ti të jesh i Kënaqur me mua! O Allah, Krijuesi i qiejve dhe i Tokës, zotërues i madhështisë, bujarisë dhe i nderit që nuk mund të tejkalohet, Ty të kërkoj, o Allah, o i Gjithëmëshirshëm, në saje të madhështisë Sate e të dritës së Fytyrës Sate, lidhe zemrën

time që ta mësojë librin Tënd, ashtu siç Ti më ke mësuar dhe më mundëso ta recitoj atë në atë mënyrë, që Ti pëlqen prej meje!
O Allah! Krijuesi i qiejve dhe i Tokës, zotërues i madhështisë, bujarisë dhe i nderit që nuk mund të tejkalohet.

Ty të kërkoj, o Allah, o i Gjithëmëshirshëm, që në saje të madhështisë Sate e të dritës së Fytyrës Sate, m'i ndrit sytë me librin Tënd, më liro gjuhën me anë të tij, më hap zemrën me anë të tij, më zgjero kraharorin me anë të tij dhe më pastro trupin me anë të tij, sepse për të pasur të vërtetën, askush nuk mund të më ndihmojë përveç Teje, askush nuk mund të ma japë atë, përveç Teje, sundim dhe fuqi s'ka askush tjetër përveç Allahut, të Lartësuar, të Madhërishëm.³⁴⁸

Një lutje e përsosur për të kërkuar çdo të mirë dhe për t'u mbrojtur nga çdo e keqe

Hazret Ebu Amama Bahli^{ra} rrëfen: “Njëherë i thamë të Dërguarit të Allahut^{sas}: Ju keni bërë kaq shumë lutje, të cilat ne nuk mund t'i mbajmë mend. Si duhet të veprojmë?” I Dërguari i Allahut^{sas} tha: “Do t'ju mësoj një lutje të përsosur:

اللَّهُمَّ إِنَّا نَسْأَلُكَ مِنْ خَيْرِ مَا سَأَلَكَ مِنْهُ نَبِيُّكَ مُحَمَّدٌ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، وَنَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ مَا اسْتَعَاذَ مِنْهُ نَبِيُّكَ مُحَمَّدٌ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ وَأَنْتَ الْمُسْتَعَانُ، وَعَلَيْكَ الْبَلَاءُ - وَلَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ -

O Allah! Të kërkojmë çdo të mirë që të ka kërkuar Profeti Yt, Muhammedi^{sas}. Të kërkojmë mbrojtje nga çdo e keqe, nga e cila

348. Tirmidhiu, Kitabud-da'vat, bab fi duail-hifz.

të ka kërkuar mbrojtje Profeti Yt, Muhammedi^{sas}. Vetëm Ti je Ai prej të cilit kërkohet ndihmë. Ty duhet të të lutemi. Sundim dhe fuqi s'ka askush tjetër, përveç Allahut.”³⁴⁹

Lutje për të kërkuar nivele të larta shpirtërore

Nëna e besimtarëve, Hazret Umi Selma^{ra}, na përcjell këtë lutje të përsosur të të Dërguarit të Allahut^{sas}:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ خَيْرَ الْمَسْأَلَةِ وَخَيْرَ الدُّعَاءِ وَخَيْرَ النَّجَاحِ وَخَيْرَ الْعَمَلِ
وَخَيْرَ الثَّوَابِ وَخَيْرَ الْحَيَاةِ وَخَيْرَ السَّمَاةِ وَتُبِّئَنِي وَتَقِلْ مَوَازِينِي وَحَقِّقْ
إِيمَانِي وَارْفَعْ دَرَجَتِي وَتَقَبَّلْ صَلَاتِي وَأَغْفِرْ خَطِيئَتِي وَأَسْأَلُكَ
الدَّرَجَاتِ الْعُلَى مِنَ الْجَنَّةِ (الْمَيْن) اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ فَوَاتِحَ الْخَيْرِ
وَخَوَاتِمَهُ وَجَوَابِعَهُ وَأَوَّلَهُ وَآخِرَهُ وَظَاهِرَهُ وَبَاطِنَهُ وَالدَّرَجَاتِ الْعُلَى مِنَ
الْجَنَّةِ (الْمَيْن) اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ أَنْ تَرْفَعَ ذِكْرِي وَتَضَعْ وَزْرِي وَتُصَلِّحَ
أَمْرِي وَتُطَهِّرَ قَلْبِي وَتُحْصِنَ فَرْجِي وَتُنَوِّرَ قَلْبِي وَتَغْفِرَ لِي ذَنْبِي وَأَسْأَلُكَ
الدَّرَجَاتِ الْعُلَى مِنَ الْجَنَّةِ (الْمَيْن) اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ أَنْ تُبَارِكَ لِي فِي
سَمْعِي وَفِي بَصَرِي وَفِي رُوحِي وَفِي خَلْقِي وَفِي خُلُقِي وَفِي أَهْلِي وَفِي
مَحْيَايَ وَفِي مَمَاتِي وَفِي عَمَلِي وَتَقَبَّلْ حَسَنَاتِي وَأَسْأَلُكَ الدَّرَجَاتِ
الْعُلَى فِي الْجَنَّةِ (الْمَيْن)-

O Allah! Të kërkoj kërkesën më të mirë, lutjen më të mirë, suksesin më të mirë, veprën më të mirë, shpërblimin më të mirë, jetën më të mirë dhe vdekjen më të mirë! Më bëj të qëndrueshëm! Jepu peshë veprave të mia! Vërteto besimin tim! Lartëso statusin tim! Pranoje namazin tim! Më fal gjynahet e mia! Të kërkoj status të lartë në xhenet! (Amin!)

349. Tirmidhiu, Kitabud-davat, bab 89.

O Allah! Të kërkoj nismat e mirësisë, kurorëzimet e saj, mbledhjet e saj, fillimin e saj, fundin e saj, të jashtmen e saj dhe brendinë e saj dhe status të lartë në xhenet! (Amin!)

O Allah! Të kërkoj të më lartësosh emrin, të më lehtësosh barrën, të më rregullosh çështjen, të më pastrosh zemrën, të më mbrosh organin gjenital, të më ndriçosh zemrën dhe të më falësh mëkatin! Të kërkoj status të lartë në xhenet! (Amin!)

O Allah! Të kërkoj të bekosh dëgjimin tim, shikimin tim, shpirtin tim, trupin tim, moralin tim, familjen time, jetën time, vdekjen time, veprën time dhe të kërkoj të pranosh veprat e mia të mira! Të kërkoj status të lartë në xhenet! (Amin!)³⁵⁰

Lutje për të kërkuar dëlirësinë, së jashtmi dhe së brendshmi

Hazret Omeri^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} atij i kishte mësuar këtë lutje:

اللَّهُمَّ اجْعَلْ سَرِيرَتِي خَيْرًا مِّنْ عَلَانِيَتِي، وَاجْعَلْ عَلَانِيَتِي صَالِحَةً
اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ مِنْ صَالِحِ مَا تُؤْتِي النَّاسَ مِنَ الْأَهْلِ وَالْمَالِ وَالْوَالِدِ
غَيْرِ الضَّالِّ وَالْمُضِلِّ

O Allah! Brendësinë time bëje më të mirë se të jashtmen time dhe të jashtmen time bëje të shëndoshë! O Allah! Nga bekimet që u ke dhënë njerëzve, të kërkoj familjen, pasurinë, fëmijët jo të devijuar e as devijues!³⁵¹

350. Mustadrik Hakim, vëll. 1, f. 520.

351. Tirmidhiu, Kitabud-da'vat, bab 124.

Lutje të ndryshme për të larë borxhet

dhe për t'u larguar nga veset

(1) Hazret Aliu^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} i kishte mësuar këtë lutje për të qenë larg borxheve:

اللَّهُمَّ اكْفِنَا بِحَلَالِكَ عَنْ حَرَامِكَ وَأَغْنِنَا بِفَضْلِكَ عَمَّنْ سِوَاكَ.

O Allah! Të kërkoj vetëmjaftueshmërinë në ato që lejon Ti, përballë atyre që ndalon Ti dhe me bekimin Tënd na dhuro pavarësi ndaj çdokujt, përveç Teje.³⁵²

(2) Njëherë në xhami, në kohën e namazit, I Dërguari i Allahut^{sas} pa Hazret Ebu Umamën të shqetësuar. E pyeti për shkakun dhe ai i tregoi problemin e borxhit dhe disa probleme të tjera që kishte. I Dërguari i Allahut^{sas} i tha: “A të të mësoj një lutje që do të të bëjë ta lash borxhin e të t'i largojë edhe shqetësimet?!” Më pas i mësoi lutjen e mëposhtme duke i thënë ta bënte çdo ditë në mëngjes e në mbrëmje. Ebu Umama thotë: “E bëra këtë lutje dhe Allahu i Madhërisëm m'i largoi edhe shqetësimet, edhe borxhet”. Ajo lutje është si më poshtë:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْهَمِّ وَالْحُزْنِ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنَ الْعَجْزِ وَالْكَسَلِ
وَأَعُوذُ بِكَ مِنَ الْجُبْنِ وَالْبُخْلِ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنَ غَلَبَةِ الدَّيْنِ وَقَهْرِ الرِّجَالِ

O Allah! Më mbro nga brenga e shqetësimi! Më mbro nga paaftësia e përtacia! Më mbro nga frika e koprracia! Më mbro nga ngarkesa e borxhit dhe nga pushtimi i njerëzve!³⁵³

352. Tirmidhiu, Kitabud-da'vat, bab 111.

353. Ebu Daud, Kitabul-vitr, bab el-istiadha.

Lutje për t'u liruar nga borxhet

Hazret Ajshja^{ra} rrëfen: “Më erdhi një ditë Ebu Bekri dhe më tha: A ke dëgjuar lutjen që më ka mësuar i Dërguari i Allahut^{sas}?” “Cilën lutje?” – e pyeta. Më tha: “Është një lutje që Hazret Isai^{as} ua mësonte dishepujve të vet. Është një lutje që, edhe sikur t'i kesh borxh dikujt një mal me flori e t'i kërkosh Zotit me anë të saj, Ai do të të mundësojë larjen e tij”. Ajo lutje është:

اللَّهُمَّ فَارِحِ الْهَمِّ، كَاشِفِ الْعَمِّ، مُجِيبِ دَعْوَةِ الْمُضْطَرِّينَ رَحْمَنَ الدُّنْيَا
وَالْآخِرَةِ وَرَحِيمَهُمَا أَنْتَ تَرَحَّمُنِي فَارْحَمْنِي بِرَحْمَةٍ تُعِينُنِي بِهَا عَنِ
رَحْمَةِ مَنْ سِوَاكَ -

O Allah, Larguesi i brengës dhe i shqetësimit, Pranuesi i lutjes së të përvuajturve, I Gjithëmëshirshmi i botës dhe i ahiretit dhe Mëshirëbërësi i të dyjave! Vetëm Ti më mëshiron. Më mëshiro me anë të mëshirës që më pavarëson nga çdo mëshirë tjetër, përveç mëshirës Sate!³⁵⁴

Lutje për t'u larguar nga borxhet dhe për të pasur vetëmjaftueshmëri

Duke iu përgjigjur kërkesës së shërbëtorit, Hazret Ajshja^{ra} i mësoi këtë lutje të të Dërguarit të Allahut^{sas}:

354. Mustadrik Hakim, vëll. 1, f. 515.

اللَّهُمَّ رَبَّ السَّمَوَاتِ السَّبْعِ وَرَبَّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ رَبَّنَا وَرَبَّ كُلِّ شَيْءٍ
مُنزِلِ التَّوْرَةَ وَالْإِنْجِيلَ وَالْقُرْآنَ فَالِقَ الْحَبِّ وَالنَّوَى أَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ
كُلِّ شَيْءٍ أَنْتَ الْخَدُّ بِنَاصِيَتِهِ أَنْتَ الْأَوَّلُ فَلَيْسَ قَبْلَكَ شَيْءٌ وَأَنْتَ
الْآخِرُ فَلَيْسَ بَعْدَكَ شَيْءٌ وَأَنْتَ الظَّاهِرُ فَلَيْسَ فَوْقَكَ شَيْءٌ وَأَنْتَ
الْبَاطِنُ فَلَيْسَ دُونَكَ شَيْءٌ اقْضِ عَنِّي الدَّيْنَ وَأَغْنِنِي مِنَ الْفَقْرِ-

**O Allah, Zoti i shtatë qiejve, Zoti i arshit madhështor, Zoti ynë,
Zoti i çdo gjëje, Dërguesi i Teuratit, i Ungjillit dhe i Kuranit,
O Ti që e bën farën dhe bërthamën të mugullojnë! Më mbro
nga e keqja e çdo gjëje që Ti e ke nën kontroll. Ti je i Pari dhe
nuk ka asgjë para Teje dhe Ti je i Fundit dhe nuk ka asgjë pas
Teje. Ti je i Dukshmi dhe nuk ka asgjë mbi Ty. Ti je i Fshehti e
nuk ka asgjë përtej Teje. Laje borxhin tim dhe më pavarëso nga
varfëria.**³⁵⁵

Lutje për të sëmurin

Hazret Ajshja^{ra} thotë se kur dikush nga anëtarët e familjes sëmurëj, i
Dërguari i Allahut^{sas}, bënte këtë lutje mbi të:

أَذْهَبِ الْبَاسَ، رَبَّ النَّاسِ، وَأَشْفِ أَنْتَ الشَّافِي لَا شِفَاءَ إِلَّا بِشِفَائِكَ
شِفَاءً لَا يُعَادِرُ سَقَمًا-

**Largoja sëmundjen, o Zoti i njerëzve, dhe shëroje! Ti je
Shëruesi! Nuk ka shërim, përveç shërimit prej Teje. Jepi shërim
që nuk i lë gjurmë të sëmundjes!**³⁵⁶

355. Muslimi, Kitabudh-dhikr, bab ma jekulu endan-neum.

356. Buhariu, Kitabut-tib, bab mashirr-rraki.

Të fryrët gjatë sëmundjes

Hazret Ebu Seid Hudriju^{ra} rrëfen: Xhibraili^{as} i erdhi të Dërguarit të Allahut^{sas} dhe e pyeti: “O Muhammed! A je i sëmurë?” “Po”, iu përgjigj ai. Atëherë, Xhibraili^{as} me këto fjalë e fryu të Dërguarin e Allahut^{sas}:

بِسْمِ اللَّهِ أَرْقِيكَ وَاللَّهُ يَشْفِيكَ مِنْ كُلِّ شَيْءٍ يُؤْذِيكَ وَمِنْ شَرِّ كُلِّ
نَفْسٍ وَعَيْنٍ حَاسِدَةٍ اللَّهُ يَشْفِيكَ بِسْمِ اللَّهِ أَرْقِيكَ -

Me emrin e Allahut po të fryj. Allahu të shëroftë nga çdo gjë e dëmshme, nga e keqja e çdo njeriu dhe nga e keqja e syrit xheloz! Allahu të shëroftë! Me emrin e Allahut po të fryj.³⁵⁷

Lutje për t’u shëruar nga temperatura

Hazret Ibni Abasi^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} i mësoi këtë lutje, që ta bënte kur të kishte temperaturë ose dhimbje të ndryshme:

بِسْمِ اللَّهِ الْكَبِيرِ نَعُوذُ بِاللَّهِ الْعَظِيمِ مِنْ شَرِّ كُلِّ عَرَقٍ نَّعَارٍ وَمِنْ شَرِّ حَرِّ
النَّارِ -

Me emrin e të Madhit Allah! Kërkojmë mbrojtjen e të Madhërishmit Allah nga e keqja e çdo vene të fryrë dhe nga çdo e keqe e afshit të zjarrit.³⁵⁸

Lutje gjatë dhimbjes

Hazret Osman Ibni Ebil-Asi^{ra} iu ankua të Dërguarit të Allahut^{sas} për dhimbje në trup. I Dërguari i Allahut^{sas} i mësoi këtë lutje duke e

357. Muslimi Kitabus-salam, bab et-tib uel-mard.

358. Ibni Maxha, Kitabut-tib, bab ma jeudhu bihil-huma.

udhëzuar të thoshte tri herë *Bismil-lah* (Lutem me emrin e Allahut) dhe shtatë herë të bënte lutjen që vijon e të frynte në trupin e vet:

أَعُوذُ بِاللَّهِ بِعِزَّتِهِ وَقُدْرَتِهِ مِنْ شَرِّ مَا أَجِدُ وَأُحَاذِرُ -

Kërkoj mbrojtjen e Allahut, të nderit të Tij dhe të mrekullibërjes së Tij nga e keqja e gjithçkaje që kam dhe që ndiej.³⁵⁹

Lutje për t'u shëruar nga bllokimi i urinës

Hazret Ebu Derda^{ra} tregon se njëherë, një njeri erdhi tek i Dërguari i Allahut^{sas} dhe i tha se babai i tij vuante nga bllokimi i urinës, për shkak të gurit në prostatë. I Dërguari i Allahut^{sas} duke i mësuar lutjen që vijon, i tha ta bënte për babanë e tij dhe t'i frynte:

رَبُّنَا اللَّهُ الَّذِي فِي السَّمَاءِ تَقَدَّسَ اسْمُكَ أَمْرُكَ فِي السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ
كَمَا رَحِمْتِكَ فِي السَّمَاءِ فَاجْعَلْ رَحِمَتَكَ فِي الْأَرْضِ وَأَغْفِرْ لَنَا حُوبَنَا
وَخَطَايَانَا أَنْتَ رَبُّ الطَّيِّبِينَ فَأَنْزِلْ شِفَاءً مِّنْ شِفَائِكَ وَرَحْمَةً مِّنْ
رَّحِمَتِكَ عَلَى هَذَا الْوَجَعِ -

Zoti ynë është Allahu që është në qiell. I Shenjtë është emri Yt. Ti sundon qiellin e Tokën. Ashtu siç e ke mëshiruar qiellin, mëshiroje edhe Tokën! Falna mëkatet dhe gabimet! Ti je Zoti i të pastërve. Dhuro shërim prej shërimit Tënd, mëshirë prej mëshirës Sate në këtë shqetësim!³⁶⁰

Lutje për të rifituar shikimin

Hazret Osman Ibni Hunejfi^{ra} rrëfen: Një i verbër erdhi tek i Dërguari i Allahut^{sas} dhe i kërkoi të bënte lutje që t'i rikthehej shikimi. I

359. Ibni Maxha, Kitabut-tib, bab ma av-vadha bihin-Nebij^{sas}

360. Ebu Daud, Kitabut-tib, bab kejfarr-rraki.

Dërguari i Allahut^{sas} i tha: Në daç ti do të lutem. Në daç duro, sepse durimi është më i miri për ty. Kur i verbëri këmbënguli për lutjen, i Dërguari i Allahut^{sas} i tha të bënte këtë lutje, pasi të kishte marrë abdes në mënyrë të mirë:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ وَأَتَوَجَّهُ إِلَيْكَ بِنَبِيِّكَ مُحَمَّدٍ نَبِيِّ الرَّحْمَةِ، إِنِّي تَوَجَّهْتُ بِكَ إِلَى رَبِّي فِي حَاجَتِي هَذِهِ لِتَقْضَى لِي اللَّهُمَّ فَشَفِّعْهُ لِي.

O Allah! Ty të kërkoj dhe në saje të Profetit Tënd Muhammed, Profetit të mëshirës, Të drejtohem Ty, Zoti im për këtë nevojë timen që të ma plotësosh! O Allah! Pranoje ndërmjetësimin e tij për mua!³⁶¹

Lutje për të shpëtuar nga sëmundjet e jashtme e të brendshme

Hazret Enesi^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} bënte këtë lutje:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْعَجْزِ وَالْكَسَلِ، وَالْجُبْنِ وَالْبُخْلِ، وَالْهَرَمِ، وَالْقَسْوَةِ وَالْغَفْلَةِ، وَالْعَيْلَةِ، وَالذَّلَّةِ وَالْمَسْكِنَةِ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنَ الْفَقْرِ، وَالْكَفْرِ وَالْفُسُوقِ، وَالشِّقَاقِ، وَالنِّفَاقِ، وَالسُّمْعَةِ وَالرِّيَاءِ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنَ الصَّمَمِ وَالْبُكْمِ، وَالْجُنُونِ وَالْجُدَامِ، وَالْبَرَصِ وَسَيِّءِ الْأَسْقَامِ.

O Allah! Më mbro nga paaftësia e përtacia, nga frika e koprracia, nga pleqëria e zemërngurtësia, nga pakujdesia e varfëria, nga poshtërimi dhe nga të qenët nevojtar! Më mbro nga skamja e mohimi, nga pabindshmëria, armiqësia e hipokrizia, nga shtirja dhe dukja! Më mbro nga shurdhimi, të qenët memec, çmenduria, lebra, lebra e bardhë dhe nga sëmundjet e këqija!³⁶²

361. Tirmidhiu, Kitabud-da'vat, bab 119.

362. Mustadrik Hakim, vëll. 1, f. 712.

Lutje për t'u mbrojtur nga syri i keq

(1) Hazret Ibni Abasi^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} me këtë lutje e frynte Hazret Hasanin^{ra} dhe Hazret Husejin^{ra} dhe thoshte: Me këto fjalë i kërkonte mbrojtje Allahut Ibrahim^{as} për djemtë e vet, Ismailin^{as} dhe Is'hakun^{as}.

أَعُوذُ بِكَلِمَاتِ اللَّهِ التَّامَّةِ مِنْ كُلِّ شَيْطَانٍ وَهَامَّةٍ وَمِنْ كُلِّ غَيِّينٍ لَآمَةٍ -

Kërkoj mbrojtjen e fjalëve të përsosura të Allahut nga çdo djall, çdo kafshë dhe nga çdo sy i keq.³⁶³

(2) Hazret Amir Ibni Rebija^{ra} tregon se një shok i tij, kur u ndikua nga syri i keq, u shërua nga kjo lutje e të Dërguarit të Allahut^{sas}:

اللَّهُمَّ أَذْهَبْ حَرَّهَا وَبَرِّدْهَا وَوَصِّبْهَا -

O Allah! Largoji afshin, ftohtësinë dhe vështirësinë!³⁶⁴

Lutja e hallexhiut

Hazret Abdurrahman Ibni Ebu Bekri^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} tha se hallexhiu duhet të bëjë këtë lutje:

اللَّهُمَّ رَحْمَتَكَ أَرْجُو، فَلَا تَكِلْنِي إِلَى نَفْسِي طُرْفَةَ عَيْنٍ، وَأَصْلِحْ لِي شَأْنِي كُلَّهُ، لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ -

O Allah, mëshirën Tënde kërkoj! As për një çast të vetëm mos më dorëzo te vetja ime! Më rregullo gjithë çështjen time! Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Teje!³⁶⁵

363. Buhariu, Kitabul-anbija, bab en-naslani fil-mashi.

364. Musned Ahmedi, vëll 3, f. 447.

365. Ebu Daud, Kitabul-adab, bab ma jekulu idha asbaha.

Lutja e atij që shikon një hallelxi

Hazret Omeri^{ra} dhe Hazret Ebu Bekri^{ra} thonë: Ai që shikon ndonjë hallelxi, le të bëjë lutjen e mëposhtme, sepse do të jetë i mbrojtur nga vështirësia e tij:

الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي عَافَانِي بِمَا ابْتَلَاكَ بِهِ، وَفَضَّلَنِي عَلَى كَثِيرٍ مِمَّنْ خَلَقَ تَفَضُّلاً -

Lavdia është e Allahut që më ka mbrojtur nga ajo me të cilën po sprovohesh dhe më dha epërsi mbi shumë nga krijesat e Tij.³⁶⁶

Lutje gjatë sprovës

Hazret Ebu Hurejrah^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} kur gjendej në vështirësi, lutej:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ جَهْدِ الْبَلَاءِ، وَدَرَكِ الشَّقَاءِ، وَسُوءِ الْقَضَاءِ، وَشَمَاتَةِ الْأَعْدَاءِ -

O Allah! Më mbro nga vështirësia e sprovës, nga kapja e fatligësisë, nga caktimi i keq dhe nga përbuzja e armiqve!³⁶⁷

Lutje të ndryshme gjatë shqetësimeve e vështirësive

(1) Hazret Abdullah Ibni Abasi^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} kur gjendej në vështirësi, thoshte këto fjalë:

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ الْعَظِيمُ الْحَلِيمُ، لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ رَبُّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ، لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ رَبُّ السَّمَوَاتِ وَرَبُّ الْأَرْضِ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ رَبُّ الْعَرْشِ الْكَرِيمِ -

366. Tirmidhiu, Kitabud-da'vat, bab ma jekulu idha ra'a mubtala.

367. Buhariu, Kitabud-da'vat, bab et-tavudh min xuhdil-bela.

Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut, të Madhërishëm e të Dhembshur! Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut, Zotit të arshit madhështor! Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut, Zotit të qiejve, Zotit të Tokës! Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut, Zotit të arshit fisnik!³⁶⁸

(2) Hazret Enes Ibni Maliku^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} kur kishte ndonjë shqetësim a vështirësi, lutej:

يَا حَيُّ يَا قَيُّوْمُ بِرَحْمَتِكَ أَسْتَغِيْثُ

O i Gjallë! O i Qëndrueshëm! Me mëshirën Tënde të kërkoj ndihmë!³⁶⁹

(3) Hazret Ebu Hurejrah^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} ka thënë: Pata një vështirësi dhe më erdhi Xhibraili^{as}, i cili më mësoi këtë lutje:

تَوَكَّلْتُ عَلَى الْحَيِّ الَّذِي لَا يَمُوتُ الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي لَمْ يَتَّخِذْ وَلَدًا وَلَمْ يَكُنْ لَهُ شَرِيْكٌ فِي الْمُلْكِ وَلَمْ يَكُنْ لَهُ وَّلِيٌّ مِّنَ الدُّنْيَا وَكَبْرَهُ تَكْبِيْرًا -

U mbështeta tek i Gjalli që nuk vdes. Lavdia është e Allahut që nuk ka bir. Askush nuk mund t'i bëhet ortak në sundim e as nuk mund t'i bëhet shok duke e gjetur të paaftë. Madhëroje Atë sa më shumë.³⁷⁰

Lutje për t'u liruar nga brengat dhe për të pasur dashurinë ndaj Kuranit

Hazret Abdullah ibni Mesudi^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} ka

368. Buhariu, Kitabud-da'vat, bab dua endal-kerb.

369. Tirmidhiu, Kitabud-da'vat, bab 92.

370. Mustadrik Hakim, vëll. 1, f. 509.

thënë: Ai që është prekur shumë nga brengat dhe pikëllimet, le të bëjë këtë lutje. Zoti i Madhërisëm do t'ia largojë brengat dhe do t'i hapë rrugët e qetësisë. Ai gjithashtu tha se çdokush që e dëgjon këtë lutje, le ta mësojë:

اَللّٰهُمَّ اِنِّىْ عَبْدُكَ، اِبْنُ عَبْدِكَ، اِبْنُ اَمَّتِكَ، نَاصِىَتِيْ بِيَدِكَ، مَا ضَىَّ
حُكْمُكَ عَدْلٌ فِىَّ قِضَاءِكَ اَسْأَلُكَ بِكُلِّ اِسْمٍ هُوَ لَكَ، سَمَّيْتْ بِهٖ
نَفْسَكَ اَوْ اَنْزَلْتَهُ فِىْ كِتَابِكَ اَوْ عَلَّمْتَهُ اَحَدًا مِّنْ خَلْقِكَ، اَوْ اَسْتَاثَرْتَ بِهٖ
فِىْ عِلْمِ الْغَيْبِ عِنْدَكَ اَنْ تَجْعَلَ الْقُرْآنَ رِبِيعَ قَلْبِىْ وَ نُورَ بَصْرِىْ،
وَ جَلَاءَ حُرْنِىْ وَ ذِهَابَ هَمِّىْ -

O Allah! Jam robi Yt, djalë i robit Tënd, djalë i robëreshës Sate, koka ime është në dorën Tënde, urdhri Yt po vepron tek unë, vendimi Yt është i drejtë për mua.

Të lutem, me çdo emër Tëndin me të cilin e ke quajtur Vetën, qoftë nga ata emra që ia ke mësuar ndonjërit prej krijesave të Tua, qoftë nga ata emra që ke zbritur në librin Tënd, qoftë nga ata emra që ke lënë në të padukshmen te Ti, që Kuranin të ma bësh flladin e zemrës dhe dritën e kraharorit dhe nëpërmjet atij, të më largosh brengën dhe pikëllimin!³⁷¹

Lutje në kohë të vështirë

Hazret Rifa'a Zerki^{fa} tregon se në betejën e Uhudit, pasi mohuesit u kthyen, i Dërguari i Allahut^{sas} u tha muslimanëve: Rreshtohuni dhe lavdërojeni Zotin tim. Sahabët u rreshtuan pas Profetit^{sas} dhe ai bërë këtë lutje:

371. El-Muxhamul-kebir, vëll. 10, f. 169.

اللَّهُمَّ لَكَ الْحَمْدُ كُلُّهُ اللَّهُمَّ لَا قَابِضَ لِمَا بَسَطْتَ وَلَا بَاسِطَ لِمَا
قَبَضْتَ وَلَا هَادِيَ لِمَا أَضَلَلْتَ وَلَا مُضِلَّ لِمَنْ هَدَيْتَ وَلَا مُعْطَى
لِمَا مَنَعْتَ وَلَا مَانِعَ لِمَا أَعْطَيْتَ وَلَا مُقَرَّبَ لِمَا بَاعَدْتَ وَلَا مُبَاعَدَ لِمَا
قَرَّبْتَ اللَّهُمَّ ابْسُطْ عَلَيْنَا بَرَكَاتِكَ وَرَحْمَتَكَ وَفَضْلَكَ وَرِزْقَكَ اللَّهُمَّ
إِنِّي أَسْأَلُكَ النَّعِيمَ الْمُقِيمَ الَّذِي لَا يَحُولُ وَلَا يَزُولُ اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ
النَّعِيمَ يَوْمَ الْعِيَلَةِ وَالْأَمْنِ يَوْمَ الْخَوْفِ اللَّهُمَّ إِنِّي عَائِدُ بِكَ مِنْ شَرِّ
مَا أَعْطَيْتَنَا وَشَرِّ مَا مَنَعْتَ اللَّهُمَّ حَبِّبِ إِلَيْنَا الْإِيمَانَ وَزَيِّنْهُ فِي قُلُوبِنَا
وَكَرِّهْ إِلَيْنَا الْكُفْرَ وَالْفُسُوقَ وَالْعِصْيَانَ وَأَجْعَلْنَا مِنَ الرَّاشِدِينَ اللَّهُمَّ تَوَفَّنَا
مُسْلِمِينَ وَأَحْبِبْنَا مُسْلِمِينَ وَأَلْحِقْنَا بِالصَّالِحِينَ غَيْرَ خَزَايَا وَلَا مَفْتُونِينَ
اللَّهُمَّ قَاتِلِ الْكُفْرَ وَالَّذِينَ يَكْفُرُونَ بِرُسُلِكَ وَيَصُدُّونَ عَن سَبِيلِكَ
وَأَجْعَلْ عَلَيْهِمْ رِجْزَكَ وَعَذَابَكَ اللَّهُمَّ قَاتِلِ الْكُفْرَةَ الَّذِينَ أَوْتُوا الْكِتَابَ
أَنَّهُ الْحَقُّ.

O Allah! E gjithë lavdia është e Jotja! O Allah! Askush nuk mund ta shtrëngojë atë që Ti i ke dhënë liri dhe askush nuk mund t'i japë liri atij që ti e ke shtrënguar. Askush nuk mund ta udhëzojë atë që Ti e ke devijuar dhe askush nuk mund ta devijojë atë që Ti e ke udhëzuar. Askush nuk mund t'i japë atij që Ti ia ke ndaluar dhe askush nuk mund ta ndalojë atë që Ti ia ke dhënë. Askush nuk mund ta afrojë atë që Ti e ke larguar dhe askush nuk mund ta largojë atë që Ti e ke afruar.

O Allah! Na fal bekimet e Tua, mëshirën Tënde, mirësinë Tënde dhe riskun Tënd. O Allah! Të kërkoj bekimin e qëndrueshëm që nuk kufizohet e nuk shteron. O Allah! Të kërkoj bekimin në ditën e skamjes dhe paqen në ditën e frikës.

O Allah! Më mbro nga e keqja e asaj që na ke dhënë dhe nga e keqja e asaj që nuk na ke dhënë. O Allah! Bëje besimin të pëlqyeshëm për ne, zbukuroje atë në zemrat tona, kurse mohimin, pabindshmërinë dhe mëkatet bëji të papëlqyeshme për ne dhe na bëj të udhëzuar.

O Allah! Na jep vdekje kur jemi muslimanë, na ringjall muslimanë dhe na bashko me të sinqertët! Mos na turpëro dhe mos na sprovo! O Allah! Vriti mohuesit që kundërshtojnë të dërguarit e Tu dhe i pengojnë (njerëzit) nga rruga Jote. Shtrëngoji dhe ndëshkoji! O Allah! Vriti edhe ata mohues që u është dhënë libri që ua tregon të vërtetën!³⁷²

Lutje për mbrojtjen e Islamit dhe për të kërkuar mirësi

Hazret Abdullah Ibni Mesudi^{ra} na përcjell këtë lutje të të Dërguarit të Allahut^{sas}:

اللَّهُمَّ احْفَظْنِي بِالْإِسْلَامِ قَائِمًا، واحْفَظْنِي بِالْإِسْلَامِ قَاعِدًا، واحْفَظْنِي
بِالْإِسْلَامِ رَاقِدًا، وَلَا تُشْمِتْ بِي عَدُوًّا حَاسِدًا، اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ مِنْ
كُلِّ خَيْرٍ خَزَائِنُهُ بِيَدِكَ وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ كُلِّ شَرٍّ خَزَائِنُهُ بِيَدِكَ

O Allah! Më mbro përmes Islamit kur qëndroj. Më mbro përmes Islamit kur ulem. Më mbro përmes Islamit kur fle. Mos i jep mundësi armikut xheloz të më poshtërojë. O Allah! Të kërkoj çdo të mirë, thesaret e së cilës i ke Ti në dorë dhe më mbro nga çdo e keqe, thesaret e së cilës i ke Ti në dorë!³⁷³

372. Musned Ahmed, vëll. 3, f. 424.

373. Mustadrik Hakim, vëll. 1, f. 525.

Lutje për besim, shëndet dhe virtyte të larta

Hazret Ebu Hurejrah^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} i tha Selman Farsiut^{ra}: Dua që të të mësoj një lutje, të cilën ta bësh ditë e natë me përkushtim të veçantë ndaj Zotit të Gjithëmëshirshëm. Ajo lutje është:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ صِحَّةً فِي إِيمَانٍ، وَإِيمَانًا فِي حُسْنِ خُلُقٍ وَنَجَاحًا
يَتَّبِعُهُ فَالَاحُ، وَرَحْمَةً مِنْكَ وَعَافِيَةً، وَمَغْفِرَةً مِنْكَ وَرِضْوَانًا.

O Allah! Të kërkoj shëndetin në besim; besimin me virtyte të bukura, suksesin pas suksesit, mëshirën prej Teje dhe qetësinë; faljen prej Teje dhe pëlqimin.³⁷⁴

Lutje për të kërkuar falje dhe mëshirë

Hazret Ebu Musa Eshariji^{ra} na përcjell këtë lutje të të Dërguarit të Allahut^{sas}:

رَبِّ اغْفِرْ لِي خَطِيئَتِي وَجَهْلِي، وَأَسْرَافِي فِي أَمْرِي كُلِّهِ، وَمَا أَنْتَ
أَعْلَمُ بِهِ مِنِّي، اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي خَطَايَايَ وَعَمْدِي وَجَهْلِي وَهَزْلِي وَكُلُّ
ذَلِكَ عِنْدِي، اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي مَا قَدَّمْتُ وَمَا أَخَّرْتُ، وَمَا أَسْرَرْتُ وَمَا
أَعْلَنْتُ، أَنْتَ الْمُقَدِّمُ، وَأَنْتَ الْمُؤَخِّرُ، وَأَنْتَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ.

O Zoti im! Më fal gabimet e mia, paditurinë time, teprimin tim në çdo çështje që Ti e di më mirë se unë. O Allah! Më fal gabimet që kam bërë me vetëdije apo pavetëdije, shakatë e mia të padenja dhe çdo gjë që kam bërë!

374. Mustadrik Hakim, vëll. 1, f. 523.

O Allah! Më fal mëkatet që kam bërë në të kaluarën dhe që do të bëj në të ardhmen, që i kam fshehur apo i kam zbuluar! Ti je Përparuesi, Ti je Tërheqësi dhe për çdo gjë Ti je i Plotfuqishëm.³⁷⁵

Një lutje me shumë ndikim për të kërkuar falje

Hazret Hilal Ibni Jesari^{ra} ka dëgjuar prej gjyshit të tij që, kushdo që i kërkon falje Zotit me anë të kësaj lutjeje, Allahu do t'ia falë mëkatet, edhe sikur ato të jenë sa shkuma e detit:

أَسْتَغْفِرُ اللَّهَ الَّذِي لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ وَأَتُوبُ إِلَيْهِ-

I kërkoj falje Allahut. Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Atij, të Gjallit, të Qëndrueshmit. Unë kthehem i penduar tek Ai.³⁷⁶

Një lutje shumë e bukur për të kërkuar falje për mëkatet

Hazret Xhabiri^{ra} tregon: Një njeri erdhi tek i Dërguari i Allahut^{sas} dhe tha: Mëkatet e mia janë të pafundme! I Dërguari i Allahut^{sas} e bëri që ta përsëriste tri herë këtë lutje dhe më pas i tha: “Mund të çohesh. Zoti t'i ka falur mëkatet”. Ajo lutje është:

اللَّهُمَّ مَغْفِرَتِكَ أَوْسَعُ مِنْ ذُنُوبِي وَرَحْمَتِكَ أَرْجَى مِنْ عَمَلِي-

O Allah! Falja Jote është më e madhe sesa mëkatet e mia dhe mëshira Jote është më shpresëdhënëse sesa vepra ime.³⁷⁷

375. Buhariu, Kitabud-da'vat, bab keulin-Nebij^{sas} “Allahumag-firli”.

376. Ebu Daud, Kitabul-vitr, bab fil-istigfar.

377. Mustadrik Hakim, vëll. 1, f. 728.

Lutje për mëshirë dhe falje

Hazret Ajshja^{ra} na përcjell këtë lutje të të Dërguarit të Allahut^{sas}:

اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي، وَارْحَمْنِي، وَالْحَقْنِي بِالرَّفِيقِ الْأَعْلَى -

O Allah! Më fal, më mëshiro dhe më bashko me Mikun më të Madh.³⁷⁸

Shënim: Sipas disa rrëfimeve, në ditët e fundit të jetës së tij, i Dërguari i Allahut^{sas} vazhdimisht thoshte pjesën e fundit të kësaj lutjeje, që është:

إِلَى الرَّفِيقِ الْأَعْلَى -

Po shkoj drejt Mikut më të Madh!

Lutje për të kërkuar falje

Hazret Amr Ibni Shuejbi^{ra} ka dëgjuar gjyshin e tij duke thënë: Hazret Xhibraili^{as} ishte shumë i gëzuar kur zbriti dhe solli këtë lutje nga qielli. Ai i erdhi Profetit^{sas} dhe i tha: O Muhammed! Allahu i Madhërishëm më ka dërguar me një dhuratë për ty, e cila është një thesar i arshit në formën e kësaj lutjeje:

يَا مَنْ أَظْهَرَ الْجَمِيلَ وَسَتَرَ الْقَبِيحَ، يَا مَنْ لَا يُؤَاخِذُ بِالْجُرَيْرَةِ وَلَا يَهْتِكُ
السِّرَّ، يَا حَسَنَ التَّجَاوُزِ، يَا وَاسِعَ الْمَغْفِرَةِ، يَا بَاسِطَ الْيَدَيْنِ بِالرَّحْمَةِ، يَا
صَاحِبَ كُلِّ نَجْوَى، يَا مُنْتَهَى كُلِّ شَكْوَى، يَا كَرِيمَ الصَّفْحِ
يَا عَظِيمَ الْمَنِّ، يَا مُبْتَدَى النِّعَمِ، قَبْلَ اسْتِحْقَاقِهَا، يَا رَبَّنَا وَيَا سَيِّدَنَا وَيَا
مَوْلَانَا، وَيَا غَايَةَ رَغْبَتِنَا، أَسْأَلُكَ يَا اللَّهُ أَنْ لَا تَشْوَى خَلْقِي بِالنَّارِ -

378. Buhariu, Kitabul-magazi, bab mardin-Nebij^{sas}

O Ti që shfaq të bukurën dhe mbulon të shëmtuarën! O Ti që nuk e kap gjynahqarin dhe nuk e zbulon atë. O Toleruesi më i mirë! O Falës i madh! O Mëshirues krahëhapur! O Shoqëruesi i çdo pëshpërtitjeje! O Pikëdorëzimi i çdo ankese! O Bujar në falje! O i Madhërishëm në mirësi! O Nismëtari i bekimeve, përpara se ato të përcaktohen. O Zoti ynë! O Udhëheqësi ynë! O Miku ynë! O Kulmi i dëshirave tona. Të kërkoj, o Allah, të mos ma djegësh trupin me zjarr!³⁷⁹

Lutje për të shpëtuar nga e keqja

(1) Hazret Imran Ibni Hesini^{ra} rrëfen: I Dërguari i Allahut^{sas} i kishte premtuar babait tim idhujtar që, nëse do të bëhej musliman, do t'i mësonte lutje shumë të dobishme. Babai im kur u bë musliman ia kujtoi premtimin Profetit^{sas}. Atëherë Profeti^{sas} i mësoi këtë lutje:

اللَّهُمَّ الْهَمْنِي رُشْدِي وَأَعِزَّنِي مِنْ شَرِّ نَفْسِي -

O Allah! Më dikto udhëzimin dhe më mbro nga e keqja e vetvetes.³⁸⁰

(2) Hazret Shekl Ibni Hamidi^{ra} rrëfen: I kërkoja të Dërguarit të Allahut^{sas} që të më mësonte ndonjë lutje për t'u larguar nga të këqijat. Ai më kapi për dore dhe më këshilloi të bëja këtë lutje:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ سَمْعِي، وَمِنْ شَرِّ بَصَرِي، وَمِنْ شَرِّ لِسَانِي
، وَمِنْ شَرِّ قَلْبِي، وَمِنْ شَرِّ هَيْئِي

379. Mustadrik Hakim, Kitabud-dua, vëll. 1, f. 545.

380. Tirmidhiu, Kitabud-da'vat, bab 70.

O Allah! Mbromë nga e keqja e dëgjimit tim, nga e keqja e shikimit tim, nga e keqja e gjuhës sime, nga e keqja e zemrës sime dhe nga e keqja e organit gjenital.³⁸¹

Lutje për të shpëtuar nga ndikimet e shejtanit

Hazret Ebu Hurejrah^{ra} na informon se në ngjarjen e udhëtimit “Isra”, një shejtan i frikshëm me zjarr në dorë po ndiqte të Dërguarin e Allahut^{sas}. Hazret Xhibraili^{as} i mësoi Profetit^{sas} një lutje duke thënë: Me këtë lutje, zjarri i shejtanit do të shuhet dhe ai do të rrëzohet. Ajo lutje është:

أَعُوذُ بِوَجْهِهِ اللَّهُ الْكَرِيمِ، وَبِكَلِمَاتِ اللَّهِ التَّامَّاتِ الَّتِي لَا يُجَاوِزُهُنَّ بَرٌّ وَلَا
فَاجِرٌ، وَمِنْ شَرِّ مَا يَنْزِلُ مِنَ السَّمَاءِ، وَشَرِّ مَا يَعْرُجُ فِيهَا، وَشَرِّ مَا دَرَأَ فِي
الْأَرْضِ، وَشَرِّ مَا يَخْرُجُ مِنْهَا، وَمِنْ فِتَنِ اللَّيْلِ وَالنَّهَارِ، وَمِنْ طَوَارِقِ اللَّيْلِ
إِلَّا طَارِقًا يَطْرُقُ بِخَيْرٍ يَا رَحْمَنُ-

Kërkoj mbrojtjen e Fytyrës së Allahut Bujar dhe të fjalëve të Tij të përsosura, të cilat nuk i tejkalon dot asnjë i mirë dhe asnjë i lig, nga e keqja e çdo gjëje që zbret prej qiellit dhe nga e keqja e çdo gjëje që ngjitet në të, nga e keqja e çdo gjëje që Ai ka krijuar në Tokë dhe nga e keqja e çdo gjëje që del nga ajo. O i Gjithëmëshirshëm! Më mbro nga trazirat e natës dhe të ditës dhe nga ndodhitë e natës, përveç asaj ndodhie që është e mbarë!³⁸²

381. Ebu Daudi, Kitabul-vitr, bab fil-istiadha.

382. Muata Imam Malik, Kitabul-xhami³, bab ma ja'muru bihi minet-tavudh.

Lutje për të shpëtuar nga e keqja e armikut

Hazret Ebu Hurejrah^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} kur ndiente rrezik nga ndonjë popull, lutej:

اللَّهُمَّ إِنَّا نَجْعَلُكَ فِي نُحُورِهِمْ وَنَعُوذُ بِكَ مِنْ شُرُورِهِمْ-

O Allah! Ty të vëmë përballë gjithë asaj që ata kanë në kraharorët e tyre dhe Ty të kërkojmë mbrojtje nga sherret e tyre.³⁸³

Lutje për të shpëtuar nga veset

(1) Hazret Zijad Ibni Alaka^{ra} na përcjell këtë lutje të të Dërguarit të Allahut^{sas}:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ مُنْكَرَاتِ الْأَخْلَاقِ وَالْأَعْمَالِ وَالْأَهْوَاءِ-

O Allah! Më mbro nga të këqijat e veseve, të veprave dhe të dëshirave!³⁸⁴

(2) Hazret Ebu Hurejrah^{ra} na tregon këtë lutje të të Dërguarit të Allahut^{sas}:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الشِّقَاقِ وَالنِّفَاقِ وَسُوءِ الْأَخْلَاقِ-

O Allah! Më mbro nga përçarja, nga hipokrizia dhe nga veset e këqija.³⁸⁵

383. Ebu Daud, Kitabul-vitr, bab ma jekulu idha khafa keuman.

384. Tirmidhiu, Kitabud-da'vat, bab duai umi selma.

385. Ebu Daud, Kitabul-vitr, bab fil-istiadha.

Një lutje e veçantë

Hazret Muadh Ibni Xhebel^{ra} rrëfen: Një ditë në namazin e sabahut i Dërguari i Allahut^{sas} erdhi kaq vonë, saqë ishte afruar koha e lindjes së diellit. Na e udhëhoqi namazin nxitimthi dhe më pas tha: “Qëndroni në vendet tuaja!” Më pas na u drejtua: Dua t’ju tregoj shkakun pse u vonova për të ardhur në namaz.

Natën u zgjova për *tehexhudin* dhe e fala aq sa kisha mundësi. Gjatë namazit më mori gjumi. Kur hapa sytë, pashë Zotin tim me një fytyrë jashtëzakonisht të bukur. Allahu më tha: “O Muhammed! A e di se për çfarë po debatojnë engjëjt?” “Nuk e di”, iu përgjigja. Allahu sërish më bëri të njëjtën pyetje dhe unë i dhashë të njëjtën përgjigje. Më pas pashë që Allahu i Madhërishëm vuri shputën e dorës së Vet mbi supin tim, derisa ndjeva freskinë e saj në kraharor dhe pastaj mua m’u qartësua çdo gjë.

Pastaj Allahu më pyeti: “O Muhammed! A e di se për çfarë po debatojnë engjëjt?” “Për shpërblesat” iu përgjigja. “Çfarë janë shpërblesat?” (që shlyejnë mëkatet), më pyeti Allahu. I thashë: “Ecja drejt xhamisë për të falur namazin me xhemat, qëndrimi në xhami pas namazit duke përkujtuar Allahun dhe marrja e plotë e abdesit, edhe pse nuk e do zemra”. Më pas Allahu më pyeti: “Çfarë janë nivelet?” I thashë: Të ushqej dikë, të flas me fjalë të buta dhe të fal namaz në kohën kur të tjerët janë në gjumë”. Allahu më tha: “Më kërko çfarë të duash”. Atëherë bëra këtë lutje.

I Dërguari i Allahut^{sas} gjithashtu tha: **“Kjo lutje është e vërtetë. Mësojeni edhe ju dhe mësojuani edhe të tjerëve”**. Ajo lutje është:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ فِعْلَ الْخَيْرَاتِ، وَتَرْكَ الْمُنْكَرَاتِ، وَحُبَّ
الْمَسَاكِينِ، وَأَنْ تَغْفِرَ لِي وَتَرْحَمَنِي، وَإِذَا أَرَدْتَ فِتْنَةً فِي قَوْمٍ فَتَوَفَّنِي
غَيْرَ مَفْتُونٍ، وَأَسْأَلُكَ حُبَّ مَنْ يُحِبُّكَ، وَحُبَّ عَمَلٍ يُقَرِّبُنِي إِلَى
حُبِّكَ

O Allah! Të kërkoj mundësinë për të bërë të mira, për të hequr dorë nga të ndaluarat, dashurinë ndaj të varfërve dhe (Të kërkoj) të më falësh e të më mëshirosh. Kur vendos të futësh popullin në trazirë, të ma marrësh shpirtin përpara se t'i vijë trazira. Të kërkoj dashurinë e atij që të do Ty dhe dashurinë e asaj vepre që më afron drejt dashurisë Sate.³⁸⁶

Lutje për të kërkuar mirësi dhe për t'u mbrojtur nga të këqijat

Hazret Enes Ibni Maliku^{ra} tregon këtë lutje të të Dërguarit të Allahut^{sas}:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ مِنَ الْخَيْرِ كُلِّهِ، مَا عَلِمْتُ مِنْهُ وَمَا لَمْ أَعْلَمْ وَأَعُوذُ
مِنَ الشَّرِّ كُلِّهِ مَا عَلِمْتُ مِنْهُ وَمَا لَمْ أَعْلَمْ -

O Allah! Të kërkoj çdo mirësi, edhe atë që e di, edhe atë që nuk e di dhe të kërkoj mbrojtje nga çdo e keqe, edhe nga ajo që e di, edhe nga ajo që nuk e di.³⁸⁷

386. Musned Ahmed, vëll. 5, f. 243.

387. Kitabud-dua, lit-TIbrani, vëll. 3, f. 1468.

Lutje për t'u ruajtur nga *shirku*

Hazret Ebu Musa Eshariji^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} tha: “Ruhuni nga *shirku*, sepse ai është më i imët se gjurmët e këmbëve të milingonës”. Sahabët e pyetën: “Si mund të ruhemi nga ai, o i Dërguari i Allahut?” Ai iu përgjigj: “Bëni këtë lutje:

اللَّهُمَّ إِنَّا نَعُوذُ بِكَ مِنْ أَنْ نُشْرِكَ بِكَ شَيْئًا نَعْلَمُهُ وَنَسْتَغْفِرُكَ لِمَا لَا نَعْلَمُ -

O Allah! Të kërkojmë mbrojtje që të mos barazojmë diçka me Ty, edhe nëse e njohim, edhe nëse nuk e njohim, dhe të kërkojmë falje për atë që nuk e dimë.³⁸⁸

Lutje për të shpëtuar nga zemërimi i Zotit

Hazret Abdullah Ibni Amri^{ra} tregon këtë lutje të të Dërguarit të Allahut^{sas}:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ زَوَالِ نِعْمَتِكَ، وَتَحَوُّلِ عَافِيَتِكَ وَفُجْأَةِ تَقَمَّتِكَ وَجَمِيعِ سُخْطِكَ -

O Allah! Të kërkoj mbrojtje nga largimi i bekimit Tënd, nga largimi i shëndetit që kam prej Teje, nga ndëshkimi i beftë prej Teje dhe nga të gjitha mospëlqimet e Tua.³⁸⁹

388. Musned Ahmed, vëll. 4, f. 403.

389. Muslimi, Kitaburr-rikak, bab ektharu ahlil-xheneti el-fukara.

Një lutje e përsosur për të hyrë në mbrojtjen e Zotit

Hazret Kab El-ahbari tregon këtë lutje të të Dërguarit të Allahut^{sas}:

أَعُوذُ بِوَجْهِ اللَّهِ الْعَظِيمِ الَّذِي لَيْسَ شَيْءٌ أَعْظَمُ مِنْهُ وَيَكَلِمَاتِ اللَّهِ
التَّامَّاتِ الَّتِي لَا يُجَاوِزُهُنَّ بَرٌّ وَلَا فَاجِرٌ وَبِاسْمَاءِ اللَّهِ الْحُسْنَى مَا عَلِمْتُ
مِنْهَا وَمَا لَمْ أَعْلَمْ مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ وَذَرَأَ، وَبَرًّا -

Kërkoj mbrojtjen e Fytyrës së Allahut të Madhërishëm, nga i cili nuk ka asgjë të madhe dhe kërkoj mbrojtjen e fjalëve të përsosura të Allahut, të cilat nuk i tejkalon dot asnjë i mirë dhe asnjë i ligë dhe kërkoj mbrojtjen e emrave të bukur të Allahut, të emrave që i di dhe të emrave që nuk i di, nga e keqja e gjithçkaje që ka krijuar, ka përhapur dhe ka formuar Ai.³⁹⁰

Lutje për t'u mbrojtur nga veset

Hazret Abdullah Ibni Amri^{ra} thotë se i Dërguari i Allahut^{sas} bënte këtë lutje:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ قَلْبٍ لَا يَخْشَعُ، وَمِنْ دُعَاءٍ لَا يُسْمَعُ وَمِنْ نَفْسٍ
لَا تَسْمَعُ، وَمِنْ عِلْمٍ لَا يَنْفَعُ، أَعُوذُ بِكَ مِنْ هَوْلَاءِ الْأَرْبَعِ -

O Allah! Më mbro nga zemra që nuk përgjërohet, nga lutja që nuk dëgjohet, nga nefsia që nuk ngopet, nga dija që nuk më bën dobi! Mbromë nga këto të katërta!³⁹¹

390. Muata Imam Malik, Kitabul-xhami' bab ma ja'muru bihi minet-tavudh.

391. Tirmidhiu, Kitabud-da'vat, bab 69.

Lutje për t'u mbrojtur nga veset

Hazret Umi Ma'bedi^{ra} tregon se ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut^{sas} duke bërë këtë lutje:

اللَّهُمَّ طَهِّرْ قَلْبِي مِنَ النِّفَاقِ، وَعَمَلِي مِنَ الرِّيَاءِ، وَلِسَانِي مِنَ الكَذِبِ،
وَعَيْنِي مِنَ الخِيَانَةِ، فَإِنَّكَ تَعْلَمُ خَائِنَةَ الْأَعْيُنِ وَمَا تُخْفِي الصُّدُورُ-

O Allah! Ma pastro zemrën nga hipokrizia, veprën nga dukja, gjuhën nga gënjeshtria, syrin nga tradhtia, sepse Ti e di tradhtinë e syve, si dhe atë që e fshehin zemrat.³⁹²

Lutje për të shpëtuar nga aksidentet

Hazret Ebul Jesri^{ra} tregon këtë lutje të të Dërguarit të Allahut^{sas}:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْهَدَمِ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنَ التَّرْدَىٰ وَمِنَ الْغَرْقِ
وَالْحَرْقِ وَالْهَرَمِ، وَأَعُوذُ بِكَ أَنْ يَتَّخِطَّنِي الشَّيْطَانُ عِنْدَ الْمَوْتِ
وَأَعُوذُ بِكَ أَنْ أَمُوتَ فِي سَبِيلِكَ مُدْبِرًا وَأَعُوذُ بِكَ أَنْ أَمُوتَ لَدِيْعًا-

O Allah! Më mbro nga shtypja! Më mbro nga rrëzimi, nga mbytja, nga djegia, nga vdekja në pleqëri të vonë! Të kërkoj mbrojtje që shejtani të mos më pushtojë gjatë vdekjes. Të kërkoj mbrojtje të mos vdes në rrugën Tënde duke treguar kurrizin dhe të kërkoj mbrojtje nga pickimi vdekjeprurës i kafshëve helmuese.³⁹³

Lutje për t'u mbrojtur nga uria dhe mashtrimi

Hazret Ebu Hurejrah^{ra} tregon këtë lutje të të Dërguarit të Allahut^{sas}:

392. Kenzul-umal, vëll. 2, f. 184.

393. Musned Ahmed, vëll. 3, f. 427.

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْجُوعِ، فَإِنَّهُ بِمَسِّ الضَّجِيعِ وَأَعُوذُ بِكَ مِنَ
الْخِيَانَةِ، فَإِنَّهَا بِمَسِّ الْبِطَانَةِ۔

O Allah! Më mbro nga uria, sepse ajo është shoqja më e keqe dhe më mbro nga mashtrimi, sepse ai është më i keqi ndër shokët e ngushtë.³⁹⁴

Lutje për umetin për udhëtimet në mëngjes

Hazret Sahrul Gamdi^{ra} tregon këtë lutje të të Dërguarit të Allahut^{sas}:

اللَّهُمَّ بَارِكْ لِأُمَّتِي فِي بُكُورِهَا۔

O Allah! Bekoje umetin tim në udhëtimet e tij të mëngjesve.³⁹⁵

Lutje për të kërkuar falje për muhaxhirët (mekasit) dhe për ensarët (medinasit)

Hazret Enes Ibni Maliku^{ra} përcjell këtë lutje të të Dërguarit të Allahut^{sas}:

اللَّهُمَّ لَا عَيْشَ إِلَّا عَيْشُ الْآخِرَةِ فَاعْفِرِ الْأَنْصَارَ وَالْمُهَاجِرَةَ۔

O Allah! Nuk ka jetë përveç jetës së ahiretit. Fali ensarët dhe muhaxhirët!³⁹⁶

Lutje për mposhtjen e armikut në betejën e Hendekut

Hazret Abdullah Ibni Ebi Eufa^{ra} tregon këtë lutje të të Dërguarit të Allahut^{sas}, që ai kishte bërë në betejën e Hendekut:

394. Ebu Daud, Kitabul-vitr, bab fil-istiadha.

395. Ebu Daud, Kitabul-xihad, bab fil-ibtikari fis-safr.

396. Buhariu, Kitab fadlis-sahaba, bab duain-Nebij^{sas} lil-ensar.

اللَّهُمَّ مُنْزِلَ الْكِتَابِ، سَرِيعَ الْحِسَابِ إِهْزِمِ الْأَحْزَابَ اللَّهُمَّ اهْزِمْهُمْ
وَوَزِّلْ لَهُمْ-

O Allah, që dërgove librin, që kërkon llogari të shpejtë! Mundi këto ushtri! O Allah! Mposhti dhe tronditi fort!³⁹⁷

Lutje për ushqimin e familjes së Profetit dhe të umetit

Hazret Ebu Hurejrah^{ra} tregon këtë lutje të të Dërguarit të Allahut^{sas}:

اللَّهُمَّ اجْعَلْ رِزْقَ آلِ مُحَمَّدٍ فِي الدُّنْيَا قُوْتًا

O Allah! Popullit të Muhammedit në këtë botë, jepi risk sa për të mbijetuar.³⁹⁸

Lutje në mbështetje të kalifëve dhe udhëheqësve të umetit

(1) Hazret Aliu^{ra} rrëfen këtë lutje të të Dërguarit të Allahut^{sas} në mbështetje të kalifëve që do të vinin pas tij:

اللَّهُمَّ ارْحَمْ خُلَفَائِي الَّذِينَ يَأْتُونَ مِنْ بَعْدِي يَرُؤُونَ أَحَادِيثِي وَسُنَّتِي
وَيُعَلِّمُونَهَا النَّاسَ-

O Allah! Mëshiroji kalifët (zëvendësit) e mi që do të vijnë pas meje, që do t'ua tregojnë e do t'ua mësojnë njerëzve fjalët dhe praktikën time.³⁹⁹

(2) Hazret Ajshja^{ra} rrëfen këtë lutje të të Dërguarit të Allahut^{sas} në mbështetje të udhëheqësve të sinqertë të umetit:

397. Buhariu, Kitabud-da'vat, bab dua alev-mushrikin.

398. Muslimi, Kitabuz-zekat, bab fil-kafaf.

399. Xhamius-saghir, lis-Sujuti, pj. 1, f. 5125.

اللَّهُمَّ مَنْ وَلِيَ مِنْ أَمْرِ أُمَّتِي شَيْئاً فَشَقَّ عَلَيْهِمْ فَاشْتَقُّ عَلَيْهِ، وَمَنْ وَلِيَ
مِنْ أَمْرِ أُمَّتِي شَيْئاً فَفَرَّقَ بِهِمْ فَارْفُقْ بِهِ-

O Allah! Ai që bëhet udhëheqës në ndonjë çështje të umetit tim dhe i shtrëngon muslimanët, edhe Ti shtrëngoje atë dhe ai që bëhet udhëheqës në ndonjë çështje të umetit tim dhe tregohet i butë ndaj tyre, edhe Ti tregohu i butë ndaj tij.⁴⁰⁰

Lutje përgjëruese e Profetit Muhammed^{sas} gjatë udhëtimit për në Taif

Hazret Abdullah Ibni Xhaferi^{ra} tregon se pas vdekjes së Ebu Talibit, i Dërguari i Allahut^{sas} shkoi te banorët e Taifit për t'u bërë thirrje drejt Islamit, të cilën ata nuk e pranuan. I Dërguari i Allahut^{sas} qëndroi nën hijen e një peme, fali dy rekate namaz dhe iu lut Zotit të Madhërishtëm me shumë përgjërim:

اللَّهُمَّ إِلَيْكَ أَشْكُو ضِعْفَ قُوَّتِي، وَقِلَّةَ حِيلَتِي وَهَوَانِي عَلَى النَّاسِ، يَا
أَرْحَمَ الرَّاحِمِينَ إِلَى مَنْ تَكَلَّمْتَنِي؟ إِلَى عَدُوِّ يَتَجَهَّمُنِي أَمْ إِلَى قَرِيبٍ
مَلَكَتَهُ أَمْرِي؟ إِنْ لَمْ تَكُنْ سَاخِطًا عَلَيَّ فَلَا أَبَالِي، غَيْرَ أَنَّ عَافِيَتَكَ أَوْسَعُ
لِي أَعْوَدُ بِنُورِ وَجْهِكَ الْكَرِيمِ الَّذِي أَضَاءَتْ لَهُ السَّمَوَاتُ وَالْأَرْضُ،
وَأَشْرَقَتْ لَهُ الظُّلُمَاتُ، وَصَلَحَ عَلَيْهِ أَمْرُ الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ، أَنْ تَجَلَّ عَلَيَّ
غَضَبُكَ أَوْ تَنْزِلَ عَلَيَّ سَخَطُكَ، وَلَكَ الْعُتْبَى حَتَّى تَرْضَى وَلَا حَوْلَ وَلَا
قُوَّةَ إِلَّا بِكَ -

O Allah! Ty të ankojem për dobësinë time, për dobësinë e planeve të mia dhe për shpërfilljen e njerëzve ndaj meje. O më i Mëshirshmi nga të gjithë mëshiruesit! Te kush do të më

400. Muslimi, Kitabul-amarah, bab fadilatil-imamil-adil.

lësh mua? Te ndonjë armik, që më shkatërron tërësisht, apo te ndonjë i afërm që më pushton në çdo çështje?

Nëse nuk je zemëruar me mua, nuk shqetësohem fare. Mëshira Jote është më e shtrenjta për mua. Kërkoj mbrojtjen e dritës së fytyrës Sate bujare, që ndriçoi qiejt dhe Tokën, që largoi errësitat dhe rregulloi çështjen e botës dhe të ahiretit, të mos më përfshijë zemërimi Yt, të mos bjerë mbi mua pakënaqësia Jote. Bëje atë që dëshiron. Sundim dhe fuqi s'ka askush tjetër përveç Teje.⁴⁰¹

Një lutje e çuditshme për të qenë i varfër

Hazret Ebu Hurejrah^{ra} tregon këtë lutje të të Dërguarit të Allahut^{sas}:

اللَّهُمَّ أَحْيِنِي بِسُكِينًا وَتَوَفَّنِي بِسُكِينًا وَأَحْشُرْنِي فِي زُرَّةِ الْمَسَاكِينِ
وَإِنَّ أَسْقَى الْأَشْقِيَاءِ مَنْ اجْتَمَعَ عَلَيْهِ فَقْرُ الدُّنْيَا وَعَذَابُ الْآخِرَةِ-

O Allah! Më mbaj gjallë të varfër. Më jep vdekje me të varfrit. Më ringjall me grupin e të varfërve. Pa dyshim, më fatligu është ai që mbledh edhe varfërinë e botës, edhe ndëshkimin e ahiretit.⁴⁰²

Lutje për t'u bërë rob i veçantë i Zotit të Madhërishëm

Delegacioni i Abdul Kejsit (që kishte ardhur në Medinë nga Jemeni), tregon se ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut^{sas} duke bërë këtë lutje:

اللَّهُمَّ اجْعَلْنَا مِنْ عِبَادِكَ الْمُنتَحِبِينَ الْغُرِّ الْمُحَجَّلِينَ الْوَفْدِ الْمُتَقَبَّلِينَ-

O Allah! Na bëj prej robërve të Tu të zgjedhur, prej ballëndriturve, prej grupit të pranuar.⁴⁰³

401. Kitabud-dua, lit-Tibrani, vëll. 2, f. 1280.

402. Tirmidhiu, Kitabuz-zuhd, bab inel-fukara el-muhaxhirin.

403. Musned Ahmed, vëll. 3, f. 431.

Anëtarët e delegacionit tregojnë: “Kemi pyetur të Dërguarin e Allahut se cilët ishin robërit e zgjedhur? Ai na u përgjigj: Robërit e sinqertë e të dëlirë të Zotit dhe ballëndriturit janë ata që u shkëlqejnë gjymtyrët për shkak të abdesit, kurse grupi i pranuar përbëhet nga ata njerëz të këtij umeti, që do të paraqiten para Zotit bashkë me Profetin e tyre”.

Lutje duke përmendur emrin më të bekuar të Zotit të Madhërishëm

Hazret Ajshja^{ra} ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut^{sas} duke bërë këtë lutje:

اللَّهُمَّ بِاسْمِكَ الطَّاهِرِ الطَّيِّبِ الْمُبَارَكِ الْأَحَبِّ إِلَيْكَ الَّذِي إِذَا
دُعِيتَ بِهِ أَجَبْتَ وَإِذَا سُئِلْتَ بِهِ أَعْطَيْتَ وَإِذَا اسْتَرْجَمْتَ بِهِ رَحِمْتَ
وَإِذَا اسْتَفْرَجْتَ بِهِ فَرَجْتَ -

O Allah! Po të lutem në saje të emrit Tënd të pastër, të dëlirë, të bekuar, të dashur për Ty, me të cilin kur njeriu të lutet, i përgjigjesh; kur të kërkon diçka, ia jep; kur të kërkon mëshirë, e mëshiron; dhe kur të kërkon t’i plotësosh ndonjë nevojë, ia plotëson.⁴⁰⁴

Një lutje e përsosur

Hazret Ebu Umama^{ra} thotë se i Dërguari i Allahut^{sas} erdhi në takimin tonë. Ne u çuam për respekt ndaj tij dhe i kërkuam që të lutet për ne. Ai u lut. I kërkuam që të lutet edhe më shumë. Na tha që në këtë lutje ju janë mbledhur të gjitha lutjet:

اللَّهُمَّ اغْفِرْ لَنَا وَارْحَمْنَا وَارْضَ عَنَّا وَتَقَبَّلْ مِنَّا وَأَدْخِلْنَا الْجَنَّةَ وَدَجِّنَا مِنَ
النَّارِ وَأَصْلِحْ لَنَا شَأْنَنَا كُلَّهُ -

404. Ibni Maxha, Kitabud-dua, bab asmaul-azem.

O Allah! Na fal! Na mëshiro! Ji i kënaqur me ne! Prano (lutjet dhe adhurimet) prej nesh! Na merr në xhenet! Na shpëto nga zjarri dhe na rregullo gjithë çështjen tonë!⁴⁰⁵

Lutje që bëhet në momentin kur pranohet lutja

Hazret Ajshja^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} ka thënë: “Kur të shihni se lutja juaj është pranuar, domethënë kur shëroheni, kur ktheheni shëndoshë nga udhëtimi etj., çfarë ju ndalon ta bëni këtë lutje?

أَلْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي بَعَّرْتَهُ وَجَلَّالِهِ تَتِمُّ الصَّالِحَاتُ۔

Lavdia është e Allahut, që me nderin e Tij dhe me madhësitinë e Tij kryhen me sukses të gjitha punët e mira.⁴⁰⁶

Lutje për të pasur përfundim të mirë

Hazret Jusri Ibni Arta^{ra} ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut^{sas} duke bërë këtë lutje:

اللَّهُمَّ أَحْسِنْ عَاقِبَتَنَا فِي الْأُمُورِ كُلِّهَا وَأَجِرْنَا مِنْ خِزْيِ الدُّنْيَا وَ
عَذَابِ الآخِرَةِ۔

O Allah! Në të gjitha çështjet na mundëso përfundime të mira dhe na shpëto nga turpërimi në këtë botë dhe nga ndëshkimi në ahiret.⁴⁰⁷

Emrat e bukur të Allahut dhe pranimi i lutjes

(1) Njëherë i Dërguari i Allahut^{sas} i tha Hazret Ajshes^{ra}: “Unë di një atribut të Allahut, të cilin duke e përmendur, nëse i lutesh, lutja do

405. Ibni Maxha, Kitabud-dua, bab duairr-Rresul^{sas}

406. Mustadrik Hakim, vëll. 1, f. 730.

407. Mustadrik Hakim, vëll. 3, f. 591.

të të pranohet patjetër”. Hazret Ajshja shumë e ngazëllyer e pyeti Profetin^{sas}: “Ma trego, të lutem, atë atribut”. I Dërguari i Allahut^{tas} tha: “Mendoj se nuk është mirë ta zbuloj atë”. Hazret Ajshja ashtu qejfmbetur iu largua paksa dhe u ul, që Profeti t’ia tregonte. Por kur kaloi pak kohë dhe Profeti^{sas} nuk ia tregoi atë atribut, ajo nuk qëndroi në vend. U çua dhe me një dashuri të veçantë erdhi tek i Dërguari i Allahut^{tas}, e puthi në ballë dhe iu lut: “O i Dërguari i Allahut! Ma trego patjetër atë atribut”. I Dërguari i Allahut^{tas} iu përgjigj: “O Ajsh! Nuk është mirë që me këtë atribut t’i kërkosh Zotit diçka që i përket kësaj bote, prandaj nuk dua ta tregoj”. Atëherë Hazret Ajshja u mërziu paksa, u çua që aty, mori abdes, shtroi sexhaden dhe filloi t’i lutej me zë Zotit, në mënyrë që edhe i Dërguari i Allahut^{tas} ta dëgjonte:

O Allah! Në saje të të gjithë emrave dhetributeve të Tua të pastra e të bukura, edhe të atyretributeve që unë i di, edhe të atyretributeve që nuk i di, të kërkoj të më falësh!

I Dërguari i Allahut^{tas}, që ishte i ulur aty pranë, po buzëqeshte. I tha: “Ajsh! Pa dyshim që ai atribut përfshihet në atributet që ti i ke numëruar”.⁴⁰⁸

Kështu që, atributet e Zotit kanë lidhje të ngushtë me pranimin e lutjes. Zoti i Madhërishëm thotë:

وَلِلَّهِ الْأَسْمَاءُ الْحُسْنَىٰ فَادْعُوهُ بِهَا

Allahu ka emra të bukur! Lutuni përmes tyre!⁴⁰⁹

(2) Hazret Ebu Hurejrah^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} tha: “Allahu i Madhërishëm ka 99tribute. Ai që i mëson mirë ato, do të jetë në xhenet”.⁴¹⁰

408. Ibni Maxha, Kitabud-dua, bab asmaul-a’zem.

409. Kurani Famëlartë 7:181.

410. Tirmidhiu, Kitabud-da’vat, bab 83; Ibni Maxha, Kitabud-dua, bab esmaul-a’zem.

Ato attribute janë:

| | | | | |
|---|---|--|---|--|
| اللَّهُ Allah Përmbledhësi i të gjitha vetive të mira | الرَّبُّ Er-Rab Zoti | الرَّحْمَنُ Er-Rahman I Gjithëmëshirshmi | الرَّحِيمُ Er-Rahim Mëshirëbërësi | الْمَلِكُ El-Melik Sunduesi |
| الْقُدُّوسُ El-Kud-dus I Shenjti | السَّلَامُ Es-Selam Paqja | الْمُؤْمِنُ El-Mu'min Paqedhënësi | الْمُهَيْمِنُ El-Muhejmin Strehuesi | الْعَزِيزُ El-Aziz Triumfuesi |
| الْجَبَّارُ El-Xheb-bar Ndreqësi | الْمُتَكَبِّرُ El-Mutekeb-bir Krenari | الْخَالِقُ El-Khalik Krijuesi | الْبَارِيُ El-Bari' Filluesi | الْمُصَوِّرُ El-Musav-ir Formuesi |
| الْغَفَّارُ El-Ghaf-far Gjithëfalësi | الْقَهَّارُ El-Kah-har I Ashpëri | الْوَهَّابُ El-Veh-hab Dhuruesi | الرَّزَّاقُ Er-Rezak Furnizuesi | الْفَتَّاحُ El-Fet-tah Hapësi |
| الْعَلِيمُ El-Alim I Gjithëdijshmi | الْقَابِضُ El-Kabid Shtrenguesi | الْبَاسِطُ El-Basit Dhënësi | الْخَافِضُ El-Khafid Mposhtësi | الرَّافِعُ Er-Rafi' Lartësuesi |
| الْمُعِزُّ El-Muiz Nderuesi | الْمُذِلُّ El-Mudhil Nënshtruesi | السَّمِيعُ Es-Semi' Dëgjuesi | الْبَصِيرُ El-Basir Vështuesi | الْحَكَمُ El-Hakem Gjykatësi |
| الْعَدْلُ El-Adl I Drejti | اللَّطِيفُ El-Latif I Paformi | الْخَبِيرُ El-Khabir I Gjithinformuari | الْحَلِيمُ El-Halim Përdëllimtari | الْعَظِيمُ El-Adhim I Madhërishtmi |
| الْغَفُورُ El-Ghafur Falësi | الشَّكُورُ Esh-Shekur Mirënjohësi | الْعَلِيُّ El-Alij I Larti | الْكَبِيرُ El-Kebir I Madhi | الْحَفِيفُ El-Hafidh Ruajtësi |
| الْمُقِيتُ El-Mukit Ushqyesi | الْحَسِيبُ El-Hasib Llogarimarrësi | الْجَلِيلُ El-Xhelil Madhështori | الْكَرِيمُ El-Kerim Bujari | الرَّقِيبُ Er-Rekib Vëzhguesi |
| الْمُجِيبُ El-Muxhib Pranuesi | الْوَاسِعُ El-Vasi' Zgjeruesi | الْحَكِيمُ El-Hekim I Urta | الْوَدُودُ El-Vedud I Dashuri | الْمَجِيدُ El-Mexhid I Nderueshmi |

Lutjet dhe përgjërimet e Profetit Muhammed^{sas}

| | | | | |
|--|---|--|---|---|
| أَبَاثُ El-Baith Ngritësi | الشَّهِيدُ Esh-Shehid Dëshmuesi | أَحَقُّ El-Hak I Vërteti | أَوْكَيْلُ El-Vekil Kujdestari | أَقْوَى El-Kavij I Fuqishmi |
| أَمْتِينُ El-Metin I Pathyeshmi | أَوْلَى El-Velij Miku | أَلْحَمِيدُ El-Hamid I Lavdëruari | أَلْمُحْصَى El-Muhsi Numëruesi | أَلْمُبْدَى El-Mubdi' Nismëtari |
| أَلْمُعِيدُ El-Mu'id Përsëritësi | أَلْمُحْيَى El-Muhji Jetëdhënësi | أَلْمُمِيتُ El-Mumit Vdekëdhënësi | أَلْحَى El-Haj I Gjalli | أَلْقِيَوْمُ El-Kaj-jum I Qëndrueshmi |
| أَلْوَاحِدُ El-Vaxhid Lënësi | أَلْمَاخِدُ El-Maxhid I Nderuari | أَلْوَاحِدُ El-Vahid I Vetmi | أَلصَّمَدُ Es-Samed I Pavaruri | أَلْقَادِرُ El-Kadir I Fuqishmi |
| أَلْمُقْتَدِرُ El-Muktedir Fuqiploti | أَلْمُقَدِّمُ El-Mukad-dim Përparuesi | أَلْمُوخِرُ El-Muakh-khir Tërheqësi | أَلْأَوَّلُ El-Ev-vel I Pari | أَلْآخِرُ El-Akhir I Fundit |
| أَلظَّاهِرُ Edh-Dhahir I Dukshmi | أَلْبَاطِنُ El-Batin I Padukshmi | أَلْوَالِي El-Vali Pronari | أَلْمُتَعَالَى El-Muteali I Lartësuar | أَلْبَرُّ El-Berr Mirëbërësi |
| أَلتَّوَابُ Et-Tev-vab Pendimpranuesi | أَلْمُنْتَقِمُ El-Muntekim Ndëshkuesi | أَلْعَفُو El-Afuv Falja | أَلرَّؤُوفُ Er-Reuf I Dhembshuri | مَالِكُ الْمَلِكِ Malikul-mulk Zotëruesi i sundimit |
| ذُو الْجَلَالِ Dhul-Xhelal Zotëruesi i madhështisë | وَالْإِكْرَامِ Vel-Ikram Zotëruesi i nderit | أَلْمُقْسِطُ El-Muksit Drejtësidhënësi | أَلجَامِعُ El-Xhami' Tubuesi | أَلْغَنِيُّ El-Ganij I Pasuri |
| أَلْمُغْنَى El-Mugni Pasuridhënësi | أَلْمَانِعُ El-Mani' Privuesi | أَلضَّارُّ Ed-Darr Dëmsjellësi | أَلنَّافِعُ En-Nafi' Dobiprurësi | أَلنُّورُ En-Nur Drita |
| أَلهَادِي El-Hadi Udhërrëfyesi | أَلْبِدِيعُ El-Bedi' Shpikësi | أَلْبَاقِي El-Baki I Përhershmi | أَلوَارِثُ El-Varith Trashëguesi | أَلرَّشِيدُ Er-Reshid Udhëzuesi |
| أَلصُّبُورُ Es-Sabur I Durueshmi | | | | |

Lutje për mbarimin e recitimit të Kuranit Famëlartë

Hazret Hudhejfa^{ra} tregon se i Dërguari i Allahut^{sas} kur përfundonte recitimin e gjithë Kuranit, bënte këtë lutje:

اللَّهُمَّ ارْحَمْنِي بِالْقُرْآنِ وَاجْعَلْ لِي إِمَامًا وَنُورًا وَهُدًى وَرَحْمَةً اللَّهُمَّ
ذَكِّرْنِي مِنْهُ مَا نَسِيتَ وَعَلِّمْنِي مِنْهُ مَا جَهِلْتُ وَارْزُقْنِي تِلَاوَتَهُ آتَاءَ
اللَّيْلِ وَأَطْرَافِ النَّهَارِ وَاجْعَلْهُ لِي حُجَّةً يَا رَبَّ الْعَالَمِينَ

O Allah! Më mëshiro në saje të Kuranit. Bëje atë për mua drejtues, dritë, udhërrëfyes dhe mëshirë. O Allah! Më kujto atë që kam harruar prej tij dhe më mëso atë që nuk e kam kuptuar prej tij. Më mundëso recitimin e tij gjatë orëve të natës dhe gjatë orëve të ditës. Bëje atë argument për mua, o Zoti i botëve.⁴¹¹

411. Ihja ulumid-din, lil-Ghazali, pj. 1, f. 278.

PJESA III

Lutjet e Imam Mehdiut,

Mesihut të Premtuar

paqja qoftë mbi të

تری رحمت عجب ہے اے میرے یار ترے فضلوں سے میرا گھر ہے گلزار
 تیرے دم میں تو پار جو ہو نومید تجھ سے، ہے وہ مُردار
 وہ ہو آوارہ ہر دُست و وادی
 فَسُبْحَانَ الَّذِي أَحْزَى الْأَعْدَى

ہوئے ہم تیرے اے قادر توانا ترے در کے ہوئے اور تجھ کو چانا
 ہمیں بس ہے تری درگہ آنا مُصیبت سے ہمیں ہر دم پہچانا
 کہ تیرا نام ہے غفار و ہادی
 فَسُبْحَانَ الَّذِي أَحْزَى الْأَعْدَى

تجھے دنیا میں ہے کس نے پکارا کہ پھر خالی گیا قسمت کا مارا
 تو پھر ہے کس قدر اس کو سہارا کہ جس کا تُو ہی ہے سب سے پیارا
 ہوا میں تیرے فضلوں کا مُنادی
 فَسُبْحَانَ الَّذِي أَحْزَى الْأَعْدَى

میں کیونکر گن سکوں تیری عنایات ترے فضلوں سے پُر ہیں میرے دن رات
 مری خاطر دکھائیں تُو نے آیات حرم سے مری سُن لی ہر ایک بات
 کرم سے تیرے دُشمن ہو گئے مات عطا کیں تُو نے سب میری مُرادات

﴿از دُشمنین صفحہ نمبر 52﴾

*Mëshira Jote, e çuditshme, o Miku im
Shtëpia ime, e lulëzuar nga bekimet e Tua*

*Të fundosurit për një çast i nxjerr
I vdekur është ai që prej Teje është i dëshpëruar.*

*Ai është i hutuar, i humbur nëpër pyje e shkretëtira.
I Shenjtë je Ti, që poshtërove armiqtë e mi*

*Jemi bërë të Tutë, o i Plotfuqishëm
Jemi bërë të pragut Tënd, që kur Të njohëm*

*Veç tek oborri Yt kemi për të ardhur
Na shpëto çdo çast nga vështirësitë*

*Se ti ke emrin Falës dhe Udhëzues
I Shenjtë je Ti, që poshtërove armiqtë e mi*

*Kush të ka thirrur në këtë botë,
E është kthyer i gjorë duarbosh?!*

*E sa shumë mbështetje mund të ketë ai
Që vetëm Ty të ka shumë të Dashur!*

*Jam bërë trumbetues i bekimeve të Tua
I Shenjtë je Ti, që poshtërove armiqtë e mi*

*Si mund t'i numëroj mirësitë e Tua
Bekimet e Tua më mbushin ditët e netët*

*Për mua ke treguar shenjat,
me dhembshuri më pranove çdo kërkesë.*

*Me mëshirën tënde u mundën armiqtë
Mua m'i plotësove të gjitha dëshirat.⁴¹²*

412. "Durr-e-themin" urdu, f. 52.

Parathënie

Udhëheqësi dhe Profeti ynë i dashur, Hazret Muhammed Mustafai^{sas}, Mesihun e Premtuar dhe Imam Mehdiun e ka quajtur shpëtimtar të kohës, kur bota do të ishte e mbërthyer nga trazirat, tha:

“Askush nuk do të ketë fuqi për t’u bërë ballë fuqive të mëdha materialiste të asaj kohe. Atëherë Allahu i Lartësuar do t’i dërgojë shpallje Mesihut të Premtuar duke thënë: ‘Çoji robërit e Mi në strehën e malit Tur!’”⁴¹³

Kjo do të thoshte se, ashtu siç Hazret Musai^{as} kishte treguar shenja të pranimit të lutjeve për popullin e tij në rrëzë të malit Tur, në të njëjtën mënyrë, edhe sot, po me bekimin e lutjeve të tilla, Mesihu i Premtuar^{as} dhe xhemati i tij do të ngadhënjenin.

Hazret Mesihu i Premtuar^{as} thotë:

“Rreth Mesihut të Premtuar shkruhet ... që mohuesit do të vriten me frymën e tij. Kjo do të thotë se ai do të kryejë të gjitha punët me anë të lutjeve të tij. ... Zoti i Madhërishëm vazhdimisht më është drejtuar mua me shpallje, që çdo gjë do të ndodhë vetëm me anë të lutjes”⁴¹⁴

Duke treguar pse Imam Mehdiu u quajt Mehdi (i udhëzuar), dijetarët e mëparshëm kanë shkruar se Zoti i Madhërishëm do ta udhëzonte Imam Mehdiun për një mision të jashtëzakonshëm dhe ai udhëzim

413. Muslimi, Kitabul-fiten.

414. “Malfuzat”, vëll. 5, f. 36.

“sekret” ka qenë pikërisht lutja, të cilën Zoti ia ka dhënë Mehdiut tonë në kohën kur bota materialiste mohon shenjat dhe mrekullitë. Zoti i Lartësuar, në shpalljen që i ka dërguar Imam Mehdiut^{as} me fjalët “Ithramud-dua”, e ka nxitur atë për lutje dhe, gjithashtu, i ka dhënë vazhdimisht edhe premtime për pranimin e lutjeve të tij. Kështu që, Hazret Imam Mehdiu^{as} e njoftoi me të madhe:

*“Le të vijë kushdo për të më përballuar në shenjën e pranimit të lutjes, që më është dhënë mua”.*⁴¹⁵

Hazret Mesihu i Premtuar^{as} praktikisht i mposhti kundërshtarët e tij, si dhe mohuesit e lutjes nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, e rrënjosi në ndërgjegjen e xhematit të tij besimin e palëkundur në lutje dhe në pranimin e tyre. Pra, Mehdiu i kësaj kohe mësoi metodat e lutjes nga Zoti i tij dhe më pas, e stolisi xhematin e tij me pasion dhe zell aq të fuqishëm për lutjet, sa që ato u janë bërë ushqimi i tyre. Duke zbuluar realitetin e lutjes, ai shkundi fort mënyrën e lutjes, që prej kohësh ishte bërë thjesht si rit. Në shtëpitë e ahmedianëve filluan të ndodhnin ngjarje të jashtëzakonshme të pranimit të lutjeve. Në çdo situatë të vështirë, Zoti i Madhërishtëm e strehoi xhematin e tij në rrëzë të malit Tur. Se sa shumë mbështetej Mesihu i Premtuar^{as} te Zoti me anë të lutjeve të tij, këtë mund ta ndiejmë sadopak në fjalët e bashkëshortes së tij, që ajo u tha fëmijëve të vet, kur Hazret Mesihu i Premtuar^{as} ndërroi jetë:

“Bij! Duke parë shtëpinë bosh, mos mendoni se ati juaj nuk ju ka lënë asgjë. Ai ju ka lënë një thesar shumë të madh lutjesh në qiell”.

415. “Malfuzat”, vëll. 2, f. 54.

Në të vërtetë, ky thesar shumë i madh lutjesh nuk është vetëm për ata që jetonin në shtëpinë e tij fizike, por për çdo njeri të sinqertë që hyn në shtëpinë e tij shpirtërore.

Hazret Mesihu i Premtuar^{as} jo vetëm që u lut natë e ditë për xhematin e tij, por, sipas profecive të Hazret Muhammedit^{sas}, la pas një thesar të paçmueshëm lutjesh të shpallura për ne, të cilat gjenden në librat, thëniet dhe letërkëmbimet e tij. Ajo që na duhet neve është vetëm të përfitojmë sa më shumë nga ky thesar dhe pikërisht ky është edhe qëllimi i përpilimit të këtij libri.

Fillimisht, kur u botuan dy pjesët e para të librit, që përbënin lutjet e Kuranit dhe lutjet e Profetit të shenjtë^{sas}, shumë nga anëtarët e xhematit donin të kishin një përmbledhje edhe të lutjeve të Mesihut të Premtuar^{as}, dhe për këtë shkak, me bekimin e Zotit, erdhi në dritë edhe pjesa e tretë e këtij libri. Është bërë përpjekje që në këtë pjesë të përmbliidhen të gjitha lutjet e Mesihut të Premtuar^{as} me gjithë kontekstin e tyre. Në fillim të saj, gjithashtu, janë paraqitur disa tema të rëndësishme në fjalët e Mesihut të Premtuar^{as}, si “Realiteti i lutjes e rëndësia dhe bekimet e saj”, “Parimet e lutjes”, “Lutjet e përditshme të Mesihut të Premtuar^{as}” etj.

Së pari, janë përmendur ato lutje të Mesihut të Premtuar^{as}, që janë në gjuhën urdu. Janë përmendur edhe udhëzime të çmueshme të tij rreth disa prej lutjeve të Kuranit Famëlartë. Ndërsa lutjet e Kuranit që atij i janë shpallur me apo pa ndryshime, janë përmendur më vete. Janë veçuar lutjet e tij të shpallura, ndërsa lutjet për të cilat nuk është gjetur dot ndonjë shënim nëse janë të shpallura ose jo, janë përmendur më vete. Lutjet e tij të shpallura, që janë të lidhura drejtpërdrejt me veten dhe pozitën e tij të qenët i dërguar, kanë një

listë më vete. Në fund, janë paraqitur disa nga lutjet e tij që janë në vargje, në gjuhën urdu, perse dhe arabe. Është bërë përpjekje që çdo lutje të ketë referencën nga ku është marrë ajo. Referencat nga libri “Tadhkirah” (Përmbledhje e shpalljeve të Mesihut të Premtuar^{as}) janë marrë nga botimi i tij i katërt, kurse për referencat e vëllimeve të “Malfuzatit” (thëniet e tij), është shfrytëzuar botimi i ri i tyre. Përveç librave, thënieve dhe letërkëmbimeve të Hazret Mesihut të Premtuar^{as}, për hartimin e këtij libri është shfrytëzuar edhe biografia e tij “Sirat Hazret Mesih Maud^{as}”, e shkruar nga Hazret Shejh Jakub Ali Irfani, si dhe materiale të tjera të botuara dhe të pabotuara.

Me shumë përulësi e falënderoj Allahun e Madhërishëm që, më në fund, më dha mundësinë t’u jap anëtarëve të xhematit këtë dhuratë lutjesh. Veç kësaj, do të doja t’ju kërkoja me përulësi lutjet tuaja edhe për djalin tim të madh, Hafiz Mazhar Ahmedin, që ka dedikuar jetën dhe tanimë shërben si misionar i xhematit, i cili më ndihmoi në përgatitjen e materialit dhe në qëmtimin e lutjeve të Mesihut të Premtuar^{as} gjatë pushimeve të tij pas mbarimit të shkollës së mesme, duke pritur për të hyrë në fakultetin e Xhematit Musliman Ahmedia për teologji. Allahu e shpërbleftë me të mira!

Zoti e bëftë këtë libër një mjet për të shtuar dijen, njohjen dhe spiritualitetin për gjithkënd dhe kështu, të bëhet një mundësi edhe për autorin modest në tërheqjen e lutjeve, bekimeve dhe të mëshirës së Zotit! Amin!

Paqja qoftë mbi ju!

Hafiz Muzaffar Ahmad

14 korrik 2005

Realiteti i lutjes, rëndësia dhe bekimet e saj

Hazret Mesihu i Premtuar^{as}, duke treguar realitetin e lutjeve, thotë:

Robi i sinqertë dhe ekzistenca e një lidhjeje tërheqëse midis tij dhe Zotit të tij, përbëjnë realitetin e lutjes. Së pari, mëshira e Zotit të Lartësuar e tërheq robin drejt Vetes e më pas, tërheqjet që shkaktohen nga sinqeriteti i robit bëjnë që Zoti t'i afrohet atij. Kjo lidhje midis tyre, në kohën kur bëhet lutja, arrin një pozitë aq të lartë, sa që shkakton rezultate të çuditshme. Kështu, gjatë një vështirësie të madhe, robi përulet para Zotit me besim të përsosur, me shpresë të përsosur, me dashuri të përsosur, me besnikëri të përsosur, me kurajë të përsosur dhe me vetëdije të plotë gris një nga një perdet e errëta të paditurisë dhe i bëhet gjithnjë më e qartë gjendja e tij e të qenët hiç. Pikërisht atje ai shikon pragun e Zotit, ku nuk shoqëron askënd e asgjë me Të. Në atë moment shpirti i tij vë kokën në pragun e Tij. Fuqia tërheqëse që i është dhuruar robit, fillon të tërheqë mirësitë e Zotit. Atëherë Zoti ndërmer përmbushjen e kërkesës së tij dhe me efektin e lutjes së tij vë në lëvizje të gjitha mjetet e nevojshme, me të cilat, më në fund, realizohet përmbushja e kërkesës së lutësit.⁴¹⁶

Shkaku i disa kategorive të mrekullisë, në fakt, është pranimi i lutjes. Burimi i mijëra mrekullive që kanë treguar profetët, si dhe i të gjitha gjërave të jashtëzakonshme që kanë treguar evlijatë deri më sot, në të vërtetë është lutja. Efekti i lutjes shpesh ka shfaqur gjëra të çuditshme e të jashtëzakonshme të krijimtarisë së Zotit. Ajo ngjarje e çuditshme që ndodhi në shkretëtirën e

416. Barakat-ud-Dua, Ruhani Khezain, vëll. 6, f. 9-10.

Arabisë; kur brenda pak ditësh rierdhën në jetë qindra mijëra të vdekur, të kequdhëhequrit prej brezash, morën ngjyra hyjnore; të verbrit fituan shikimin; memecët filluan të flasin për njohjen hyjnore, dhe bota përnjëherë pati një revolucion të tillë, që nuk ishte parë a dëgjuar më parë! A e dini se çfarë e shkaktoi këtë? Ishin përgjyerimet gjatë netëve të errëta të dikujt që ishte përhumbur pas Allahut, që lëshuan një britmë në të gjithë botën dhe shfaqën mrekulli të tilla, sa që dukeshin të pamundura për një të paarsimuar e të papërkrahur si ai.

اللَّهُمَّ صَلِّ وَسَلِّمْ وَبَارِكْ عَلَيْهِ وَالْهَبْ بَعْدَ دَهْمِهِ وَعَجْمِهِ وَ
حُزْنِهِ لِهَذِهِ الْأُمَّةِ وَأَنْزِلْ عَلَيْهِ أَنْوَارَ رَحْمَتِكَ إِلَى الْأَبَدِ-

O Allah, zbrit mbi të dhe ndjekësit e tij bekimet dhe paqen Tënde sipas dhimbjes dhe ankthit që ai ndjeu për umetin e tij dhe hidh mbi të përgjithmonë dritën e mëshirës Sate.⁴¹⁷

Duke treguar përvojën e tij në pranimin e lutjeve, Hazret Mesihu i Premtuar^{as} thotë:

E them edhe nga përvoja, që efekti i lutjeve është shumë më i fortë sesa efekti i tipareve të ujit apo të zjarrit. Madje asgjë nga gjërat natyrore nuk është më shumë efektive sesa lutja.⁴¹⁸

Ai gjithashtu tha:

Gjatë sprovave të ndryshme shihen tipare dhe efekte të çuditshme të lutjeve. E vërteta është se Zoti ynë njihet vetëm me anë të lutjeve.⁴¹⁹

417. Barakat-ud-Dua, Ruhani Khezain, vëll. 6, f. 10-11.

418. Barakat-ud-Dua, Ruhani Khezain, vëll. 6, f. 11.

419. "Malfuzat", vëll. 2, f. 147.

Efektin dhe fuqinë e lutjes që ndjeu Hazret Mesihu i Premtuar^{as}, e shprehu me këto fjalë:

Ajo lutje që bëhet pas njohjes së përsosur të Zotit dhe lind me anë të bekimit të Tij, tiparet dhe ngjyrat e saj janë krejtësisht të tjera. Ajo është një gjë vdekjeprurëse; një zjarr i ndjeshëm; një fuqi magnetike për të tërhequr mëshirën e Zotit; një vdekje që të ringjallë përfundimisht; një përmbytje e fortë, por në fund shndërrohet në varkë. Çdo problem rregullohet me të dhe çdo helm bëhet shërues me anë të saj. Të bekuar janë ata të burgosur që nuk lodhen duke u lutur, sepse do të lirohen një ditë. Të bekuar janë ata të verbër që nuk lodhen duke u lutur, sepse do të fitojnë shikimin një ditë. Të bekuar janë ata që janë varrosur, të cilët me anë të lutjes i kërkojnë ndihmë Allahut, sepse një ditë do të nxirren nga varret. I bekuar je ti që nuk lodhesh duke u lutur, kur shpirti yt shkrihet dhe sytë e tu lotojnë duke bërë lutje, mandej ajo të ngjall një zjarr në gjoksin tënd, dhe për të gjetur kënaqësinë e vetmisë të çon në kasolle të errëta e në vende të shkreta dhe të çmend e të shqetëson ty jashtë mase. Kështu ndodh, sepse më pas ti do të bekohesh. Ai Zot, drejt të cilit ne të ftojmë ty, është shumë Bujar, shumë i Mëshirshëm, shumë i Hijshëm, shumë Besnik dhe i Vërtetë, që mëshiron ata që janë të paaftë. Prandaj edhe ti bëhu besnik dhe lutu me gjithë besimin dhe besnikërinë, sepse Ai do të të mëshirojë ty.⁴²⁰

Një gjë duhet të kemi parasysh, që pranimi i lutjes bëhet në dy forma: njëra është si sprovë dhe tjetra si shenjë e sinqeritetit. Në formën e parë lutjet u pranohen edhe mëkatarëve, të pabindurve, madje edhe

420. Lekçer Sialkot, Ruhani Khezain, vëll. 20 f. 222-223.

mohuesve, por ky pranim nuk quhet pranim i vërtetë. Ndërsa lutja që pranohet si shenjë e sinqeritetit, ka këto veçori:

Së pari, lutësi duhet të jetë njeri me *takva*, i qëndrueshëm në rrugën e drejtë dhe i bindur ndaj Zotit.

Së dyti, ai njoftohet për pranimin e lutjes përmes komunikimeve me Zotin.

Së treti, lutjet që i pranohen, shpesh u përkasin çështjeve që janë sa madhore, aq edhe të vështira dhe zgjidhja e tyre dëshmon se ajo nuk ishte punë njeriu, por një mrekulli e veçantë e Zotit të Madhërishëm, që Ai shfaq për njerëzit e Tij të veçantë.

Së katërti, lutjet si sprovë pranohen rrallëherë, por lutjet e njerëzve të sinqertë pranohen dendur.

Së pesti, njeriu që gëzon pranimin e lutjeve për shkak të sinqeritetit të tij, tërheq dashurinë dhe mirësitë e Zotit dhe, në të gjitha punët, Zoti bëhet Kujdestar i tij. Fytyra e tij rrezaton dritën e dashurisë ndaj Zotit, nderimin hyjnor, shijen dhe bekimet shpirtërore.

Këto janë pesë veçori që shohim fuqishëm në shenjat e pranimit të lutjeve të Hazret Mesihut të Premtuar^{as}.

Më poshtë paraqesim disa nga thëniet e Hazret Imam Mehdiut e Mesihut të Premtuar^{as} rreth realitetit dhe rëndësisë së lutjes.

Duke folur për disa njerëz të caktuar, ai tha:

- ❖ *“Ata nuk dinë realitetin e lutjes dhe janë të paditur për efektin e saj. Dhe kur shohin që dëshirat e tyre boshe nuk u plotësohen, thonë se lutja është e kotë dhe pastaj e braktisin”.*⁴²¹

421. “Malfuzat”, vëll. 2, f. 150.

Ai gjithashtu tha:

- ❖ “Edhe njeriu ka një helm, siç e ka gjarpri. Shërimi i tij është lutja, me anë të së cilës hapet një burim në qiell. Ai që është i paditur në lutje, është i vdekur. Ai që ka kaluar një ditë dhe një natë pa u lutur, i afrohet shejtanit. Çdo ditë duhet ta pyesni veten se “a e kam plotësuar detyrën e lutjes për sot apo jo?”⁴²²
- ❖ “Nëse dëshironi që ju të jeni mirë dhe të keni paqe në shtëpitë tuaja, lutuni sa më shumë! Mbushini shtëpitë tuaja me lutje, se Zoti nuk e shkatërron atë shtëpi në të cilën bëhen shumë lutje”.⁴²³
- ❖ “Mendova që t’ju tregoj burimin e bekimeve të Zotit. Ndërkohë Zoti më njoftoi duke diktuar në zemrën time, që burimi i tyre është (ky ajet) “Ud’uni astaxhib lakum” [d.m.th. “Më thërrisni Mua, Unë do t’ju përgjigjem.” (Kurani Famëlartë 40:61)] Askush nuk mund të shpëtojë nga mëkatet, përveçse me anë të bekimit të Zotit”.⁴²⁴
- ❖ “Rrënja e shenjës (mrekullisë) është lutja. Ajo është Ism-i-Azem (Emri më i lartë i Zotit) dhe mund ta ndryshojë botën krejtësisht. Ajo është arma e besimtarit dhe patjetër që është e tillë. Dhe është e sigurt që, së pari, ai duhet të kalojë në gjendjen e përvuajtjes”.⁴²⁵
- ❖ “Ata që hyjnë në këtë xhemat, gjëja më e mirë që fitojnë është kjo që unë do të lutem për ta. Lutja është një gjë e tillë, që mund të lulëzojë edhe një degë të thatë dhe mund të ringjallë një të

422. “Malfuzat”, vëll. 3 f. 591.

423. “Malfuzat”, vol 3, f. 232.

424. “Malfuzat”, vëll. 3, f. 333.

425. “Malfuzat”, vëll. 3, f. 202.

vdekur. Ajo ka shumë fuqi”⁴²⁶

- ❖ “Lutja është një gjë shumë e dobishme. Nëse do Zoti, ajo mund të bëhet edhe mjet i faljes së mëkateve. Nëpërmjet saj, dalëngadalë Zoti i tregon mëshirë lutësit. Ai që nuk i lutet Zotit, së pari i ndryshket zemra, pastaj i ngurtësohet, më pas fillon ta mohojë Atë, pastaj armiqësohet me Të dhe përfundimisht mbetet pa besim”⁴²⁷
- ❖ “Njerëzit nuk janë në dijeni për një bekim, që lëmoshat, lutja dhe bamirësia largojnë të keqen. Po të mos ishte kjo mundësi, njeriu do të shkatërrohej, edhe sikur të mbetej i gjallë”⁴²⁸
- ❖ “Nëse ndonjë fat (i keq) është ende pezull, atëherë lutja dhe sadakaja mund ta largojnë atë, pastaj Zoti me bekimin e Tij e ndryshon atë fat”⁴²⁹
- ❖ “E vetmja derë që Zoti i Madhërishëm ka lënë hapur për të mirën e krijesave të Tij është lutja. Kur një njeri hyn në këtë derë, duke qarë dhe duke u përgjëruar, Zoti Bujar e mbulon me çarçafin e pastërtisë e të dëlirësisë”⁴³⁰
- ❖ “Rruga më e mirë për të gjetur bekimin e Zotit është lutja. Ajo lutje ... që bëhet me përulësi të plotë, me përvuajtje dhe me zemër të prekur, sjell bekimin e Zotit të Madhërishëm.... Edhe për lutjen e vërtetë duhet lutje”⁴³¹

426. “Malfuzat”, vëll. 3, f. 100.

427. “Malfuzat”, vëll. 3, f. 628.

428. “Malfuzat”, vëll. 3, f. 201.

429. “Malfuzat”, vëll. 3, f. 24.

430. “Malfuzat”, vëll. 3, f. 315.

431. “Malfuzat”, vëll. 3, f. 397.

Parimet e lutjes

(Thënie të Hazret Imam Mehdiut e të Mesihut të Premtuar⁴³)

- ❖ *“Lutja është diçka shumë e çuditshme. Por do të shprehja keqardhjen, sepse lutësit as nuk janë në dijeni për parimet e lutjes e as për metodat që duhet të ndjekin, të cilat çojnë në pranimin e saj. E vërteta është se vetë lutja është bërë diçka e panjohur. Ka disa që e mohojnë kategorikisht lutjen dhe ka të tjerë që nuk e mohojnë atë, por gjendja e tyre është më keq se mohuesit e saj, sepse lutjet e tyre nuk pranohen, pasi ata nuk i dinë parimet e tyre. Lutja e njerëzve të tillë nuk është lutje në kuptimin e vërtetë të fjalës”⁴³²*
- ❖ *“Njerëzit që nuk u treguan të qëndrueshëm e të palëkundur në lutje dhe që nuk i zbatuan kushtet e saj, nuk fituan asnjë dobi prej saj dhe përfundimisht e mohuan edhe efektin e saj. Me kalimin e kohës, ata u bënë mohues të Zotit dhe thanë se po të ekzistonte Zoti, ai do t’ua dëgjonte lutjet. Këta naivë pse nuk menduan që lutjet e tyre të ishin lutje të vërteta, sepse Zoti patjetër që ekziston?!”⁴³³*
- ❖ *“Kushti i parë është që të kesh besim të plotë në Atë, të cilit i lutesh. Të besosh se Ai ekziston dhe është Dëgjues, Shikues, i Gjithëdijshëm, Kontrollues, i Plotfuqishëm dhe të jesh i bindur se Ai dëgjon lutjet dhe i pranon ato”⁴³⁴*

432. “Malfuzat”, vëll. 2, f. 692-693.

433. “Malfuzat”, vëll. 3, f. 617.

434. “Malfuzat”, vëll. 3, f. 522.

- ❖ “Njëra prej arsyeve për shumicën e lutjeve që refuzohen, është që lutësi, për shkak të dobësisë së besimit të tij, vetë e tërheq refuzimin e lutjes”.⁴³⁵
- ❖ “Katër kushte janë të domosdoshme për pranimin e lutjes: së pari, të druheni ndaj Zotit... Së dyti ... të keni dhimbje në zemër ... Së treti ... të gjeni kohën më të përshtatshme për t’u lutur ... Së katërti, të shfrytëzoni periudhën e plotë të lutjes”.⁴³⁶
- ❖ “Disa njerëz ... nuk janë të informuar për kushtet që duhen zbatuar kur i kërkojnë dikujt që të lutet për ta. Derisa kërkuesi nuk ka përmirësim dhe nuk ndjek rrugën e bindjes, lutja nuk i bën efekt”.⁴³⁷
- ❖ “Lutja e njeriut pranohet atëherë kur ai, për hir të Allahut të Lartësuar, heq dorë nga shkujdesja, pabindshmëria dhe ligësia. Njeriu sa më shumë që fiton afrimin me Zotin, aq më shumë shijon frytin e pranimit të lutjes”.⁴³⁸
- ❖ “Ka disa elemente të papëlqyeshme që vonojnë ose pengojnë pranimin dhe frytin e lutjes dhe njeriu duhet të shmanget nga ato”.⁴³⁹
- ❖ “Derisa nuk e ke zemrën të pastër, nuk të pranohet lutja. Nëse ke mëri në zemër, qoftë ndaj një personi të vetëm në ndonjë çështje të kësaj bote, nuk mund të të pranohet lutja”.⁴⁴⁰

435. “Malfuzat”, vëll. 2, f. 702.

436. “Malfuzat”, vëll. 1, f. 535-536.

437. “Malfuzat”, vëll. 3, f. 39.

438. “Malfuzat”, vëll. 1, f. 436.

439. “Malfuzat”, vëll. 4, f. 287.

440. “Malfuzat”, vëll. 5, f. 170.

- ❖ “Mbani mend! Ai që nëpërkëmb të drejtat e krijesave të Zotit, nuk i pranohet lutja, sepse ai është keqbërës”.⁴⁴¹
- ❖ “Keqbërësit dhe të padëgjueshmit, në përgjithësi, nuk i pranohet lutja”.⁴⁴²
- ❖ “Mbani mend! Lutjet nuk do t’ju pranohen, derisa nuk do të keni drujtje ndaj Zotit”.⁴⁴³
- ❖ “Disa njerëz tregohen të ngathët. ... Unë ata i konsideroj të paguximshëm. Madje, them se nuk duhet të sprapseni e nuk duhet të dorëzoheni, edhe sikur të kalojnë tridhjetë a dyzet vjet. ... Allahu i Lartësuar nuk i shkatërron ata që luten”.⁴⁴⁴
- ❖ “Hazret Jakubi^{as} ... vijoi të lutej ... për dyzet vjet. ... Pas dyzet vitesh lutjet e tij e sollën përfundimisht Jusufin^{as}”.⁴⁴⁵
- ❖ “Lutja nuk bëhet thjesht me gojë, por lutja në të vërtetë është ajo që thuhet në një shprehje:

“جو مَنگے سو مر رہے مرے سونگن جا۔”

“T’i lutesh dikujt është njësoj sikur të vdesësh, dhe pa vdekur, nuk mund të bësh lutje”.⁴⁴⁶

- ❖ “Derisa nuk ka mall dhe shqetësim të singertë në lutje, ajo është një punë krejtësisht e paefektshme dhe e kotë”.⁴⁴⁷

441. “Malfuzat”, vëll. 2, f. 195.

442. “Malfuzat”, vëll. 2, f. 682.

443. “Malfuzat”, vëll. 5, f. 130.

444. “Malfuzat”, vëll. 5, f. 106.

445. “Malfuzat”, vëll. 2, f. 152.

446. “Malfuzat”, vëll. 5, f. 107.

447. “Malfuzat”, vëll. 5, f. 455.

- ❖ “Mbani mend! Lutja është një lloj vdekjeje. Ashtu siç njeriu përpëlitet e zhgërryhet në çastet e vdekjes, në të njëjtën mënyrë edhe në lutje ai duhet ta sjellë atë lloj përpëlitjeje e vrulli ... Prandaj, duhet që ai vazhdimisht të çohet gjatë natës e të shfaqë shqetësimet e tij para Zotit të Lartësuar me shumë përulësi, përgjërime e të qarë. Dhe kaq shumë të lutet, saqë të kalojë në një gjendje vdekjeje. Atëherë lutja bëhet e pranueshme”.⁴⁴⁸
- ❖ “Në të vërtetë lutja tregon shenjat e pranimit, atëherë kur ajo shndërrohet në shqetësim tejet të ankthshëm. ... Atëherë, së pari, i rregullohen mjetet në qiell, pastaj ajo shfaq efektin e saj në Tokë. Kjo nuk është diçka e vogël, por është një realitet shumë i madh. E vërteta është se ai që dëshiron të shohë shfaqjen e Zotit, le të lutet”.⁴⁴⁹
- ❖ “Kur vjen koha e pranimit të lutjes, Allahu i Madhërishëm shkakton një vrull dhe ankth të vetvetishëm në zemrën e lutësit. Nganjëherë, Vetë Zoti i mëson ndonjë lutje. ... Zoti i Madhërishëm Vetë ua mëson përmes shpalljeve robërve të Tij të sinqertë, lutjet që ua pranon”.⁴⁵⁰
- ❖ “Lutja është një mjet që zgjidh çdo problem. ... Njerëzit nuk ia dinë vlerën lutjes, prandaj shumë shpejt dëshpërohen. ... Kurse lutja kërkon palëkundshmëri dhe qëndrueshmëri. ... Sinqeriteti dhe përpjekja janë kushtet e lutjes, por edhe për to duhet lutje”.⁴⁵¹

448. “Malfuzat”, vëll. 3, f. 616.

449. “Malfuzat”, vëll. 3, f. 618.

450. “Malfuzat”, vëll. 2, f. 164.

451. “Malfuzat”, vëll. 3, f. 615.

- ❖ “Ai që zgjohet gjatë natës, sado shpërqendrim e padurim të ketë, nëse lutet: “O Zot! Ti sundon dhe kontrollon zemrën, prandaj Ti Vetë ma pastro atë”, prej shtrëngimit të tij do të burojë ngazëllimi”.⁴⁵²
- ❖ “Kur dhimbja jua pushton zemrën tërësisht për të bërë lutje dhe çan çdo perde, atëherë kuptojeni se lutja ju është pranuar. Ky është “ism-i-azem” [Emri më i lartë i Zotit], përballë të cilit asgjë nuk është e pamundur. Edhe një i lig nëse gjen mundësi të bëjë lutje të tilla, ai pa dyshim do të bëhet i dëlirë”.⁴⁵³
- ❖ “Para se të bëni lutje, është e nevojshme që të keni parasysh edhe mjetet materiale e pastaj të përqendrohëni në lutje”.⁴⁵⁴
- ❖ “Sa më shumë që shqetësimi dhe ankthi të shtohet duke u lutur, aq më shumë shpirti ju zbutet dhe kjo është një ndër faktorët e pranimit të lutjes”.⁴⁵⁵
- ❖ “Nganjëherë duket se lutja nuk po ju pranohet. Në këtë rast, mund t’i kërkoni një njeriu tjetër të sinqertë, që ai të lutet për ju dhe ju vetë të luteni që Zoti të pranojë lutjet e atij njeriu të sinqertë (që zgjodhët)”.⁴⁵⁶
- ❖ “Nuk lejohet të bëni ndryshime në lutjet e Kuranit. ... Në lutjet që janë përmendur në hadithe, mund të ndryshoni vetëm numrin njëjës në numrin shumë”.⁴⁵⁷

452. “Malfuzat”, vëll. 3, f. 397, 398.

453. “Malfuzat”, vëll. 3, f. 100.

454. “Malfuzat”, vëll. 1, f. 89.

455. “Malfuzat”, vëll. 2, f. 707.

456. “Malfuzat”, vëll. 5, f. 182.

457. “Malfuzat”, vëll. 5, f. 194.

- ❖ “Duhet të gjeni fjalë emocionuese duke bërë lutje. Nuk është e mirë që thjesht duke mësuar përmendsh lutjet e praktikuara t’i namatisni ato, pa e kuptuar realitetin. Është e vërtetë që duhet ta ndiqni praktikën e Profetit^{as}, por të keni emocion në lutje, edhe kjo është praktika e tij. Lutuni në gjuhën tuaj që ju e kuptoni më mirë, në mënyrë që të ndieni emocione kur të luteni ... Po, duhet të bëni edhe lutjet e praktikuara që të kërkonti bekime ... Ai që di gjuhën arabe dhe e kupton, le të lutet në arabisht”.⁴⁵⁸
- ❖ “Në namaz, lutuni në gjuhën tuaj. Emocioni që mund të keni në gjuhën tuaj amtare, kurrsesi nuk mund ta keni në një gjuhë të huaj”.⁴⁵⁹
- ❖ “Lutuni shumë! Namazi është çelësi për të zgjidhur vështirësitë. Përveçse të bëni lutjet e praktikuara, lutuni shumë edhe në gjuhën tuaj amtare, në mënyrë që të keni emocione. Dhe mos hiqni dorë nga lutja, derisa të emocionoheni, sepse kjo do t’ju pastrojë shpirtin dhe pikërisht kjo do t’ju mundësojë çdo gjë”.⁴⁶⁰
- ❖ “Lutuni vazhdimisht. Lutuni në namazet tuaja, në çdo pozicion ku keni mundësi të luteni, në ruku e në sexhde dhe braktiseni namazin e shkujdesur. Namazi ritual nuk ju sjell asgjë”.⁴⁶¹
- ❖ “Njeriu duhet të sjellë në mendje mëkatet e tij e të lutet. Ai mund të shpëtojë vetëm nëse Allahu i Lartësuar e shpëton. Allahu i Lartësuar tha: “Më lusni mua! Unë do t’jua pranoj”.⁴⁶²

458. “Malfuzat”, vëll. 1, f. 538.

459. “Malfuzat”, vëll. 4, f. 29.

460. “Malfuzat”, vëll. 3, f. 589.

461. “Malfuzat”, vëll. 3, f. 176.

462. “Malfuzat”, vëll. 3, f. 573.

- ❖ “Kushdo që shikon veten të dobët për të hequr dorë nga një mëkat i caktuar, le ta piketojë atë e të lutet, atëherë, me bekimin e Zotit, do të gjejë forcën”.⁴⁶³
- ❖ “Edhe lutja që tërheq bekimin e Allahut të Madhërishëm, nuk është në dorën e njeriut. Njeriu nuk e ka në dorë të gjejë vetë të gjitha elementet e lutjes, të përqendrimit, mbështetjen, përkormërinë, emocionin etj. Kur atij i jepet mundësia të bëjë një lutje të tillë, ajo e tërheq bekimin e Allahut të Lartësuar, ia plotëson të gjitha kushtet dhe elementet që përbëjnë shpirtin e veprave të mira”.⁴⁶⁴

Shembulli i Hazret Mesihut të Premtuar^{as} në lutje

Lutje me pasion

Hazret Mesihu i Premtuar^{as} thotë:

*“Ashtu siç deti ka forcë, Zoti më dha forcë të tillë në lutje”.
“Unë lutem kaq shumë, saqë bëhem i pafuqishëm duke u lutur.
Nganjëherë më bie të fikët dhe gati vdes kur lutem”.*⁴⁶⁵

***El-Fatiha* në fillim të lutjes**

Hazret Mufti Muhammed Sadiku thoshte se gjatë lutjes Hazret Mesihu i Premtuar^{as} më së pari thoshte *El-Fatihanë* dhe më pas lutej për ndonjë gjë tjetër.

463. “Malfuzat”, vëll. 3, f. 622.

464. “Malfuzat”, vëll. 3, f. 389.

465. “Malfuzat”, vëll. 3, f. 389.

Lutje për udhëzimin e botës

Hazret Mesihu i Premtuar^{as} thotë:

“Lutja jonë është që Zoti ta mbrojë xhematin, bota të shohë se Profeti fisnik^{sas} ishte i dërguar i vërtetë dhe njerëzit të fitojnë besimin në Zot”.⁴⁶⁶

Lutje për t’u pastruar nga mëkatet

“Lutja e parë dhe më e rëndësishme e njeriut duhet të jetë që ai të pastrohet nga mëkatet. Edhe rrënja, edhe dega e të gjitha lutjeve është po kjo, sepse nëse i pranohet kjo lutje dhe ai pastrohet e lahet nga çdolloj papastërtie dhe në sy të Zotit të Madhërishëm vlerësohet si i pastruar, ai nuk do të ketë më nevojë të lutet për kërkesat e tij të tjera. Ato do t’i përmbushen vetvetiu. Lutja më e vështirë dhe më e mundimshme është pikërisht kjo që njeriu të pastrohet nga mëkatet dhe në sy të Zotit të Madhërishëm të vlerësohet i druajtur dhe i sinqertë”.⁴⁶⁷

Lutje për miqtë

Hazret Mesihu i Premtuar^{as} thotë:

“Në mënyrë të përsëritur kam marrë shpalljen:

أُجِيبُ كُلَّ دُعَائِكَ

D.m.th. “Do të të pranohet çdo lutje e dobishme”. ... Fillimisht kur e kam marrë këtë shpallje ... u gëzova shumë, duke menduar

466. “Malfuzat”, vëll. 4, f. 261.

467. “Malfuzat”, vëll. 3, f. 617.

*se Allahu i Madhërishëm patjetër do të më pranojë të gjitha lutjet e mia që unë do t'i bëja për veten time dhe për miqtë e mi ... Prandaj, për miqtë e mi e kam si parim që, medoemos lutem për të mirën e tyre në çështjet e besimit e të botës, edhe sikur ata të më kujtojnë a të mos më kujtojnë, edhe sikur të më tregojnë ndonjë problem të tyre apo të mos më tregojnë”.*⁴⁶⁸

*“Kushdo që dëshiron që unë të kem dashuri ndaj tij dhe lutjet e mia përgjyruese e të dhembshura për të të shkojnë në qiell, le të më bindë se ai ka aftësi për t'u bërë shërbëtor i fesë”.*⁴⁶⁹

*“Ajo që më tërheq vëmendjen dhe që më motivon për të bërë lutje është vetëm të mësoj për dikë që ai është i denjë për t'i shërbyer fesë dhe është i dobishëm për Zotin e Madhërishëm, për të Dërguarin e Tij, për librin e Tij dhe për robërit e Tij. Njeriu i tillë kur ndien dhimbje e shqetësohet, edhe unë ndiej dhimbje e shqetësohem”.*⁴⁷⁰

*“Unë gjithmonë qëndroj i angazhuar në lutje dhe lutja kryesore e imja është që Zoti të m'i ruajë miqtë nga shqetësimet dhe brengat, sepse pikërisht shqetësimet dhe problemet e tyre më shqetësojnë mua. Përveç kësaj, këtë lutje e bëj edhe në mënyrë të përgjithshme që, nëse ndokush ka ndonjë shqetësim a brengë, Allahu i Lartësuar ta shpëtojë atë nga problemi i tij. E gjithë vëmendja dhe angazhimi im është që t'i lutem Allahut të Lartësuar”.*⁴⁷¹

468. “Malfuzat”, vëll. 1, f. 67.

469. “Malfuzat”, vëll. 1, f. 311.

470. “Malfuzat”, vëll. 1, f. 215.

471. “Malfuzat”, vëll. 1, f. 66.

Lutje për armikun

*“Qëndrimi im është që as armikun nuk duhet ta përjashtoj nga lutjet e mia. Sa më e gjerë të jetë lutja, aq më e dobishme do të jetë ajo për lutësin dhe sa më shumë që lutësi tregohet koprrac në lutjen e tij, aq më shumë largohet ai nga Allahu i Madhërishtëm”.*⁴⁷²

Lutje për besimin

*“Anëtarët e xhematit tonë duhet të luten duke qarë gjatë natës ... Për lutjen në përgjithësi njerëzit mendojnë se ajo është vetëm për botën. Ata janë si krimbat e tokës që nuk mund të kalojnë përtej. Lutja e vërtetë bëhet për besimin.”*⁴⁷³

Sipas gazetës “El-Bader”, Hazret Mesihu i Premtuar^{as} ka thënë:

“Lutja e vërtetë bëhet për besimin dhe besimi i vërtetë qëndron në lutje. Duhet të luteni shumë në namaz edhe për besimin, edhe për botën.

*Namazi ndryshe quhet lutje. Prandaj, lutuni në të, që Zoti t’ju shpëtojë nga shqetësimet e botës e të ahiretit dhe t’ju mundësojë fundin e mbarë”.*⁴⁷⁴

Lutje për fëmijët dhe bashkëshorten

“Përveç lutjeve që bëni për të pasur ndryshim të pastër në veten tuaj, duhet të luteni edhe për fëmijët dhe për bashkëshorten, sepse shumica e gjëmave njeriut i vijnë prej fëmijëve. Nëse dikush dëshiron të ketë fëmijë, le të dojë ... që të ketë një, që bëhet shkak

472. “Malfuzat”, vëll. 1, f. 353.

473. “Malfuzat”, vëll. 5, f. 132.

474. “Malfuzat”, vëll. 3, f. 435.

i ngritjes së emrit të Islamit. Nëse njeriu ka një dëshirë të pastër si kjo, Allahu i Madhërishëm është i Plotfuqishëm t'i dhurojë fëmijë, njësoj siç i kishte dhuruar Zakariasë".⁴⁷⁵

Lutja më e dobishme

"Lutja më e dobishme është që të keni pëlqimin e Zotit të Madhërishëm dhe shpëtimin nga mëkatet. Sepse mëkatet e ngurtësojnë zemrën dhe njeriu bëhet krimb i tokës. Lutja jonë duhet të jetë që Zoti i Madhërishëm të na largojë nga mëkatet që na ngurtësojnë zemrat dhe të na udhëzojë drejt pëlqimit të Tij".⁴⁷⁶

Lutje për të kërkuar pëlqimin e Zotit

"Lutjet, së pari, duhet t'i bëni për të kënaqur Allahun e Lartësuar. Lutjet e tjera do t'ju pranohen vetvetiu, sepse bekimet do t'ju vijjnë vetë, kur të largoheni nga mëkatet. Kështu lutja që bëhet vetëm për hir të kësaj bote, nuk pranohet".⁴⁷⁷

"Duhet t'i luteni Zotit të Madhërishëm me shumë dhimbje e me shumë pasion, që, ashtu siç ju ka mësuar shijet nga më të ndryshme të frutave e të gjërave të tjera, t'ju japë një herë edhe shijen e adhurimit dhe të namazit".⁴⁷⁸

Pasi pa hënën e muajit Rebiul-evvel, Hazret Mesihu i Premtuar^{as} tha:

"Çdo muaj ka gjërat e tij të mira e të këqija, prandaj duhet të luteni".⁴⁷⁹

475. "Malfuzat", vëll. 3, f. 579.

476. "Malfuzat", vëll. 4, f. 30.

477. "Malfuzat", vëll. 3, f. 602.

478. "Malfuzat", vëll. 3, f. 28.

479. "Malfuzat", vëll. 3, f. 323.

Lutja e përditshme e Hazret Mesihut të Premtuar^{as}

“Disa lutje që bëj çdo ditë rregullisht, janë:

Së pari: lutem për veten time, që Zoti Bujar të më mundësojë të bëj atë punë, e cila shfaq nderin dhe madhështinë e Tij dhe të më dhurojë pëlqimin e plotë të Tij.

Së dyti: lutem për anëtarët e familjes, që Zoti të më mundësojë prej tyre prehjen e syve dhe ata të ndjekin pëlqimet e Zotit të Madhërishëm.

Së treti: lutem për fëmijët e mi që ata, që të gjithë, të bëhen shërbëtorë të fesë.

Së katërti: lutem për miqtë e mi të sinqertë, duke i përmendur emrin secilit.

Së pesti: lutem për të gjithë ata që janë të lidhur me këtë xhemat, edhe ata që i njoh, edhe ata që nuk i njoh.”⁴⁸⁰

Shpalljet e Hazret Mesihut të Premtuar^{as} rreth pranimit të lutjes

(1) قُلْ مَا يَعْزُبُ بِكُمْ رَبِّي لَوْلَا دُعَاؤُكُمْ

“Thuaj: Zot im nuk do t’ju përfillë nëse nuk do të jetë lutja juaj.”⁴⁸¹

(2) أَفَمَنْ يُضِلُّ إِذَا دَعَا

480. Gazeta “El-Hakem”, vëll. 4, f. 2-11, data 17 janar 1900; nr. i letrës 4, drejtuar Maulana Abdul Kerimit.

481. “Tirjakul-kulub”, f. 60.

“Po Ai që i përgjigjet lutjes së të brengosurit të ngelur pa zgjidhje, kur ai i lutet?!”⁴⁸²

(3) إِنَّهُ سَمِيعُ الدُّعَاءِ

“Ai pa dyshim e dëgjon shumë lutjen”.⁴⁸³

(4) أَدْعُوْنَ اسْتَجِبْ لَكُمْ

“Lutmuni Mua dhe Unë do t’ju përgjigjem”.⁴⁸⁴

(5) أَجِيبُ دَعْوَةَ الدَّاعِ إِذَا دَعَانِ

“I përgjigjem lutjes së lutësit kur ai Më lutet”.⁴⁸⁵

(6) دُعَاءُكَ مُسْتَجَابٌ

“Lutja jote është pranuar”.⁴⁸⁶

(7) أَجِيبْتُ دُعْوَتَكَ

“Lutja jote u pranua”.⁴⁸⁷

(8) میں تیری ساری دعاؤں کو قبول کروں گا مگر شرکاء کے بارے میں نہیں۔

“Unë do të pranoj të gjitha lutjet e tua, por jo në lidhje me disa të afërmit e Tu”⁴⁸⁸

482. “Tadhkirah”, f. 729.

483. “Tadhkirah”, f. 96.

484. “Aina kamalat-e-Islam”, “Ruhani Khezain”, vëll. 5, f. 604.

485. “Tadhkirah”, f. 81, botimi i tretë.

486. “Tadhkirah”, f. 475.

487. “Tadhkirah”, f. 744.

488. “Hakikatul-uehi”, “Ruhani Khezain”, vëll. 22, f. 254.

Ngjarje besimshtytëse të Mesihut të Premtuar^{as} rreth pranimit të lutjeve

Hazret Mesihu i Premtuar dhe Imam Mehdiu^{as} thotë:

“Mbani mend se njëra prej shenjave të forta për të kuptuar pranueshmërinë e robërve të Zotit është pranimi i lutjeve të tyre. Madje, nuk ka shenjë më të madhe sesa ajo e pranimit të lutjes, sepse pranimi i lutjes së robit provon se ai ka vlerë dhe nder pranë Zotit. Ndonëse lutjet nuk pranohen çdo herë, pasi nganjëherë Zoti i Madhërishëm zgjedh dëshirën e Vet, por nuk ka asnjë dyshim që njerëzit e pranuar nga i Madhi Zot kanë shenjë dalluese që lutjet e tyre pranohen shumë shpesh në krahasim me të tjerët. Madje, askush nuk mund të garojë me ta në pranimin e lutjeve dhe unë e them duke u betuar për Zotin e Madhërishëm, se mijëra lutje të mia janë pranuar. Nëse do t'i shkruaja të gjitha ato, do të bëhej një libër voluminoz”⁴⁸⁹.

Në librat e tij, si “Nuzul-ul-Mesih”, “Tirjakul-kulub”, “Hakikatul-uehi”, Hazret Mesihu i Premtuar^{as} ka përmendur ngjarje të ndryshme të pranimit të lutjeve të tij. Këtu si shembuj do të paraqesim vetëm disa prej tyre, të cilat janë përshkruar nga ai vetë.

Hazret Mesihu i Premtuar^{as} thotë:

- ❖ “Një herë pata nevojë jashtëzakonisht të ngutshme për para, gjë që e dinin shumë mirë edhe ata të quajturit Lala Sharampati dhe Malavamali, që i përkasin fesë arje. Ata gjithashtu e dinin se nuk kishte asnjë shenjë që mund të më jepte shpresë për të gjetur para. Në këtë situatë, në mënyrë të vetvetishme ndjeva një vrull

489. “Hakikatul-uehi”, “Ruhani Khezain”, vëll. 22, f. 334.

të fuqishëm për të bërë lutje, në mënyrë që të më zgjidhej edhe problemi dhe njerëzit në fjalë të dëshmojnë ndonjë shenjë. Kështu që, pasi u luta, Allahu i Lartësuar më njoftoi për ndihmesën financiare duke më dërguar shpallje:

«س دن کے بعد میں مونج دکھا ہوں۔ آلا ان نصر اللہ قرنت فی شابل مقباس۔
دن ول یوگوٹو امرتسر۔»

Domethënë, paratë do të vijnë pas dhjetë ditësh. Ndihma e Zotit është afër dhe ashtu siç deveja që ngre bishtin për të lindur, kuptohet se këlyshi do të lindë nga çasti në çast, në të njëjtën mënyrë, edhe ndihma e Zotit është afuar, dhe pas dhjetë ditësh kur të të vijnë paratë, do të shkosh në Amritser. Ndodhi pikërisht ashtu siç ishte parashikuar, për të cilën kanë qenë dëshmitarë edhe arjatë e lartëpërmendur. Pra, deri në dhjetë ditë nuk erdhi asnjë gjë, por ditën e njëmbëdhjetë erdhën njëqind e dhjetë rupi prej të nderuarit Muhamed Afzal Khan të Ravalpindisë, dhe erdhën edhe njëzet rupi të tjera nga një vend tjetër dhe më pas filluan të vinin vazhdimisht para, edhe pse nuk pritej një gjë e tillë”.⁴⁹⁰

- ❖ “I nderuari Khalifa Sejid Muhamed Hasan ka qenë në një sprovë dhe ishte i shqetësuar dhe i brengosur. Ai vazhdimisht më shkruante për të bërë lutje. Një ditë, papritur, më erdhi shpallje:

چل رہی ہے نسیم رحمت کی
جو دعا کیجئے قبول ہے آج

Po fryn filladi i mëshirës, sot

Çfarëdo lutje që të bësh, do të të pranohet.

490. “Tirjakul-kulub”, “Ruhani Khezain”, vëll. 15, f. 258-257.

M'u kujtua që të bëja lutje pikërisht për z. Hasan. Vetëm pak kohë pasi e bëra lutjen, ai u lirua nga sprova dhe përmes një letre më njoftoi për këtë".⁴⁹¹

- ❖ *"Njëherë, i ndjeri Navab Muhamed Ali Khan i qytetit Ludijana më dërgoi letër dhe më njoftoi se i ishin ndërprerë disa të ardhura jetese dhe më kërkoi të lutesha që t'i zgjidhej problemi. Kur bëra lutje, mora shpalljen se do t'i zgjidhej. Për këtë e njoftova me një letër. Vetëm dy-tri ditë pas kësaj, ai mori të ardhurat dhe kjo ia forcoi besimin. Njëherë tjetër ai më dërgoi letër për të më njoftuar për disa probleme të tij personale. Në momentin kur ai e futi letrën në kutinë postare, pikërisht në atë çast mora shpalljen se një letër e tillë me përmbajtjen që u përmend, do të më vinte prej tij. Unë menjëherë i shkrova duke e njoftuar se më kishte dërguar një letër të tillë. Të nesërmen më erdhi letra e tij dhe e imja i shkoi atij. Ai u befasua pa masë se si unë u njoftova për diçka nga e padukshmja, sepse askush nuk e dinte sekretin. Nga kjo ngjarje, ai u bind kaq shumë, sa që u flijua nga dashuria e respekti*".⁴⁹²
- ❖ *"Një mik më shkroi letër, ku më thoshte se ishte në vështirësi të madhe, pasi një i afërm i tij ishte paditur për një çështje të rëndë dhe nuk kishte asnjë shpresë lirimi. Në letrën e tij, ai më kërkoi të lutesha për të. Të njëjtën natë gjeta kohë të përshtatshme për t'u përqendruar në lutje. Njoftova një njeri të besimit arje për shenjat e pranimit të kësaj lutjeje. Pas disa ditësh erdhi lajmi se paditësi pësoi vdekje të papritur dhe personi për të cilën u bë lutja, u lirua. Lavdia është e Allahut!"*⁴⁹³

491. "Nuzul-ul-Mesih", "Ruhani Khezain", vëll. 18, f. 603.

492. "Hakikatul-uehi", "Ruhani Khezain", vëll. 22, f. 258-257.

493. "Tirjakul-kulub", "Ruhani Khezain", vëll. 15, f. 260.

- ❖ “Njëherë, kur u luta për mikun tim të sinqertë, z. Abdurrahman, që është tregtar nga Madrasi, mora shpalljen:

قادر ہے وہ پارگاہ نونا کام بناوے
بنا بنایا توڑوے کوئی اس کا بید نہ پاوے

**I Plotfuqishëm është Ai Zot,
që rregullon punët e prishura
Prish një punë të rregulluar,
askush nuk mund ta dijë sekretin**

*Ky ishte një sihariq, që ai do të lirohej nga shqetësimi që kishte. Kështu që, pas pak javësh, Zoti i Madhërishëm e qetësoi nga brenga duke ia zgjidhur problemin”.*⁴⁹⁴

- ❖ “Njëherë pata nevojë për pesëdhjetë rupi. Njerëzit që përvetësojnë varfërinë, por njëherësh edhe besimin e palëkundur, nganjëherë përballen edhe me situata, në të cilat janë nevojëtarë. Ashtu ishte edhe gjendja ime dhe nuk kisha asnjë mundësi. Në mëngjes dola për shëtitje. Nevoja më shtyu që të bëja lutje diku aty në pyll. Kalova në një vend të fshehtë buzë lumit, që është tri milje larg nga Kadiani, në drejtim të Batalasë, dhe bëra lutje. Sapo e përfundova lutjen, më erdhi fuqishëm një shpallje, përkthimi i së cilës është: “Shiko se sa shpejt do t’i pranoj lutjet e tua”. U gëzova dhe dola nga pylli për t’u kthyer në Kadian dhe shkova direkt në treg, që të takoja e të pyesja zëvendës drejtorin e postës së Kadianit se mos kishin ardhur para në emrin tim. Pas kontrollit që ai bëri në zyrat postare, gjeti një letër që njoftonte se dikush

494. “Nuzul-ul-Mesih”, “Ruhani Khezain”, vëll. 18, f. 611.

nga Ludjana më dërgonte pesëdhjetë rupi. Të njëjtën ditë, me sa më kujtohet, ose të nesërmen i tërhoqa paratë”⁴⁹⁵

- ❖ “Abdurrahim Khani, i biri i Sardar Navab Muhamed Ali Khanit, që ishte një njeri me ndikim në Malerkotla, u sëmur nga ethe të forta tifoide. Nuk kishte asnjë shenjë mbijetese dhe ishte thuajse i vdekur. Në këtë situatë u luta për të dhe u njoftova që caktimi ishte i patjetërsueshëm. Atëherë u përgjërora: “O Zot! Prano ndërmjetësimin tim për të”. Në përgjigje të lutjes sime, Zoti i Madhërishëm më tha:

مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ

Domethënë: “Kush guxon të bëjë ndërmjetësim për dikë, pa lejen e Zotit?” U tërhoqa. Por, pa u vonuar, më erdhi shpallje tjetër ku thuhej:

إِنَّكَ أَنْتَ الْمَجَارُ

“Të lejohet të bësh ndërmjetësim”. Atëherë fillova të bëja lutje me të qara e me ngashërim. Zoti i Madhërishëm ma pranoi lutjen dhe djali filloi të shfaqte shenja përmirësimi, tamam sikur u ringjall nga vdekja. Ai ishte dobësuar kaq shumë, sa që iu desh një kohë e gjatë që të merrte veten. Përfundimisht u shërua plotësisht dhe tani është gjallë.⁴⁹⁶

- ❖ Mikut tim të singërtë, z. Maulvi Nurudinit, i vdiq djali i vetëm. Për këtë, disa kundërshtarë naivë treguan gëzimin e tyre duke reklamuar se miku im mbeti pa fëmijë. Atëherë u luta shumë për

495. “Tirjakul-kulub”, “Ruhani Khezain”, vëll. 15, f. 294-295.

496. “Hakikatul-uehi”, “Ruhani Khezain”, vëll. 22, f. 229-230.

të dhe më pas u njoftova prej Zotit të Lartësuar se, për shkak të lutjes sime, ai do të ketë një fëmijë dhe shenja që më ishte treguar se ai do të lindte vetëm falë lutjes është se ai do të kishte shumë puçrra në trupin e tij. Kështu që, z. Maulvi Nurudinit i lindi djalë, që u quajt Abdulheij, dhe atij i kishin dalë puçrra në mënyrë të pazakontë. Ai ende i ka njollat e puçrrave në trup, ndërkohë, përpara se të lindte djali, kjo si shenjë ishte paralajmëruar në një njoftim që u botua.⁴⁹⁷

- ❖ Njëherë djali im i vogël, Mubarak Ahmedi, u sëmur. I binte vazhdimisht të fikët. Unë isha i zënë në lutje në një dhomë tjetër afër tij, ndërkohë shumë gra ishin pranë tij. Papritmas, një grua bërtiti: “Lëreni se djali ka vdekur!” Atëherë shkova pranë djalit, vura dorën mbi trupin e tij dhe u përqendrova për t’iu lutur Zotit të Madhërishtëm. Pas dy-tri minutash, i erdhi fryma. Edhe pulsi filloi t’i ndihej dhe djali u ringjall. Atëherë e kuptova se e njëjta gjë ka qenë edhe ringjallja e të vdekurve nga Isai^{as}, të cilën mendjelehtët më vonë e ekzagjeruan.⁴⁹⁸
- ❖ Mrekullia e pestë që u shfaq këto ditë ka lidhje me pranimin e një lutjeje, që në fakt është e barabartë me ringjalljen e të vdekurit. Përshkrimi i hollësishëm i kësaj ngjarjeje ka të bëjë me një djalosh të quajtur Abdul Kerim, të birin e Abdurrahmanit, banor të Hajderabadit (Hyderabad). Ai është nxënës në Medresenë tonë. Për shkak të caktimit, një ditë, atë e kafshoi një qen i tërbuar. E çuam në qytetin Kasoli për mjekim, ku për disa ditë u mjekua dhe më pas u kthye në Kadijan. Por, pas disa ditësh atij iu shfaqën shenjat e tërbimit, që shfaqen nga kafshimi i qenit të

497. “Hakikatul-uehi”, “Ruhani Khezain”, vëll. 22, f. 230.

498. “Hakikatul-uehi”, “Ruhani Khezain”, vëll. 22, f. 265.

tërbuar. Ai filloi t'i trembej ujit. Gjendja e tij ishte alarmante. Atëherë u shqetësova pa masë për atë kurbetxhi të gjerë dhe gjeta përqendrimin e duhur për të bërë lutje për të.

Çdonjëri mendonte që ai i gjerë do të vdiste pas disa orësh. Detyrimisht atë e larguan nga konvikti dhe e vendosën në një vend tjetër larg njerëzve, duke marrë të gjitha masat karantinore. Mjekëve anglezë të Kasolit u dërguam telegram për të pyetur se a mund t'i bëjmë ndonjë mjekim në këtë gjendje. Ata na kthyen përgjigje nëpërmjet telegramit duke thënë: “Tanimë nuk ka asnjë ilaç për të”. Por unë u shqetësova shumë në zemër për atë djalë të gjerë dhe kurbetxhi dhe gjeta përqendrim të veçantë për lutje. Edhe miqtë e mi më thoshin vazhdimisht që të lutesha për të, sepse në këtë gjendje, larg shtëpisë së tij, ai të ngjallte mëshirë. Gjithashtu, kisha frikë se, nëse do të vdiste, vdekja e tij do të shkaktonte përbuzjet e kundërshtarëve. Atëherë, zemra ime ndjeu një shqetësim dhe dhimbje të fortë për të dhe unë gjeta një përqendrim të jashtëzakonshëm, që kurrë nuk mund ta gjeja nga forcat e mia. E gjithë kjo ishte nga Zoti i Lartësuar.

Kur gjendet ky lloj përqendrimi, atëherë me urdhrin e Zotit të Lartësuar tregon një efekt të tillë, që ka mundësi që edhe një i vdekur mund të ringjallet. Shkurt, gjeta gjendjen që do të më mundësonte pranimin e lutjes prej Zotit, dhe kur ajo arriti kulmin e saj dhe dhimbja më pushtoi zemrën, atëherë të sëmurit, i cili më saktë duhet të quhej i vdekur, filluan t'i shfaqeshin shenjat e përmirësimit. Para pak kohësh ishte koha kur ai i trembej ujit dhe i ikte dritës, kurse tani ai përnjëherë filloi ta merrte veten dhe tha: “S’kam frikë më nga uji”. Atij i dhanë ujë, të cilin e piu

pa asnjë frikë, madje mori abdes dhe fali namazin dhe gjithë natën fjeti qetësisht. Më nuk kishte asnjë grimë tërbimi dhe, më në fund, brenda disa ditësh, u shërua tërësisht.

Gjatë lutjes, vetëtimthi m'u diktua në zemër, që kjo gjendje tërbimi e tij nuk ishte që ai të vdiste, por që të shfaqej një mrekulli e Zotit të Lartësuar. Njerëz me përvojë thonë se kurrë nuk ka ndodhur në botë që dikë ta ketë ngrënë një qen i tërbuar dhe shenjat e tërbimit t'i ishin shfaqur në këtë mënyrë dhe ai të shpëtonte. Cila mund të jetë dëshmia më e madhe, sesa ajo që mjekët specialistë të kësaj sëmundjeje që shërbejnë në spitalin shtetëror të qytetit Kasoli, i ishin përgjigjur me fjalë të prera telegramit tonë që s'ka mjekim më për të.

Duhet të shtoj një gjë këtu, që, kur jam lutur për atë djalë, Zoti më dërgoi mesazh në zemrën time që t'i jepja një ilaç të caktuar dhe unë ia dhashë atij disa herë, derisa ai u shërua, ose më saktë u ringjall nga vdekja. Ndërsa përgjigjja që kishte ardhur nga mjekët e Kasolit, e cila është në anglisht, po e shkruajmë më poshtë bashkë me përkthimin e saj. Ata thanë:

“Sorry, nothing can be done for Abdul Karim”.

“Me keqardhje, nuk mund të bëjmë asgjë për Abdul Kerimin”⁴⁹⁹

499. “Tatima Hakikatul-uehi”, “Ruhani Khezain”, vëll. 22, f. 480-481.

Hazret Mesihu i Premtuar^{as} thotë:

Kjo është plotësisht e vërtetë, që njerëzve të afërt me Zotin u pranohen shumica e lutjeve. Madje, mrekullia e tyre më e madhe është pikërisht pranimi i lutjes. Kur ata ndiejnë shqetësim në zemër, për shkak të ndonjë vështirësie dhe në atë gjendje shqetësimi ata i drejtohen Zotit të tyre, Zoti i dëgjon dhe atëherë dora e tyre bëhet sikur dora e Zotit. Zoti është si një thesar i fshehur. Ai zbulon fytyrën e Tij përmes njerëzve të përsosur e të pranuar. Shenjat e Zotit shfaqen pikërisht në kohën kur të pranuarit e Tij shqetësohen, kur të tjerët i lëndojnë jashtë mase. Kur ndodh kjo, atëherë kuptojeni se shenja e Zotit do të shfaqet së shpejti, madje ajo mund të jetë te dera. Kështu ndodh, sepse Zoti i do kaq shumë njerëzit, që me zemër e me shpirt bëhen të Tij, saqë nuk mund të dojë ndokush kaq shumë as djalin e tij të dashur. Zoti bën mrekulli për hir të tyre dhe tregon forcën e Tij në atë mënyrë, sikur të jetë zgjuar një luan nga gjumi. Zoti është i fshehtë dhe janë pikërisht këta njerëz, të cilët e zbulojnë Atë. Zoti qëndron pas mijëra perdeve dhe janë pikërisht këta njerëz, që ia zbulojnë fytyrën.⁵⁰⁰

500. “Hakikatul-uehi”, “Ruhani Khezain”, vëll. 22, f. 20-21.

Lutjet e Imam Mehdiut, Mesihut të Premtuar^{as}

Një lutje e përlurur për të kërkuar faljen e mëkateve

Hazret Mesihu i Premtuar^{as}, në një letër ngushëllimi, duke iu drejtuar me shumë modesti Maulana Nuruddinit (Kalifit të Parë të Mesihut të Premtuar), të cilit i kishte vdekur djali, (në gusht 1885), i tërheq vëmendjen për këtë lutje. Ai shkruan:

Kjo lutje është zakoni i këtij robi modest dhe në të vërtetë është tamam për gjendjen time.

Ai gjithashtu e këshilloi:

Është mirë që, kur ta bëni këtë lutje, të keni parasysh që lutësi duhet ta pranojë gabimin e tij me gjithë zemër dhe gjithashtu favorin dhe bekimin e Zotit të tij. Sepse s'ka dobi nëse thuhet vetëm me gojë, ndaj duhet një emocion në zemër, bashkë me mallëngjimin e me të qarët.

Pastaj ai i tregoi se si duhet bërë kjo lutje, duke thënë:

Zgjuhuni në pjesën e fundit të natës, merrni abdes dhe me shumë sinqeritet falni dy nafle, pastaj bëni këtë lutje me shumë përlurje e me shumë dhimbje:

O Mirëbërësi im, o Zoti im, unë jam një rob Yti, i paaftë, shumë mëkatar dhe shumë përtac. Unë bëja padrejtësi pas padrejtësie

dhe Ti më dhe bekime mbi bekime. Unë bëja mëkat pas mëkati dhe Ti më bëre mirësi pas mirësie. Ti gjithmonë m'i mbulove mëkatet dhe më dhurove bekimet e Tua të panumërta. Prandaj, edhe tani, më mëshiro mua njeri të kotë dhe mëkatar, dhe më fal gabimin dhe mosmirënjohjen time e më liro nga ky mëkat imi, se s'ka ndihmës tjetër përveç Teje. Amin! Amin!⁵⁰¹

Disa lutje të tjera për shpëtimin nga mëkatet

O Zoti im! Jam rob Yti mëkatar, i pavlerë. Udhëzomë!⁵⁰²

Jemi robërit e Tu mëkatarë. Vetja na ka pushtuar. Na fal dhe na shpëto nga rreziqet e botës së përtejme.⁵⁰³

Jam mëkatar dhe i pafuqishëm. Pa mbështetjen dhe bekimin Tënd nuk mund të bëhet asgjë. Më mëshiro, më pastro, sepse kurrsesi nuk mund të pastrohem nga mëkatet, përveçse me bekimin dhe mëshirën Tënde.⁵⁰⁴

Lutja e pendesës gjatë *bejt*it (besëlidhjes)

Bejti që mori Hazret Mesihu i Premtuar^{as} nga Hazret Maulana Nurudini^{ra}, nga kërkesa e këtij të fundit, Hazret Mesihu i Premtuar^{as} ia kishte shkruar në letër. Fjalët e tij janë:

**Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit
Atë e lavdërojmë dhe (të Dërguarit të Tij) i dërgojmë *salavate***

501. "Maktubat-e-Ahmedia", vol. 5, nr. 2, f. 3.

502. "Malfuzat" vëll. 7, botim i vjetër f. 227.

503. Gazeta "El-Beder", vëll. 2, f. 30.

504. Gazeta "El-Beder", vëll. 3, f. 41.

Sot, në dorën e Ahmedit pendothem për të gjitha mëkatet dhe veset, në të cilat isha i përfshirë dhe me zemër të sinqertë dhe vullnet të palëkundur zotohem se do të përpiqem sipas forcës dhe mendjes sime të shpëtoj nga mëkatet deri në ditën e fundit të jetës. Besimit do t'i jap përparësi mbi rehatinë materiale dhe mbi dëshirat vetjake. Sa të kem mundësi do t'u përmbahem dhjetë kushteve të përmendura në broshurë. I kërkoj falje Zotit të Madhërishëm për mëkatet e mia të mëparshme!

أَسْتَغْفِرُ اللَّهَ رَبِّي. أَسْتَغْفِرُ اللَّهَ رَبِّي. أَسْتَغْفِرُ اللَّهَ رَبِّي مِنْ كُلِّ ذَنْبٍ وَأَتُوبُ إِلَيْهِ وَأَشْهَدُ أَنْ
لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ وَأَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ. رَبِّ إِنِّي ظَلَمْتُ نَفْسِي
وَاعْتَرَفْتُ بِذُنُوبِي. فَاعْفِرْ لِي ذُنُوبِي فَإِنَّهُ لَا يَغْفِرُ الذُّنُوبَ إِلَّا أَنْتَ.

I kërkoj falje Allahut, Zotit tim! I kërkoj falje Allahut, Zotit tim!
I kërkoj falje Allahut, Zotit tim, për çdo mëkat dhe kthehem
tek Ai! Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut. Ai
është i Vetëm dhe i Pashoq dhe dëshmoj se Muhammedi është
robi dhe i Dërguari i Tij. O Zoti im! I kam bërë keq vetes dhe
pranoj fajin tim. M'i fal mëkatet, sepse askush nuk mund të m'i
falë ato, përveç Teje!

Z. Mir Shefi Ahmed nga qyteti i Delhit rrëfen:

*Kur Hazret Mesihu i Premtuar^{as} thoshte fjalët e bejtit, të gjithë
njerëzit qanin dhe u lotonin sytë, sepse zëri i tij vinte kaq
emocionues, saqë njerëzit fillonin të qanin.⁵⁰⁵*

E vërteta është që kjo lutje e Profetit Muhammed^{sas} (të cilën e përdori
Mesihu i Premtuar^{as} në lutjen e pendesës gjatë bejtit) ka një ndikim

505. "Siratul-Mehdi", pj. III, nr. i rrëfimit 747, f. 166.

të thellë. Madje, edhe tani kur e bëjmë bashkërisht, përjetojmë të njëjtin emocion. Ajo lutje është:

O Zoti im! I kam bërë keq vetes dhe e pranoj fajin tim. M'i fal mëkatet, sepse askush nuk mund të m'i falë ato, përveç Teje!

Kjo vërtetohet nga vetë Mesihu i Premtuar^{as}, sepse thotë:

Gjatë bejtit kur njeriu pendohet, zbret një bekim.⁵⁰⁶

Lutje për të kërkuar pëlqimin e Zotit

Në një letër të tij të drejtuar Hazret Navab Muhamed Ali Khanit, Hazret Mesihu i Premtuar^{as} e këshilloi:

Lutuni shumë dhe përvetësoni përlësinë. Lutja që bëhet thjesht nga goja si traditë a zakon, nuk ka asnjë dobi. Përveç namazeve të obligueshme, bëni shprehi për të kaluar pak kohë në vetmi dhe lutuni në gjuhën tuaj me përlësi të skajshme, sikur të jeni robi më i ulët. Lutjuni Zotit të Lartësuar:

O Zoti i botëve! Nuk mund të të falënderoj për mirësitë e Tua. Ti je shumë Mëshirëbërës dhe shumë Bujar. Unë kam favoret e Tua të panumërta. M'i fal mëkatet, që të mos shkatërrohem! Vendos në zemrën time dashurinë Tënde të pastër, që të ringjallem! M'i mbulo gjynahet dhe më mundëso të bëj punë të tilla, që Ti të kënaqesh! Kërkoj mbrojtjen e fytyrës Sate bujare, që të mos më përfshijë zemërimi Yt! Vetë mëshiromë dhe shpëtomë nga gjëmat në besim, në botë e në ahiret, sepse çdo bekim e mëshirë është në dorën Tënde! Amin! Amin!⁵⁰⁷

506. "Malfuzat" vëll. 4, f. 174.

507. "Maktubat-e-Ahmedia" vëll. 5, nr. i letrës 4, f. 5.

Lutja e vetmisë për të pasur shoqërinë e Zotit

O Zoti im! Dëgjo klithmën time, sepse jam i vetëm. O Streha ime! O Mbrojtësi im! O i Dashuri im! Mos më lër kështu! Unë jam me Ty dhe shpirti im është në sexhde te pragu Yt.⁵⁰⁸

Lutje për të pasur përqendrim në namaz

Më 16 maj të vitit 1902, Hazret Mesihu i Premtuar^{as} i shkroi një letër Maulvi Nezir Husejn Sakhaut të Delhit duke iu përgjigjur letrës së tij dhe duke i treguar metodën për të pasur përqendrim në namaz. Ai i tha:

Lutuni vazhdimisht në namaz për veten dhe mos u gëzoni nga namazi i pavëmendshëm dhe sipërfaqësor, madje, sa të keni mundësi, përpiquni ta falni me përqendrim. Nëse nuk përqendrohëni dot, bëni këtë lutje në namaz, kur ngriheni pas çdo rekati, në të gjitha faljet e pesë vakteve:

O Zot i Madhërishëm, i Plotfuqishëm dhe i Gjithëpushtetshëm! Jam mëkatar dhe helmi i mëkatit kaq shumë më ka ndikuar në zemër, mish dhe gjak, sa që nuk gjej dot emocion dhe përqendrim në namaz. Ti Vetë me bekimin dhe mëshirën Tënde m'i fal mëkatet, gjynahet dhe më zbut zemrën dhe vendos në të madhësinë Tënde, frikën Tënde dhe dashurinë Tënde, në mënyrë që të më hiqet ngurtësia e saj dhe unë të gjej përqendrim në namaz!⁵⁰⁹

508. Sheikh Jakub Ali Irfani, "Siret Hazret Mesih Maud^{as}", vëll. 5, f. 573.

509. "Fatava Mesih Muad", f. 37.

Lutje për të shpëtuar nga mosagjërimi në muajin e Ramazanit

Duke këshilluar për lutje, për të pasur mundësinë e agjërimin, Hazret Mesihu i Premtuar^{as} thotë:

Çdo gjë duhet t'ia kërkonti Zotit të Madhërishëm. Ai është i Plotfuqishëm absolut dhe nëse do, mund të mundësojë edhe një të sëmurë me temperaturë që të agjërojë. Prandaj, sipas meje, ai që nuk agjëron dot, le të lutet:

O Zoti im! Ky është muaji Yt i bekuar dhe unë mbetem i privuar nga ky. Kushedi nëse vitin e ardhshëm do të jem i gjallë apo jo, a do të mund të plotësoj agjërimet që nuk po agjëroj apo jo?!

Personi i tillë, nëse do t'i kërkojë mundësi Zotit, jam i bindur që Zoti i Madhërishëm do t'i japë forcë atij.⁵¹⁰

Lutje për të bërë në Qabe

Në një letër të tij që i kishte shkruar mikut të vet të quajtur Hazret Sufi Munshi Ahmed Xhani, kur ai po shkonte në haxh, Hazret Mesihu i Premtuar^{as} i kërkoi të bënte lutje për të, duke thënë:

Unë, modest dhe i kotë, kam një kërkesë shumë modeste. Me bekimin e Zotit, kur do të gëzoni vizitën e Shtëpisë së Allahut, në atë vend të lavdishëm e të bekuar, lutuni me zemër të prekur me këto fjalë nga ana e një robi më të pavalërë prej robërve të Allahut si unë:

510. "Malfuzat", vëll. 2, f. 563.

O Mëshiruesi i të gjithë mëshiruesve! Një rob i paaftë, i kotë, shumë mëkatar dhe i pavlerë, i quajtur Ghulam Ahmed, që jeton në tokën Tënde të Indisë po të lutet: O Mëshiruesi i të gjithë mëshiruesve! Ji i kënaqur me mua dhe m'i fal gjynahet dhe mëkatet, sepse Ti je shumë Mëkatfalës dhe Mëshirëbërës dhe më mundëso të bëj punë të tilla, me të cilat Ti kënaqesh jashtëzakonisht shumë. Midis meje dhe vetes sime vendos largësinë e Lindjes e Perëndimit dhe jetën time, vdekjen time dhe çdo forcë që kam, përdore në rrugën Tënde. Më mbaj gjallë vetëm me dashurinë Tënde, më merr shpirtin vetëm me dashurinë Tënde dhe më ringjall vetëm midis ndjekësve që përsosmërisht janë të dashuruar me Ty. O Mëshiruesi i të gjithë mëshiruesve! Vetë me bekimin Tënd përmbushe detyrën për të cilën më ke caktuar dhe për të cilën më ke dhënë kaq pasion në zemër. Përsose Islamin me dorën time të paaftë përballë kundërshtarëve dhe të gjithë atyre që ende nuk janë në dijeni të të mirave të tij. Në saje të faljes dhe mëshirës Sate më mbaj në strehën Tënde mbrojtëse mua të paaftë, dhe të gjithë miqtë, të sinqertët dhe bashkëmendimtarët e mi dhe bëhu Mbrojtësi dhe Miku i tyre në besim e në botë dhe pranoji ata të gjithë në shtëpinë Tënde të pëlqimit. *Salavate*, selam dhe bekime sa më shumë qofshin mbi Profetin^{sas}, mbi popullin dhe sahabët e tij! Amin, o Zoti i botëve!

Kjo është lutja ime në Shtëpinë e Allahut, pranë Mëshiruesit të të gjithë mëshiruesve. Konsiderojeni si obligim që ta bëni këtë lutje po me këto fjalë, pa bërë asnjë ndryshim.

Paqja qoftë mbi ju!

Përvulësisht

Ghulam Ahmed, 1303 hixhri⁵¹¹

511. "Maktubat-e-Ahmedia" vëll. 5, f. 17-18; "Maktubat Imam hamam kelmi", vëll. 1, viti 1892, f. 61.

Lutje për të varrosurit në *Bahishti Makberah*⁵¹²

Lutem që Zoti ta bekojë këtë tokë dhe ta bëjë atë *Bahishti Makberah*. Aty u prefshin njerëz zemërpastër të këtij xhemati, të cilët me të vërtetë i dhanë fesë përparësi mbi botën dhe duke hequr dorë nga kënaqësia e kësaj bote; u bënë të Zotit, sollën një ndryshim të pastër në qeniet e tyre dhe treguan shembullin e besnikërisë dhe vërtetësisë, ashtu si i Dërguari i Allahut^{sas} dhe sahabët e tij! Amin, o Zoti i botëve!

Lutem sërisht: O Zoti im i Plotfuqishëm! Bëje këtë tokë varrezë të atyre zemërpastërve nga xhemati im, që me të vërtetë janë bërë të Tutë dhe punët e të cilëve nuk kanë qëllime të kësaj bote! Amin, o Zoti i botëve!

Lutem përsëri për herë të tretë: O i Plotfuqishmi dhe Bujari im, o Zot Mëkatfalës dhe i Mëshirshëm! Vetëm atyre jepu vend për varr, të cilët kanë besim të vërtetë te ky i dërguar Yti; të cilët nuk kanë aspak hipokrizi, qëllime vetjake dhe paragjykime dhe besojnë e binden ashtu siç duhet; të cilët, me zemrat e tyre kanë sakrifikuar jetën për hirin Tënd e në rrugën Tënde; me të cilët Ti je i kënaqur dhe sipas dijenisë Sate ata janë kredhur në dashurinë Tënde; të cilët, me plot besnikëri, respekt e besimçiltërsi, kanë lidhje dashurie e devotshmërie me të dërguarin Tënd. Amin, o Zoti i botëve!⁵¹³

512. Varrezë e xhenetlinjve

513. "Testamenti", Prishtinë, 2011, f. 21-23.

Lutje për xhematin e tij

Në librin e tij “Kishti-e-Nuh” (Arka e Nuhut), pasi përmend temën “Mësimi ynë”, Hazret Mesihu i Premtuar^{as} e mbyll me këtë lutje:

“Tani, lutem që ky mësim imi të bëhet i dobishëm për ju dhe paçi ndryshim të tillë në veten tuaj, saqë u bëfshi yjet e Tokës dhe Toka u ndriçoftë nga drita që ju do të merrni prej Zotit tuaj!”⁵¹⁴

Lutje për përparimin e xhematit Ahmedia

“O Zot im! Xhemati im përparoftë dhe pastë ndihmën dhe mbështetjen Tënde.”⁵¹⁵

Unë lutem shumë që xhemati im të bëhet ndër ata që i druhen Zotit të Madhërishëm, tregohen të qëndrueshëm në namaz, çohen gjatë natës dhe bien në tokë dhe qajnë, që nuk shpërfillin porosinë e Zotit; që nuk janë koprracë e dorështrënguar dhe që nuk janë krimba të tokës. Shpresoj që Zoti i Madhërishëm do të m’i dëgjojë këto lutje dhe do të më tregojë se unë lë pas njerëzit me cilësitë e lartpërmendura dhe jo ata, sytë e të cilëve bëjnë kurvëri, zemrat e të cilëve janë më keq se jashtëqitjet dhe që nuk e kanë parasysh vdekjen fare. Unë dhe Zoti im jemi të distancuar nga ata. Do të jem shumë i gëzuar nëse njerëzit e tillë do të shkëpusin lidhjen e tyre me mua, sepse Zoti dëshiron ta bëjë këtë xhemat një popull, që të tjerët ta kujtojnë Zotin vetëm duke parë shembullin e tyre. Njerëzit e mi duhet të jenë në gradën më të lartë të druajtjes e të dëlirësisë, që me të vërtetë i kanë dhënë

514. “Kishti-e-Nuh”, “Ruhani Khezain”, vëll. 19, f. 85.

515. Sheikh Jakub Ali Irfani, “Siret Hazret Mesih Maud^{as}”, vëll. 5, f. 628.

*besimit përparësi mbi botën. Por ata çrregullues që vendosin dorën e tyre nën dorën time për të pohuar se besimit do t'i japin përparësi mbi botën, dhe kthehen nëpër shtëpi e angazhohen kaq shumë në punë çrregulluese, saqë zemrat e tyre pushtohen vetëm nga bota, as shikimin nuk e kanë të pastër e as zemrën. As duart e tyre nuk bëjnë ndonjë mirësi e as këmbët e tyre nuk lëvizin drejt ndonjë pune të mirë. Ata i ngjajnë miut që jeton në errësirë, që qëndron dhe vdes aty. Njerëzit e tillë janë të shkëputur nga xhemati ynë në qiell. Ata më kot pohojnë se bëjnë pjesë në këtë xhemat, sepse në qiell ata nuk janë pjesëtarë të këtij xhemati”.*⁵¹⁶

Lutje për kundërshtarët

“O kundërshtarë! Zoti ju mëshiroftë dhe ju haptë sytë!”⁵¹⁷

“Jam shumë i brengosur për këtë popull të paditur, si ai që brengoset nga sëmundja e një familjari të vet. Lutem:

O Zot i Plotfuqishëm dhe i Madhërishëm! O Udhëzuesi dhe Prijësi ynë! Hapu sytë këtyre njerëzve, dhuroju shikim dhe dërgo në zemrat e tyre diktimin e vërtetësisë dhe të udhëzimit!⁵¹⁸

“O Zot i Plotfuqishëm dhe Absolut! Edhe pse zakoni dhe praktika Jote e hershme është që fëmijëve dhe të pashkolluarve u dhuron mend, ndërsa të zgjuarve të kësaj bote dhe filozofëve u vë perde të errëta në sytë e në zemrat e tyre, po përgjerohem dhe lutem me shumë përlësi pranë Teje, që edhe prej këtyre njerëzve tërhiq një grup drejt nesh, ashtu siç na ke sjellë disa të

516. “Tablig-e-risalat”, vëll. 10, f. 61-62.

517. “Berahin-e-Ahmedia”, vëll. 5, “Ruhani Khezain”, vëll. 21, f. 79.

518. “Maktubat-e-Ahmedia”, vëll. 6, pj. I, f. 98.

tillë. Edhe atyre jepu sy, veshë dhe zemra, në mënyrë që edhe ata të shohin, të dëgjojnë, të kuptojnë e të vlerësojnë bekimin Tënd, që Ti ke zbritur në kohën e duhur dhe të kushtojnë vëmendjen e duhur për ta gjetur atë. Ti mund ta bësh këtë, nëse e do, sepse asgjë nuk është e pamundur për Ty!”⁵¹⁹

Në librin e tij “Hakikatul-uehi”, pasi përmend shenja të vërtetësisë së tij, Hazret Mesihu i Premtuar^{as} lutet:

“Zoti i Lartësuar krijoftë shumë shpirta të tilla, që përfitojnë nga këto shenja, që zgjedhin rrugën e së vërtetës dhe që heqin dorë nga mëria dhe urrejtja. O Zoti im i Plotfuqishëm! Dëgjoji lutjet e mia të përulura dhe hapja veshët dhe zemrën këtij populli. Na trego atë kohë, kur adhurimi i të adhuruarve të rremë të zhduket nga kjo botë dhe Ti të adhurohesh me sinqeritet dhe Toka të mbushet kaq shumë me robër të sinqertë dhe adhurues të Tu, ashtu siç deti është i mbushur me ujë. Po ashtu, edhe madhështia dhe vërtetësia e të Dërguarit Tënd fisnik, Muhammedit^{sas}, të rrënjoset në zemrat e njerëzve.

O Zoti im i Plotfuqishëm! Ma trego këtë ndryshim në botë dhe m’i prano lutjet, sepse çdo forcë e fuqi e ke vetëm Ti. Kështu bëje, o Zot i Plotfuqishëm! Amin! Amin!”⁵²⁰

519. “Izala-e-Auham”, “Ruhani Khezain”, vëll. 3, f. 120.

520. “Hakikatul-uehi”, “Ruhani Khezain”, vëll. 22, f. 603.

Lutje për vendosjen e njëshmërisë së Zotit në të gjithë botën

O Zot i Plotfuqishëm! O Udhëzuesi i robërve të Tu! Ashtu siç e ke veçuar këtë epokë si epokë të mjeteve të reja e të zhvilluara, në të njëjtën mënyrë zbuloj argumentet e Kuranit Famëlartë popujve të paditur dhe tërhiq njerëzit e kësaj epoke drejt Vetes, drejt librit Tënd dhe drejt njëshmërisë Sate. Mohimi dhe idhujtaria janë përhapur shumë dhe Islami është zbehur. Tani, o Zot i Nderuar, lëshoje flladin e njëshmërisë Sate në Lindje e në Perëndim dhe trego një shenjë tërheqëse prej qiellit. O Mëshirëbërës! Jemi shumë nevojtarë të mëshirës Sate. O Udhëzues! Na duhen shumë udhëzimet e Tua. Sa e bekuar do të jetë ajo ditë, kur do të zbresë drita Jote! Sa fatsjellës do të jetë ai çast, kur do të bjerë daullja e fitores Sate! Te Ti u mbështetëm. Sundim dhe fuqi s'ka askush tjetër përveç Teje dhe Ti je i Larti, Madhështori.⁵²¹

Lutje për udhëzimin e njerëzimit

O Zot, Bujar! Udhëzo zemrat e përgatitura të të gjithë popujve, që ata të besojnë Muhammed Mustafain^{sas}, të Dërguarin Tënd më të bekuar nga të gjithë të dërguarit, dhe Kuranin Famëlartë, fjalën Tënde të përsosur e të shenjtë, dhe të zbatojnë porositë e tyre, në mënyrë që të gëzojnë shpëtimin dhe jetën e amshueshme, të cilat i mundësohen njeriut jo vetëm në botën e përtejme, por të sinqertët i gjejnë që në këtë botë. O Zot, Bujar! Udhëzoje popullin anglez në veçanti, i cili ende nuk ka marrë aspak dritë nga ky diell i

521. "Aina-e-kamalat-e-Islam", "Ruhani Khezain", vëll. 5, f. 213-214.

vërtetësisë. I jemi mirënjohës qeverisë së tij, për shkak të mirësive dhe bashkëpunimit miqësor të saj dhe kjo pikërisht na nxit fort, që ne të duam mirësi dhe paqe për ta, në mënyrë që fytyrat e tyre, ashtu siç janë të zbardhura në këtë botë, të jenë të ndritura edhe në ahiret.

فَنَسْأَلُ اللَّهَ تَعَالَى خَيْرَهُمْ فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ اللَّهُمَّ اهْدِهِمْ وَأَيِّدِهِمْ
بِرُوحِ بِنِكَ وَاجْعَلْ لَهُمْ حَظًّا كَثِيرًا فِي دِينِكَ وَاجْذِبْهُمْ بِحَوْلِكَ
وَقُوَّتِكَ لِيُؤْمِنُوا بِكِتَابِكَ وَرَسُولِكَ وَيَدْخُلُوا فِي دِينِ اللَّهِ أَفْوَاجًا -
آمِينَ ثُمَّ آمِينَ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ -“

I kërkojmë Allahut të mirën për ta në këtë botë dhe në ahiret. O Allah! Udhëzoji dhe ndihmoji ata me shpirtin prej Teje dhe dhuroju një pjesë të madhe të besimit Tënd, tërhiqi drejt Vetes me fuqinë dhe forcën Tënde, që ata të besojnë librin Tënd, të Dërguarin Tënd dhe të hyjnë grupe-grupe në fenë Tënde. Amin! Amin! Lavdia është e Allahut, Zotit të botëve!⁵²²

Lutje për pjesëmarrësit në *Xhelsa Salana*

“Në fund, e mbyll me lutjen, që:

Zoti i Lartësuar qoftë me të gjithë ata që do të marrin rrugën për të ardhur në këtë *Xhelsa*, që është për hir të Zotit! Zoti i shpërbleftë me shpërblim të madh, i mëshiroftë, u lehtësoftë vështirësitë dhe shqetësimet dhe u largoftë dhimbjet e brengat, i liroftë nga çdo shqetësim dhe u plotësoftë dëshirat, i ringjalltë në ditën e ahiretit bashkë me ata robër të Tij, që gëzojnë bekimin dhe mëshirën e Tij,

522. “Maxhmua ishtiharat”, vëll. 1, f. 25.

**dhe Vetë u bëftë Udhëheqësi i tyre deri në fund të udhëtimit të tyre!
O Zot! O Zotëruesi i nderit dhe i dhuntisë! O Mëshirëbërës dhe
Larguesi i shqetësimeve! M'i prano të gjitha këto lutje dhe na jep
triumf mbi kundërshtarët tanë me shenja të qarta, sepse vetëm Ti
ke çdo forcë e fuqi! Amin! Amin!**

Paqja qoftë mbi atë që ndjek udhëzimin!

Autor modest, Ghulam Ahmed nga Kadiani, rrethi i Gurdaspurit.

Allahu më faltë!

7 dhjetor 1892

**Udhëzime të Hazret Mesihut të Premtuar^{as}
rreth disa lutjeve të Kuranit**

(1) Hazret Mesihu i Premtuar^{as} thotë:

Nuk ishte askush me mua në këtë botë, kur Zoti më mësoi lutjen:

رَبِّ لَا تَذَرْنِي فَرْدًا وَأَنْتَ خَيْرُ الْوَارِثِينَ

O Zoti im! Mos më lër vetëm! Ti je më i miri nga të gjithë trashëgimtarët. (Kurani Famëlartë 21:90)⁵²³

(2) Xhemati ynë duhet ta bëjë sa më shumë lutjen e mëposhtme në rekatën e fundit të çdo namazi, pasi të ngrihen nga ruku:

رَبَّنَا آتِنَا فِي الدُّنْيَا حَسَنَةً وَفِي الْآخِرَةِ حَسَنَةً وَقِنَا عَذَابَ النَّارِ

O Zoti ynë! Na jep të mirën në këtë botë, të mirën në ahiret dhe na shpëto nga ndëshkimi i zjarrit! (Kurani Famëlartë 2:202)⁵²⁴

(3) Hazret Mesihu i Premtuar^{as}, në një vend tjetër, thotë:

Këto ditë duhet të bëni lutjen e Hazret Ademit^{as}, e cila i ishte pranuar menjëherë.⁵²⁵

Lutja e Hazret Ademit^{as} ishte:

رَبَّنَا ظَلَمْنَا أَنفُسَنَا وَإِن لَّمْ تَغْفِرْ لَنَا وَتَرْحَمْنَا لَنَكُونَنَّ مِنَ الْخَاسِرِينَ

O Zoti ynë! I kemi bërë keq vetes! Nëse nuk do të na falësh dhe nuk do të na mëshirosh, do të bëhemi ndër të humburit. (Kurani Famëlartë 7:24)

523. “Tuhfatun-nadvah”, “Ruhani Khezain”, vëll. 19, f. 97.

524. “Malfuzat”, vëll. 1, f. 6.

525. “Malfuzat”, vëll. 2, f. 577.

(4) Znj. Sejida Navab Mubarika Begum^{ra} pa një ëndërr, në të cilën Hazret Mesihu i Premtuar^{as} i tha: “Thuaji xhematit tim që të bëjë këtë lutje sa më shumë:

رَبَّنَا لَا تُزِغْ قُلُوبَنَا بَعْدَ إِذْ هَدَيْتَنَا وَهَبْ لَنَا مِنْ لَدُنْكَ رَحْمَةً، إِنَّكَ أَنْتَ الْوَهَّابُ

O Zoti ynë! Mos na shtrebëro zemrat pasi na ke udhëzuar dhe na dhuro mëshirë prej Teje! Me të vërtetë, Ti je Dhuruesi i madh!”
(Kurani Famëlartë 3:9)⁵²⁶

526. Gazeta “El-Fazl, 3 janar 1974, f. 4.

**Lutjet e Kuranit që iu shpallën
Hazret Mesihut të Premtuar^{as}**

(1) اللَّهُ خَيْرَ حَافِظًا وَهُوَ أَرْحَمُ الرَّاحِمِينَ

Allahu është Mbrojtësi më i mirë dhe është Mëshiruesi i të gjithë
mëshiruesve. (Kurani Famëllartë 12:65)⁵²⁷

(2) رَبِّ أَدْخِلْنِي مُدْخَلَ صِدْقِي

O Zoti im! Më mundëso hyrjen me vërtetësi. (Kurani Famëllartë
17:81)⁵²⁸

(3) رَبِّ أَرِنِي كَيْفَ تُحْيِي الْمَوْتَى

O Zoti im! Më trego se si i ringjall të vdekurit! (Kurani Famëllartë
2:261)⁵²⁹

(4) رَبِّ زِدْنِي عِلْمًا

O Zoti im! Më shto diturinë! (Kurani Famëllartë 20:115)⁵³⁰

(5) رَبِّ الْمَسْجِدِ أَحَبُّ إِلَيَّ مِمَّا نَدْعُونَكَ إِلَيْهِ

O Zoti im! Më shumë e dua burgun, sesa atë për të cilën ato më
ftojnë. (Kurani Famëllartë 12:34)⁵³¹

(6) رَبِّ لَا تَذَرْنِي الْأَرْضَ مِنَ الْكَافِرِينَ دَيَّارًا

O Zoti im! Mos lër askënd nga mohuesit të banojë në tokë. (Kurani
Famëllartë 71:27)⁵³²

527. "Tedhkirah" f. 107.

528. "Tedhkirah" f. 49.

529. "Tedhkirah" f. 241, 414, 727.

530. "Tedhkirah" f. 379.

531. "Tedhkirah" f. 101.

532. "Tedhkirah" f. 681.

(7) رَبَّنَا أَمْنَا فَأَكْتُبْنَا مَعَ الشَّاهِدِينَ-

O Zoti ynë! Ne besuam, prandaj na shëno ndër dëshmitarët.
(Kurani Famëlartë 5:84)⁵³³

(8) رَبَّنَا افْتَحْ بَيْنَنَا وَبَيْنَ قَوْمِنَا بِالْحَقِّ وَأَنْتَ خَيْرُ الْفَاتِحِينَ

O Zoti ynë! Vendos me drejtësi midis nesh dhe midis popullit tonë.
Ti je më i miri prej të gjithë gjykatësve. (Kurani Famëlartë 7:90)⁵³⁴

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ ﴿١﴾ مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ ﴿٢﴾ وَمِنْ شَرِّ مَا نَسَفَ إِذَا وَقَبَ ﴿٣﴾

Thuaj: Kërkoj mbrojtjen e Zotit të agimit nga e keqja e asaj që
Ai ka krijuar; nga e keqja e errësuesit kur sjell errësirë. (Kurani
Famëlartë 113:2-4)⁵³⁵

Lutje të shpallura

(Lutjet kuranore që iu shpallën
Hazret Mesihut të Premtuar^{as} me pak ndryshime)

(1) Në vitin 1893, Hazret Mesihut të Premtuar^{as} iu shpall kjo lutje:

رَبِّ إِنِّي مَغْلُوبٌ فَأَنْتَ الصِّرْ

O Zoti im! Jam i pushtuar, më ndihmo!⁵³⁶

533. “Tedhkirah” f. 242.

534. “Tedhkirah” f. 241.

535. “Tedhkirah”, botimi i tretë, f. 82.

536. “Tedhkirah”, f. 245.

(2) Lutja e sipërme iu shpall edhe një herë më 26 prill 1903, por me disa fjalë shtesë:

رَبِّ اِنِّى مَغْلُوبٌ فَانْتَصِرْ فَسَجِّفْهُمْ تَسْجِيفًا

O Zoti im! Jam i pushtuar, më ndihmo, kurse ata shtypi tërësisht!⁵³⁷

Në një vend tjetër, në vend të fjalëve “*Jam i pushtuar*” raportohen fjalët “*Më është bërë padrejtësi*”.⁵³⁸

(3) رَبِّ اغْفِرْ وَاَرْحَمْ مِّنَ السَّمَاءِ

O Zoti im! (Më) fal dhe mëshiro nga qielli!⁵³⁹

(4) رَبِّ تَوَلَّنِي مُسْلِمًا وَالْجَفِيْنَ بِالصَّالِحِيْنَ

O Zoti im! Më jep vdekjen kur jam i nënshtruar dhe më bashko me të sinqertët!⁵⁴⁰

(5) رَبِّ نَجِّنِي مِنْ غَيِّ

O Zoti im! Më liro nga brenga ime!⁵⁴¹

(6) رَبِّ هَبْ لِي ذُرِّيَّةً طَيِّبَةً

O Zoti im! Më dhuro pasardhës të dëlirë!⁵⁴²

537. “Hakikatul-uehi”, “Ruhani Khezain”, vëll. 22, f. 107.

538. “Tadhkirah” f. 470.

539. “Tadhkirah” f. 47.

540. “Hakikatul-uehi”, “Ruhani Khezain”, vëll. 22, f. 111.

541. “Tadhkirah” f. 101.

542. “Tadhkirah” f. 740.

(7) رَبَّنَا أَمَّنَّا فَاكْتُبْنَا مَعَ الشَّاهِدِينَ

O Zoti ynë! Ne besuam! Prandaj, na shëno ndër dëshmitarët!⁵⁴³

(8) رَبَّنَا إِنَّنا جَنَّتَاكَ مَطْلُومِينَ فَافْرِقْ بَيْنَنَا وَبَيْنَ الْقَوْمِ الظَّالِمِينَ-

O Zoti ynë! Te Ti kemi ardhur pasi na është bërë padrejtësi. Bëj ndarjen midis nesh dhe popullit të padrejtë.⁵⁴⁴

(9) رَبَّنَا اغْفِرْ لَنَا ذُنُوبَنَا إِنَّا كُنَّا خَاطِبِينَ-

O Zoti ynë! Na fal gjynahet tona! Ne pa dyshim jemi gjynahqarë.⁵⁴⁵

(10) Në vitin 1907, Hazret Mesihut të Premtuar^{as} iu shpall kjo lutje:

رَبَّنَا لَا تَجْعَلْنَا طَعْمَةً لِّلْقَوْمِ الظَّالِمِينَ

O Zoti ynë! Mos na bëj kafshatë të popullit mizor!⁵⁴⁶

رَبَّنَا لَا تَجْعَلْنَا طَعْمَةً لِّلْقَوْمِ الظَّالِمِينَ-

Bëj që zemrat e shumicës së njerëzve të anojnë nga unë!⁵⁴⁷

(Hazret Mesihu i Premtuar^{as} tha: “Ky është një sihariq për përparimin e xhematit”.)

543. “Tadhkirah” f. 339; “Tirjakul-kulub”, f. 59, në fusnotë.

544. “Hakikatul-uehi”, “Ruhani Khezain”, vëll. 22, f. 621.

545. “Hakikatul-uehi”, “Ruhani Khezain”, vëll. 22, f. 104.

546. “Tadhkirah” f. 805.

547. “Tadhkirah” f. 776.

Lutje për të kërkuar falje dhe për t'u bërë rob i veçantë i Zotit

Hazret Mesihu i Premtuar^{as}, duke këshilluar Çaudri Rustem Aliun, që ishte një mik i tij i afërt, shkroi: “Bëni sa më shumë këtë lutje, në sexhdet tuaja, gjatë ditës e natës”.

يَا أَحَبُّ مِنْ كُلِّ مَحْبُوبٍ اغْفِرْ لِي ذُنُوبِي وَادْخِلْنِي فِي عِبَادِكَ الْمُخْلِصِينَ - آمين

**O Ti që je më i Dashuri nga të gjithë të dashurit! Më fal gjynahet
dhe më prano në grupin e robërve të Tu të sinqertë! Amin!**⁵⁴⁸

Lutje për të kërkuar falje dhe përfundim të mirë

Në një letër të tij drejtuar Mir Abas Aliut të Ludianasë, Hazret Mesihu i Premtuar^{as} i shkroi këtë lutje:

رَبَّنَا اغْفِرْ لَنَا ذُنُوبَنَا وَلَا خَوَانَنَا الَّذِينَ سَبَقُونَا بِالْإِيمَانِ وَصَلِّ عَلَيَّ
نَبِيِّكَ وَحَبِيبِكَ مُحَمَّدٍ وَآلِهِ وَسَلِّمْ وَتَوَقَّنَا فِي أُمَّةٍ وَأَتْبَعْنَا فِي أُمَّةٍ وَآتَنَا
مَا وَعَدْتِ لِأُمَّةٍ رَبَّنَا إِنَّا أَمْنَا فَكُتِبْنَا فِي عِبَادِكَ الْمُؤْمِنِينَ -

**O Zoti ynë! Na fal ne dhe vëllezërit tanë paraardhës në besim.
Lartësoje Profetin dhe të dashurin Tënd Muhammed, popullin
e tij dhe bekoje atë. Na jep vdekje në umetin e tij. Na jep atë që
i ke premtuar umetit të tij. O Zoti ynë! Ne besuam. Prandaj, na
shëno si robërit e Tu besimtarë.**⁵⁴⁹

548. “Maktubat-e-Ahmedia” vëll. 5, nr. 3, f. 74, letra e shkruar më 15 shkurt 1888.

549. “Maktubat-e-Ahmedia” vëll. 1, f. 108.

Lutje për të pasur pastërti dhe dëlirësi

Rreth vitit 1878, Hazret Mesihu i Premtuar^{as} shkroi:

Përafërsisht para njëzet e pesë vjetësh, kur isha në Gurdaspur, pashë një ëndërr. E pashë veten të ulur në një krevat. Në të njëjtin krevat ishte ulur edhe i ndjeri Maulvi Abdullah Geznavi. Ndjeva një motivim në zemër që ta ulja Maulvi Abdullahun në tokë. Kështu që, fillova të spostohesha tek ai, derisa ai zbriti nga krevati dhe u ul në tokë. Papritmas tre engjëj u shfaqën nga qielli, njëri prej të cilëve quhej Hejrajti. Edhe ata u ulën në tokë, bashkë me Maulvi Abdullahun, kurse unë vijoja të rrija mbi krevat. Atëherë u thashë: “Do të bëj një lutje dhe ju të gjithë thoni Amin!” U luta:

يَا أَذْهَبَ عَنِّي الرَّجْسَ وَطَهَّرْنِي تَطْهِيراً

O Zoti im! Largo papastërtinë nga unë dhe më pastro tërësisht!

Të tre engjëjt, si dhe Maulvi Abdullahu thanë “Amin!” dhe më pas ata të katërt u ngjitën në qiell. Atëherë më doli gjumi. Menjëherë e pata të qartë se vdekja e Maulvi Abdullahun është afër, ndërsa për mua po përgatitej një bekim i veçantë në qiell. Pas kësaj, gjithmonë ndieja që një forcë qiellore vepronte tek unë, derisa filluan të më vinin shpalljet. Ishte pikërisht ajo kohë, kur në një natë të vetme, Allahu i Lartësuar më përmirësoi në mënyrë të plotë e të përsosur dhe unë pata ndryshim të atillë në vetvete, që nuk mund të bëhet nga dora a vullneti i njeriut.⁵⁵⁰

550. “Hakikatul-uehi”, “Ruhani Khezain”, vëll. 18, f. 614-615.

Këshilla për të dërguar *salavatet* dhe për të kërkuar falje

Në një letër të tij të drejtuar Munshi Rustem Aliut, Hazret Mesihu i Premtuar^{as} e këshilloi:

Pas namazit të akshamit e të jacisë, dërgoni sa më shumë salavate, sa të keni mundësi. Dërgojini me plot dashurinë dhe sinqeritetin e zemrës. Do të jetë mirë nëse dërgoni salavate një mijë e njëqind herë ose shtatëqind herë në ditë.

اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ كَمَا صَلَّيْتَ عَلَى إِبْرَاهِيمَ
وَعَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ إِنَّكَ حَمِيدٌ مَّجِيدٌ-اللَّهُمَّ بَارِكْ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ
مُحَمَّدٍ كَمَا بَارَكْتَ عَلَى إِبْرَاهِيمَ وَعَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ إِنَّكَ حَمِيدٌ مَّجِيدٌ-

O Zot! Lartësoje Muhammedin dhe popullin e tij, ashtu siç e lartësove Ibrahimin dhe popullin e tij! Me të vërtetë, Ti je i Lavdëruar, i Nderuar!

O Zot! Bekoje Muhammedin dhe popullin e tij, ashtu siç e bekove Ibrahimin dhe popullin e tij! Me të vërtetë, Ti je i Lavdëruar, i Nderuar!

Këto salavate dërgojini dhe nëse vazhdimisht do të veproni kështu, me dashuri e zell të sinqertë, mund të takoni edhe të Dërguarin fisnik^{as}. Këto salavate janë shumë të fuqishme për të pasur qëndrueshmërinë dhe dritën shpirtërore. Përveç kësaj, pas namazit të sabahut, me përulësi të plotë kërkojini falje Zotit, të paktën njëqind herë.⁵⁵¹

551. “Maktubat-e-Ahmedia” vëll. 5, f. 7.

Salavatet që buruan nga thellësia e shpirtit

اللَّهُمَّ صَلِّ وَسَلِّمْ وَبَارِكْ عَلَيْهِ وَآلِهِ بِقَدْرِمَمِّهِ وَعَمِّهِ وَخُرْنِهِ لِهَيْدِهِ الْأُمَّةِ وَأَنْزِلْ
عَلَيْهِ أَنْوَارَ رَحْمَتِكَ إِلَى الْأَبَدِ

O Allah! Lartësoje Muhammedin^{sas}, dërgoji paqe dhe bekoje atë dhe familjen e tij sipas shqetësimit, dhimbjes dhe brengës që ai ndjeu për umetin e tij dhe hidh mbi të përgjithmonë dritën e mëshirës Sate.⁵⁵²

Disa lutje të veçanta

Duke këshilluar Hazret Navab Muhammed Ali Khanin që të lutej gjatë vështirësive në të cilat gjendej, Hazret Mesihu i Premtuar^{as} i tha:

Pas namazeve, thoni me përulësi të plotë:

لَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ الْعَلِيِّ الْعَظِيمِ

Sundim dhe fuqi s’ka askush tjetër, përveç Allahut të Lartësuar, të Madhërishëm.

Dhe para se të flini, pasi të keni falur namazet e zakonshme, thoni të paktën dyzet e një herë salavatet. Më pas falni dy rekate namaz dhe në çdo sexhde, bëni të paktën tri herë këtë lutje:

يَا حَيُّ يَا قَيُّوْمُ بِرَحْمَتِكَ أَسْتَغِيْثُ

O i Gjallë! O i Qëndrueshëm! Në saje të mëshirës Sate Të përgjërohem.⁵⁵³

552. “Barakatud-dua”, “Ruhani Khezain”, vëll. 6, f. 10-11.

553. “Maktubat-e-Ahmedia” vëll. 7, pj. I, f. 33.

Lutje e shpallur për të shpëtuar nga gjëma dhe sëmundja

Rreth vitit 1880, Hazret Mesihu i Premtuar^{as} u sëmur keq. Kaloi 16 ditë me diarre me hemorragji. E njëjta sëmundje i kishte marrë jetën dikujt tjetër në fshat brenda tetë ditësh. Prandaj, njerëzit e shtëpisë së Mesihut të Premtuar^{as}, të dëshpëruar i kënduan tri herë suren *Jasin*. Ai thotë:

Ashtu siç Zoti i Madhërishëm u mësoi lutje të ndryshme disa profetëve të Tij për të shpëtuar nga vështirësitë në të cilat ata gjendeshin, edhe mua më mësoi një lutje, duke më dërguar shpallje.

Siç qe udhëzuar në shpallje, Hazret Mesihu i Premtuar^{as} mori ujin e lumit me gjithë rërën, tha lutjen e shpallur dhe lagu duart, fytyrën, kraharorin dhe kurrizin me të. Hazret Mesihu i Premtuar^{as} shton:

Betohem për Atë Zot, në dorën e të cilit është jeta ime, çdo herë kur i përsërisja fjalët dhe e lagia trupin me ujë, ndieja që zjarrmia më largohej nga trupi, derisa pas gjashtëmbëdhjetë ditësh, sëmundja më kaloi tërësisht.⁵⁵⁴

Lutja në fjalë është:

سُبْحَانَ اللَّهِ وَبِحَمْدِهِ سُبْحَانَ اللَّهِ الْعَظِيمِ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ وَآلِ مُحَمَّدٍ

I Shenjtë është Allahu, me lavdinë e Tij! I Shenjtë është Allahu, i Madhërishmi. O Allah! Lartësoje Muhammedin dhe popullin e Muhammedit!

554. “Tirjakul-kulub”, “Ruhani Khezain”, vëll. 36-37.

“Emri madhor” (Ismi Azem)

Më 6 dhjetor 1902, Hazret Mesihu i Premtuar^{as} shkroi:

Mbrëmë gjendja ime ishte kaq delikate, saqë nuk kisha aspak dyshim se isha në momentet e fundit të jetës. Ndërkohë, më zuri gjumi. Në ëndërr e pashë veten në një vend ku ishin tri qe. Njëri m'u afrua dhe unë e largova duke e goditur. Erdhi i dyti dhe e largova edhe atë. Erdhi i treti, që dukej kaq i fortë, saqë nuk gjeja dot shpëtim nga ai. Teksa po mendoja kështu, Zoti i Madhërishëm bëri që kau të kthente kokën në një drejtim tjetër. Shfrytëzova kohën për të kaluar pranë kaut e të largohesha prej andej. Kur po vrapoja, më ngjau që edhe ai po më ndiqte, por unë nuk e ktheva kokën. Atëherë, po në ëndërr, Zoti i Lartësuar më frymëzoi në zemër këtë lutje:

رَبِّ كُلِّ شَيْءٍ خَادِمُكَ رَبِّ فَاحْفَظْنِي وَأَنْصُرْنِي وَأَرْحَمْنِي

O Zoti im! Çdo gjë është shërbëtorja Jote. Prandaj, më mbro, o Zoti im, më ndihmo dhe më mëshiro!

Ai gjithashtu më frymëzoi që ky është Emri madhor (Ismi Azem), që do të thotë se janë fjalët që, kushdo që i lexon, do të shpëtojë nga gjëma në të cilën gjendet.⁵⁵⁵

Më pas, Hazret Mesihu i Premtuar^{as} u dërgoi letra sahabëve të tij duke i këshilluar ta bënin vazhdimisht këtë lutje me sinqeritet dhe përlulesi të plotë, në *ruku*, në *sexhde* dhe në *qëndrim* pasi të recitonin suren *El-Fatiha*.⁵⁵⁶

555. “Tadhkirah”, f. 442-443.

556. “Maktubat-e-Ahmedia” vëll. 5, pj. I, f. 38.

Lutje për të gjetur shërim

Gjatë kohës kur kishte rënë një epidemi, Zoti i Madhërishëm i tregoi Mesihut të Premtuar^{as} se duhet të përmendte sa më shpesh këta emra të Tij:

يَا حَفِيظُ - يَا عَزِيزُ - يَا رَفِيقُ -

“Ja Hafiz! Ja Aziz! Ja Refik!”

O Mbrojtës! O i Plotfuqishëm! O Shok!

Mesihu i Premtuar^{as} tha: “*Refik* (d.m.th. shok) është një prej atyre emrave të Zotit të Madhërishëm, që nuk ka qenë i njohur më parë.”⁵⁵⁷

Lutje për të gjetur shërim nga dhimbja e sëmundjes

Më 27 janar 1905, Mesihut të Premtuar^{as} iu ënjt faqja e djathtë, duke i shkaktuar shumë dhimbje. Pasi bëri lutje, iu shpallën fjalët e mëposhtme, me të cilat kur e fryu, gjeti shërim të shpejtë.⁵⁵⁸

بِسْمِ اللَّهِ الْكَافِي بِسْمِ اللَّهِ الشَّافِي بِسْمِ اللَّهِ الْعَفْوَرِ الرَّجِيمِ بِسْمِ اللَّهِ
الْبِرِّ الْكَرِيمِ يَا حَفِيظُ يَا عَزِيزُ يَا رَفِيقُ يَا أَوْلَىٰ أَشْفِيئِي -

Me emrin e Allahut të Mjaftueshëm! Me emrin e Allahut Shërues! Me emrin e Allahut Falës, Mëshirëbërës! Me emrin e Allahut Favorbërës, Bujar! O Mbrojtës! O i Plotfuqishëm! O Shok! O Mik! Shëromë!

(Në rast se i sëmuri është dikush tjetër, mund të luteni “Shëroje”).

557. Gazeta “El-Beder”, vëll. 2, nr. 35, data 18 shtator 1903; “Tadhkira” f. 485.
558. “Tadhkira” f. 525.

Edhe një lutje tjetër për të gjetur shërim

Në vitin 1906, kur Mesihu i Premtuar^{as} qe i sëmurë, iu shpall kjo lutje:

إِشْفِيْ مِنْ لَّدُنْكَ وَارْحَمْنِيْ

Më shëro dhe më mëshiro!⁵⁵⁹

Lutje për të dalë nga vështirësia

(1) Në vitin 1899, Hazret Mesihu i Premtuar^{as} pa në ëndërr që atij po i vërsuleshin zjarri, tymi dhe shkëndijat, por nuk po e dëmtonin dot, ndërkohë ai po bënte lutjen e mëposhtme:

يَا حَىُّ يَا قَيُّوْمُ بِرَحْمَتِكَ أَسْتَغِيْثُ إِنَّ رَبِّيُّ رَبُّ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ

O i Gjallë! O i Qëndrueshëm! Në saje të mëshirës Sate të përgjerohem! Zoti im është Zoti i qiejve dhe i tokës.⁵⁶⁰

(2) Njëherë, dikush i përmendi Hazret Mesihut të Premtuar^{as} vështirësitë në të cilat ai gjendej. Hazret Mesihu i Premtuar^{as} i tha:

Kërkojini sa më shumë falje Zotit dhe bëni shumë këtë lutje në namazet tuaja:

يَا حَىُّ يَا قَيُّوْمُ بِرَحْمَتِكَ يَا أَرْحَمَ الرَّاحِمِيْنَ

O i Gjallë! O i Qëndrueshëm! Në saje të mëshirës Sate të përgjerohem, o Mëshiruesi i të gjithë mëshiruesve!⁵⁶¹

559. "Tadhkira" f. 611.

560. "Tadhkira", f. 335-336; letër drejtuar Maulana Abdul Kerimit.

561. "Malfuzat", vëll. 4, f. 250.

Lutje për të pasur dashurinë dhe faljen e Zotit

Në një letër të drejtuar mikut të tij, Munshi Rustem Aliut, Hazret Mesihu i Premtuar^{as} e ngushëlloi për vdekjen e Sunder Dasit, që qe shok i tij i ngushtë dhe e këshilloi të bënte lutjen e mëposhtme dhe tha: *Vazhdimisht bëni këtë lutje në sexhde, gjatë ditës e gjatë natës:*

يَا أَحَبُّ مِنْ كُلِّ مَحْبُوبٍ اغْفِرْ لِي ذُنُوبِي وَأَدْخِلْنِي فِي عِبَادِكَ الْمُخْلِصِينَ

O Ti që je më i Dashuri prej të gjithë të dashurve! Më fal gjynahun dhe më prano në grupin e robërve të Tu të zgjedhur!⁵⁶²

Një lutje me plot dashuri ndaj Zotit

رَبِّ إِنَّكَ جَلِيٌّ وَرَحْمَتِكَ جَلِيٌّ وَأَهْلَانِكَ عِزِّي وَفَضْلِكَ رِزَالِي

O Zoti im! Ti je parajsa ime. Mëshira Jote është mbështetja ime. Shenjat e Tua janë ushqimi im dhe bekimi Yt është mbulesa ime.⁵⁶³

Lutje për të pasur ndihmës të fesë

Gjatë periudhës së vetmisë, Hazret Mesihu i Premtuar^{as} me zemër të dhimbsur lutej që t'i mundësoheshin ndihmëtarë të fesë. Këtë lutje të tij ai e përmendi në një letër, që i kishte dërguar Hazret Maulvi Nurudinit^{ra}, i cili më vonë do të bëhej edhe Kalifi i tij i parë. Lutja e tij vijon:

562. “Maktubat-e-Ahmedia” vëll. 5, nr. V, f. 74.

563. “Hakikatul-uehi”, “Ruhani Khezain”, vëll. 22, f. 361.

رَبِّ أَغْطِيْ مِنْ لَّدُنْكَ أَنْصَارًا فِيْ دِينِكَ وَأَذِمْ عَنِّيْ حَزْنَ وَأَصْلِحْ لِيْ شَأْنِيْ
كُلَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ.

O Zoti im! Më dhuro ndihmës së fesë Sate, më largo dhe më rregullo të gjithë çështjen time. Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Teje.⁵⁶⁴

Lutje për të pasur bekim të përjetshëm

Rreth vitit 1883, Zoti i Madhërishëm i mësoi Mesihut të Premtuar^{as} një lutje për të pasur bekim dhe më pas, me shumë mirësi, e njoftoi edhe për pranimin e saj.⁵⁶⁵

Lutja në fjalë vijon:

رَبِّ اجْعَلْ لِيْ مُبَارَكًا حَيْثُ مَا كُنْتُ

O Zoti im! Më beko kudo që të jem!

Lutje për të pasur bereqet në pasuri

Më 2 mars 1904, Hazret Mesihu i Premtuar^{as} pa në ëndërr që ai po lidhte një pako parash me një shami të bardhë dore dhe, me anë të shpalljes, mësoi lutjen:

رَبِّ اجْعَلْ بَرَكَةً فِيْهِ

O Zoti im! Bekoje!⁵⁶⁶

564. “Maktubat-e-Ahmedia”, vëll. 5, nr. i letrës 24, f. 34.

565. “Berahin-e-Ahmedia”, pj. IV, “Ruhani Khezain”, vëll. 1, f. 621.

566. “Tadhkirah”, f. 506.

**Lutje të ndryshme për të shtuar dijen (*ilmin*)
dhe njohjen (*irfanin*)**

(1) Më 7 qershor 1906, Hazret Mesihut të Premtuar^{as} iu shpall kjo lutje:

رَبِّ أَرِنِي أَنْوَارَكَ الْكَلِمَاتِ

O Zoti im! Më trego dritat e Tua gjithëpërfshirëse!⁵⁶⁷

(2) Në shpalljet e vitit 1906 është edhe kjo lutje:

رَبِّ عَلِّمْنِي مَا مَوْخَبَّرَ عِنْدَكَ

O Zoti im! Më mëso atë që është e mirë sipas Teje!⁵⁶⁸

(3) Më 20 korrik 1907, iu shpall kjo lutje:

رَبِّ أَرِنِي حَقَائِقَ الْأَشْيَاءِ

O Zoti im! Më mëso realitetin e gjërave!⁵⁶⁹

Lutje për të pasur mendësinë dhe dijen e duhur

وَمَا نُوَفِّقِينَ إِلَّا بِاللَّهِ رَبِّنَا إِهْدِنَا صِرَاطَكَ الْمُسْتَقِيمَ وَمَبِّ لَنَا مِنْ عِنْدِكَ فَهَمَّ

الذِّبْنَ الْقَوِيمَ وَعَلِّمْنَا مِنْ لَدُنْكَ عِلْمًا

Mundësia nuk është prej meje, por vetëm prej Allahut. O Zoti ynë! Na udhëhiq në rrugën Tënde të drejtë dhe na dhuro prej Vetes kuptimin e fesë së qëndrueshme dhe na jep dije.⁵⁷⁰

567. “Tadhkirah”, f. 623.

568. “Hakikatul-uehi”, “Ruhani Khezain”, vëll. 22, f. 106.

569. “Tadhkirah”, f. 724.

570. “Hakikatul-uehi”, “Ruhani Khezain”, vëll. 22, f. 7.

Lutje për të pasur të vërtetën dhe udhëzimin

وَمَا تَوْفِيقِي إِلَّا بِاللَّهِ رَبِّ انصُرْنِي بِالْحَقِّ وَكُفِّبْ عَلَيْنَا الْحَقَّ وَامْدِنَا إِلَى حَقِّ
مُبِينٍ

Mundësia nuk është prej meje, por vetëm prej Allahut. O Zoti im! Na mundëso të flasim të vërtetën, na zbulo të vërtetën dhe na udhëzo drejt së vërtetës.⁵⁷¹

Lutje për mëshirë dhe ndihmë

وَمَا تَوْفِيقِي إِلَّا بِاللَّهِ رَبِّ انصُرْنِي مِنْ لَدُنْكَ رَبِّ ائِدْنِي مِنْ لَدُنْكَ
رَبِّ اِنَّ قَوْمِي طَرَدُونِي فَاَوْنِي مِنْ لَدُنْكَ رَبِّ اِنَّ قَوْمِي لَعَنُونِي
فَارْحَمْنِي مِنْ لَدُنْكَ اِرْحَمْنِي يَا رَبَّ الْاَرْضِ وَالسَّمَاءِ- اِرْحَمْنِي
يَا اَرْحَمَ الرَّحْمَاءِ وَلَا رَاحِمَ اِلَّا اَنْتَ- اِنَّكَ اَنْتَ جَبِي فِي الدُّنْيَا
وَالْاٰخِرَةِ وَاَنْتَ اَرْحَمُ الرَّاحِمِيْنَ تَوَكَّلْتُ عَلَيْكَ وَاَنْتَ لَا تَضِيْعُ
الْمُتَوَكِّلِيْنَ-

Mundësia nuk është prej meje, por vetëm prej Allahut. O Zoti im! Më ndihmo! Më mbështet! O Zoti im! Populli im më ka refuzuar, prandaj, Më streho! O Zoti im! Populli im më ka mallkuar, Më mëshiro! Mëshiromë, o Zoti i tokës dhe i qiellit! Më mëshiro, o Mëshiruesi i të gjithë mëshiruesve, se nuk ka mëshirues tjetër, përveç Teje! Vetëm Ti je dashuria ime në këtë botë dhe në ahiret. Ti je Mëshiruesi i të gjithë mëshiruesve. Te Ti u mbështeta dhe Ti nuk i lë mbështetësit të shkatërrohen.⁵⁷²

571. "Berahin-e-Ahmedia", pj. V, "Ruhani Khezain", vëll. 21, f. 414.

572. "Huxhetullah", "Ruhani Khezain", vëll. 12, f. 164.

Lutje për të kërkuar mëshirë

(1) Më 31 maj 1903, Hazret Mesihut të Premtuar^{as} iu shpall kjo lutje:

اللَّهُمَّ ارْحَمْنَا

O Allah! Mëshiro!

(2) Më 4 prill 1907, iu shpall kjo lutje në gjuhën urdu:

يا الله ارحمنا

O Allah! Mëshiro!

(3) Më 30 shtator 1907, iu shpall lutja e mëposhtme:

رَبِّ ارْحَمْنِي إِنَّ فَحْشَاتِكَ وَرَحْمَتَكَ يُبْتَلَىٰ مِنَ الْعَذَابِ

O Zoti im, më mëshiro! Vetëm bekimi Yt dhe mëshira Jote sigurojnë shpëtimin nga ndëshkimi.

Lutje për ndihmë pas përbaljes me përgënjeshttrimin

Hazret Mesihu i Premtuar^{as} thotë:

Kur u shqetësova tej mase nga sharjet e kundërshtarëve, prej të cilëve edhe të afërm, mbylla dyert e mia dhe iu luta Zotit Tim Mëshirëbërës. Rashë para Tij në sexhde dhe iu përgjérova:

يَا رَبِّ انصُرْ عَبْدَكَ وَ اخْذُلْ اَعْدَاءَكَ. اسْتَجِبْنِي يَا رَبِّ اسْتَجِبْنِي. اَلَمْ
يُسْتَهْزَءْ بِكَ وَ بِرَسُوْلِكَ. وَ حَتَّامٌ يُكْذِبُوْنَ كِتَابَكَ وَ يَسْتُوْنُ نَبِيَّكَ. بِرَحْمَتِكَ
اسْتَعِيْنْتُ يَا حَيُّ يَا قَيُّوْمُ يَا مُعِيْنُ.

O Zoti im! Ndihamoje robin Tënd! Poshtëroji armiqtë e Tu! M'u përgjigj, o Zoti im, m'u përgjigj! Edhe sa do të tallen ata me

Ty dhe me të dërguarin Tënd?! Deri kur do të mohojnë librin Tënd dhe do të shajnë profetin Tënd?! Në saje të Mëshirës Sate Të përgjërohem, o i Gjallë, i Qëndrueshëm dhe Ndhimues!⁵⁷³

Lutje për kundërshtarët më mizorë dhe armiqtë e fesë

يَا رَبِّ فَاسْمَعْ دُعَائِي وَمَرْقِ أَعْدَانِكَ وَأَعْدَائِي وَأَنْجِرْ وَعَدِّكَ وَأَنْصُرْ عَبْدَكَ
وَأَرِنَا آيَاتِكَ وَشَهِّرْ لَنَا حُسَامَكَ وَلَا تَذَرْنَا مِنَ الْكَافِرِينَ شَرِيرًا.

O Zoti im, ma dëgjo lutjen! Copëto armiqtë e Tu dhe të mitë! Përmbushe premtimin dhe ndihmo robin Tënd! Na trego ditët e Tua! Ngrehe shpatën Tënde për ne dhe mos lër asnjërin nga mohuesit keqbërës!⁵⁷⁴

Lutje për të pasur ndihmës të fesë

اللَّهُمَّ انصُرْ مَنْ نَصَرَ دِينَ مُحَمَّدٍ ﷺ واجعلنا منهم - آمين - اللَّهُمَّ اخذلْ
مَنْ خَذَلَ دِينَ مُحَمَّدٍ ﷺ ولا تجعلنا منهم - آمين -

O Allah! Ndhimoji ata që ndihmojnë fenë e Muhammedit^{sas} dhe na bëj një prej tyre! Amin!

O Allah! Poshtëroji ata që poshtërojnë fenë e Muhammedit^{sas} dhe mos na bëj një prej tyre! Amin!

Lutje për përmirësimin e umetit të Muhammedit^{sas}

(1) Në një letër që i kishte dërguar Mir Abas Aliut, Hazret Mesihu i Premtuar^{as} bëri këtë lutje:

573. "Aina kamalat-e-Islam", "Ruhani Khezain", vëll. 5, f. 569.

574. "Tadhkirah", f. 509.

اللَّهُمَّ أَصْلِحْ أُمَّةَ مُحَمَّدٍ اللَّهُمَّ ارْحَمْ أُمَّةَ مُحَمَّدٍ اللَّهُمَّ أَنْزِلْ عَلَيْنَا بَرَكَاتِ
مُحَمَّدٍ وَصَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ وَتَارِكِ وَسَلِّمْ.

O Allah! Përmirëso *umetin* e Muhammedit! O Allah! Mëshiro *umetin* e Muhammedit! O Allah! Lësho mbi ne bekimet e Muhammedit! Lartësoje Muhammedin, bekoje dhe dërgoji paqe atij!⁵⁷⁵

(2) Njëra prej lutjeve që Mesihut të Premtuar^{as} i është mësuar nëpërmjet shpalljes, është edhe kjo:

رَبِّ أَصْلِحْ أُمَّةَ مُحَمَّدٍ

O Zoti im! Përmirëso *umetin* e Muhammedit!⁵⁷⁶

Një lutje përgjëruese pas lëndimeve nga një kundërshtar

Maulvi Muhammed Husejn Batalvi kur kaloi çdo kufi në sharje, mallkime dhe lëndime me fjalë, Hazret Mesihu i Premtuar^{as} bëri lutjen vijuese, e cila duket shumë e ngjashme me lutjen e Hazret Profetit Muhammed^{sas}, që ai bëri gjatë kthimit nga Taifi:

O Miku im! O i Dashuri dhe Udhëheqësi im! Ty të kam lënë që t'u përgjigjesh të gjitha fjalëve të rënda, mallkimeve dhe sharjeve të atij njeriu. Nëse pëlqimi Yt është kjo që ndodhi, nuk dua asgjë më shumë, sesa Ti të jesh i kënaqur me mua. Zemra ime nuk është e fshehtë për Ty. Shikimi Yt depërton deri në thellësi të shpirtit tim. Nëse e kam sadopak gabim, ma rregullo! Në shikimin Tënd nëse kam ndonjë ligësi, pasha

575. "Maktubat-e-Ahmedia", vëll. 1, f. 50.

576. "Tadhkirah", botimi i katërt, f. 47.

fytyrën Tënde, Ty të kërkoj strehë nga ajo! O Udhëheqësi im i Dashur! Nëse kam ndjekur rrugën e shkatërrimit, më shpëto prej saj dhe më mundëso të bëj atë që të pëlqen Ty. Shpirti im më thotë se Ti je dhe do të jesh për mua. Që kur më the: “Unë jam me ty” dhe që kur më je drejtuar mua me fjalët:

إِنِّي مُبِينٌ مِّنْ أَرَادَائِكَ

“Unë do të poshtëroj çdokënd që synon poshtërimin tënd” dhe që kur më the me plot dashuri e mirësi:

أَنْتَ مِنِّي بِمَنْزِلَةِ لَا يَعْلَمُهَا الْخَلْقُ

“Ti je prej Meje në një shkallë që nuk e di askush”, që atëherë më erdhi shpirti në trupin tim. Bisedat e Tua ngushëlluese janë melhem për plagët e mia. Fjalët e Tua plot dashuri janë freski për zemrën time të përvuajtur. Kam qenë i brengosur e Ti më dhe lajme të gëzueshme. Kam qenë i rrethuar nga vështirësitë dhe Ti më pyete për hallin. I Dashur! Më mjafton për të qenë i kënaqur, që Ti je për mua dhe unë për Ty. Sulmet e Tua do të çajnë rreshtat e armiqve dhe të gjitha premtimet e Tua të pastra do të përmbushen. Ti do të jesh Përkrahës i robit Tënd.⁵⁷⁷

Një lutje e përsosur me plot dashuri ndaj Zotit

Duke u përballur me sharjet dhe kundërshtimet e “dijetarëve” të fesë, Hazret Mesihu i Premtuar^{as} iu lut Zotit të Madhërishtëm me këto fjalë:

577. “Asmani Fejsla”, “Ruhani Khezain”, vëll. 4, f. 319.

اللَّهُمَّ فَاحْفَظْنَا مِنْ فِتْنَتِهِمْ وَبَرِّئْنَا مِنْ تَهْمَتِهِمْ وَاخْصُصْنَا بِحِفْظِكَ
 وَاصْطِفَائِكَ وَخَيْرِكَ- وَلَا تَكِلْنَا إِلَى كَلَاءِ غَيْرِكَ وَأَوْزِعْنَا أَنْ نَعْمَلَ
 صَالِحًا تَرْضَاهُ نَسئَلُكَ رَحْمَتَكَ وَفَضْلَكَ وَرِضَاءَكَ وَأَنْتَ خَيْرُ
 الرَّاحِمِينَ- رَبِّ كُنْ بِفَضْلِكَ قُوَّتِي وَنُورَ بَصَرِي وَمَا فِي قَلْبِي وَقَبْلَةَ
 حَيَاتِي وَمَمَاتِي- وَاشْفُئْنِي مَحَبَّةً وَأَتِنِي حُبًّا لَا يَزِيدُ عَلَيْهِ أَحَدٌ مِنْ
 بَعْدِي رَبِّ فَتَقَبَّلْ دَعْوَتِي وَأَعْطِنِي مَنِيَّتِي وَصَافِنِي وَغَافِنِي وَاجْذِبْنِي
 وَقُدْنِي وَأَيِّدْنِي وَوَقِّفْنِي وَرَكِّبْنِي وَتَوَرَّنِي وَاجْعَلْنِي جَمِيعًا لَكَ وَكُنْ
 لِي جَمِيعًا- رَبِّ تَعَالَى إِلَى مِنْ كُلِّ بَابٍ وَخَلِّصْنِي مِنْ كُلِّ حِجَابٍ-
 وَاسْقِنِي مِنْ كُلِّ شَرَابٍ- وَأَعِنِّي فِي هَيْجَاءِ النَّفْسِ وَجَذَابَاتِهَا-
 وَاحْفَظْنِي مِنْ مَهَالِكِ الْبَيْنِ وَظُلُمَاتِهَا- وَلَا تَكِلْنِي إِلَى نَفْسِي طُرْفَةً
 عَيْنٍ وَأَعْصِمْنِي مِنْ سَيِّئَاتِهَا وَاجْعَلْ إِلَيْكَ رَفْعِي وَصَعُودِي وَادْخُلْ
 فِي كُلِّ ذَرَّةٍ مِنْ ذَرَاتِ وَجُودِي وَاجْعَلْنِي مِنَ الَّذِينَ لَهُمْ مَسْجِحٌ فِي
 بَحَارِكَ وَمَسْرَحٌ فِي رِيَاضِ أَنْوَارِكَ وَرِضَاءٌ تَحْتَ مَجَارِي أَقْدَارِكَ
 وَبَاعِدْ بَيْنِي وَبَيْنَ أَغْيَارِكَ- رَبِّ بِفَضْلِكَ وَبِنُورِ وَجْهِكَ أَرِنِي
 جَمَالَكَ وَاسْقِنِي زُلَالِكَ وَأَخْرِجْنِي مِنْ كُلِّ أَنْوَاعِ الْحِجَابِ وَالْغُبَارِ
 وَلَا تَجْعَلْنِي مِنَ الَّذِينَ نَكَسُوا فِي الظُّلْمَةِ وَالْإِسْتِتَارِ وَتَنَاهَوْا عَنِ
 الْبَرَكَاتِ وَالْإِشْرَاقَاتِ وَالْأَنْوَارِ وَانْقَلَبُوا بِعَقْلِهِمُ النَّاقِصِ وَجَدَّهِمُ
 النَّكَاصِ مِنْ دَارِ السَّعِيمِ إِلَى دَارِ الْبُورِ- وَارْزُقْنِي أَمْحَاضَ الطَّاعَةِ
 لَوَجْهِكَ وَسُجُودَ الدَّوَامِ فِي حَضْرَتِكَ وَأَعْطِنِي هِمَّةً تَحُلُّ فِيهَا عَيْنَ
 عِنَايَتِكَ وَأَعْطِنِي شَيْئًا لَا تُعْطِيهِ إِلَّا لِوَجْهِكَ مِنَ الْمُقْبُولِينَ- وَأَنْزِلْ عَلَيَّ

رَحْمَةً لَا تُنْزِلُهَا إِلَّا عَلَىٰ فَرِيدٍ بَيْنَ الْمُحِبُّونَ - رَبِّ أَحِي الْإِسْلَامَ
بِجُهْدِي وَهَمَمِّي وَدُعَائِي وَكَلَامِي وَأَعْدِي سَخْنَتَهُ وَحَبْرَهُ وَسَبْرَهُ وَ
مَزْقَ كُلِّ مُعَانِدٍ وَكِبْرَهُ رَبِّ أَرِنِي كَيْفَ تُحْيِي الْمَوْتَى أَرِنِي وَجُوهَهَا
ذَوِي السَّمَائِلِ الْإِيمَانِيَّةِ وَنُفُوسًا ذَوِي الْحِكْمَةِ الْيَمَانِيَّةِ وَعُيُونًا بَاكِيَةً
بِسُنِّ خَوْفِكَ وَقُلُوبًا مُتَشَعِّرَةً عِنْدَ ذِكْرِكَ وَأَصْلًا تَقِيًّا يَرْجِعُ إِلَى الْحَقِّ
الصَّوَابِ وَيَتَتَمَّى ظِلَالُ الْمَجَازِيْبِ وَالْأَقْطَابِ وَأَرِنِي عَرَائِكَ سَاعِيَةً إِلَى
الْمَتَابِ وَالْإِعْدَادِ لِلْمَأَبِ -

O Allah! Na mbro nga trazimi i tyre, na liro nga akuzat e tyre dhe na veço për mbrojtjen, zgjedhjen dhe mirësinë Tënde. Mos na dorëzo te dikush tjetër përveç Teje dhe na mundëso të veprojmë siç të pëlqen Ty. Të kërkojmë mëshirën, bekimin dhe pëlqimin Tënd. Pa dyshim, Ti je Mëshiruesi më i mirë. Me bekimin Tënd, o Zoti im, bëhu forca ime, drita e syve dhe e zemrës sime dhe drejtimi (*kibla*) i jetës dhe i vdekjes sime. Më bëj të jem i dashuruar dhe më dhuro dashuri aq të madhe, sa të mos më tejkalojë në dashuri askush tjetër pas meje.

O Zoti im! Më prano lutjen! Më plotëso dëshirat! Më pastro! Më jep shëndet! Më tërhiq! Më prij! Më përkrah! Më mundëso! Më dëlirëso! Më dritëso dhe më bëj mua tërësisht Tëndin dhe Ti i tëri bëhu imi! O Zoti im! Eja tek unë nga çdo derë! Më hiq çdo perde! Më dhuro çdo pije! Më ndihmo gjatë çdo tundimi dhe dëshire të *nefsit* tim! Më mbro nga shkatërrimet dhe errësitat e ndarjes prej Teje! As edhe për një çast të vetëm mos më dorëzo mua te vetja ime! Më shpëto nga ligësitë e saj! Ngjitjen dhe lartësimin tim bëje drejt Teje! Hyr në çdo grimcë të qenies sime! Më bëj ndër ata që notojnë në

oqeanet e Tua, që shëtisin në kopshtet e Tua plot dritë, që kënaqen me përmbushjen e caktimet e Tua! Më distanco nga ata që janë ndarë prej teje!

O Zoti im! Në saje të bekimit Tënd dhe të dritës së fytyrës Sate, më trego bukurinë Tëndë! Më jep për të pirë ujin Tënd të kulluar! Më nxirr nga çdolloj perdeje a pluhuri! Mos më bëj si ata që ranë përmbys në errësira, që u larguan prej çdolloj bekimi dhe çdolloj drite, që, për shkak të mendjes së tyre të mangët dhe të përpjekjes së tyre të mbrapshtë, u kthyen nga shtëpia e bekimeve në atë të mjerimeve! Më mundëso bindjen e pastër ndaj fytyrës Sate dhe sexhdet e qëndrueshme te pragu Yt! Më jep kurajën që tërheq shikimin Tënd mirëbërës! Më dhuro atë që nuk i ke dhuruar askujt, përveç ndonjërit prej të pranueshmëve! Më zbrit mëshirën që nuk i ke zbritur askujt, përveç ndonjërit prej të dashurve!

O Zoti im! Ringjalle Islamin përmes përpjekjes, kurajës, lutjes dhe fjalës sime dhe nëpërmjet meje ktheja madhështinë, hijeshinë dhe bukurinë dhe copëto çdo armik, bashkë me mburrjen e tij. O Zoti im! Më trego se si i ringjall të vdekurit! Më trego fytyrat që mbajnë vetitë e besimit, shpirtrat që ushqejnë urtësinë e djathtë, sytë që qajnë nga druajtja Jote, zemrat që dridhen nga kujtimi Yt, natyrshmërinë e pastër që kthehet kah e vërteta dhe kah rruga e drejtë!

Një lutje tejet emocionuese për dashurinë e Zotit

رَبِّ أَنْزِلْ عَلَيَّ قَلْبِي - وَاطْهَرْنِي مِنْ جَبِيئِي بَعْدَ سَلْبِي - وَأَمْلَأْ بِنُورِ الْعِرْفَانِ
فُؤَادِي - رَبِّ أَنْتَ مُرَادِي فَاتِنِي مُرَادِي - وَلَا تُمَتِّنِي مَوْتَ الْكِلَابِ -
بِوَجْهِكَ يَا رَبَّ الْأَرْبَابِ - رَبِّ إِنِّي اخْتَرْتُكَ فَاخْتَرْنِي - وَأَنْظُرْ إِلَى قَلْبِي
وَاحْضُرْنِي - فَإِنَّكَ عَلِيمٌ الْأَسْرَارِ - وَخَبِيرٌ بِمَا يَكْتُمُ مِنَ الْأَغْيَارِ - رَبِّ إِنْ
كُنْتَ تَعْلَمُ أَنَّ أَعْدَائِي هُمُ الصَّادِقُونَ الْمُخْلِصُونَ - فَأَهْلِكْنِي كَمَا
تُهْلِكُ الْكُذَّابُونَ - وَإِنْ كُنْتَ تَعْلَمُ أَنِّي مِنْكَ وَمِنْ حَضْرَتِكَ - فَقُمْ
لِنُصْرَتِي فَإِنِّي أَحْتَاجُ إِلَى نُصْرَتِكَ وَلَا تَفُوضْ أَمْرِي إِلَى أَعْدَاءِ يَمْرُوعَ
عَلَيَّ مُسْتَهْزِئِينَ - وَاحْفَظْنِي مِنَ الْمُعَادِينَ وَالْمَاكِرِينَ - إِنَّكَ أَنْتَ
رَاجِي وَرَاحَتِي وَجَنَّتِي وَجَنَّتِي - فَانْصُرْنِي فِي أَمْرِي وَاسْمَعْ بُكَائِي
وَرُتْنِي - وَصَلِّ عَلَيَّ مُحَمَّدٍ خَيْرِ الْمُرْسَلِينَ - وَإِمَامِ الْمُتَّقِينَ - وَهَبْ لَهُ
مَرَاتِبَ مَا وَهَبْتَ لِغَيْرِهِ مِنَ النَّبِيِّينَ - رَبِّ أَعْطِهِ مَا أَرَدْتَ أَنْ تُعْطِيَنِي
مِنَ النُّعْمَاءِ - ثُمَّ اغْفِرْ لِي بِوَجْهِكَ وَأَنْتَ أَرْحَمُ الرَّحْمَاءِ - وَالْحَمْدُ لَكَ
عَلَى أَنَّ هَذَا الْكِتَابَ قَدْ طُبِعَ بِفَضْلِكَ فِي مُدَّةٍ عِدَّةٍ الْعَيْنِ - فِي يَوْمِ
الْجُمُعَةِ وَفِي شَهْرِ مُبَارَكٍ بَيْنَ الْعِيدَيْنِ - رَبِّ اجْعَلْهُ مُبَارَكًا وَنَافِعًا
لِلطُّلَّابِ - وَهَادِيًا إِلَى طَرِيقِ الصَّوَابِ - بِفَضْلِكَ يَا مُجِيبَ الدَّاعِينَ -
الْمُبِينِ ثُمَّ آمِينَ -

O Zoti im! Zbrit mbi zemrën time! Shfaqu prej jakës sime pasi të asgjësosh qenien time! Më mbush zemrën me dritën e njohjes Sate! O Zoti im! Ti je dëshira ime, pra, përmbushma dëshirën dhe mos më lër të vdes si qen! Pasha fytyrën Tënde, o Krijuesi i të gjithë krijuesve, unë të kam zgjedhur, o Zoti

im, prandaj edhe Ti më zgjidh! Hidhi sytë mbi zemrën time dhe eja tek unë, sepse Ti je i Dijshmi i të fshehtave dhe i Informuari i asaj që mbahet sekret nga të tjerët.

O Zoti im! Nëse Ti di që armiqtë e mi kanë të drejtë dhe ata janë të sinqertë, më shkatërro, ashtu siç shkatërroren gënjeshtarët. Dhe nëse Ti di që unë jam nga Ti dhe prej Teje, ngrihu për të më ndihmuar, sepse jam nevojtar për ndihmën Tënde. Mos e dorëzo çështjen time tek armiqtë që vërtiten duke u tallur me mua! Më mbro nga armiqtë dhe intriguesit! Freskia ime, rehatia ime, parajsa ime dhe mburoja ime je vetëm Ti. Prandaj, më ndihmo në çështjen time! Më dëgjo klithmën dhe hallin!

Lartësoje Muhammedin, më të mirin e të dërguarve, udhëheqësin e të devotshmëve dhe dhuroji pozitë që u ke dhuruar profetëve të tjerë! O Zoti im! Jepi edhe ato bekime që ke caktuar për mua dhe pastaj, në saje të fytyrës Sate, më fal mua! Ti je Mëshiruesi i të gjithë mëshiruesve.

Lavdia është e Jotja që ky libër⁵⁷⁸ me bekimin Tënd, u botua ditën e xhumasë, në muajin e bekuar, midis dy Bajrameve, brenda shtatë ditësh. O Zoti im! Bekoje dhe bëje të dobishëm për kërkimtarët dhe udhëzues drejt rrugës së drejtë! Në saje të bekimit Tënd ma prano lutjen, o Pranuesi i lutjeve! Amin!
Amin!⁵⁷⁹

578. Bëhet fjalë për librin e tij "Exhazul-Mesih".

579. "Exhazul-Mesih", "Ruhani Khezain", vëll. 18, f. 203.

Lutje për një sahab të tij të sinqertë, që ai të bëhej me djalë

Hazret Halifa Nurudin Xhemuni (studiuues i varrit të Jezusit) nuk kishte djalë. Ai thotë se në vitin 1893, ai erdhi në Kadian së bashku me gruan e tij të dytë. Ai lindi shumë fëmijë me të, por nuk i rroi asnjë. I kërkoi Hazret Mesihut të Premtuar^{as} që të lutej për të. Edhe e shoqja iu lut që t'i jepte ndonjë lutje. Hazret Mesihu i Premtuar^{as} me dorën e vet i shkroi një lutje, e cila u pranua mrekullisht. Në dhjetor të vitit 1893, çiftit në fjalë i lindi një djalë, i cili u quajt Abdurrahim. Pas gjashtë vjetësh, për herë të parë ata e sollën djalin në Kadian për të takuar Mesihun e Premtuar^{as}, por për shkak se fëmija nuk rehatohej, i kërkuan leje të ktheheshin shpejt. Hazret Mesihu i Premtuar^{as} iu drejtua djalit dhe i tha:

“Të lumtë! Kam bërë aq lutje duke qarë që të lindje, dhe ti po mërzhitesh që qëndron këtu? Ende nuk kemi shtuar gosti për ty!”

Të nesërmen, Hazret Mesihu i Premtuar^{as} mblodhi njerëzit në kopsht, i qerasi me mana dhe i tha djalit: “Ja, u bë edhe gostia jote!” Avokati Abdulaziz Halifa, zëvendës-presidenti i xhematit Musliman Ahmedia i Kanadasë, është pasardhës i tij.

Për sa i përket Abdurrahimit, ai arriti pozita të larta në shtetin Xhamu Kashmir dhe arriti deri në pozitën e sekretarit.⁵⁸⁰

Lutja që Hazret Mesihu i Premtuar^{as} i kishte shkruar çiftit, nuk ishte botuar deri më tani. Më 3 qershor 2005, gjatë udhëtimit tim në Kueta

580. Gazeta “El-Hakam”, 7-14 nëntor 1939, f. 5-6; Maulvi Kudratullah Sanuri, “Siret Ahmed”, f. 179-180; “Safarnama Pir Siraxhulhak Numani”, qershor 1915, f. 259.

të Pakistanit, ma dhanë këtë lutje z. Halifa Xhemil Ahmed dhe z. Halifa Tahir Ahmed, e cila është:

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ مَجْمَعِ الرَّحْمَةِ وَبَارِكْ عَلَى أَحْمَدَ شَفِيعِ
الْمُذْنِبِينَ وَالْمُذْنِبَاتِ وَعَلَى آلِهِ وَأَصْحَابِهِ أَجْمَعِينَ وَلَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا
بِاللَّهِ وَهُوَ أَرْحَمُ الرَّحِيمِينَ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ - الرَّحْمَنِ
الرَّحِيمِ - مَالِكِ يَوْمِ الدِّينِ إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ اهْدِنَا الصِّرَاطَ
الْمُسْتَقِيمَ صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا
الضَّالِّينَ - آمِينَ -

وَالَّذِينَ سَعِدُوا فِي الْجَنَّةِ خَالِدِينَ فِيهَا مَا ذَامَتِ السَّمَوَاتُ وَالْأَرْضُ
إِلَّا مَا شَاءَ اللَّهُ - عَطَاءٌ غَيْرَ مَجْدُودٍ - رَبِّ ارْحَمْ عَلَى نُورِ دِينِ وَامْرَأَتِهِ
وَنَجِّهِمَا مِنْ هُمُومِهِمَا وَاعْطِ لَهُمَا وَلَدًا صَالِحًا وَاجْعَلْ لَهُمَا بَرَكَاتًا
وَشِفَاءً بِكُتَابِي هَذَا بِنَبِيِّكَ وَكِتَابِكَ وَرَحْمَتِكَ الَّتِي لَا تُغَادِرُ صَغِيرَةً وَلَا
كَبِيرَةً رَبِّ فَتَقَبَّلْ دَعْوَتِي وَلَا تَذَرَهَا فَرْدًا وَأَنْتَ خَيْرُ الْوَارِثِينَ - آمِينَ
ثُمَّ آمِينَ

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit

**O Allah! Lartëso Muhammedin që është epiqendër e mëshirës!
Beko Ahmedin, që do të ndërmjetësojë gjynahqarët dhe
gjynahqaret, familjen e tij dhe të gjithë sahabët e tij. Sundim dhe
fuqi s'ka askush tjetër, përveç Allahut dhe Ai është Mëshiruesi
i të gjithë mëshiruesve. Lavdia është e Allahut, Zotit të botëve,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit; Sunduesit të ditës së**

grykimit. Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty të kërkojmë ndihmë. Na udhëzo në rrugën e drejtë! Në rrugën e atyre që i bekojnë, që nuk tërhiqen zemërim dhe që nuk devijuan! Amin!

Ata që janë fatlumë, do të jenë në xhenet, ku do të jetojnë përgjithmonë, derisa të vijojnë qiejt dhe Toka, përveç asaj që do Allahu. Kjo është një dhunti që nuk ndërpritet. O Zoti im! Mëshiro Nurudinin dhe gruan e tij, liroji ata nga brengat e tyre, dhuroju një djalë të shëndoshë dhe bëje këtë shkrim timin bekim dhe shërim për ta, vetëm në saje të Profetit Tënd, në saje të librit Tënd dhe në saje të mëshirës Sate që nuk lë (pa mbuluar) asnjë mëkat, as të vogël, as të madh! O Zoti im! Ma prano lutjen dhe mos i lër vetëm ata! Ti je Trashëgimtari më i mirë. Amin! Amin!

Disa lutje të veçanta të shpallura mbi Hazret Mesihun e Premtuar^{as}

(të cilat duken të veçanta me pozitën e tij si i caktuar prej Allahut, por që mund të përdoren në rrethana të ndryshme).

(1)

رَبِّ اجْزُهُ جَزَاءً أَوْفَى

O Zoti im! Jepi shpërblim të plotë.⁵⁸¹

(Para kësaj lutjeje përmendet një shpallje rreth Hazret Mesihut të Premtuar^{as}:

581. "Tadhkirah", f. 513.

امام رافع القدر

d.m.th. “*Imami me pozitë të lartë*”. Kjo tregon se lutja në fjalë ishte për veten e tij.)

(2)

رَبِّ اصْبِحْ زَوْجِي

O Zoti im! Përmirësoje bashkëshorten time.⁵⁸²

(3)

رَبِّ اشْفِ زَوْجِي هَذَا وَاجْعَلْ لَهَا بَرَكَاتٍ فِي السَّمَاءِ وَبَرَكَاتٍ فِي الْأَرْضِ-

O Zoti im! Shëroje bashkëshorten time dhe jepi bekime në qiell dhe në tokë.⁵⁸³

(4)

رَبِّ زِدْنِي عُمْرِي وَعَمِّرْ زَوْجِي زِيَادَةً خَارِقَ الْعَادَةِ

O Zoti im! Ma zgjat jetën mua dhe bashkëshortes sime në mënyrë të jashtëzakonshme!⁵⁸⁴

(5)

رَبِّ لَا تُصَبِّحْ عُمْرِي وَعُمْرَ مَا وَاحْفَظْنِي مِنْ كُلِّ آفَةٍ تُرْسِلُ إِلَيَّ

O Zoti im! Bëj që të mos priset jeta ime dhe jeta e saj (e bashkëshortes) dhe më mbro nga çdo gjëmë që mund të më vijë!⁵⁸⁵

582. “Tadhkirah”, f. 338.

583. “Tadhkirah”, f. 596.

584. “Tadhkirah” f. 406.

585. “Tadhkirah” f. 661.

(6)

رَبِّ احْفَظْنِي فَإِنَّ الْقَوْمَ يَتَجَدَّدُونَ سُخْرَةً.

O Zoti im! Më mbro, sepse populli po më përqesh!⁵⁸⁶

(7)

رَبِّ أَخْرِجْنِي مِنَ النَّارِ

O Zoti im! Më nxirr nga zjarri!⁵⁸⁷

Shënim: Menjëherë pas kësaj përmendet shpallja “Lavdia është e Allahut që më shpëtoi nga zjarri”. Në kohën e Hazret Kalifit të Dytë të Mesihut të Premtuar^{as}, xhemati u përball me trazirën e shkaktuar nga grupi i Ahrarëve. Në fjalimin e tij të së premtes, të mbajtur më 14 qershor 1935, Hazret Kalifi i Dytë^{ra}, rreth shpalljes që u përmend më sipër, tha se në jetën e Mesihut të Premtuar^{as} nuk u vërejt ndonjë gjëmë pas kësaj shpalljeje, prandaj ajo duhet të kishte qenë një profeci për të ardhmen dhe kuptimi ishte që pasuesit e tij do të përballëshin me një lloj ferri, por Zoti do t’i shpëtonte ata.

(8)

Hazret Mesihu i Premtuar^{as} tha:

Duke iu referuar tërmetit, më erdhi shpallje:

رَبِّ أَرِنِي آيَةً مِنَ السَّمَاءِ

O Zoti im! Më trego ndonjë shenjë prej qiellit!⁵⁸⁸

586. “Tadhkirah” f. 683.

587. “Tadhkirah” f. 723.

588. “Tadhkirah”, f. 601.

Bashkë me këtë lutje, m'u shpallën edhe fjalët:

اكرام مع الانعام

d.m.th. “Nderim me bekim”. Këto fjalë tregonin se bashkë me këtë shenjë, Zoti do të jepte nder, i cili do të shoqërohej me një bekim.

(9) Hazret Mesihu i Premtuar^{as} thotë:

Më doli para syve një pamje tërmeti dhe më pas më erdhi shpallje:

رَبِّ اجْرُؤْتْ هَذَا.

O Zoti im! Shtyje kohën e tij për më vonë!⁵⁸⁹

Menjëherë pas saj vjen shpallja që e njofton për pranimin e kësaj lutjeje, duke thënë se Zoti i Madhërishëm e shtyu për një kohë tjetër.⁵⁹⁰

(10)

Më 31 gusht 1905, më erdhi shpallje:

أرئى زلزلة الساعة

Më trego tërmetin e orës së premtuar!

D.m.th., t'i tregohej pamja e tij në vizion (*keshf*).

(11)

Lutja e mësipërme iu pranua dhe më pas, më 9 mars 1906, ai mori shpallje:

رَبِّ لَأْتِرِنِي زَلزلة الساعة. رَبِّ لَأْتِرِنِي مَوْتِ أَخِيئِنَهُمْ.

O Zoti im! Mos më trego tërmetin e kiametit! O Zoti im! Mos

589. “Tadhkirah”, f. 606.

590. “Tadhkirah”, f. 655.

më trego vdekjen e askujt prej tyre!

(Bëhet fjalë për shërbëtorët dhe ndihmësit e tij të veçantë në besim. Autori). Kjo shpallje në formë lutjeje i erdhi pas vdekjes së Haret Maulvi Abdul Kerimit, që qe nga Sijalkoti. Kjo shpallje përbën lutje për ta shtyrë tërmetin për më vonë. Edhe kjo u pranua.⁵⁹¹

(12)

رَبِّ قَرِيْبِيْ بَيْنَ صَادِقِيْ وَكَاذِبِيْ أَنْتَ تَرَى كُلَّ مُصْلِحٍ وَصَادِقٍ-

O Zoti im! Bëj dallim midis të vërtetit dhe gënjeshtarit! Ti njeh çdo reformator e të sinqertë!⁵⁹²

Hazret Mesihu i Premtuar^{as} thotë:

Në këtë shpallje hidhet poshtë fjala e Abdul Hekimit, ku ai pretendon të jetë i vërtetë. Zoti thotë: “Unë do të bëj dallim midis të vërtetit dhe gënjeshtarit”.⁵⁹³

(13)

رَبِّ لَا تُبْقِيْ لِيْ مِنَ الْمَغْزِيَّاتِ ذِكْرًا-

O Zoti im! Mos lër asnjë kujtim poshtërues për mua!⁵⁹⁴

Kjo lutje iu pranua. Kështu që, më 1903, Zoti i Madhërishëm i dërgoi një shpallje tjetër, duke i siguruar se nuk do të linte asgjë që mund t'i shkaktonte poshtërim.⁵⁹⁵

591. “Tadhkirah”, f. 562.

592. “Tadhkirah”, f. 620.

593. “Ishtihar”, 16 gusht 1906, “Hakikatul-uehi”.

594. “Tadhkirah”, f. 672.

595. “Tadhkirah”, f. 452.

(14)

رَبِّ اجْعَلْنِي غَالِبًا عَلَىٰ غَيْرِي-

O Zoti im! Më bëj të triumfoj mbi rivalin tim!⁵⁹⁶

Bashkë me këtë, i erdhi një shpallje tjetër me fjalët “Fitorja ime”, që është shenjë e pranimit të lutjes së shpallur më parë.

(15)

وَأَجْعَلْ لِي غَلَبَةً فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ-

Më jep triumf në botë e në besim!⁵⁹⁷

(16)

وَأَجْعَلْ لِي نَافِعًا هَذِهِ التِّجَارَةَ

Bëje këtë tregti të dobishme për mua!⁵⁹⁸

(Fjala është për tregtinë që përmendet edhe në Kuran, ku Zoti thotë: “A t’ju tregoj një tregti, që do t’ju shpëtojë nga ndëshkimi i dhimbshëm?” (Kurani Famëllartë 61:11))

(17)

رَبِّ سَلِّطْ لِي عَلَى النَّارِ-

O Zoti im! Më jep kontroll mbi zjarrin!⁵⁹⁹

(18)

هُوَ شَفَعْنَا لِنَفْسِنَا

Këto fjalë janë në gjuhën hebraike,⁶⁰⁰ dhe përkthehen kështu:

596. “Tadhkirah”, f. 765.

597. “Tadhkirah”, f. 778.

598. “Tadhkirah”, f. 778.

599. “Tadhkirah”, f. 606.

600. Psalmet 118:25; Mateu 21:9.

“O Zot! Më jep shpëtimin dhe më çliro nga vështirësitë!” “Të dhamë shpëtimin”.⁶⁰¹

Hazret Mesihu i Premtuar^{as} thotë:

Kjo ishte një profeci, e cila ishte bërë në formë lutjeje dhe më pas u njoftova edhe për pranimin e saj.⁶⁰²

(19)

رَبِّ تَجَلَّ رَبِّ تَجَلَّ

O Zoti im, shfaqu! O Zoti im, shfaqu!⁶⁰³

(20)

اللَّهُمَّ بَارِكْ لِي فِي هَذِهِ الرُّؤْيَا.

O Allah! Ma beko këtë ëndërr!⁶⁰⁴

(21)

اللَّهُمَّ إِنْ أَهْلَكْتَ هَذِهِ الْعَصَايَةَ فَلَنْ تُعْبِدَنِي الْأَرْضُ أَبَدًا.

O Allah! Nëse e shkatërron këtë xhemat, kurrë nuk do të adhurohesh në tokë!⁶⁰⁵

(22)

يَا اللَّهُ فَتِحْ

O Allah! Fitore!⁶⁰⁶

601. “Tadhkirah”, f. 102.

602. “Berahin-e-Ahmedia”, vëll. 5, “Ruhani Khezain”, vëll 21, f. 104, 195.

603. “Tadhkirah”, botimi i katërt, f. 208.

604. “Tadhkirah”, f. 248.

605. “Tadhkirah”, f. 430.

606. “Tadhkirah”, botimi i katërt, f. 472.

Disa nga lutjet e Hazret Mesihut të Premtuar^{as} në vargje

کافر کہنے والوں کے حق میں دعا

اے میرے پیارے ضلالت میں پڑی ہے میری قوم
تیری قدرت سے نہیں کچھ دور گر پائیں سدھار
خاکساری کو ہماری دیکھ اے دانائے راز
کام تیرا کام ہے ہم ہو گئے اب بے قرار
اک کرم کر، پھیر دے لوگوں کو فرقاں کی طرف
نیز دے توفیق تا وہ کچھ کریں سوچ اور بچار
گو وہ کافر کہہ کے ہم سے دور تر ہیں جا پڑے
ان کے غم میں ہم تو پھر بھی ہیں حزین و دلفگار
ہم نے یہ مانا کہ ان کے دل ہیں پتھر ہو گئے
پھر بھی پتھر سے نکل سکتی ہے دینداری کی نار
کیسے ہی وہ سخت دل ہوں ہم نہیں ہیں نا امید
آیت لَا تَيْسَسُوا رَکْهَتِي ہے دل کو استوار
پیشہ ہے رونا ہمارا پیش رب ذوالمنن
یہ شجر آخر کبھی اس نہر سے لائیں گے بار

Lutje për ata që e quajnë mohues (qafir)

*O i Dashuri im! Popull im ka pësuar devijim
Asgjë nuk është e pamundur nga Madhështia Jote, nëse do
përmirësim.*

*Shikoma përulësinë time, o Njohës i sekreteve
Puna është e Jotja, por unë jam i shqetësuar*

*Trego mëshirë dhe ktheji njerëzit drejt Kuranit
Jepu mend, që ata të mendojnë, të reflektojnë*

*Edhe pse janë të distancuar nga ne duke na quajtur qafirë
Ne, megjithatë, jemi të shqetësuar e të brengosur për ta*

*E pranojmë që zemrat u janë bërë gurë
Por, edhe prej gurit mund të dalë shkëndija e besimit*

*Sado zemërgurë qofshin ata, ne nuk e humbim shpresën
Ajetei “Mos u dëshpëroni!” na mban gjallë zemrën*

*Puna jonë është që të qajmë para Zotit të botëve
Kjo pemë më në fund do të sjellë fruta prej lumit të lotëve.⁶⁰⁷*

607. “Durr-e-themin” urdu, f. 143, 147.

توحید و توکل کے مضمون پر مشتمل عمدہ تحریک دعا

جناب شیخ محمد بخش صاحب رئیس کڑیا نوالہ ضلع گجرات کو سخت مالی مشکلات کی شکایت پر حضور نے انہیں یہ نظم لکھ کر عطا فرمائی خدا تعالیٰ نے حضرت مسیح موعود کی دعا کے طفیل ان کی تکالیف دور کر دیں۔

اک نہ اک دن پیش ہوگا توفنا کے سامنے
چل نہیں سکتی کسی کی کچھ قضا کے سامنے
چھوڑنی ہوگی تجھے دنیائے فانی ایک دن
ہر کوئی مجبور ہے حکم خدا کے سامنے
مستقل رہنا ہے لازم اے بشر تجھ کو سدا
رنج و غم یاس و الم فکر و بلا کے سامنے
بارگاہ ایزدی سے تو نہ یوں مایوس ہو
مشکلیں کیا چیز ہیں مشکل گشا کے سامنے
حاجتیں پوری کریں گے کیا تیری عاجز بشر
کریاں سب حاجتیں حاجت روا کے سامنے
چاپئے تجھ کو مٹانا قلب سے نقش دوئی
سر جھکا بس مالک ارض و سما کے سامنے
چاہئے نفرت بدی سے اور نیکی سے پیار
ایک دن جانا ہے تجھ کو بھی خدا کے سامنے
راستی کے سامنے کب جھوٹ پھلتا ہے بھلا
قدر کیا پتھر کی لعل بے بہا کے سامنے
(درمیان اردو صفحہ ۱۵۷)

Motivim për lutje dhe për mbështetje te Zoti i Vetëm

Z. Shejkh Muhamed Bakhsh, që ishte një njeri me ndikim në Kerijanvala, rrethi i Guxhratit, pati vështirësi të mëdha financiare dhe iu ankua Hazret Mesihut të Premtuar^{as}. *Huzuri*^{as} i shkroi këtë vjershë dhe Zoti i Madhërishëm, duke ia dëgjuar lutjen Muhamed Bakhshit, ia largoi problemet.

*Një ditë, pa dyshim, do të asgjësohesh
Asgjë nuk mund të qëndrojë përballë caktimit*

*Do ta lësh patjetër botën e vdekshme një ditë
Çdokush është i detyruar para urdhrit të Zotit*

*Ji i qëndrueshëm, o njeri, në çdo rrethanë
Në brengë e në probleme, në ankthe e në dhimbje, në shqetësime e në gjëmime*

*Si mund të të përmbushin nevojat njerëzit e paaftë?!
Të gjitha kërkesat paraqitja vetëm Përmbushësit të tyre*

*Të duhet të fshish nga zemra shenjën e dualizmit
Ule kokën vetëm para Sunduesit të Tokës e të qiellit*

*Të duhet të urresh ligësinë e të duash mirësinë
Një ditë edhe ti ke për t'u paraqitur para Zotit*

*Gënjeshtër nuk lulëzon përballë së vërtetës
Çfarë vlere ka guri përballë diamantit të paçmueshëm!⁶⁰⁸*

608. "Durr-e-themin" urdu, f. 157.

اسلام کی حالت زار اور غلبہ دین کے لئے درد بھری دعائیں

کشتی اسلام بے لطف خدا اب غرق ہے
مجھ کو دے اک فوق عادت اے خدا جوش و پیش
وہ لگا دے آگ میرے دل میں ملت کے لئے
اے خدا تیرے لئے ہر ذرہ ہو میرا فدا
ہر طرف سے پڑ رہے ہیں دین احمد پر تبر
کونسی آنکھیں جو اس کو دیکھ کر روتی نہیں
کھا رہا ہے دین طمانچے ہاتھ سے قوموں کے آج
یہ مصیبت کیا نہیں پہنچی خدا کے عرش تک
اے خدا شیطان پہ مجھ کو فتح دے رحمت کے ساتھ
جنگ یہ بڑھ کر ہے جنگ روس اور جاپان سے
دل نکل جاتا ہے قابو سے یہ مشکل سوچ کر
اے میرے پیارے فدا تجھ پر ہر ذرہ مرا
کچھ خیر لے تیرے کوچہ میں یہ کس کا شور ہے
فضل کے ہاتھوں سے اب اس وقت کر میری مدد
میرے سقم و عیب سے اب کیجئے قطع نظر
میرے زعموں پر لگا مرہم کہ میں رنجور ہوں
دیکھ سکتا ہی نہیں میں ضعفِ دین مصطفیٰ
کیا سلائے گا مجھے تو خاک میں قبل از مراد
یا الہی فضل کر اسلام پر اور خود بچا
قوم میں فسق و فجور و معصیت کا زور ہے
ایک عالم مر گیا ہے تیرے پانی کے بغیر

اے جنوں کچھ کام کر بیکار ہیں عقلموں کے وار
جس سے ہوجاؤں میں غم میں دیں کے اک دیوانہ وار
شعلے پہنچیں جس کے ہر دم آسمان تک بے شمار
مجھ کو دکھلا دے بہار دیں کہ میں ہوں اشکبار
کیا نہیں تم دیکھتے قوموں کو اور ان کے وہ وار
کون سے دل ہیں جو اس غم میں نہیں ہیں بے قرار
اک تزلزل میں پڑا اسلام کا عالی منار
کیا یہ شمس الدین نہاں ہو جائے گا اب زیر غار
وہ اکٹھی کر رہا ہے اپنی فوجیں بے شمار
میں غریب اور ہے مقابل پر حریف نامدار
اے مری جاں کی پناہ فوج ملانک کو اتار
پھیر دے میری طرف اے سارباں جگ کی مہار
خاک میں ہوگا یہ سرگر تو نہ آیا بن کے یار
کشتی اسلام تا ہو جائے اس طوفاں سے پار
تا نہ خوش ہو دشمن دیں جس پہ ہے لعنت کی مار
میرے فریادوں کو سن میں ہو گیا زار و زار
مجھ کو کراے میرے سلطان کامیاب و کامگار
یہ تو تیرے پر نہیں امید اے میرے حصار
اس شکستہ ناؤ کے بندوں کی اب سن لے پکار
چھار رہا ہے ابر یاس اور رات ہے تاریک و تار
پھیر دے اے میرے مولیٰ اس طرف دریا کی دھار

اب نہیں ہیں ہوش اپنے ان مصائب میں بجا رحم کر بندوں پہ اپنے تا وہ ہوویں رستگار
کس طرح نپٹیں کوئی تدبیر کچھ بنتی نہیں بے طرح پھیلی ہیں یہ آفات ہر سو ہر کنار
ڈوبنے کو ہے یہ کشتی آمرے اے ناخدا آگیا اس قوم پر وقت خزاں اندر بہار
اے خدا بن تیرے ہو یہ آپاشی کس طرح جل گیا ہے باغِ تقویٰ دیں کی ہے اب اک مزار
تیرے ہاتھوں سے میرے پیارے اگر کچھ ہو تو ہو ورنہ فتنہ کا قدم بڑھتا ہے ہر دم سیل وار
ایک نشان دکھلا کہ اب دیں ہو گیا ہے بے نشان اک نظر کر اس طرف تا کچھ نظر آوے بہار

Përshkrimi i gjendjes së mjerueshme të muslimanëve dhe lutje plot dhimbje për triumfin e Islamit

*Arka e Islamit me pambështetje hyjnore, ja po fundoset
Bëj diçka, o marrëzi, mendjet nuk po ia dalin!*

*Që tash o Zot, jepmë një vrull e zjarrmi të pazakontë
Që të më bëjë të marrë, të përmallë për besimin*

*Më ndiz në zemër një zjarr për umetin
Flakët e të cilit të arrijnë pafundësisht gjer në qiell*

*Çdo grimcë imja u flijoftë për Ty, o Zot
Tregomë pranverën e besimit se jam duke qarë*

*Nga çdo anë po i bien sëpatat fesë së Ahmedit
Si nuk po i shikoni (o njerëz) popujt dhe sulmet e tyre?!*

*A ka sy që nuk qan duke i parë ato?
A ka zemër që nuk shqetësohet tejmasë nga kjo brengë?!*

*Feja po ha shuplaka nga duart e popujve, sot
Minarja madhështore e Islamit po tronditet fort*

*Vallë, a nuk ka arritur deri te Zoti kjo gjëmë?!
Vallë, a do të fshihet ky diell i besimit në humnerë?!*

*Përmes mëshirës Sate më jep fitoren kundër shejtanit, o Zot
ai po mblihdhka ushtritë e tij pafundësisht*

*Luftë kjo, por më e madhe sesa e Rusisë, e Japonisë
Unë jam i papërkrahur e përballë meje kundërshtari famëzi*

*Zemra po humb kontrollin duke menduar këtë shqetësim
Zbarko ushtritë e engjëjve, o Streha e shpirtit tim!⁶⁰⁹*

*O i Dashuri im! Për Ty u flijoftë çdo grimcë e imja
Ktheje tash drejt meje, o Kalorës, gojëzën e botës*

*Kontrollo pakëz, kush po gjëmuaka në qoshen Tënde
Hi do të bëhet kjo kokë, po nuk erdhe për të më ndihmuar*

*Më ndihmo tani në këtë çast me dorën Tënde të bekuar
Që varka e Islamit t'ia dalë kësaj furtune*

*Më tolero mangësitë dhe dobësitë
Që të mos gëzohet armiku i mallkuar i besimit*

*Vër melhem në plagët e mia se jam i dërrmuar
Dëgjomi klithmat se nga të qarët jam i brengosur*

*Nuk mund të shoh kurrsesi dobësinë e fesë së Muhammedit
O Sunduesi im, jepmë sukses dhe ngadhënjim*

*A do të më varrosësh pa ma plotësuar dëshirën?
Nuk e pres këtë prej Teje, o Pronari im*

*Bekoje Islamin, o Zoti im, shpëtoje atë
Dëgjoje klithmën e robërve të kësaj varke të thyer*

609. "Durr-e-themin" urdu, f. 146-149.

*Gjithë populli është i zhytur në mëkate e pandershmëri
Po përhapet re e pashpresë dhe një natë tej në errësi*

*Një botë e tërë ka vdekur pa ujin Tënd të bekuar
Tash, drejtoje lumin në këtë kah, o Miku im!*

*Nuk kemi më mend në këto trazira, shpëtona
Mëshiroji robërit e Tu, që ata të drejtohen*

*Si t'ia bëjmë e nga t'ia nisim, nuk i gjendet dermani
Gjëmat po bien gjithkund e gjithkah pafundësisht*

*Ja, po fundoset kjo varkë, të lutem eja, o Kapiteni im!
I paska ardhur vjeshta këtij populli pranveror!*

*Si të vaditet ky kopsht pa Ty, o Zot?!
Janë djegur bimët e takvasë, besimi mbeti në varr*

*Vetëm me dorën Tënde, o Miku im, mund të ndodhë diçka
Përndryshe anarkia po marshon, me shpejtësi, me furi.*

*Tash, më shfaq ndonjë shenjë, se feja mbeti pa shenjë
Shiko drejt nesh, që ne të shohim pak pranverë.⁶¹⁰*

610. "Durr-e-themin" urdu, f. 128-129.

اولاد کے حق میں دعائیں

کر ان کی خود حفاظت ہو ان پر تیری رحمت
 یہ روزِ کرمبارک سُبْحَانَ مَنْ يَوَّابِنِ
 رتبہ میں ہوں یہ برتر اور بخش تاج و افسر
 یہ روزِ کرمبارک سُبْحَانَ مَنْ يَوَّابِنِ
 میں جاؤں تیرے واری کر تو مدد ہماری
 یہ روزِ کرمبارک سُبْحَانَ مَنْ يَوَّابِنِ
 دے اس کو عمر و دولت کر دور ہر اندھیرا
 یہ روزِ کرمبارک سُبْحَانَ مَنْ يَوَّابِنِ
 تیرا بشیر احمد تیرا شریف اصغر
 یہ روزِ کرمبارک سُبْحَانَ مَنْ يَوَّابِنِ
 یہ روزِ کرمبارک سُبْحَانَ مَنْ يَوَّابِنِ
 کر ان کے نام روشن جیسے کہ ہیں ستارے
 یہ روزِ کرمبارک سُبْحَانَ مَنْ يَوَّابِنِ
 کر ایسی مہربانی ان کا نہ ہووے ثانی
 یہ روزِ کرمبارک سُبْحَانَ مَنْ يَوَّابِنِ
 رحمت سے ان کو رکھنا میں تیرے منہ کے واری
 یہ روزِ کرمبارک سُبْحَانَ مَنْ يَوَّابِنِ
 میری دعائیں سن لے اور عرض چاکرانا
 یہ روزِ کرمبارک سُبْحَانَ مَنْ يَوَّابِنِ
 ہر رنج سے بچانا دکھ درد سے چھڑانا
 یہ روزِ کرمبارک سُبْحَانَ مَنْ يَوَّابِنِ
 یہ ہادی جہاں ہوں یہ ہوویں نور یکسر
 یہ روزِ کرمبارک سُبْحَانَ مَنْ يَوَّابِنِ
 حق پر نثار ہوویں مولیٰ کے یار ہوویں
 یہ روزِ کرمبارک سُبْحَانَ مَنْ يَوَّابِنِ

کر ان کو نیک قسمت دے ان کو دین و دولت
 دے رشد اور ہدایت اور عمر اور عزت
 اے میرے بندہ پرور کر ان کو نیک اختر
 تو ہے ہمارا رہبر تیرا نہیں ہے ہمسر
 میری دعائیں ساری کریو قبول باری
 ہم تیرے درپے آئے لیکر امید بھاری
 لخت جگر ہے میرا محمود بندہ تیرا
 دن ہوں مرادوں والے پڑ نور ہو سویرا
 اس کے ہیں دو برادر ان کو بھی رکھو خوشتر
 کر فضل سب پہ یکسر، رحمت سے کر معطر
 چنگے رہیں ہمیشہ کریو نہ ان کو مندے
 اے میرے دل کے پیارے اے مہرباں ہمارے
 یہ فضل کر کہ ہوویں نیکو گھر یہ سارے
 اے میری جاں کے جانی اے شاہ دو جہانی
 دے بخت جاودانی اور فیض آسمانی
 سن میرے پیارے باری میری دعائیں ساری
 اپنی پناہ میں رکھو سکر یہ میری زاری
 اے واحد و یگانہ اے خالق زمانہ
 تیرے سپرد تینوں دیں کے قمر بنانا
 اقبال کو بڑھانا اب فضل لے کے آنا
 خود میرے کام کرنا یارب نہ آزمانا
 یہ تینوں تیرے چاکر ہوویں جہاں کے رہبر
 یہ مرجع شہاں ہوں یہ ہوویں مہر انور
 اہل وقار ہوویں فخر دیار ہوویں
 بابرگ و بار ہوویں اک سے ہزار ہوویں

Lutje për të ardhmen e fëmijëve

*Bëji të ndritshëm fëmijët e mi, jepu besim e pasuri
Vetë mbroji! Vetë mëshiroji!*

*Jepu udhëzim, jetë dhe nder!
Bëje të bekuar këtë ditë! I Shenjtë je që më shikon*

*O Mirëbërësi im! Bëji ata me fat të mbarë
me pozitë të lartë, jepu edhe kurorë e përgjegjësi*

*Ti je Prijësi ynë, askush nuk është i barabartë me Ty
Bëje të bekuar këtë ditë! I Shenjtë je Ti që më shikon*

*Pranoji lutjet e mia që të gjitha, o Zot
U flijofsha për Ty, na ndihmo*

*Kemi ardhur te pragu Yt me shpresë të madhe
Bëje të bekuar këtë ditë! I Shenjtë je Ti që më shikon*

*Mahmudi është zemra ime, është edhe rob Yti
Jepi jetë e pasuri, largo çdo errësi të prej tij*

*Çdo ditë i qoftë shpresëdhënëse, çdo agim i ndritur
Bëje të bekuar këtë ditë! I Shenjtë je Ti që më shikon*

*Ai ka dy vëllezër të tjerë, gëzoji edhe ata
Beshir Ahmedi Yt dhe Sherfi Yt i vockël*

*Bekoji që të gjithë, spërkati me mëshirë
Bëje të bekuar këtë ditë! I Shenjtë je Ti që më shikon*

*Gjithmonë qofshin të mirë e kurrë mos u bëfshin të ligj
Bëje të bekuar këtë ditë! I Shenjtë je Ti që më shikon*

*O i Dashuri i zemrës sime, o Mirëbërësi ynë
Bëji ata të shquar, sikur të jenë yje*

*Me bekimin Tënd, mbaji të pastër, sikur të jenë diamante
Bëje të bekuar këtë ditë! I Shenjtë je Ti që më shikon*

*O Shpirti i shpirtit tim, o Mbreti i dy botëve
Mëshiroji, që ata të jenë të pashembullt*

*Jepu fat të përhershëm dhe bekim qiellor
Bëje të bekuar këtë ditë! I Shenjtë je Ti që më shikon*

*O Udhëzuesi im i Dashur, dëgjomi të gjitha lutjet
Mbaji nën mëshirën Tënde, për Ty u flijofsha unë*

*Mbaji në strehën Tënde, ky është përgjërimi im
Bëje të bekuar këtë ditë! I Shenjtë je Ti që më shikon*

*O Zot i Vetëm! O Krijues i botës!
Pranomi të gjitha lutjet, të gjitha përgjërimet*

*Të tre Ty t'i kam dorëzuar, si hëna u ndriçofshin për fenë
Bëje të bekuar këtë ditë! I Shenjtë je Ti që më shikon*

*Rritua nderin, jepua bekimin
Shpëtoji nga brenga, liroji nga vuajtjet*

*Kryeji punët e mia, mos na sprovo, o Zot
Bëje të bekuar këtë ditë! I Shenjtë je Ti që më shikon*

*Që të tre shërbëtorët e Tu, u bëfshin prijësit e botës
U bëfshin udhëzuesit e botës, u ndriçofshin nga drita Jote*

*Epiqendër e mbretërve qofshin, të ndritur si hëna e plotë
Bëje të bekuar këtë ditë! I Shenjtë je Ti që më shikon*

*U bëfshin dinjitozë, krenari e botëve
Flijues për të vërtetën, të dashurit e Zotit*

*U bëfshin të blertë e të lulëzuar, një mijë prej njërit
Bëje të bekuar këtë ditë! I Shenjtë je Ti që më shikon⁶¹¹*

.....

*Kam një lutje, O Udhëheqësi im
Te pragu Yt po qaj me përgjërim*

*Dhuromë çfarë kjo zemër bren
kam turp e marre, me gjuhë së them*

*Evlatin tim që është dhuratë nga Ti
Unë t'i shoh të dëlirë, gjithsecilin*

*Çfarë pengese mund të ketë e Jotja Madhështi
Atë që ma dhe mua, ta ketë secili⁶¹²*

*Bamirës i çuditshëm je, o Oqeani plot bekime
I Shenjtë je Ti, që poshtërove armiqtë e mi*

*Ata nga papastërtia liroji
robërit e Tu të përsosur bëji*

*Të jenë të ngazëllyer e bekimplotë
nga jeta gjynahqare shpëtoji, o Zot*

*Lajmëtarë të fesë si unë të jenë
I Shenjtë je Ti, që poshtërove armiqtë e mi*

*Fatbardhësia iu shfaqte në ballë
shpëtoji të tyre as mos u afroftë Dexhall*

*Shpëtoji nga çdo pikëllim në çdo situatë
të mos hutohen nga brengat e as nga vështirësitë*

611. "Durr-e-themin" urdu, f. 36-38.

612. "Durr-e-themin" urdu, f. 47.

*Kështu shpreson zemra ime nga Ti
I Shenjtë je Ti, që poshtërove armiqtë e mi*

*Ty, o i Dashuri im, të përgjerohem
në asnjë kohë ata të mos brengosen*

*Pragun Tënd të mos e lëshojnë kurrsesi
përkrahi ata në çdo çast, O Miku im*

*O Udhëheqësi im, kështu shpresoj nga Ti
I Shenjtë je Ti, që poshtërove armiqtë e mi*

*Ata të mos shohin kurrë mjerim
Kohën e vështirësive, vuajtjeve e as dëshpërim*

*E unë të shoh takvanë e gjithsecilit
Kur të më vijë koha e largimit*

*Vetë ma dhe myzhdenë paraprakisht
I Shenjtë je Ti, që poshtërove armiqtë e mi*

*O Zot, bekimet e Tua i kujtoj
Më dhe edhe myzhdetë, më pas edhe pasardhësit*

*E më the: “Kurrë nuk do të shkatërrohen;
sikur të jenë pisha, në kopshte do të lulëzohen”*

*Shumë herë më ke dhënë këtë lajm Ti
I Shenjtë je Ti, që poshtërove armiqtë e mi⁶¹³*

613. “Durr-e-themin” urdu, f. 47-49.

ایک پرانی جامع منظوم دعا (فارسی)

صنعتش مهرماه وافلاک است
زنده کن دین خویش دیگر بار
باز بر ما نظر کن از رحمت
گس کفر از جہاں زائل کن
راحتے بخش از سگ و مردار
جان من از بلاء غم برہان
ہست بخشائشت بروں از حد
بردو عالم توئی خدائے یگان
تو وحیدی و پاک و فرد قدیم
کمرن بہ بندورہ بکشائے
سرمن خاک کوئے پاکاں کن
ہمہ کارم بوجہ احسن کن
کہ نماند تصرف شیطان
گم کن از خویش و ہستی کن
کہ دے ناید قرار ازراں
سینہ ام پر گن از خاطر نور
کہ نماند زمن نہ شاخ و بن
مست و مجذوب خود بگردانم
آنگہ بے تو زبان و گوش نیست

آن خداوند برتر و پاک است
ہرہ و کوچہ پرشد از اشرار
باز بنما بدین خوش شوکت
باز احیائے دین احمد کن
کافر و کفر از جہاں بردار
اے خداوند قادر و منان
تو غفوری و اکبر و امجد
کس شریک تو نیست در دو جہاں
تو بزرگ و شان تست عظیم
اے خدا ہمتم بدین افزائی
دل من رشک درد ناکاں کن
دیدہ من بصدق روشن کن
از وجود خودم بر آرام چناں
ہم بنیاد خود پرستی کن
کشے دہ بوئے خودرا نشان
دل من پاک کن زکبر و غرور
آں چنانم اسیر عشق خود بکن
شور مجنون بریز در جانم
آنگہ یکدم بجز تو ہوش نیست

آن بگردان مراکے چیزے نیست
آنکہ اور اخلق کار نماند
دایم الحبس شد دران چاہے
سیم وزرکن حقیر در نظر
آنچنان بخش عقل حق جویم
شور عشقت بریز درجام
ہمہ مدح و ثنائے تو خواہم
تا مرا دل بہ تو حمد تو پیوست

قدر او نزد اور پیشیزے نیست
باز کارش بروزگار نماند
کہ نیائید ازو بروں گاہے
فقرکن مطلب بزرگ ترم
کہ براہش بچشم و سرپویم
مست و مجذوب ہم بگردانم
ہرچہ خواہم برائے تو خواہم
از ہمہ کاروبار ہا بگست

(سیرت حضرت مسیح موعود از شیخ یعقوب علی صاحب عرفانی جلد پنجم صفحہ ۵۳۵ تا ۵۳۷)

Një lutje e hershme në gjuhën perse

*Zoti është i Madh dhe i Shenjtë
Që krijoi diellin, hënën dhe qiejt*

*Çdo rrugë, çdo qoshe është plot me sherrxhinj
Vetë jepi jetë fesë Sate, o Zot!*

*Edhe një herë zbulo madhësitinë e fesë Sate
Edhe një herë hidhi shikim të mëshirshëm*

*Edhe një herë gjallëro fenë e Ahmedit
Largoje mizën mohuese nga kjo botë*

*Asgjëso mohuesin dhe mohimin nga kjo botë
Qetësoje botën duke larguar qenin dhe ngordhësirën*

*O Zot i Plotfuqishëm dhe Mirëbërës
Qetësoje shpirtin tim nga brenga për besimin*

*Falës je, i Madh dhe i Shenjtë je
Falja Jote nuk njeh kufi*

*Nuk ka asnjë të barabartë me Ty në të dyja botët
Vetëm Ti je i Vetëm dhe i Pashoq*

*I Urtë je, madhështia Jote është e paarritshme
Je i Vetëm, i Shenjtë dhe i Përjetshëm*

*Më jep kurajën, o Zot, për përparimin e fesë
Ma shtrëngo rripin dhe më udhëzo!*

*Edhe zemrat më të dhimbsura ta kenë lakmi zemrën time
Koka ime të jetë pluhuri i qoshes së njerëzve të dëlirë*

*Mbushmi sytë me dritën e vërtetësisë
Zbukuromi të gjitha punët e mia*

*Më ndaj nga nefsi im në atë mënyrë
Që djalli kurrë të mos ketë kontroll mbi mua*

*Shkatërro themelet e vetadhurimit nga unë
Zhduk qenien time dhe jepmë jetë në Qenien Tëndë*

*Dhuromë një tërheqje të tillë, që ajo vetë të kërkojë shenjën e aromës Sate
E më pas, për as një çast unë të mos mund të jetoj pa të.*

*Ma pastro zemrën nga krenaria e mburrja
Ma ndriço gjoksin me dritën Tëndë*

*Lidhmë me prangat e dashurisë Sate
Që vetëm Ti të jesh edhe rrënjë, edhe degë për mua*

*Shpirti im të gjëmojë si i çmendur për Ty
Unë të jepem e tërhiqem vetëm pas Teje*

*As për një çast të mos gjej qetësi pa Ty
Pa Ty edhe gjuha e veshët e mi të pushojnë së punuari*

*Pa Ty, asgjë të mos ketë vlerë për mua
Vlera dhe kimeti i saj të jetë asgjë për mua*

*Po, më bëj ashtu që të mos kem asnjë lidhje as me këtë epokë, as me
këtë botë*

*Të jem i prangosur përgjithmonë në dashurinë Tënde
E të mos gjej më lirim nga ajo*

*Ari dhe argjendi të jenë të pavlerë për mua
Synimi im i shenjtë të jetë vuajtje për Ty*

*Jepmë mendje të drejtë
Që të vij i përulur në rrugën Tënde*

*Spërkat kripën e dashurisë mbi shpirtin tim
Që unë të kënaqem e të jepem pas Teje*

*Lavdërimi Yt të jetë kulmi i dëshirave të mia
Shkurt, çdo dëshirë e imja të jetë me pëlqimin Tënd*

*Zemra ime që kur u lidh me Ty e me dashurinë ndaj Teje
Ka hequr dorë nga çdo punë e tregti e kësaj bote!⁶¹⁴*

614. Sheikh Jakub Ali Irfani “Siret Hazret Mesih Maud^{as}”, vëll. 5, f. 535-537.

بخشش اور محبت الہی کی دعا

اے خداوند من گناہم بخش سونے درگاہ نویلش راہم بخش
روشنی بخش دردل و جانم پاک کن از گناہ پنہانم
دلستانی دلربائی کن بہ نگاہے گرہ کشائی کن
دردو عالم مرا عزیز توئی وآنچہ میخواہم از تو نیز توئی

(برائین احمدیہ و روحانی خزائن جلد اول صفحہ ۱۶)

Lutje për të kërkuar falje dhe dashurinë e Zotit

O Zot im! M'i fal gjynahet
Më udhëzo që të vij drejt Teje

Jepi dritë zemrës dhe shpirtit tim
Pastromë nga gjynahet e mia të fshehta

Ki mëshirë e dashuri ndaj meje
Me shikimin Tënd bamirës zgjidhmë çdo nyjë

Ti je më i Dashuri im në të dyja botët
Ty të kërkoj Vetën Tëndë!⁶¹⁵

615. "Berahin-e-Ahmedia", "Ruhani Khezain" vëll. 1, f. 16.

امتیاز حق و باطل کے لئے ایک فیصلہ کن دعا

اے رحیم و مہربان و رہنما
ایکے از تو نیست چیزے مستتر
گر تو دیدستی کہ ہستم بدگہر
شاد گن این زمرہ اغیار را
ہر مرادشاں بفضل خود برآر
دشمنم باش و تبه کن کارمن
قبلہ من آستانت یافتی
کز جہاں آں راز را پوشیدہ
اندکے افشائے آں اسرار کن
واقعی از سوز ہر سوزندہ
زاں محبت ہاکہ دردل کاشتم
اے تو کہف و ملجأ و مادائے من
وز دم آں غیر خود را سوختی
وین شب تارم مبدل کن بروز
اے شدیدہ لطش ہنما زور را
یک گلے از بوستان خود نما
غافلان را نیست وقت موت یاد
بچو طفلان مائل افسانہ اند
روئے دلہا تافتہ از کوئے دوست
از کرہا آفتابے را برابر

اے قدیر و خالق ارض و سما
اے کہ میداری تو بر دلہا نظر
گرتوے بینی مرا پُر فسق و شر
پارہ پارہ کن من بدکار را
بردل شاں ابررحمت با ببار
آتش افشاں بردر و دیوار من
ورما از بندگانت یافتی
دردل من آں محبت دیدہ
با من از روئے محبت کارکن
ایکے آئی سوئے ہر جوئندہ
زاں تعلق با کہ ہاتو داشتم
خود بروں آ از پئے ابراء من
آتھے کاندردلم افروختی
ہم از اں آتش رخ من برفروز
چشم بکشا این جہان کوررا
زآسماں نور نشان خود نما
این جہاں بنیم پر از فسق و فساد
از حقائق غافل و بیگانہ اند
سرد شد دلہا ز مہر روئے دوست
سیل درجوش است و شب تاریک و تار

Lutje për të kërkuar gjykimin midis së vërtetës dhe gënjeshtërs

O i Plotfuqishëm, Krijues i tokës dhe i qiellit
O i Gjithëmëshirshëm, Mëshirëbërës dhe Udhëheqës

O Miku im që sheh çdo zemër
O Ti që asgjë nuk është e fshehur për Ty

Nëse vëren se jam i mbushur me sherr e ligësi
Nëse më gjen me karakter plot djallëzi

Të ligun si unë shkatërro dhe copëto
Dhe gëzoje grupin e kundërshtarëve nga asgjësimi im

Spërkat shiun e mëshirës mbi zemrat e tyre
Plotëso çdo dëshirë të tyre, në saje të bekimit Tënd

Zjarr dërgo mbi pragun dhe mbi muret e shtëpisë sime
Bëhu armiku im dhe shkatërromë gjithë batakçillëkun tim

Por, nëse më gjen ndër robërit e Tu
Dhe fytyrën time të drejtuar te pragu Yt

Nëse gjen atë dashuri në zemrën time
Të cilën Ti e ke mbajtur të fshehtë nga bota

Sillu me mua ashtu siç sillesh me të dashurit e Tu
Shfaq pak sekretet e dashurisë që ke për mua

Ti Vetë vjen te çdo kërkues
Ti Je i Informuari i dashurisë që bren çdo zemër

Të thërras me lidhjen që kam me Ty
Me dashurinë që kam mbjellë në zemrën time

Vetë më liro nga akuzat e tyre
O Ti që je streha dhe vendkthimi im

*Flaka që Ti ke ndezur në zemrën time
Më ka djegur çdo dashuri përveç Tëndes*

*E tash, ma dritëso fytyrën përmes kësaj flake
Edhe netët e mia të errëta ktheji në dritë të plotë*

*Ndriçoja sytë edhe botës së verbër
O i Fortë në ndëshkim, shfaq fuqinë Tënde*

*Vetë trego shenjë prej qiellit
Vetë na jep për të shijuar fruta nga kopshti Yt*

*Kjo botë po mbushet me sherr e ligësi
Me njerëz aq të shkujdesur, që edhe vdekjen e harrojnë*

*Gjenden larg realitetit dhe indiferentë nga ai
Sikur fëmijët që kënaqen vetëm nga përrallat*

*Zemrat janë bërë të ftohta nga vlera e vërtetë
Kjo ngrirje i ka sprapsur ato nga rruga e drejtë*

*Po vjen një përmbytje e fuqishme dhe një natë tejet e errët
O Mëshirues! Vetë na zbulo diellin Tënd ndriçues!*⁶¹⁶

616. “Durr-e-themin” persisht, f. 178-179.

چند دعائیہ اشعار بزبان عربی

يَا رَبِّ اَيِّدْنَا بِفَضْلِكَ وَانْتَقِمِ
مِمَّنْ يَدْعُ الْحَقَّ كَالْعُشَّاءِ
يَا رَبِّ قَوْمِي غَلَسُوا بِجَهَالَةٍ
فَارْحَمْ وَاَنْزِلْ لَهُمْ بَدَارِضِيَاءِ

يَا رَبَّنَا افْتَحْ بَيْنَنَا بِكَرَامَةٍ
يَا مَنْ يَرَى قَلْبِي وُلْبَّ لِحَائِي
يَا مَنْ ارَى ابْوَابَهُ مَفْتُوحَةً
لِلسَّائِلِينَ فَلَا تَرُدُّ دُعَائِي

يَا رَبِّ صَلِّ عَلَيَّ نَبِيَّكَ دَائِمًا
فِي هَذِهِ الدُّنْيَا وَبَعَثْ ثَانِ

Disa strofa përgjëruese në gjuhën arabe

*O Zoti ynë! Na ndihmo me bekimin Tënd dhe hakmerru
me çdokënd që shpërfill skajshëm të vërtetën*

*O Zoti im! Populli im ka rënë në errësira të paditurisë
Pra, mëshiroje dhe sille atë në shtëpinë e dritës!*⁶¹⁷

*O Zoti ynë! Gjyko me drejtësi midis nesh
O Ti që ma sheh zemrën, të dukshmen e të padukshmen time*

*O Ti që dyert e Tua janë gjithnjë të hapura
për kërkimtarët, prandaj, mos ma refuzo lutjen.*⁶¹⁸

*O Zoti im! Lartësoje Profetin Tënd gjithmonë,
në këtë botë dhe në botën vijuese!*⁶¹⁹

617. "Anxham-e-At'hem", "Ruhani Khezain", vëll. 11, f. 277.

618. "El-istifta zamima Hakikatul-Uehi", "Ruhani Khezain", vëll. 22, f. 735.

619. "Aina kamalat-e-Islam", "Ruhani Khezain", vëll. 5, f. 593.

Shpjegim i termave

| | |
|---------------------|--|
| <i>Ajet</i> | Varg i Kuranit Famëlartë. |
| <i>Amin</i> | Ashtu e bëftë Zoti! (Thuhet pas lutjes.) |
| <i>Arsh</i> | Fron. |
| <i>Bejt</i> | Besëlidhje. |
| <i>Farz</i> | Thuhet edhe fard. Vepër e obligueshme. Për shembull, namaz <i>farz</i> . |
| <i>Hadith</i> | Thënie e Profetit Muhammed ^{sas} |
| <i>Hadith kudsî</i> | Thënie e Zotit të Madhërishëm që tregoi Profeti Muhammed ^{sas} , por që nuk është shkruar në Kuranin Famëlartë. |
| <i>Hazret</i> | Shumë i nderuar. |
| <i>Kalif</i> | Pasardhës. Termi “kalif i Allahu” përdoret për profet. Ndërsa termi “kalif i profetit” përdoret për pasardhësin e profetit që vijon misionin e tij. |
| <i>Nafil</i> | Vepër e mirë vullnetare, jo e detyrueshme. Shpesh thuhet për namazin vullnetar. |
| <i>Namaz</i> | Thuhet edhe <i>salat</i> . Falja në Islam. |
| <i>Ruku</i> | Pozicioni i përkuljes në namaz. |
| <i>Sadaka</i> | Lëmoshë. |
| <i>Sahab</i> | Besimtar i Zotit që ka jetuar me ndonjë Profet. |
| <i>Salavat</i> | Lutjet që i bëjmë Zotit, duke i kërkuar paqe, bekime dhe lartësime profetëve të Tij, sidomos Profetit Muhammed ^{sas} . |
| <i>Sexhde</i> | Pozicioni i përkuljes gjatë namazit, kur falësi vë ballin dhe hundën në tokë në shenjë përulësie të skajshme para Zotit të Madhërishëm. |
| <i>Takva</i> | <i>Takva</i> , në arabisht, do të thotë “drojë prej Zotit”. Ajo gjithashtu nënkupton se një besimtar i vërtetë, duke qenë i devotshëm, gjithmonë i shmanget mospëlqimit të Zotit dhe mundohet ta kënaqë Atë. |
| <i>Tehexhud</i> | <i>Namaz</i> vullnetar që falet gjatë natës, për të cilin besimtari çohet pasi të ketë fjetur një herë. Koha e këtij namazi është nga mesnata deri para namazit të sabahut. |
| <i>Umet</i> | Populli besimtar i një profeti. |

| | |
|----------------------|--|
| <i>Xhemat</i> | Kuptimi leksikor: bashkësi. Grup besimtarësh që ka një udhëheqës. |
| <i>Tesbih</i> | Lartësimi i Zotit. |
| <i>Tahmid</i> | Lavdërimi i Zotit. |
| <i>Tekbir</i> | Madhërimi i Zotit. |
| <i>Shirk</i> | Adhurimi i tjetërkujt në vend të Allahut. Çdo vlerësim që bën njeriu ndaj vetvetes, ndaj dikujt a diçkaje, që në fakt duhet t'i atribuohet Zotit të Madhërishëm. |
| <i>Teshehud</i> | Të thënë e shehadetit në pozicionin e uljes pas dy sexhdeve në rekatën e dytë, të tretë (kur namazi është tre-rekatësh) dhe të katërt. |
| <i>Huzur</i> | Shumë i nderuar. |
| <i>Shehadet</i> | Të dëshmosh se “nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut dhe Muhammedi është rob dhe i dërguar i Allahut”. |
| <i>Xhelsa Salana</i> | Mbledhje vjetore që organizohet në Xhematin Musliman Ahmedia në rangun kombëtar. |
| <i>Dexhall</i> | Kuptimi leksikor: “mashtrues i madh”. |
| <i>Salat</i> | Shih: <i>namaz</i> . |

Shkurtesat

- s.a.s. *Selallahu alejhiveselam* (Paqja e bekimi i Allahut qofshin mbi të!), shkruhet e lexohet kur përmendet emri i Hazret Profetit Muhammed^{sas}.
- a.s. *Alejhiselam* (Paqja qoftë mbi të!), shkruhet e lexohet kur përmendet emri i ndonjë profeti të Allahut.
- r.a. *RadijAllahu anhu/anha/anhum* (Allahu qoftë i kënaqur me të/ta!), shkruhet e lexohet kur përmendet emri i ndonjë sahabi a sahabeje të ndonjë profeti.

Adresat

Shqipëri

Rr. "Pavarësia"
Mëzez, Tiranë
Kutia postare 8176
darulfalah@gmail.com

+355 672168054
+355 662974992
+355 695876901

Kosovë

Rr. "Holger Pedersen"
Lagjja e Spitalit,
Prishtinë
amj.kosovo@gmail.com

+377 44817813
+381 38558436
Fax: +381 38512408

www.alislam.al

Me sa shumë ëndrra e dashuri i rritin dhe i edukojnë prindërit fëmijët e tyre. Që në vegjëli u mësojnë gjuhën. I mësojnë të thonë: nënë e babë. I mësojnë të kërkojnë ujë, qumësht, bukë. E kur fëmija mëson të shprehet dhe fillon t'u kërkojë prindërve duke belbëzuar, sa shumë gëzohen ata dhe me çfarë kënaqësie ia plotësojnë dëshirën! Me reflekset e tyre, fëmijët e vegjël e të pafajshëm të bëjnë për vete aq fort, saqë tregoheshi i gatshëm t'u japësh gjithçka që të kërkojnë. Por edhe kërkesat e fëmijëve zakonisht nuk kanë ndonjë peshë për sa i përket vlerës materiale, ashtu siç as prindërit ose kushdo qoftë dhënësi, nuk kanë mundësinë që t'ua përmbushin çdo dëshirë.

Edhe Zoti ynë Bujar që na do shumë, më shumë sesa prindërit tanë, Vetë na ka mësuar metodat e të kërkuarit duke thënë: **“Lypni prej Meje, Unë do t’ju jap”**. Ai na ka mësuar edhe fjalët përgjëruese, që na tregojnë se me çfarë dashurie e përlulësie duhet të shtrijmë duart para Tij. E gjithë kjo a nuk është vallë, sepse Ai dëshiron të na bekojë e begatojë?! Pa dyshim, këto janë pretekstet e Tij vetëm për të na plotësuar kërkesat..

Në librin që keni në dorë, janë përmbledhur (1) të gjitha lutjet e Kuranit Famëlartë, që janë mbi 90, (2) mbi 250 lutje dhe përgjërime tejet emocionuese të Profetit Muhammed^{as} dhe, gjithashtu, (3) lutjet e themeluesit të Xhematit Musliman Ahmedia, Hzret Mirza Ghulam Ahmed^{as}.

www.alislam.al



ISBN 1-84480-258-2



9 781848 802582

This is the Albanian translation of the book *“Khazeenatud-Dua”*
(Treasure of prayers).